



Muhammed Xhevàd Mugnìjeh

FIKHU I IMAM

XHA'FERR SADIKUT

(Paqja goftë mbi të!)

VII

Titulli: Fikhu i Imam Xha`ferr Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) **VII**

Autori: Muhamed Xhevàd Mugnijeh

Përktheu: H. Selim Stafa (*Allahu e mëshiroftë!*)

Recensent: H. Vullnet Merja

Redaktoi: Jerida Kulla

Perkujdesja garfike: Sabrie Feza

Kapaku: Sabrie Feza

Botoi: Shoqata FLLADI

بسم الله الرحمن الرحيم

KREDIA DHE BORXHI

Ndryshimi mes kredisë dhe borxhit

Borxhi dhe kredia kanë të përbashkët përfitimin që vjen prej tyre. Ky përfitim bëhet i mundur duke i konsumuar ato. Njëkohësisht kredia dhe borxhi janë një e drejtë e vërtetuar me garanci. Dallimi mes kredisë e borxhit është se te kreditimi, sendi i kredituar shlyhet me një të ngjashëm në lloj e në cilësi, për shembull, kur ti merr kredi para, ato janë të ruajtura në garantimin tënd për kredidhënësin, të cilit duhet t'i kthesh para të njëjta. Gjithashtu, edhe nëse ke marrë kredi ushqim, pije, etj, bazuar mbi sa u shpjegua, themi se kthimi i kredisë reduktohet me të ngjashme dhe jo me të vlerësuara.

Edhe garantimi i borxhit vërtetohet me njërin prej shkaqeve që e kanë detyruar marrjen e borxhit, si kredia, shitja, qeraja, martesë, zgjidhje kundrejt pagesës, çështje penale, shpenzime, transferime parash e pronësie, etj. Bazuar mbi këtë shpjegim, shihet se borxhi është më përfshirës se kredia. Borxhi shlyhet me

të ngjashmin e marrë ose me vlerën e tij, nëse është gjë që vlerësohet.

Borxhdhënësi është pronari i borxhit, kurse borxhmarrësi, nga vetë fjala, kuptohet se ka detyrimin ta shlyejë borxhin e marrë prej tij. Në terminologjinë e sheriatit islam ndeshemi edhe me fjalën arabe “garijm”, që do të thotë detyrim për të paguar për diçka që nuk e ke detyrim. Kjo fjalë përfshin borxhdhënësin dhe borxhmarrësin dhe përcaktimi bëhet vetëm me anë të krahasimit se cili është i detyruari.

Borxhi është i urryer

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Njeriu nuk kërkon kredi mbi shpinën e tij veçse kur ku ka besë se do ta shlyejë, qoftë edhe duke trokitur nëpër portat e njerëzve për të lypur, pavarësisht se ata mund ta kthejnë vetëm me një apo dy copa të vogla bukë, me një kokërr ose me dy kokrra hurma. Por edhe për këto, ai duhet të ketë një ndihmues, i cili garanton shlyerjen e borxhit pas tij.”

Këtë transmetim fukahatë e kanë mbartur në borxhin si veprim të urryer, me përjashtim të rasteve kur marrja e borxhit është domosdoshmëri, ose borxhmarrësi ka pasuri që do të kthehen te ai, prandaj ai është në gjendje ta mbajë besën për shlyerjen e borxhit, ose ai ka një mik e një ndihmës që e merr përsipër borxhin e tij. Në qoftë se nuk ka asnjë nga këto që u thanë, është më e pëlqyer që ai të pranojë sadakanë, madje duhet ta përballojë marrjen e sadakasë dhe të mos marrë borxh, nga frika

se nuk do të jetë në gjendje të shlyejë të drejtat që u takojnë njerëzve dhe nuk do jetë shkak që atyre të mos i humbë pasuria.

Disa fukahave kanë thënë se është haram marrja e kredisë, kur është e pamundur mbajtja e besës për shlyerjen e saj. Këtë thënie të fukahave autori i librit “El Xheuahir” e gjen në kundërshtim me fjalët e teksteve dhe me sentencat e fukahave, të cilët e kanë lejuar marrjen e borxhit edhe në rast se borxhmarrësi e kredimarrësi nuk kanë pasuri të ngjashme dhe nuk kanë fuqi ta mbajnë besën për shlyerjen e borxhit.

Nijeti i shlyerjes

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që kërkon borxh dhe nuk ka qëllim ta shlyejë borxhin e marrë, është në pozitën e vjedhësit, kurse ai që ka borxh dhe ka qëllim ta shlyejë borxhin e marrë, së bashku me të, prej Allahut janë dy ruajtës që e ndihmojnë atë të kryejë amanetin që ka për të kryer. (Borxhi është amanet.) Në qoftë se nijeti për të shlyer borxhin pakësohet, për borxhmarrësin pakësohet edhe ndihma, në atë masë sa është pakësuar nijeti i tij.”

Bazuar mbi këtë transmetim, fukahatë kanë dhënë fetvanë dhe kanë thënë: “Meqenëse mbajtja e besës është detyrim, patjetër që është detyrim edhe vendosmëria për plotësimin e besës.

Shpërblimi për borxhdhënësin

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Të jap një borxh, për mua është më e dashur se sa atë shumë e jap sadaka.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon: “I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: “Ai që i jep borxh një besimtari dhe e pret atë, derisa ai të jetë në gjendje të mirë, pasuria e tij është zekat dhe ai vetë është në lutjen e engjëjve, derisa atij t’i kthehet borxhi.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në derën e Xhenetit, sadakaja është shkruar me dhjetë fish, kurse borxhi është shkruar me tetëmbëdhjetë fish.”

Në të vërtetë, borxhi është bërë me më shumë mirësi se sadakaja, sepse borxhin burri e kërkon vetëm për ndonjë nevojë, ndërsa sadekanë mund ta kërkojë edhe pa pasur nevojë për sadakanë.

Dëshmori i Dytë (Shehijdu Thanij) ka shtuar mbi këtë: “Dirhemi i dhënë borxh rikthehet te i zoti dhe ai e jep atë borxh për herë të dytë, kështu që përfitojnë njerëzit, kurse dirhemi i dhënë sadaka nuk rikthehet te i zoti, kështu që dobia prej atij dirhemi ndërpritet.

Shkrimi i borxhit

Allahu i Lartësuar thotë:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا تَدَايَنْتُمْ بِدَيْنٍ إِلَى أَجَلٍ مُّسَمًّى فَاكْتُبُوهُ”

“O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetri për një afat të caktuar, bëjeni me shkrim...” (Sure “El Bekare”, ajeti 282)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Atij që i humb e drejta pa ndonjë dokument, nuk shpërblehet.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk pranohet lutja e atij që ka pasuri dhe që e jep atë hua pa ndonjë dokument. Allahu, i Plotpushtetshëm i thotë atij: “A nuk të urdhërova ty për dëshmitarë?”

Fukahatë e kanë mbartur kuptimin e këtij ajeti të Kur’anit dhe transmetimin për shkrimin e borxhit në veprim mustehab dhe jo në veprim farz, madje shumica e njerëzve, në mënyrë absolute, nuk janë të përkushtuar për zbatimin e dispozitës për dhënien dhe marrjen e borxhit me shkrim.

Kontrata

Borxhi është prej kontratave, të cilat kanë nevojë për ofertën, nga ana e borxhdhënësit dhe për pranimin nga ana e borxhmarrësit. Oferta dhe pranimi për borxhin bëhet realitet edhe me çdo fjalë ose punë që tregon ofertën dhe pranimin.¹

¹ Për kontratën ka dy kuptime: i veçantë, që është oferta dhe pranimi me fjalë dhe i përgjithshëm, që është çdo veprim që tregon përputhjen e dy vullneteve për një gjë të vetme, qoftë edhe kur treguesi është fjalë ose punë. Në shumicën e rasteve, në këtë libër, fjalën kontratë ne e përdorim në kuptimin e përgjithshëm dhe në jo në kuptimin e veçantë.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në fakt, në të (te borxhi) ka hyrë marrëdhënia e dyanshme, në këtë kuptim kontrata e borxhit ka më përparësi se kontrata e shitjes dhe ecja në rrugën e borxhit është më e plotë.”

Fukahatë më të dëgjuar kanë mbështetur dëshminë e autorit të librit “El-Xhevahir” dhe të autorit të librit “Miftahul-Kerameh” dhe janë shprehur se pronësia realizohet me kontratë dhe me marrjen në dorë të sendit të vënë në shitje dhe nuk qëndron te veprimi. Disa fukaha të tjerë kanë thënë: “Jo, realizohet vetëm krahas veprimit.”

Kjo fjalë ka ardhur se veprimi është një kusht i shtuar, pasi origjina për borxhin kërkon mosveprimin, kurse për pronën lejohet veprimi. Atëherë cili është shkaku për këtë?

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Sikur të mos ishte fjala e përbashkët e fukahave, fjala do të ishte e orientuar në arritjen e pronësisë vetëm me shkrimin e kontratës, pa qenë nevoja për marrjen në dorë të sendit, ashtu siç veprohet për kontratat e tjera, por kuptimi i borxhit nuk realizohet pa marrjen në dorë.”

Pyetje: A është borxhi prej kontratave të lejuara, në atë mënyrë që borxhdhënësit i lejohet të kërkojë sendin e dhënë dhe ta marrë atë prej dorës së borxhmarrësit para se ai të veprojë me të? Përgjigjja për këtë pyetje kërkon disa sqarime, të cilat do t'i rendisim më poshtë:

1- Borxhdhënësi kthen pas kontratës dhe para marrjes në dorë. S'ka dyshim që ai ka të drejtë të heqë dorë e të kthejë, sepse për borxhin sendi merret në pronësi vetëm me marrjen e atij sendi

ne dorë dhe borxhmarrësi mund ta marrë në dorë sendin vetëm me lejen e borxhdhënësit. Vetëm në këtë mënyrë është e lejuar kontrata e borxhit.

2- Borxhdhënësi mund të bëjë përpjekje që ta kthejë pas kontratës dhe pas marrjes në dorë, por para veprimt me borxhin. Shumica e fukahave të dëgjuar kanë shkuar te fjala e autorit të librit “El Xheuahir”, i cili thotë:

(Ku mbarojnë fjalët e autorit?) “Borxhdhënësi nuk ka të drejtë për këtë, sepse borxhmarrësi e vuri në zotërim sendin me anë të marrjes në dorë dhe tani ka detyrim ta kthejë borxhin nën kujdesin e tij me një të ngjashëm me sendin e marrë dhe, si origjinë është mosdalja e këtij sendi prej pasurisë së tij.

Nga ky këndvështrim, kontrata është obligim nga ana e borxhdhënësit dhe e lejuar nga ana e borxhmarrësit, domethënë se borxhmarrësit i lejohet t’ia kthejë sendin e marrë të zotit, para se ai të veprojë me atë send. Gjithashtu, borxhdhënësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë dhe të mos e pranojë atë send.

3- Borxhdhënësi ka të drejtë të kërkojë një zëvendësues të sendit, pasi borxhmarrësi ka vepruar me sendin e marrë, kur vonesa nuk është vënë kusht në kontratë. Vetëkuptohet se borxhdhënësi ka të drejtën e plotë të kërkojë zëvendësues, kur të dëshirojë, përderisa e drejta e tij është vërtetuar se është në ruajtjen e borxhmarrësit.

Gjithashtu, edhe borxhmarrësi ka të drejtë të paguajë zëvendësues, kur të dojë. Nga këtu rezulton se kontrata është e lejuar prej të dyja palëve. Në analogji me zëvendësimin e sendit,

nuk është detyrim as dashamirësia, as pritja për pagimin e borxhit e as kërkimi i borxhit.

4- Vonesa në afat të jetë kusht në kontratë, por, pasi borxhmarrësi vepron me borxhin e marrë, borxhdhënësi ka të drejtë të kërkojë prej tij zëvendësuesin. Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se kushti i vonimit nuk është i detyrueshëm, prandaj borxhdhënësi ka të drejtë të kërkojë prej borxhmarrësit kthimin e borxhit para mbarimit të afatit, sepse ky kusht te fukahatë më të dëgjuar, është thjesht premtim, prandaj mbajtja e besës për këtë premtim nuk është detyrim, sepse borxhdhënësi është bamirës dhe, mbi bamirësit nuk ka detyrime.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në këtë, unë nuk gjej asnjë kundërshtim, kështu e ka pranuar edhe El Kashanij.” Patjetër, kur vihet kusht vonimi në përmbajtjen e kontratës, pritja është detyrim dhe është si ai që ka shitur një send, me kusht që çmimin ta marrë prej blerësit në një kohë të caktuar, do të thotë se vonimi bëhet i detyrueshëm, plotësisht siç është i detyrueshëm edhe zbatimi i kontratës, si për shembull, kur ai shet shtëpinë me kusht që në këtë shtëpi ai të banojë një vit, prandaj në këtë gjendje, banimi i kushtëzuar, është një e drejtë si çmimi.

Ebu Hasen El Asfehanij, në librin “Uesijletu Nexhàt”, thotë: “Madje kushti është obligim dhe pritja është detyrim deri në hyrjen e afatit, edhe kur vonimi nuk është vënë kusht në një kontratë të detyrueshme.”

Ne i mbështesim ata, sipas fjalës së Allahut të Lartësuar: “أوفوا بالعقود” “**...mbani besën për kontratat.**” (Sure “El Maide”, ajeti 1), pasi edhe borxhi është kontratë, prandaj është detyrim mbajtja

e besës për borxhin me të gjitha veprimet që kanë lidhje me borxhin. Njëkohësisht, duke pritur kthimin e borxhit, borxhdhënësi tregon humanizëm. Për këtë çështje kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

”إِذَا تَدَايَيْتُمْ بِدَيْنٍ إِلَى أَجَلٍ مُّسَمًّى فَاكْتُبُوهُ“

“...kur merrni hua prej njëri-tjetri për një afat të caktuar, bëjeni me shkrim...” (Sure “El Bekare”, ajeti 282)

Ajeti i nderuar tregon se afati ka ndikimin e tij. Sikur të lejohej kërkimi i borxhit para mbarimit të afatit, patjetër do të ishte përmendur afati dhe mungesa e afatit në mënyrë të barabartë, por kjo është në kundërshtim me atë që njihet zakonisht te tradita. Përveç kësaj, borxhmarrësi ka rrezikuar të kërkojë borxh me kushtin e vonimit dhe të pritjes, prandaj sikur ne të lejojmë shtrëngimin e borxhmarrësit para afatit të vendosur, në fakt, e detyrojmë atë me diçka që ai nuk do ta merrte përsipër, ndryshe shtrëngimi i borxhmarrësit do të ishte bërje keq atij dhe jo bamirësi.

Në paragrafin tjetër do të shikojmë se borxhdhënësi ka të drejtë të lërë një pjesë të borxhit të dhënë, me qëllim që borxhmarrësi t’i shlyejë atij borxhin para afatit, vetëkuptohet se, sikur pritja të mos jetë e detyrueshme, borxhdhënësi patjetër që nuk kishte përse ta bënte këtë lëshim në pasurinë e tij.

Sikur borxhmarrësi të kërkojë shtyrje afati, pas lidhjes së kontratës dhe pas plotësimit të saj, vonimi nuk është i detyrueshëm. Kjo është e barabartë, qoftë kur borxhi i vërtetuar është kredi, qoftë kur është shumë për kurorë, qoftë kur është çmim për sendin e vënë në shitje, qoftë kur është për ndonjë gjë

tjetër, pasi kushti është fillestar, prandaj nuk është detyrim mbajtja e besës për këtë kusht, sepse borxhmarrësi riskoi të njohë të drejtën e borxhdhënësit për të kërkuar prej tij shlyerjen e borxhit kur ai të dëshirojë.

Si përmbledhje themi: Kontrata e borxhit, me një fjalë të thjeshtë, nuk është as esenciale e as e lejuar, por ajo është e lejuar prej anës së borxhdhënësit e prej anës së borxhmarrësit para marrjes në dorë. Gjithashtu, ajo është e lejuar nga ana e borxhmarrësit, por jo nga ana e borxhdhënësit pas marrjes në dorë dhe para veprimit me borxhin. Ajo është e lejuar prej të dyja anëve, pas veprimit, në raport me afatin e shënuar, pasi te fukahatë më të dëgjuar obligimi nuk është detyrim, kurse te ne është detyrim në analogji me borxhdhënësin.

Shpejtimi i shlyerjes së borxhit duke hequr një pjesë të tij

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka për të marrë borxhin dikujt dhe i thotë borxhmarrësit para se të përfundojë afati: “Më shlyej më shpejt gjysmën e së drejtës që më takon dhe unë të lë ty gjysmën tjetër.” A është hallall kjo?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që duhet ta shlyejë borxhin në një afat të caktuar, ndërkaq vjen te ai borxhdhënësi dhe i thotë: “Më shpëto, duke më dhënë kaq ose aq dhe unë heq dorë nga detyrimi që ke për pjesën që mbetet. A janë të drejta fjalët e tij?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nuk shikoj ndonjë problem, pasi, në të vërtetë, ai nuk shtoi gjë mbi kapitalin.”

Në këtë transmetim ka një deklaram se, kur pritja vihet kusht, mbajtja e besës për këtë kusht është detyrim, njëkohësisht transmetimi tregon se borxhdhënësi nuk ka aq pasuri, derisa detyrohet të heqë dorë prej pasurisë së tij, që duhet ta marrë.

Nuk lejohet shtyrja e afatit për shlyerjen e borxhit të marrë me shlyerje të shpejtë, me kusht që të të japë më shumë, sepse shtesa është kamatë, pra, është haram.

Kur borxhmarrësi pranon të shlyejë borxhin e marrë para afatit, me kusht shlyerje të vonuar, ai ka të drejtë të heqë dorë, për shembull, kur ai ble me pagim të vonuar, ose martohet me pagesë të vonuar të shumës së kurorës (mehri muexh'xhel) dhe pastaj blerësi, ose burri e shikon veprim të mirë që të shpejtojë të vonuarën, pas këtij miratimi, afati rrëzohet për të. Me rrëzimin e afatit, ai ka të drejtë të heqë dorë nga miratimi i tij dhe të kthehet përsëri te afati, për pasojë borxhdhënësi s'ka të drejtë të kërkojë borxhin prej borxhamrrësit para afatit të caktuar me pretendimin se kështu ishte miratimi i borxhmarrësit, sepse thjesht miratimi nuk është as kontratë e detyrueshme e as rrjedhojë e një kontrate detyruese, pasi, në të vërtetë, është vetëm premtim dhe me kaq mjafton.

Kushtet

Te borxhi, përveç kontratës dhe marrjes në dorë, kushtëzohen disa punë:¹

1- Borxhdhënësi e borxhmarrësi të ketë aftësinë për të vepruar, të jetë në moshën e pjekurisë dhe të gëzojë shëndet mendor.

2- Borxhdhënësi të jetë pronar, ose i lejuar, ashtu siç është kërkesë në të gjitha veprimet pasurore.

3- Sendi i dhënë borxh pranon dhënien në pronësi dhe marrjen në pronësi, sendit i njihet lloji dhe cilësitë, plotësisht si sendi i vënë në shitje, sepse mospasja dijeni për sendin e bën të pamundur mbajtjen e besës dhe është shkak për konflikt.

Kushti i përfitimit

Më sipër, në pjesën e tretë të këtij vëllimi, libri “Kamata”, trajtuam edhe paragrafin “Prishja e bashkëpunimit të ndërsjellë me kamatë”.

Gjithashtu, në paragrafin “Kamata e kredisë” pamë se borxhi, krahas kushtit të përfitimit, është kamatë haram dhe prishës për bashkëpunim e ndërsjellë, sipas fjalës së të Dërguarit

¹ Kushtet janë në kuptimin e veçantë dhe nuk përfshijnë dy kushtet e kontratës: ofertën dhe pranimin, sepse këto dy kushte janë brenda kushteve, ndërsa këtu kushti është jashtë kontratës. Kushti, në kuptimin e përgjithshëm, përfshin ofertën dhe pranimin. Në studimet tona, në këtë libër, fjalën “kusht” e përdorim në kuptimin e saj të përgjithshëm.

më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Çdo kredi me përfitim, është haram.”

Gjithashtu, më sipër pamë se shtesa dhe përfitimi, dhënë për bamirësi pa ndonjë kusht, është veprim i lejuar, sepse njeriu më i mirë është ai që shlyen më mirë. Këtë mendim ka edhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*).

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Më e fuqishme është thënia për ndalimin e kredisë me kushtin më pak se vlera, ose qeradhënia, ose kontrata të tjera, përveç kontratës së dhurimit e të ngjashme me këtë të fundit, sepse me sentencat e fukahave dhe me tekst, kredia bën që të qarkullojë përfitimi haram.

Zgjatja e kohës, krahas fuqisë për shlyerjen

Zgjatja e kohës, krahas fuqisë për shlyerjen e borxhit, është haram, ashtu siç është haram edhe shtrëngimi i borxhmarrësit, kur ai është në gjendje të ngushtë. Allahu i Lartësuar thotë:

“وَإِنْ كَانَ دُوْ عُسْرَةٌ فَنُظِرَةٌ إِلَىٰ مَيْسَرَةٍ”

“Në qoftë se ai (borxhmarrësi) është në gjendje të vështirë, atëherë priteni derisa ai të jetë në gjendje të mirë...” (Sure “El Bekare”, ajeti 280)

I Dërguari më i madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Është hallall nderi e dënimi i atij që ka pasuri dhe zgjat shlyerjen e borxhit.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ashtu siç është haram për atë që e shtyn shlyerjen e borxhit që ka marrë, edhe pse është në gjendje të mirë, po ashtu është haram edhe për ty që ta shtrëngosh borxhmarrësin, kur ti e di se ai është në gjendje të ngushtë.”

Meqenëse nuk lejohet kerkimi i borxhit, kur borxhmarrësi është në gjendje jo të mirë, akoma më shumë nuk lejohet burgosja e borxhmarrësit, për shkak të moskthimit të borxhit. Fukahatë më të degjuar janë shprehur se të falimentuarit nuk burgosen.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), burgoste për mosshlyerje të borxhit, por, kur mësoi se ai kishte falimentuar dhe se ishte në nevojë, e liroi që ai të mos përfitojë prej pasurisë publike.

Një grua u ankua te Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) kundër burrit të saj, që ishte te Aliu, se ai nuk shpenzonte për të. Midis të tjerash, gruaja tha se bashkëshorti i saj ishte në gjendje të ngushtë, atëherë Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) kundërshtoi ta arrestojë këtë burrë dhe lexoi ajetin e Kur'anit “إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا” - “**Padyshim që pas vështirësisë vjen lehtësimi.**” (Sure “El Inshirah, ajeti 6.)

Forma e mbajtjes së besës

Në mbajtjen e besës çdo gjë kthehet e barabartë me pjesën e me cilësitë e saj, si për shembull, gruri dhe elbi, sepse është vërtetuar se sendi i marrë borxh të kthehet me një të ngjashëm dhe

jo me çmim. Në këtë çështje nuk ka dallim, nëse çmimi i sendit mbetet ashtu siç ishte në kohën e kreditimit, nëse është më shumë, nëse është më i ulët. Natyrisht, kur është vështirë të gjendet një send i ngjashëm si ai, për të mbajtur besën, bëhet detyrim shlyerja me çmimin e tregut të çastit, por jo për kreditimin, sepse, nën kujdestari, kredia mbetet të kthehet me të ngjashme, deri në kohën e plotësimit të afatit për të cilin është dhënë besa dhe vetëm pas kalimit të afatit, kalohet në shlyerjen e borxhit me çmimin e tregut.

Çdo send, pjesët e të cilit pësojnë ndryshim, si për shembull, kafsha, për atë vërtetohet çmimi i tregut në ditën e huamarrjes, domethënë, ditën në të cilën huamarrësi ka marrë në dorëzim sendin e dhënë hua.

Nxitiimi në shlyerjen e borxhit

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se borxhmarrësi ka detyrim të nxitojë shlyerjen e borxheve që ka marrë, plotësisht siç ka detyrë të nxitojë për të siguruar ushqimin e tij dhe të njerëzve që ka në ngarkim, sepse, ai që nuk plotëson detyrimin që ka, detyrimi mbi të mbetet detyrë, të cilën ai duhet ta plotësojë patjetër, domethënë se plotësimi i detyrimit është farz për të.

Mbajtja e besës për një pjesë të borxhit

Kur borxhmarrësi ka qëllim të shlyejë një pjesë të borxhit, a ka të drejtë borxhdhënësi të mos pranojë dhe të thotë: “Nuk pranoj. E dua të gjithë njëherësh!”?

Përgjigje: Borxhdhënësi nuk e ka këtë të drejtë, por merr prej borxhmarrësit atë që ai ka mundësi ta japë. Gjithsesi, borxhdhënësi ka të drejtë të kërkojë pjesën e mbetur, madje edhe nëse borxhin ia ka dhënë borxhmarrësit njëherësh, sepse borxhi nuk është prej sendeve që jepen disa sende me një kontratë të vetme, që do të thotë se te borxhi, pjesa është plotësisht si e tëra, megjithatë, qoftë pjesa që borxhmarrësi jep, qoftë pjesa e mbetur e borxhit, është një e drejtë që duhet të marrë borxhdhënësi dhe nuk ka lidhje ekzistenca e njëres me ekzistencën e tjetrës.

Mbajtja e besës për shlyerjen e borxhit me shumën (dijeti) e marrë për vrasjen

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka kryer një vrasje dhe për rrjedhojë është i detyruar të paguajë shumën për shlyerjen e gjakut. Në rastin tonë, i vrari nuk ka lënë pasuri, ndërkaq familja e të vrarit merr shumën e caktuar për shlyerjen e gjakut. A kanë detyrim ata të shlyejnë borxhin e të vrarit prej shumës që morën për gjakun e tij? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po.”

Të gjithë fukahatë kanë dhënë fetva se nuk ka asnjë dallim mes shumës për shlyerjen e gjakut dhe mallrave të tjerë që ka lënë borxhmarrësi, në atë mënyrë që shlyerja e borxhit të varet prej asaj që i vrari ka lënë. Kjo është e barabartë, qoftë kur shumën për shlyerjen e gjakut merret për vrasje gabimisht, qoftë kur ajo merret për vrasje me qëllim.

Një grup fukahash kanë thënë se, kur borxhmarrësi vritet me qëllim, të afërmit e të vrarit nuk kanë të drejtë të kërkojnë

ekzekutimin e vrasësit pa marrë garanci se i vrari nuk kishte borxh për të shlyer. Në lidhje me këtë çështje ka një transmetim të ardhur prej Ehli Bejtit (*Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta!*).

Shlyerja e borxhit prej Shtëpisë së Pasurisë

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se ai që ka marrë borxh për punë që nuk përbëjnë mëkat dhe e ka të pamundur ta mbajë besën për shlyerjen e borxhit të marrë, borxhet e këtij njeriu shlyhen prej Shtëpisë së pasurisë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që e kërkon këtë furnizim prej hallallit të tij, me qëllim që ta përdorë për vete e për njerëzit që ka në ngarkim, është si luftëtari në rrugën e Allahut. Në qoftë se ai mposhtet, atëherë le të kërkojë borxh prej Allahut e prej të Dërguarit të Tij, aq sa duhet për ushqimin e tij e për njerëzit që ai ka në ngarkim.

Kjo çështje është trajtuar në Kur’anin Fisnik, në ajetin 60 të sures “Et Teube”:

”إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسْكِينِ وَالْعَامِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَفِي الرِّقَابِ وَالْغَارِمِينَ وَفِي سَبِيلِ اللَّهِ
وَابْنِ السَّبِيلِ ۖ فَرِيضَةً مِّنَ اللَّهِ ۖ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ“

“Në të vërtetë, sadakatë janë për të varfrit, për ata që s’kanë asgjë, për mbledhësit e sadakave, për personat që u duhet fituar zemra, për lirimin e robërve, për ata që janë të mbytur në borxhe, për luftëtarët në rrugën e Allahut dhe për atë që ka mbetur në rrugë; detyrim prej Allahut, Allahu është i Gjithëdituri, i Urti.”

Të mbytur në borxhe janë ata që kanë rënë në borxhe dhe i kanë shpenzuar borxhet në bindje të urdhrave të Allahut.

Të veçuarat për shlyerjen e borxhit

Borxhmarrësi ka detyrim të shesë të gjitha sendet që ka në pronësi, me qëllim që ta mbajë besën për shlyerjen e borxheve të tij, më përjashtim të banesës, ushqimin e një dite e një nate për veten e tij e për njerëzit që ka në ngarkim, të rrobave të tij e të njerëzve të tij.

Gjithashtu, për të larë borxhin, ka detyrim të shesë edhe librat shkencorë, në qoftë se është prej atyre që merren me shkencë e me dituri të ndryshme. Në qoftë se borxhmarrësi nuk e bën këtë veprim, atëherë gjykatësi ligjor bën ngurtësimin e pasurisë së tij dhe e shet atë me kushtet që janë përmendur në kapitullin “Ngurtësimi”.

Në lidhje me veçimin e shtëpisë, tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk nxirret burri prej shtëpisë, ku i ka rënë koka, për shkak të borxhit.”

Autori i librit “El Hadaik” ka thënë: “Nuk kam ndeshur në ndonjë tekst që flet për veçimin, me përjashtim të shtëpisë.”

Fjala e mësipërme është më e përhapur dhe mendohet se si argument për këtë veçim është nevoja e madhe që ka njeriu për objektet e lartpërmendura.

Borxhdhënësi nuk dihet ku është

Kur burri merr borxh prej një personi dhe më pas borxhdhënësi nuk dihet ku është, megjithëse borxhmarrësi e ka kërkuar atë aq sa ka pasur mundësi, përveç kësaj ai nuk di që atë e ka parë ndonjë njeri, madje nuk gjen asnjë shenjë të tij, nuk ka dijeni, nëse ai ka ndonjë të prokuruar, ose ndonjë të afërm, ose ndonjë trashëgimtar, në këtë gjendje, borxhmarrësi e ndan sadaka borxhin e marrë prej borxhdhënësit, ashtu siç është dispozita në lidhje me pronarin e panjohur të një sendi, sepse burimi është prej njerëzve të tij dhe të atyre që e miratojnë atë.

Me këtë rast, theksojmë dallimin mes sendit të gjetur përdhe, sendit që nuk i dihet pronari dhe kthimit të asaj që është marrë padrejtësisht.

Sendi i gjetur përdhe është një pasuri e humbur, që nuk i takon askujt. Dispozita për sendin e gjetur përtokë është: Në qoftë se vlera e sendit të gjetur përdhe është më pak se një dirhem, gjetësi ka të drejtë ta marrë në pronësi, pa e bërë të njohur. Në qoftë se vlera e këtij sendi është një dirhem e më shumë, ai e bën të njohur sendin e gjetur dhe, në qoftë se nuk i del pronari, atëherë gjetësi i atij sendi përzgjedh: ose e jep sadaka me kusht që të ai të jetë garantues, nëse del pronari i sendit, ose e mban atë send në dorën e tij si amanet, duke e marrë në pronësi, me kushtin e garantimit, e gjitha kjo, nëse ai nuk e ka gjetur në dyshemenë e xhamisë së Qabes. Për këtë çështje, me lejen e Allahut, do të flitet me hollësi në kapitullin “Sendi i gjetur përdhe”.

Për sa i përket pasurisë që nuk i njihet pronari, ajo pasuri është e tjetrit, që ndodhet nën kujdesin tënd. Prej pasurive që nuk

i njihet pronari është edhe një send që qëndron jashtë, të cilin ti e ke marrë atë në pronësi dhe tani gjendet nën kujdesin tënd, ose një pasuri, pranuari i të cilës nuk dihet se kush është, por që atë pasuri ti e ke në dorën tënde, me kusht që kjo pasuri nuk është sendi që ti e ke gjetur përdhe. Gjithashtu, pasuri që nuk i njihet pronari është edhe pasuria e marrë prej rrëmbyesit e prej sundimtarit tiran, sepse që të dy, e kanë marrë atë send prej dorës së pronarit.

Nuk ka dallim mes pronarit të panjohur dhe mes atij pronari që e ke njohur në fillim dhe më pas nuk e njeh, si dhe mes atij që në fillim të punës nuk e ke ditur se cili është, si për shembull, kur ti gjendesh në një vend së bashku me një person që nuk ia njeh identitetin e tij dhe më pas ai largohet, por nga harresa ka lënë disa prej se deve të tij.

Në lidhje me sendet e marra padrejtësisht, autori i librit “Miftahul Kerameh”, në vëllimin 5, në faqen 17, ka thënë: “Pasuria që nuk i dihet pronari dhe kthimi i pasurisë së marrë padrejtësisht, si as thënies më të përhapur, është e njëjta gjë.”

Autori i librit “El Xheuahir” dhe autori i librit “Miftahul Kerameh” kanë thënë: “Nuk është kusht që sendi të cilit nuk i dihet pronari, të dorëzohet te gjykatësi ligjor, por ai send jepet sadaka për pronarin e vërtetë, krahas keqardhjes për mosnjohjen e atij pronari.”

Bazuar mbi këtë thënie, kanë dhënë fetva edhe fukahatë, kurse tekstet që flasin për këtë çështje, janë të transmetuara prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) dhe, prej këtyre transmetimeve kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) kur

ai është pyetur për një burrë që ka gjetur një send të një personi që ishte së bashku me të, por ai nuk e njeh këtë person. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse puna qëndron kështu, atëherë shite atë send dhe shumëni jepe sadaka për pronarin e atij sendi.”

Ky tekst i qartë tregon se për pasurinë që nuk i dihet pronari, nuk është kusht të merret leje prej gjykatësit ligjor për dhënien sadaka të këtij sendi.¹

Pjesëtimi i borxhit

Shumica e fukahave më të dëgjuar janë mbështetur në dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” që thotë se pjesëtimi i borxhit nuk është i vlefshëm. Shembull për ilustrim: Një borxh është në mirëbesim të dy vetëve, të Zejdit e të Amrit. Të dy janë marrë vesh mes tyre që pjesa e borxhit që duhet të shlyejë Zejdi të jetë për njërin prej atyre të dyve. Gjithashtu, ata janë marrë vesh që pjesa që duhet të shlyejë Amri, të jetë edhe për tjetrin. Fukahatë e kanë ndaluar këtë lloj ndarje të borxhit dhe kanë thënë se ajo çka arrihet prej borxhit, është për të dy dhe ajo çka shkatërrohet prej borxhit, është detyrim mbi të dy. Për këtë përfundim, fukahatë janë bazuar në pyetjen që i është bërë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) për dy burra që kanë të përbashkët një pasuri dhe prej

¹ Ka mbetur pa u sqaruar edhe një çështje e rëndësishme: Kur mësohet se kush është pronari i pasurisë, pasi ajo është dhënë sadaka dhe ai e kërkon pasurinë prej atij që e dha sadaka, a është ky i fundit garantuesi, në atë mënyrë që të jetë i detyruar t’i paguajë pronarit të asaj pasurie kompensim me një pasuri të ngjashme ose me vlerën e saj? Rregulli flet për mosgarantimin, sepse dhënia sadaka ishte me urdhër të ligjit. Me lejen e Allahut, do të flasim për lakminë e njeriut për pasurinë e tij në kapitullin “Sendi i gjetur përdhe”.

kësaj pasurie ka edhe borxh, kështu që ata të dy kanë ndarë mes tyre pasurinë dhe borxhin, domethënë që borxhi i takoi njërit dhe nuk i takoi tjetrit. A duhet ta paguajë borxhin ai që e ka marrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po.”

Heqja e parasë nga qarkullimi

Kur borxhi është prej llojit të monedhave, që në vetvete kanë vlerë, si për shembull, monedha prej floriri e prej argjendi, por më vonë shteti i heq ato nga qarkullimi dhe veprimin me ato monedha e bën të pavlerë, në këtë gjendje, është detyrim që borxhi të shlyhet me të ngjashme.

Në qoftë se monedha janë të llojit letër, të cilat, në vetvete, nuk kanë vlerë, veçse në konsideratën e shtetit, atëherë borxhmarrësi ka detyrim ta shlyejë borxhin me monedhën tregtare, duke bërë vlerësimin me vlerën që kishte monedha e marrë borxh në kohën e heqjes nga qarkullimi, sepse borxhmarrësi mbetet kërkuesi i monedhës së mëparshme dhe përgjegjës për shlyerjen e borxhit me atë monedhë, deri në kohën e heqjes së saj prej qarkullimit. Por për kohën pas heqjes nga qarkullimi, përgjegjësia e shlyerjes me monedhën e vjetër kalon në shlyerjen me monedhën e re.

Vdekja nuk e prish afatin

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se borxhi me shlyerje të vonuar, me vdekjen e borxhmarrësit, bëhet borxh që duhet të shlyhet në çast, sepse i vdekuri s’ka si mban përgjegjësi

dhe trashëgimtari nuk është përgjegjës për borxhin e marrë, sepse dihet që njeriu nuk dënohet për vdekjen e tjetrit, prandaj borxhi mbetet i varur prej sendeve të lëna prej të vdekurit në kohën e vdekjes.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur burri ka borxh për të shlyer në një afat të caktuar dhe ai vdes, afati prishet.”

Në qoftë se vdes borxhdhënësi, pasuria borxh që ai kishte në kujdesin e borxhmarrësit, kalon te trashëgimtarët e të vdekurit, por sipas rregullit të shoqërimit, afati mbetet ashtu siç ishte.

Shlyerja e borxhit me këste (et tenxhijm)

Shlyerje e borxhit me këste do të thotë shpërndarja e borxhit për t’u shlyer në kohë të caktuara. Ligjërisht ky veprim është i vlefshëm e i lejueshëm, por, kur borxhdhënësi i vë kusht borxhmarrësit: Nëse ai vonon në shlyerjen e një pjese të borxhit në afatin e caktuar, prishet veprimi për të gjitha pjesët e tjera të borxhit. Më sipër është folur për këtë çështje në pjesën e tretë të kapitullit “Pagesa e shpejtë dhe e vonuar”, paragrafi “Vonimi”.

Për shlyerjen e borxhit me këste bëhet fjalë kur shlyerja bëhet e bazuar në atë që ne kemi përzgjedhur, që kushti i vonimit për shlyerjen e borxhit, e bën të detyruar mbajtjen e besës për këtë borxh, kurse, sipas thënies së fukahave më të dëgjuar, mbajtja e besës nuk është detyrim, për rrjedhojë, ky nuk është objekt për të cilin mund të flitet.

Kalimi i kohës

Pjesa më e madhe e fukahave janë shprehur se e drejta për kthimin e borxhit të dhënë nuk humbet për shkak të moskërkimit të borxhit, pavarësisht sa zgjat koha, sepse ajo që vërtetohet me një shkak ligjor, rrëzohet vetëm me një rrëzues ligjor, mirëpo në ligjin e fesë kalimi i kohës nuk është prej shkaqeve rrëzuese.

Autori i librit “El Hadaik”, në vëllimin 5, në fundin e kapitullit “Borxhi”, ka cituar prej shejkhut Es Saduk: “Ai që le një shtëpi, një truall, ose një tokë në dorën e një tjetri dhe nuk kërkon që t’ia kthejë, madje për këtë nuk ka konflikt për një periudhë kohore prej dhjetë vitesh, për atë s’ka më të drejtë.”

Për këtë çështje flet transmetimi i ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “Toka është e Allahut dhe ai e ka bërë tokën vakëf për robtë e Tij, prandaj ai që e le tokën pa punuar për tre vjet me radhë, pa ndonjë shkak e pa ndonjë pengesë, ajo tokë i merret dhe i jepet një tjetri. Gjithashtu, edhe ai që nuk e kërkon të drejtën e tij për dhjetë vjet, ai s’ka më të drejtë për ta marrë këtë të drejtë.”

Kjo fjalë shumë e qartë tregon se, kush nuk e kërkon të drejtën e tij për dhjetë vjet me radhë, e drejta e tij bie që në themel. Me këtë shpjegim bëhet e qartë se fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është e përafërt me atë që thuhet në ligjet civile.

Më pas, autori i librit “El Hadaik”, ka thënë: “Si tërësi, çështja nuk është pa vështirësi.”.

Vështirësia qëndron në faktin se transmetimi është i devijuar, pasi me këtë transmetim s’ka punuar askush përveç

Sadikut (vdekur në vitin 381H). (është për Imam Sadikun apo për ndonjë person, Sadukun?) Për më tepër, një grup dijetarësh kanë atakuar përcjellësit e këtij transmetimi. Qëllimi ynë, me theksimin e këtij transmetimi dhe fjalës së Saduikut, është për të tërhequr vëmendjen se në legjislacionin islam ka efekte degë, në lidhje me kalimin e kohës. Duhet të theksohet se prej legjislacionit islam, në lidhje me këtë çështje kanë marrë edhe ligjet civile.

Shkëputja e borxhit (el mekàsah)

Kur një person merr prej teje një send dhe ti merr prej tij diçka që ka të bëjë me sendin që ai mori prej teje, në lloj e në cilësi, ajo çka ti more prej tij është plotësim i të drejtës tënde. Në qoftë se ajo që more dhe ajo që dhe janë të barabarta në peshë dhe, në qoftë se është mangët, do të zbresësh në atë masë sa more. Por nëse ajo që more është më shumë, ti ke përgjegjësi për këtë shtesë, por kjo s'ka asgjë të përbashkët me shkëmbimin mall me mall (klering), sepse dy sendet e dhëna, në mënyrë të ndërsjellë, ishin me vullnetin e të dyja palëve dhe quhet përgënjeshttrim i ndërsjellë, kur ata të dy kanë rënë në marrëveshje për llojin, cilësinë dhe sasinë.

Në qoftë se ti merr prej tij jo llojin që ai mori prej teje, si për shembull, ai mori prej teje para dhe ti more prej tij ushqim, por më pas ai nuk e mban besën për të dhënë sendin për të cilin kishit rënë në marrëveshje, në këtë rast ty të lejohet të bësh llogari për aq sa ushqim more prej tij, kundrejt shumës së parave që i dhe në mbajtje të besës për ushqimin e marrë, duke u bazuar mbi çmimin

e ushqimit në kohën e bërjes së marrëdhënies së ndërsjellë dhe të shkëmbimit dhe jo në kohën e marrjes në dorë.

Patjetër që kur ai të jep ty ushqimin me pretendimin e mbajtjes së besës, merret në konsideratë çmimi në ditën e marrjes në dorë.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burë i cili i ka dhënë borxh një tjetri dhe, kur vjen afati i shlyerjes së borxhit që i jep atij ushqim, ose pambuk, pa i përendur çmimin, por pas dy ose tri muajve, çmimi i atij sendi ngrihet ose bie, atëherë mbi cilin çmim do të bëhet llogaria? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Çmimi llogaritet në kohën e pagesës.”

Kur borxhmarrësi e mohon që ka marrë borxh prej teje, ose e zgjat kohën e shlyerjes, për ty lejohet të marrësh prej pasurisë së tij, me të gjitha rrugët, sasinë e të drejtës që të takon, pa bërë padrejtësi, ashtu siç është fjala e të Lartit:

“فَمَنْ اعْتَدَىٰ عَلَيْكُمْ فَاعْتَدُوا عَلَيْهِ بِمِثْلِ مَا اعْتَدَىٰ عَلَيْكُمْ”

“Kush sulmon kundër jush, edhe ju sulmoheni atë në atë masë që ai sulmoi kundër jush.” (Sure “El Bekare”, ajeti 194)

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që i ka dhënë borxh një tjetri, por ky i fundit e mohon që i ka marrë borxh. Më pas burri arrin të marrë prej tij atë që ai mohonte. A duhet ta marrë këtë sasi, kur mohuesi nuk ka dijeni për këtë veprim? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po.”

Pikërisht këtë fukahatë e quajnë “shkëputje të borxhit”, për të cilën, me lejen e Allahut, do të vëmë një kapitull të veçantë, në fundin e kapitullit “Gjykimi”. Ai që e shkëput të drejtën që i takon prej atij që ia ndalon këtë të drejtë, për këtë shkëputje s’ka nevojë të marrë leje prej gjykatësit ligjor, sepse nuk ka argument që e bën të detyruar marrjen e lejes prej tij, sepse argumentet flasin për lejimin e shkëputjes të së drejtës që të takon.

Pyetje: A i lejohet të varfrit nevojtar të marrë pa leje prej pasurisë së atij që nuk e jep zekatin, kur ky i varfër nevojtar është prej atyre që i takon të marrin zekat?

Përgjigje: Kurrë, sepse zekati është vërtetuar në pasurinë e të pasurve për të varfrit në përgjithësi dhe jo për një njeri në veçanti, që të jetë e lejuar shkëputja. Me fjalë të tjera, borxhi është një pasuri private, kurse zekati është pasuri publike. Dallimi është fare i qartë.

* * *

PENGLËNIA

Ç'do të thotë penglënie?

Fjala “penglënie”, nga ana gjuhësore, ka disa kuptime, prej të cilave kemi fjalën “ndaloi” dhe “mbylli”. Allahu i Lartësuar, në librin e Tij, thotë:

“كُلُّ امْرِئٍ بِمَا كَسَبَ رَهِينٌ” “كُلُّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ رَهِينَةٌ”

“Çdo njeri është peng i punës që ka bërë.” (Sure Et Tur”, ajeti 21)

“Çdo njeri është peng i punës së vet.” (Sure “El Mudeth’thir”, ajeti 38)

Këto ajete janë edhe baza e fjalës së fukahave: Pengu është dokumenti i borxhit për pengpranuesin.

Lejimi i penglënies

Penglënia është e lejuar me librin e Allahut, me Sunetin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!) dhe me fjalën e përbashkët të fukahave. Allahu i Lartësuar thotë në Librin e Tij:

“وَإِنْ كُنْتُمْ عَلَىٰ سَفَرٍ وَلَمْ تَجِدُوا كَاتِبًا فَرِهَانٌ مَّقْبُوضَةٌ”

“Në qoftë se jeni në udhëtim dhe nuk gjeni shkrues, atëherë merrni peng (kapar ose paradhënie).”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur atij që e ka pyetur për penglënien: “Kërko sa të mundesh garantim për pasurinë tënde.”

Lënia peng është e vlefshme në udhëtim dhe në vendbanim. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim në mesin tonë, transmetohet se Profeti (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka lënë peng mburojën e tij te një jehudi, kur banonte në Medine.”

Për lënien peng ka disa baza që janë: formula që saktëson se sendi i lënë peng, domethënë objekti i pengut, është një e drejtë e vërtetuar e penglënësit dhe e pengpranuesit. Për të gjithë këta tituj ka dispozita. Në vijim ne do t’i sqarojmë me radhë.

Kontrata

Penglënia ka nevojë për kontratë dhe në kontratën e penglënies theksohet ajo që vihet në konsideratë në kontratat e tjera, domethënë oferta nga ana e penglënësit dhe pranimi nga ana e pengpranuesit, me fjalë ose me punë, madje mjafton edhe një shenjë kuptimdhënëse, në raste pamundësie për t’u shprehur me fjalë. Për sa i përket shkresës, nuk përjashtohet bërja e saj, krahas

qëllimit, edhe sikur shkruesi të jetë i aftë të shqiptojë formulën e kontratës me fjalë.

Autori i librit “El Hadaik” në fillim të kapitullit “Penglënia”, tekstualisht thotë: “Disa studiues mjaftohen vetëm me bërjen me shenjë dhe shkresën. Të dyja janë kuptimdhënëse, krahas fuqisë së shqiptuar me fjalë, sepse qëllimi është të kuptuarit e kësaj pune, prandaj kudo që gjendet ky kuptim, është i mjaftueshëm.”

Marrja në dorë

Vallë, a plotësohet kontrata e penglënies vetëm me marrjen në dorë, në atë mënyrë që marrja në dorë është kusht për lidhjen e kontratës së penglënies e për vlefshmërinë e saj? Me mosmarrjen e pengut në dorë, që në bazë s’ka kontratë penglënie, plotësisht ashtu siç qëndron çështja me sadakanë, me dhurimin, me shkëmbimin, me kredinë, por as kontrata e as përmbajtja e kontratës nuk është kusht për vlefshmërinë e penglënies, ashtu siç e pamë te kontrata e shitjes. apo është kusht brendia e kontratës, nga ana e penglënësit dhe jo për vlefshmërinë e për lidhjen e kontratës?

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë tri thënie.¹ Më e sakta është: Në mënyrë absolute, marrja në dorë nuk është kusht,

¹ Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Shumica e fukahave mendojnë se në këtë çështje ka dy thënie, por ai që ndjek këto thënie, konstaton se ato janë tri thënie. Thënia e parë: Në vlefshmërinë dhe në përmbajtjen kontratës nuk hyn marrja në dorë e sendit të lënë peng. Thënia e dytë: Vlefshmëria qëndron mbi marrjen në dorë. Thënia e tretë: Përmbajtja dhe jo në vlefshmëria.

as për vlefshmërinë e sendit të lënë peng e as për brendinë e tij, sepse kontrata e penglënies, si të gjitha kontratat e tjera, plotësohet me ofertën dhe me pranimin. Kur kontrata lidhet, ajo është e detyrueshme sipas diktimit të fjalës së Allahut të Lartësuar: “أَوْفُوا بِالْعُقُودِ” - “...mbani premtimet për kontratat.” (Sure “El Maide”, ajeti 1), si dhe sipas hadithit: “Besimtarët janë në kushtet e tyre.”, prandaj përmbajtja e kontratës nuk qëndron as në marrjen në dorë të saj, as në mosmarrjen në dorë të sendit të lënë peng, për shkak se për të gjitha këto s’ka asnjë argument.

Për sa i përket ajetit:

“وَإِنْ كُنْتُمْ عَلَىٰ سَفَرٍ وَلَمْ تَجِدُوا كَاتِبًا فَرِهَانٌ مَّقْبُوضَةٌ ۚ فَإِنْ أَمِنَ بَعْضُكُم بَعْضًا فَلْيُؤَدِّ الَّذِي أُؤْتِنَ أَمَانَتَهُ وَلْيَتَّقِ اللَّهَ رَبَّهُ”

“Në qoftë se jeni në udhëtim dhe nuk gjeni shkrues, atëherë merrni peng (kapar ose paradhënie) dhe, nëse i besoni njëri-tjetrit, atij që i është besuar le të kryejë amanetin që i është besuar dhe le të ketë frikë Allahun, Zotin e tij...” (Sure “El Bekare”, ajeti 283)

Ky ajet nuk tregon as nga afër e as nga larg që marrja në dorë është detyrim, sepse ajeti i nderuar shpalos dispozitën e borxhit në udhëtim dhe jo dispozitën e penglënies e as kushte për penglënien në udhëtim. Ajeti e përmend mbajtjen peng si orientim, kur nuk gjendet shkruesi i kontratës. Vetëkuptohet që në rastin e lënies peng, kjo është një gjë dhe kushti i marrjes në dorë është një gjë tjetër.

Për sa i përket transmetimit të ardhur prej Imam Bakirit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), babai i

Imam Xhafer Sadikut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) “S’ka penglënie pa marrje në dorë.”, ai është përgjigjur se ky transmetim është me përcjellës të shkallës “Daijf”- “Dobët” dhe është thjesht vetëm për orientim, plotësisht siç tregon edhe ajeti i nderuar. Për këtë shkak, këtë transmetim e kanë mënjanuar një grup prej fukahave të mëdhenj, të mëparshëm e të mëvonshëm, ndër të cilët sheh Mufijdi, Dëshmori i Parë, poliedriku El-Halij dhe studiuesi, autori i librit “Esh Sheràiu”.

Pyetje: Sendi i lënë peng është dokument për borxhin, ashtu siç u tha më sipër në përkufizimin e tij, por si do të kërkojë penglënësi dokument prej pasurisë së tij, krahas mosmarrjes në dorë? Me fjalë të tjera, ç’dobi ka ai prej sendit të lënë peng, derisa marrja në dorë nuk është kusht për penglënien?

Kësaj pyetjeje ne i përgjigjemi: Qëllimi me lënien peng është ndalimi për të vepruar me sendin e lënë peng dhe ndalimi i penglënësit që të veprojë me sendin e lënë peng me anë të shitjes ose me veprime të ngjashme. Është e qartë se ky ndalim ka qëllim që pengpranuesi të ketë mundësi ta marrë të drejtën e tij të plotë prej sendit të lënë peng. Padyshim që ky qëllim realizohet edhe pa marrjen në dorë, edhe pse realizimi i këtij qëllimi është më i sigurt me marrjen në dorë.

Me një fjalë, penglënësi është i ngurtësuar, në raport me sendin e lënë peng dhe është si i falimentuari, ashtu siç nuk kushtëzohet marrja në dorë për vlefshmërinë e marrjes në dorë mbi të falimentuarin, po ashtu marrja në dorë nuk kushtëzohet as për penglënien.

Ne pëlqyem të bazohemi në thënien se marrja në dorë nuk është kusht as për vlefshmërinë e penglënies e as për përmbajtjen e saj nga ana e penglënësit, kështu që nuk mbetet vend për degët që kanë nxjerrë fukahatë mbi detyrimin e marrjes në dorë, sepse rrëzimi i origjinës kërkon edhe rrëzimin e degës dhe, prej degëve që ata kanë ndërtuar, duke u bazuar mbi përmbajtjen e marrjes në dorë, është edhe mosvlefshmëria e marrjes në dorë të sendit të lënë peng pa lejen e penglënësit, si dhe mosdetyrimi për vijimin e marrjes në dorë. Gjithashtu, ata kanë nxjerrë edhe mungesën e sendit të lënë peng prej kuvendit të lënies peng, si dhe të tjera çështje që ata kanë ndërtuar, duke u bazuar mbi kushtin e marrjes në dorë të sendit të lënë peng.

Penglënia është absolute, e pakushtëzuar

Borxhi është i vlefshëm të jetë me kohë absolute, gjithashtu, është i vlefshëm të jetë i përkohshëm, kurse pengu, në asnjë gjendje, nuk është i vlefshëm të jetë i kushtëzuar me kohë. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë mbështetur dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir”, që kushti i afatit për pengun, jo vetëm që është i prishur, por është edhe prishës i kontratës së penglënies, pavarësisht, nëse borxhi është i caktuar në kohë ose jo, sepse qëllimi me pengun është që pengu shërben si dokument për borxhin, kurse caktimi i kohës është në kundërshtim me kërkimin e dokumentit, sepse ka mundësi që mbajtja e besës për shlyerjen e borxhit në kohën e caktuar mund të mos jetë e lehtë, atëherë menjëherë përfundon penglënia dhe borxhi mbetet pa dokument, çka është e kundërta e qëllimit, prandaj mbetet që sendi i lënë peng të vijojë të jetë peng, derisa të kryhet shlyerja e borxhit, ose

kur penglënësi e fal sendin e lënë peng, ose kur ai heq dorë nga e drejta e tij për sendin e lënë peng.

Penglënia e kushtëzuar, pa afat kohor

Penglënia mund të jetë pa asnjë kusht, por penglënia mund të jetë edhe me kushte. Kushti për penglënien mund të jetë i vlefshëm, si për shembull, kushti që sendi i lënë peng të jetë në dorën e penglënësit, ose në dorën e një njeriu të besueshëm, ose kushti që pengpranuesi ka të drejtë për të shitur sendin e lënë peng dhe me shumën e realizuar të shlyejë borxhin e penglënësit;¹ ose vetë kushti është i prishur, por nuk është prishës i penglënies, si për shembull, kushti që sendi i lënë peng të shitet vetëm me çmimin që dëshiron penglënësi, edhe nëse ky çmim është disafish më shumë se çmimi i tregut.

Gjithashtu, ka kusht që si kusht, nuk është i prishur, por është dhe prishës, si për shembull, kur pengpranuesi vë kusht që sendi i lënë peng të jetë për atë send i vënë në shitje, në qoftë se penglënësi nuk i shlyen të drejtën e tij. Autori i libri “El Xheuahir” ka thënë: “Fukahatë ndajnë një fjalë të vetme për prishjen e kushtit

¹ Për këtë çështje, shumica e fukahave janë shprehur se pengpranuesi vë kusht në favor të vetes së tij prokurimin në shitjen e sendit të lënë peng. Ka fukaha që e kanë vështirësuar çështjen, duke thënë se prokurimi nuk realizohet thjesht duke e vënë atë kusht në kontratë, pasi kushtëzimi i prokurimit kërkon kushtin që edhe penglënësi t’i lërë pengpranuesit një garantues, por penglënësi mund të mos e bëjë këtë, në rastin, kur penglënësi nuk sjell garantuesin, pengpranuesi ka të drejtë të prishë penglënien për shkak të vonimit të kushtit. Bazuar mbi këtë pikë, nuk realizohet dot qëllimi i kërkuar. Për të mos e zgjatur fjalën më shumë, ne kemi hequr dorë prej kushtit të prokurimit për shitjen dhe kemi kaluar në kushtin e të drejtës për shitjen. Ky kusht quhet rezultati, domethënë, në vetvete prokurimi nuk është vënë kusht, por është vënë kusht rezultati.

të penglënies, sepse origjina e penglënies është mostransferimi i sendit prej pasurisë së pronarit, për faktin se një send nuk mund të jetë në të njëjtën kohë send i lënë peng edhe send i vënë në shitje, sepse dihet që shitja nuk mund të quhet shitje pa shkakun e saj, që ishte formula së bashku me kushtet e tjera.

Kjo është një analogji për prishjen e kushtit, kurse prishja e penglënies është përcaktuar me mosshlyerjen. Më sipër është thënë që penglënia të mos jetë e kufizuar me ndonjë send, pasi, në vërtetë, me dispozitë penglënia zgjidhet me shlyerjen e detyrimit, ose me heqjen dorë prej së drejtës. Për sa i përket çështjes se si e merr pengpranuesi të drejtën e tij prej sendit të lënë peng, shpjegimin e kësaj pyetjeje do ta shikojmë në paragrafin “Pamundësia e mbajtjes së besës për sendin që nuk është lënë peng”.

Sendi i lënë peng

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se sendi i lënë peng duhet të jetë i atillë, që marrja e atij sendi në pronësi dhe shitja e tij është veprim i vlefshëm. Gjithashtu, është e mundur edhe dhënia e atij sendi në dorëzim dhe patjetër që sendi i lënë peng të dihet si është dhe të mos jetë i panjohur. Pra, plotësisht ashtu siç kërkohet edhe për sendin e vënë në shitje.

Sendi i lënë peng nuk është i vlefshëm, kur ai është borxh që duhet të shlyhet, sepse, në këtë gjendje, ai është një punë e përgjithshme që nuk ekziston, për rrjedhojë, nuk është e mundur që ai send të merret në dorë, në një kohë kur marrja në dorë e sendit është kusht për penglënien. Ajo që kemi zgjedhur ne për

mosvënien kusht të marrjes në dorë, s'ka ndonjë pengesë për të moskërkuar borxh dhe që ti të lësh peng ato sende që ke nën detyrimin e një tjetri, kur sendi është dhënë pa afat, atëherë ai e bllokton këtë borxh për llogari të penglënësit, plotësisht ashtu siç veprohet me të falimentuarin.

Në mënyrë absolute nuk është e vlefshme lënia peng e përfitimit, pavarësisht se kemi thënë ose nuk kemi thënë që marrja në dorë është kusht, sepse dobia arrihet gradualisht, përfitim pas përfitimi, i cili është i pamundur të zotërohet, duke mos e konsumuar atë, por kështu nuk realizohet qëllimi me penglënien, domethënë, shlyerja e borxhit me sendin e lënë peng, kur penglënësi e ka të pamundur ta mbajë besën për shlyerjen e borxhit.

Gjithashtu, nuk është e vlefshme të lihet peng një send që nuk ka mundësi të kapet, si për shembull, shpendët në qiell dhe peshqit në ujë.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për vlefshmërinë e lënies peng të një pjese të njohur të një sendi, si për shembull, burri lë peng gjysmën e shtëpisë së tij, ose të tokës së tij, ose lë peng pjesën e truallit që ka në ortakëri me një tjetër. Kjo është e barabartë, qoftë kur pjesën e tij e lë peng te ortaku i tij, qoftë kur e lë peng te ndonjë tjetër. Gjithashtu, kjo është e barabartë, qoftë kur sendi i lënë peng e pranon pjesëtimin, qoftë kur ai send nuk e pranon pjesëtimin.

Fukakahtë ndajnë një fjalë të përbashkët se njeriu ka të drejtë të marrë hua mallin e tjetrit dhe ta lërë atë peng me lejen e huadhënësit kundrejt borxhit që ka, me kusht që t'i shpjegojë llojin

e borxhit, sasinë dhe afatin e shlyerjes. Në qoftë se huadhënësi kundërshton, pronari i mallit ka të drejtë ta prishë penglënien dhe të kërkojë kthimin e sendit të lënë peng.

E drejta

Qëllimi me të drejtën këtu është ajo çka merret prej sendit të lënë peng, kur nuk ka dyshim për lejimin e marrjes së sendit të lënë peng kundrejt borxhit të vërtetuar e të saktësuar, qoftë kur borxhi është me afat të shpejtë shlyerjeje, qoftë kur është me afat shlyerje të vonuar, ose është çmim për sendin e shitur, ose është shumë qeraje, ose është shumë kurore, qoftë edhe kur borxhi është marrë përpara penglënies, ose është marrë në të njëjtën kohë me sendin e lënë peng. Shembull për ilustrim: Një person thotë se këtë send ta shes ty për dhjetë, me kusht që ta lesh peng te unë këtë send, por nuk lejohet që më parë të lihet pengu dhe pastaj të kërkohet borxhi.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Atë, pa asnjë kundërshtim e gjej në mesin tonë, sepse sendi i lënë peng është dokument për pasurinë dhe nuk mund të kërkohet dokument pa marrë mallin.”

Ky është edhe shkakun që fukahatë më të dëgjuar janë shprehur për mosvlefshmërinë e penglënies së sendit ose të shumës që do të merret pas kryerjes së punës, domethënë, para plotësimit të asaj pune, si për shembull, kur burri thotë se, kush bën kaq punë, unë i jap kaq para, ose kaq mall. Në këtë këndvështrim, nuk është e vlefshme që punëtori të lërë peng mëditjen, pa kryer punën për të cilën merr edhe mëditjen, pasi

detyrimi është që shpërblimi për atë nuk vërtetohet para se ai ta kryejë punën.

Pyetje: A është e vlefshme penglënia e sendit, ashtu siç është e vlefshme për borxhin? Kur ti le një send në mirëbesim (emanet) te një njeri, ose kur dikush merr prej teje me qera një makinë, ose makinën e mori me qëllim që ta provojë, pasi ka qëllim ta blejë. Kjo mënyrë marrëdhënie e ndërsjellë, në terminologjinë e fukahave, quhet me termin “es’seum” – “shkon kah të dëshiroje”, përveç kuptimeve të tjera të kësaj fjale.

Tani shtrohet pyetja: A është e vlefshme të lihet peng një send dhe ti, si pronar, kërkon dokument për mallin tënd, kur qeramarrësi neglizhon plotësimin e detyrimit, ose ai që mori makinën për provë, ose huamarrësi, ose ai që i është lënë amanet?

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët, me dëshminë e autorit të librit “El Xhe ahir” dhe me autorin e librit “El Hadaik”, se depozita e kreditimit, kur nuk janë të garantuara, nuk është e vlefshme të lihet peng. Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre për sendet e tjera. Ka fukaha që janë shprehur për vlefshmërinë e penglënies së sendit të pagarrantuar. Fukaha të tjerë janë shprehur se nuk është e vlefshme penglënia e sendit të pagarrantuar.

Autori i librit “El Xheuahir” është shprehur për vlefshmërinë, me përjashtim të penglënies për shkak të depozitimit dhe kreditimit të pagarrantuar, sepse argumentet për penglënien janë të përgjithshme, për rrjedhojë përfshijnë sendin konkret dhe borxhin. Por prej këtij rregulli, me fjalën e përbashkët të fukahave, kanë dalë jashtë depozitat e lartpërmendura të kreditimet, kurse sendet e tjera mbeten brenda rregullit

përgjithësues, në të cilin përfshihet edhe penglënia, për shkak se mbi këtë rregull renditen të gjitha dispozitat e penglënies.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka blerë një kafshë, ose ushqim me parapagim. Shitje me parapagim mund të jetë me pagim të shpejtuar dhe sendi të jepet me vonesë. A merret peng vetëm për aq sa është paguar?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po, sigurohu për pasurinë tënde me çka të mundesh.”

Shtimi i borxhit

Lejohet që penglënësi të kërkojë borxh për herë të dytë prej pengpranuesit dhe totalin e borxhit të parë e të borxhit të dytë e vë mbi sendin që ai la peng për borxhin e parë. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim, unë këtë e gjej në mesin tonë, si për shembull, kur lë peng një shumë që në fillim. Nuk është e nevojshme që penglënia e parë të bëhet e pavlefshme dhe pastaj të ripërtërihet.”

Sendi i lënë peng prishet shpejt

Kur sendi i lënë peng është nga lloji që prishet shpejt, pengpranuesi njofton penglënësin për punën e këtij sendi të lënë peng, kur ai ka frikë se sendi prishet. Në qoftë se kontaktimi me penglënësin është i pamundur, atëherë pengpranuesi i drejtohet gjykatësit ligjor. Në qoftë se edhe kjo është e pamundur, atëherë pengpranuesi e merr vetë në dorë procesin e shitjes, krahas

kujdesit të plotë për të ruajtur personalisht të drejtën e penglënësit. Në vijim kjo çështje do të trajtohet hollësisht.

Kushtet për penglënësin dhe pengpranuesin

Është kusht që penglënësi dhe pengpranuesi të ketë aftësi për të vepruar me pasurinë, prandaj penglënia, nga ana e të çmendurit dhe e fëmijës që akoma nuk dallon, është marrëzi. Gjithashtu, është marrëzi edhe lënia peng nga ana e të imponuarit dhe e të dehurit, si dhe i atij që e ka ngurtësuar sendin për veten e vet, ose e atij që ka falimentuar. Lejimi për veprim, nga ana e këtij të falimentuari, me pasurinë e tij, qëndron në dorën e atij që ka të drejtën e lejimit. Kujdestarit dhe të porositurit i lejohet të lërë peng pasurinë që ka në kujdesin e tij, kur këtë veprim e kërkon interesi i pronarit të pasurisë që ata kanë në kujdestari. Gjithashtu, për këta të dy lejohet të japin kredi prej asaj pasurie, ose të lënë peng, gjithnjë krahas ruajtjes së interesit të pronarit.

Disa fukaha kanë sjellë si shembull që për minorenin e për të lajthiturin, kur bëhet fjalë për grurë e drithëra të ngjashëm me grurin, pra, për sende për të cilat gjithmonë është frika se mund të prishen, për të këtilla sende s'ka asnjë që dëshiron t'i marrë peng këto sende, përveçse t'i marrë me kredi, ose t'i blejë me pagim të vonuar. Në këtë gjendje, kujdestari i shet këto lloje mallrash ose i krediton krahas penglënies, ose edhe pa mbajtur peng asgjë, kur huamarrësi është njeri besnik.

Veprimi i penglënësit dhe i pengpranuesit

Penglënësi dhe pengpranuesi kanë të përbashkët faktin se çdo njëri prej tyre e ka të ndaluar të veprojë me sendin e lënë peng pa lejen e tjetrit. Për pengpranuesin, ndalimi për të mos vepruar me sendin e lënë peng te ai, është fare i qartë, sepse sendi i lënë peng nuk është pasuri e tij, ndërsa ndalimi për veprim, nga ana e penglënësit, qëndron në atë se qëllimi me sendin e lënë peng, është se ai send i lënë peng të jetë dokument sigurie për borxhin e marrë, prandaj ndalimi për mosveprim hiqet vetëm me heqjen e pushtetit të penglënësit mbi sendin e lënë peng, të cilin pengpranuesi e ka të ndaluar ta shesë atë send, ose ta japë me qera, përfshirë edhe të gjitha llojet e tjera të veprimeve që janë në kundërshtim me marrjen e sendit të lënë peng si dokument për pasurinë e dhënë.

Kur pengpranuesi e lejon penglënësin ta shesë sendin e lënë peng te ai, penglënia prishet që në themel, sepse çmimi nuk është peng si sendi i vlerësuar me çmim. Në këtë gjendje, penglënia ka nevojë për penglënie të re.

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë veshje.”

Pengpranuesi ka përparësi ndaj të gjithë borxhdhënësve

Kur penglënësi ka borxhe që janë të barabarta me pasurinë e tij, ose edhe më shumë dhe, kur gjykatësi ka ngrirë pasurinë e tij, në këtë gjendje, sipas thënies më të përhapur në mesin e fukahave, pengpranuesi ka më përparësi ndaj të gjithë borxhdhënësve të

tjerë në të drejtën e tij për sendin e lënë peng. Në rast se borxhi është më shumë se pasuria e borxhmarrësit, atëherë çmimi i sendit të lënë peng për borxhin, kjo shtesë që është më shumë, shpërndahet ndër të gjithë borxhdhënësit. Nëse borxhi është më pak se pasuria e tij, atëherë penglënësi është i barabartë me borxhdhënësit e tjerë në pjesën që i ka mbetur atij prej borxhit.

Transmetohet prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) se rruga e pengpranuesit është rruga e të tjerëve ndaj huamarrësve dhe askush përveç pengpranuesëve nuk mund të ketë përparësi mbi sendin e lënë peng.

Thënia më e përhapur është se fukahatë e kanë neglizhuar këtë transmetim dhe përmbajtjen e tij, për shkak të shkallës “Dobët” të përcjellësve të transmetimit, ose për shkak të interpretimit të tekstit.

Prishja e sendit të lënë peng

Sendi i lënë peng është amanet në dorën e pengpranuesit dhe ai e siguron atë vetëm nëse vë dorë ose abuzon me sendin e lënë peng.

Kur sendi i lënë peng priset për shkak të pengpranuesit, ai është i detyruar të sigurojë sendin e prishur. Gjikimi bëhet sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur çmimi i sendit të lënë peng është më shumë se pasuria e pengpranuesit, ai ka detyrim t’i paguajë penglënësit tepricën, domethënë atë që është më shumë. Nëse është më pak, atëherë penglënësi është i detyruar

t'i paguajë shtesën pengpranuesit dhe, në qoftë se është e barabartë, atëherë ai s'ka asnjë detyrim."

Në qoftë se sendi i lënë peng priset prej ndonjë sëmundje shfarosëse, penglënia priset për shkak të ngritjes së objektit të penglënies dhe pengpranuesi e kërkon borxhin prej penglënësit, sepse borxhi nuk rrëzohet, kur priset sendi i lënë peng.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Kur humb sendi i lënë peng, ai është prej pasurisë së penglënësit dhe pengpranuesi i kërkon penglënësit pasurinë që i ka dhënë."

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që lë peng skllavin e tij, por skllavi sëmurët. Për llogari të kujt është ai? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Është për llogari të pronarit të tij. Si mendon ti, nëse ai skllav do të vriste një njeri, mbi cilin do të binte dënimi?"

Pyetësi tha: "Mbi qafën e skllavit."

Më pas Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: "Si mendon ti, sikur çmimi i tij të ishte njëqind dhe të bëhej dyqind, për cilin do të ishte kjo shumë?"

Pyetësi tha: "Për pronarin e skllavit."

Atëherë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: "Kështu qëndron puna edhe me pasurinë e tij, pra, ai është për llogari të pronarit."

Kur sendin e lënë peng e prish, ose e asgjëson një i huaj, prej tij merret peng një send zëvendësues dhe tani sendi zëvendësues është peng si sendi origjinal, sepse zëvendësuesi hyn

në dispozitën e sendit që ka zëvendësuar. Në këtë gjendje, ai që i kundërvihet këtij mëkatarit prishës dhe që ngre padi kundër tij, është vetë penglënësi, i cili s'ka të drejtë të falë mëkatarin, pa miratimin e pengpranuesit. Në qoftë se penglënësi nuk ngre padi kundër këtij prishësi, atëherë pengpranuesi ka të drejtë ta kundërshtojë këtë prishës të sendit, për shkak të varësisë që ka e drejta e tij me këtë mëkatar.

Dobitë e dala prej sendit të lënë peng

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur prej sendit të lënë peng dalin dobi, këto dobi i takojnë penglënësit. Kjo është e barabartë, qoftë kur dobitë vijnë në kohën e penglënies, qoftë kur ato vijnë pas penglënies, qoftë kur këto dobi janë të ndara prej sendit të lënë peng, qoftë kur ato janë të bashkuara me të, sepse vetë sendi është pronë e penglënësit dhe dobia ndjek sendin. Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse dobitë hyjnë në penglënien, në atë mënyrë që edhe ato të jenë peng, siç është origjina prej nga ato kanë dalë, apo dobitë nuk hyjnë në penglënien, apo ai bën ndarjen në mes llojeve të dobive?

Shumica e fukahave janë mbështetur në dëshminë e autorit të librit “El-Hadaik” dhe të autorit të librit “El Xheuahir”, që flasin për dallimin mes dobive të dala prej sendit të lënë peng që janë të pranishme në kohën e lidhjes së kontratës së penglënies, të cilat dalin vetëm me kushtin e hyrjes, si dhe dallimin mes dobive të ripërtërishme pas kontratës, të cilat hyjnë në penglënien, krahas kushtit të daljes së tyre.

Një grup prej fukahave të mëdhenj, ndër të cilët autori i librit “El Xheuahir”, janë shprehur për moshyrjen e dobive në penglënie, në mënyrë absolute, të përtëritura ose të papërtëritura, qofshin këto dobi, përveçse kur edhe ato janë lënë peng me kusht.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Për shkak të mospasjes argument ligjor për hyrjen (në penglënie), sepse origjina është: Pronari ka në zotërim pasurinë e tij.”

Ajo që ne shikojmë në këtë çështje, rezulton se nuk kanë asgjë prej dispozitave ligjore që puna me këto dispozita të referohet te ligjvënësi, ose te studiuesit e ligjit, domethënë te fukahatë, sepse ato kanë lidhje vetëm në kuptimin dhe në atë çka kuptohet prej fjalës, prandaj gjykimi në lidhje me këto çështje i referohet vetëm traditës dhe askund tjetër veç saj.

Pamundësia e mbajtjes së besës pa sendin e lënë peng

Më sipër u tha se penglënësi e pengpranuesi e kanë të ndaluar të veprojnë me sendin e lënë peng pa lejen e tjetrit, kurse tani, në lidhje me gjykimin e çështjes së pamundësisë për mbajtjen e besës, pa sendin e lënë peng, shpjegojmë si më poshtë:

1- Kur penglënësi vdes para se të shlyejë detyrimin për sendin e lënë peng dhe pengpranuesi ka frikë se mos i humb pasuria e tij për shkak të mohimit që mund të bëjnë trashëgimtarët, ai merr të plotë të drejtën e tij prej sendit të lënë peng, pa i marrë leje trashëgimtarëve.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka vdekur dhe ka lënë trashëgimtarë, ndërkaq vjen një burrë që

pretendon se te ai ka një pasuri të lënë peng prej trashëgimlënësit të tyre. Si duhet të veprohet në këtë situatë?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në qoftë se i vdekuri i detyrohej atij për ndonjë pasuri dhe pengpranuesi nuk ka argument, atëherë ai le të marrë të drejtën e vet prej asaj pasurie të vënë peng që është në dorën e tij dhe pjesën tjetër ia kthen trashëgimtarëve. Nëse pengpranuesi pohon sendin e lënë peng që ka në dorë, ai e merr të drejtën e vet prej asaj pasurie, ndërkaq i kërkohet dokument për pretendimin e tij.”

E gjitha kjo do të thotë se pengpranuesi ka të drejtë të mbajë të fshehtë prej trashëgimtarëve çështjen e sendit të lënë peng dhe nuk e pohon se te ai është një peng i lënë, për shkak që të mos dëmtohet e të humbë pasurinë e vetë për shkak të pohimit të tij. Gjithashtu, do të thotë se ai ka të drejtë të marrë të plotë vetë të drejtën e tij, kur ka frikë se do të dalë i humbur, madje edhe kur nuk është i porositur prej penglënësit që të shesë sendin e lënë peng, gjithashtu pengpranuesi e shet sendin e venë peng pa lejen e trashëgimtarëve për të shlyer borxhet e penglënësit.

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Fukahatë e kanë marrë këtë transmetim dhe kanë punuar me atë.”

2- Pengpranuesi lejohet të shkruajë në kontratën e penglënies kushtin për shitjen e sendit të lënë peng, me qëllim që ai të marrë të plotë të drejtën e tij prej këtij sendi, gjithashtu, pengpranuesit, me këtë kusht, i lejohet të shesë sendin e lënë peng, kur të dëshirojë. Kur borxhi është pa afat, ose kur borxhi është me afat, atëherë ai e shet sendin e lënë peng, pasi kalon afati

dhe për punën e shitjes ai nuk është i detyruar të marrë leje as prej penglënësit e as prej gjykatësit.

3- Kur pengpranuesi nuk e ka vënë kusht në kontratë, shitjen e sendit të lënë peng dhe penglënësi e ka të pamundur të shlyejë detyrimin, ose ai e ka këtë mundësi, atëherë çështja shtrohet te gjykatësi ligjor, sepse vetëm ai e ka në dorë çështjen e atij që nuk shlyen detyrimin, sepse ai është vënë në atë post për të zgjidhur konfliktet dhe për të ndaluar grindjet. Në këtë gjendje, gjykatësi, nga ana e tij, e detyron penglënësin të bëjë shitjen, krahas përdorimit nga ana e gjykatësit të rrugëve të kërcënimit e të dënimit dhe, nëse penglënësi përsëri nuk e shlyen detyrimin për sendin e lënë peng, atëherë vetë gjykatësi, ose personi i ngarkuar prej tij, merr në dorë shitjen e sendit të lënë peng, me qëllim që të mbahet besa për shlyerjen e borxhit.

Në qoftë se është e pamundur të gjendet gjykatësi, ose edhe gjendet, por ai s'ka fuqi të veprojë, në këtë gjendje për pengpranuesin lejohet, pasi shpreh keqardhjen, të shesë sendin e lënë peng me vlerën që ka dhe prej kësaj shume ai të marrë të drejtën që i takon, ashtu siç i lejohet çdo borxhdhënësi të marrë të plotë të drejtën e tij prej pasurisë së borxhmarrësit, kur ky borxhmarrës nuk e kryen të drejtën ndaj borxhdhënësit.

Pyetje: A nuk ka kontradiktë mes kësaj që u tha më sipër dhe mes transmetimit që tregon se, kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka lënë peng një send te një burrë tjetër dhe më pas ai largohet. Si rrjedhim, pengpranuesi s'ka mundësi ta gjejë atë, në këtë gjendje, a shitet sendi i lënë peng? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Jo, derisa të vijë pronari i atij sendi."

Autori i librit “El Xhevahir”, në përgjigje të këtij transmetimi dhe të transmetimeve të tjera që janë në këtë kuptim, ka thënë: “Ato tregojnë që shitja e sendit të lënë peng është veprim jo i pëlqyer “keràhet” dhe nuk tregojnë që shitja është e ndaluar “haram”, ose ato tregojnë për mosdëmtimin e pengpranuesit dhe për këtë porositi që pengpranuesi të bëjë durim e të presë ardhjen e penglënësit.”

Siç shihet, transmetimi tregon pikërisht këtë, nëse është e mundur që transmetimi të shpjegohet në këtë mënyrë, ndryshe është detyrim që transmetimi të shqyrtohet që nga kreu për shkak të deduksioneve që kanë nxjerrë fukahatë për këtë transmetim, ose shumica e tyre.

Shlyerja e një pjese të borxhit

Autori i librit “Miftahul Kerameh”, në pjesën e pestë, në faqen 201, ka thënë: “Sikur borxhmarrësi të shlyejë një pjesë të borxhit, sendi i lënë peng mbetet i gjithi peng, për shkak të mosshlyerjes së pjesës së mbetur të borxhit, sepse sendi është lënë peng për çdo pjesë të së drejtës që i takon pengpranuesit në sendin e lënë peng, duke pasur parasysh që në shumicën e rasteve qëllimet janë të varura me marrjen e borxhit prej sendit të lënë peng deri më një.”

Patjetër që kjo është vetëm një kërkesë ngulmuese e pohim prej autorit të librit “Miftahul Kerameh”, por ne pamë se, kur pengpranuesi ka vënë kusht qëndrimin e sendit peng te ai deri në shlyerjen e pjesës së fundit të borxhit, domethënë që sendi i lënë peng mbetet në gjendjen që është dhe prej tij nuk shkëputet asnjë

pjesë dhe, kur mos ndarja e sendit të lënë peng nuk është vënë kusht sipas shpjegimit të mësipërm, borxhmarrësi paguan, me qëllim që të mbajë besën për shlyerjen e borxhit.

Gjithashtu, edhe marrja në dorë e sendit të lënë peng prej pengpranuesit bëhet me qëllim që ai të marrë të drejtën e tij të plotë, duke shpëputur prej sendit të lënë peng aq sa është edhe pjesa e shlyer prej borxhit, gjithnjë duke vepruar sipas gjendjes, pasi në pikëpamjen e traditës, sendi i lënë peng ndjek borxhin.

Më sipër në kapitullin “Borxhi”, paragrafi “Shlyerja e një pjese të borxhit”, është thënë se borxhmarrësit nuk i lejohet të mos ketë në dorë një pjesë të së drejtës së tij, gjithashtu borxhmarrësi nuk mund të detyrohet që ai të shlyejë borxhin të plotë njëherësh.

Shpenzimi për sendin e lënë peng

Kur sendi i lënë peng është kafshë, ose ndonjë gjë tjetër që ka nevojë për shpenzim, konservim e ruajtje fizike, atëherë shpenzimi dhe të gjitha pagesat janë mbi penglënësin, sepse edhe dobitë e sendit të lënë peng i takojnë atij. Kur pengpranuesi merr ndonjë gjë prej dobive të sendit të lënë peng, pagesa bëhet me dhen dhe ai ka detyrim të paguajë një pagesë të ngjashme.

Një grup fukahash kanë thënë se, kur pengpranuesi shpenzon për sendin e lënë peng, atëherë atij për shpenzimin e bërë i takon dobia që vjen prej sendit të lënë peng. Këtë thënie fukahatë e kanë argumentuar me hadithin e transmetuar prej të Dërguarit më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Kafsha e lënë peng përdoret për hipje (ngarkesë),

shpenzimi për këtë kafshë është për atë që i hip (ngarkon). Gjithashtu, kur kafsha e lenë peng millet, shpenzimi për këtë kafshë është mbi atë që pi qumështin.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) kur një burrë pranon peng një deve, nëse ka të drejtë ta përdorë këtë deve për hipje. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse ai e ushqen devenë me bar, ai ka të drejtë ta përdorë atë për hipje, por, nëse këtë deve e ushqen me bar pronari i saj, pengpranuesi nuk ka të drejtë ta përdorë devenë për hipje.”

Autori i librit “El Xheuahir” është përgjigjur se hadithi dhe transmetimi tregojnë se detyrimi për shpenzimin mund të jetë për llogari të penglënësit ose të pengpranuesit dhe, nëse ky detyrim për shpenzimin nuk do të ishte i mundur, ose hadithi e transmetimi janë për ndonjë kuptim tjetër, atëherë shtrimi i kuptimit të detyrimit për të shpenzuar për kafshën i drejtohet të dyve, domethënë penglënësit e pengpranuesit, sepse që të dy e kanë të ndaluar të veprojnë me sendin e lënë peng, pa marrëveshje mes tyre.

Nuk është larg që tradita të jetë e pranishme në këtë çështje, por, kur sillet teksti, atëherë orientimi bëhet sipas traditës që ndiqej në atë kohë, domethënë: Pengpranuesi shpenzon dhe për shpenzimin e bërë, ai merr dobinë. Kur tradita ndryshon, atëherë gjykatësi ligjor vendos që dobia i takon pronarit, i cili është i detyruar të shpenzojë për sendin që ai ka lenë peng. Gjithashtu, tradita tregon se pengpranuesi është i ndaluar të veprojë me sendin e lënë peng pa lejen e penglënësit.

Konflikti

1- Kur sendi është në dorën e borxhdhënësit dhe ai thotë se ky send është peng te unë kundrejt borxhit, ndërsa pronari i atij sendi thotë: “Jo, ai send është i depozituar te ti.”, atëherë cili është pretenduesi dhe cili është mohuesi?

Shumica e fukahave të dëgjuar, kanë përshtatur dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir”, që thotë: “Mohues është pronari dhe pretendues është borxhdhënësi, sepse si bazë është moslënia peng.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për dy burra që kanë konflikt për një pasuri, nëse ajo është borxh apo është e depozituar. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Merret për bazë fjala e pronarit, me betimin e tij.”

2- Kur vdes pengpranuesi, e drejta e sendit të lënë peng i kalon trashëgimtarëve të tij, ndërkaq pronari i pasurisë thotë: “Nuk jam i siguar prej trashëgimtarëve për sendin e lënë peng.” Atëherë çështja mbetet siç thotë pronari. Nëse penglënësi e trashëgimtarët e pengpranuesit bien dakord ta lënë këtë pasuri në ruajtje te një njeri besnik, veprohet sipas marrëveshjes, ndryshe pasuria e vënë peng lihet në garancinë e gjykatësit ligjor, ose te ndonjë person që e për zgjedh pronari.

3- Kur penglënësi e pengpranuesi bien dakord për sendin e lënë peng, por kanë kundërshtim mes tyre për shumën e borxhit, gjykimi bëhet sipas fjalës së penglënësit, sepse si bazë nuk është shtesa, pra, veprohet sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur ata të dy kanë kundërshtime për sendin e lënë peng dhe njëri prej atyre të dyve thotë se është lënë peng për një mijë, kurse

tjetri thotë se është lënë për një qind, në këtë gjendje, merret për bazë fjala e atij që thotë një mijë, krahas sjelljes së argumentit. Nëse ai nuk ka argument, atëherë gjykohet në favor të atij që thotë një qind, krahas betimit të tij.”

4- Më sipër është thënë disa herë se penglënësit nuk i lejohet të veprojnë me sendin e lënë peng pa lejen e pengpranuesit dhe, kur penglënësi e shet sendin e lënë peng me pretendimin se pengpranuesi e ka lejuar shitjen për atë, ndërkaq pengpranuesi e mohon thënien e penglënësit, atëherë merret për bazë fjala e pengpranuesit, krahas betimit që ai bën, sepse si bazë është moslejimi i shitjes, derisa të vërtetohet e kundërta.

Kur pengpranuesi e lejon shitjen dhe, pasi sendi i lënë peng është shitur, pengpranuesi thotë: “Unë e kam ndryshuar mendimin para shitjes.”, kurse penglënësi e mohon që ai ka ndryshuar mendim, atëherë merret për bazë fjala e penglënësit, sepse si bazë është mosndryshimi, derisa të vërtetohet e kundërta.

Kur ata të dy kanë rënë në marrëveshje për lejimin dhe për heqjen dorë prej lejimit, por kanë kundërshtim mes tyre në lidhje se më parë është lejuar dhe pastaj është thënë moslejimi, në qoftë se pengpranuesi thotë: “Hoqa dorë nga lejimi para shitjes së sendit.”, atëherë shitja është e prishur, kurse penglënësi thotë: “Jo, ti ndryshove mendim për moslejim pas shitjes.”, në këtë gjendje, shitja është e vlefshme. Atëherë cili është mohuesi dhe cili është pretenduesi?

Rregullat e ligjit të fesë kërkojnë që të shikohet: Në qoftë se data e shitjes dihet dhe data e kthimit të fjalës për moslejim nuk dihet, për shembull, ne dimë se shitja është bërë ditën e xhuma,

por nuk dimë, a ka ndodhur kthimi për moslejimin ditën e enjte, apo ka ndodhur ditën e shtunë, në këtë gjendje, ne bëjmë analogjinë për mosndodhjen e shitjes deri ditën e shtunë, sepse është datë e panjohur.¹ Me këtë vërtetojmë se shitja ishte e krahasueshme me moskthim për lejimin dhe përfundimisht vendosim që shitja është e vlefshme, derisa të vërtetohet e kundërta.

Në lidhje me këtë çështje merret për bazë fjala e penglënësit.

¹ Ne bëjmë analogjinë e datës së panjohur deri në kohën e ndodhjes së datës, pavarësisht nga vonesa e ndodhjes tjetër, në të cilën u mësua data e ndodhjes, duke u larguar prej origjinës së vërtetuar, kurse efektet e rendisim bazuar mbi ekzistencën e datës së njohur, kur këto efekte janë të renditura, bazuar mbi ekzistencën e ndodhjes së njohur si datë, duke bërë krahasimin me mosekzistencën e datës tjetër të njohur, të vetë asaj dhe të ngjashmëve me të me subjektet e përbëra prej dy pjesësh, kur njëra prej pjesëve është e realizuar si ekzistencë, kurse pjesa tjetër është me analogji. Këtë çështje ne e kemi sqaruar në pjesën e tretë të këtij libri dhe, bazuar mbi sa është thënë, analogjia, në të gjitha gjendjet, ndodh në datën e panjohur, kur ne dimë mosanalogjinë e krahasuar me ndodhjen e datës për ekzistencën e ndodhjes së datës tjetër, sepse mundësia e krahasimit është e mjaftueshme për sistemimin e origjinës së mosrenditjes së efektit mbi kontratën. Hollësitë në lidhje me këtë çështje janë dhënë në bazat e Fik'hut logjik, si për shembull në librin "Resail" të shehut El-Ensarij, në pjesën e dytë të librit "Kifajetul-Usul" të shehut El-Kharasani, në pjesën e dytë të librit "Takrijrul-Mirza En'nainij" të shehut El-Khauij, ose të shehut Muham'med Ali El-Kharasani. Ky studim është i njohur me titullin "Data e panjohur" dhe është prej studimeve më të rëndësishme të bazave, është prej studimeve më të hollësishme e më dobiprurëse. Sipas mendimit tim, vetëm një përqind e studentëve arrijnë ta kuptojnë këtë çështje. Më parë kam menduar se çështja e datës së panjohur mund të ishte prej novacioneve e prej zbulimeve të dijetarëve të rij të fesë, derisa pashë se edhe autori i librit "El-Xhevahir" e ka cituar këtë çështje prej Muham'med bin Mek'kij, i njohur me epitelin Dëshmori i Parë, në fundin e kapitullit "Penglënia", "Çështja e gjashtë", vëllimi 3, në lidhje me konfliktin. Unë e vlerësova shumë këtë njeri të madh dhe bashkë me të tjerët shprehëm se edhe unë e lexoj atë. Të mëparshmit s'kanë lënë gjë për të mëvonshmit. Theksojmë se Dëshmori i Parë ka vdekur në vitin 786H.

Kur data e kthimit për moslejimin e shitjes është e njohur, kurse data e shitjes është e panjohur, si për shembull: Ne dimë se shitja është bërë ditën e xhuma dhe nuk dimë, nëse kthimi për mosshitjen ka ndodhur para apo pas kësaj dite, atëherë bëjmë analogjinë e vonimit të shitjes prej kthimit për moslejimin, sepse ajo datë është e panjohur. Me këtë ne vërtetojmë se kthimi ka ndodhur i krahasuar me mosshitjen, prandaj ne gjykojmë për prishjen e shitjes, derisa të vërtetohet e kundërta. Për këtë çështje merret për bazë fjala e pengpranuesit.

Në qoftë se ne nuk dimë as datën e shitjes e as datën e kthimit, atëherë të dyja datat janë prej kapitullit “Data e panjohur”, çka kundërshton rregullin e shoqërimit të mosndodhjes së njërës prej të dyja datave, kur ndodh data tjetër, për rrjedhojë, të dyja bazat shkojnë krah për krah, por edhe rrëzohen në mënyrë të ndërsjellë, kështu që çështja mbetet ashtu siç ishte dhe në vijim, për bazë merret fjala e pengpranuesit.

Pikërisht këtë kërkojnë edhe rregullat e vendosura në shkencën e bazave, por fukahatë më të dëgjuar janë larguar prej dëshmisë së autorit të librit “El Xheuahir” dhe kanë mbështetur në mënyrë absolute tezën se për bazë merret fjala e pengpranuesit pa asnjë analogji për qëndrimin e sendit të lënë peng në gjendjen e tij, derisa të vërtetohet e kundërta.

5- Kur ata të dy bien dakord për lënien peng dhe kanë kundërshtim në lidhje me caktimin e sendit të lënë peng, për bazë merret fjala e penglënësit, si për shembull, kur penglënësi thotë se e lashë peng te ti këtë shtëpi, por jo kopshtin, ndërsa pengpranuesi thotë se më le kopshtin, jo shtëpinë, atëherë ne mohojmë lënien peng të shtëpisë, sipas pohimit të pengpranuesit,

i cili në këtë gjendje, është pretendues si pengpranues i kopshtit, për rrjedhojë pengpranuesi duhet të sjellë argumentin, ndërsa penglënësi, kur s'ka argument, do të betohet.

6- Burri ka dy borxhe për t'i shlyer të njëjtit person dhe njëra prej dy borxheve është me penglënie, kurse borxhi tjetër nuk është me penglënie. Më pas ai shlyen vetëm njërin borxh dhe nuk shlyen borxhin tjetër, ndërkaq borxhmarrësi dhe borxhdhënësi kanë kundërshtim mes tyre dhe borxhmarrësi thotë: "I kam shlyer borxhin për të cilin ai kishte pengun.", kurse borxhdhënësi thotë: "Ke shlyer borxhin tjetër dhe jo atë të pengut.", në këtë gjendje, merret për bazë fjala e borxhmarrësit.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë veshje, sepse pagesa shikohet më mirë në qëllimin e tij dhe merret vesh vetëm nga ana e tij.

* * *

GARANTIMI

Garantimi, transferimi i pasurisë dhe marrja përsipër e detyrimit të tjetrit

Kur një person i ka dhënë borxh një tjetri në mirëbesim dhe ti merr përsipër që t'i shlyesh borxhdhënësit këtë borxh në vend të borxhmarrësit, pa kërkuar asgjë për veten tënde kundrejt sigurimit që jep për shlyerjen e këtij borxhi, në këtë gjendje, ti quhesh “Sigurues”, borxhdhënësi quhet “I siguruar” dhe borxhmarrësi quhet “I siguruar prej tij”.

Kur ti kërkohesh në vend të borxhmarrësit për shumën që more përsipër të shlyesh në vend të tij, kjo marrje përsipër, nga ana jote, quhet “Sigurim”, ose “Transferim i pasurisë”, që në gjuhën arabe thirret me termin “hauàleh”.

Kur ti nuk merr përsipër që borxhdhënësit t'i shlyesh borxhin, por merr përsipër të sjellësh te borxhdhënësi borxhmarrësin, të cilin ia dorëzon borxhdhënësit, kur ky i fundit e kërkon, kjo marrje përsipër quhet “Siguri me personin” dhe në gjuhën arabe thirret me termin “kefàleh”.

Me këtë shpjegim del qartë se termi “sigurim” te fukahatë ka dy kuptime: sigurim në kuptimin të veçantë, që do të thotë marrja përsipër e një detyrimi pasuror në favor të të cilit ti nuk ke asnjë detyrim, kurse në një kuptim të përgjithshëm, përsëri quhet sigurim, por që përfshin edhe sigurimin e veçantë.

Gjithashtu, sigurimi përfshin transferimin e detyrimit pasuror për të shlyer detyrimin për të garantuarin prej tij (borxhmarrësin), kurse sigurimi i përgjithshëm përfshin edhe marrjen përsipër për të shlyer borxhin e tjetrit kur ai s’ka mundësi të shlyejë borxhin e marrë.

Fukahatë kanë vënë nga një kapitull të veçantë për sigurimin në kuptimin e veçantë, për transferimin e detyrimit pasuror mbi veten dhe për marrjen përsipër të shlyerjes së borxhit për tjetrin.

Fukahatë në fillim kanë trajtuar sigurimin, pastaj transferimin e detyrimit pasuror dhe në fund marrjen përsipër të shlyerjes së borxhit për tjetrin. Edhe ne do të ndjekim rrugën e fukahave në trajtimin e këtyre çështjeve.

Ligjshmëria e garantimit

Sigurimi është veprim i ligjëruar me fjalën e përbashkët të fukahave, me librin e Allahut dhe me Sunetin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Allahu i Lartësuar, në librin e Tij, thotë: “وَأَنَا بِهِ زَعِيمٌ وَلِمَنْ جَاءَ بِهِ حِمْلُ بَعِيرٍ” - “... kush e sjell atë (enën e mbretit) ka (shpërblim) një barrë deveje dhe, për këtë unë jam garantues.” (Sure “Jusuf”, ajeti 72)

Në tekstin e Kur'anit fjala "garantues" ka ardhur me fjalën arabe "zeijm".

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka vdekur dhe ka pasur borxh dhe këtë të vdekur e garanton njëri prej kreditorëve. A mban përgjegjësi ai për shlyerjen e borxhit? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Kur për këtë janë dakord kreditorët, ai s'mban më përgjegjësi për shlyerjen e borxhit."

I Dërguari më i madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Ai që garanton për vëllain e tij një nevojë, Allahu i Lartësuar shumë shpejt do të plotësojë për këtë garantues nevojën që ai mund të ketë."

Garantimi e marrja përsipër e detyrimit të tjetrit, janë veprime të urryera

Ekspozimi dhe ballafaqimi me sigurimin dhe marrja përsipër e detyrimit tënd prej një tjetri, është veprim i urryer. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Ç'të mirë ke ti, kur tjetri merr përsipër detyrimin tënd? A nuk e ke mësuar se ky veprim ka shkatërruar brezat e përparshëm?!"

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Bëni kujdes ndaj kryerjes së detyrimeve dhe duroni ndaj pësimeve."

Përsëri Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Në Teurat është shkruar se marrja përsipër e shlyerjes së detyrimit të tjetrit, është pendim e gjobë."

Padyshim që këto fjalë të Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregojnë orientim e këshillë dhe jo vënien e një dispozite në ligjin e fesë islame, madje fjala e Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është e ngjashme me thënien “Ruhu prej germave shoqëruese.”, domethënë: Bëj kujdes prej ortakërisë, prokurimit dhe marrjes përsipër për të shlyer detyrimin e tjetrit (bërja garant për shlyerjen e detyrimit të tjetrit).”. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe imamët e nderuar kanë folur me cilësinë e tyre si individë të zakonshëm, ashtu siç kanë folur edhe me njohuritë e tyre ligjore për shpjegimin e dispozitave të ligjit të fesë islame.

Kontrata

Sigurimi mbështetet mbi disa kolona që janë: kontrata, siguruesi, sendi i siguruar, i siguruari (borxhdhënësi), i siguruari prej tij (borxhmarrësi) dhe e drejta e siguruar. Formula e sigurimit përbëhet prej ofertës nga ana e siguruesit dhe prej pranimi nga ana e të siguruarit. Kjo është më se e mjaftueshme për të gjitha aspektet që tregojnë këto dy terma të kontratës.¹

Për sigurimin nuk është kusht miratimi nga ana e të siguruarit prej tij, sepse shlyerja e borxhit të një personi prej një tjetri nuk mund të konsiderohet qëllim e miratim nga ana e borxhmarrësit. Patjetër, njoftimi që i bën siguruesi borxhmarrësit

¹ Shejkh En Nàijnij, duke komentuar kapitullin e parë “Sigurimi” të librit “El Urvetul Uuthkà”, ka thënë: “Rruga për të marrja përsipër e një detyrimi, reduktohet vetëm me fjalën, kurse kryerja e atij detyrimi reduktohet vetëm me veprimin, prandaj një detyrim takasativ i mirëfilltë, për të cilin, në mënyrë absolute nuk ka rrëzues.

se ai i ka shlyer borxhin e tij borrxhdhënësit, konsiderohet lejim nga ana e borxhmarrësit për siguruesin, ashtu siç do të shpjegohet më poshtë.

Një grup fukahash kanë thënë se në formulën e kontratës së garantimit është detyrim që fjalët të jenë sa më të shkurtra e kuptimplota dhe garantimi të mos jetë i varur me ndonjë gjë, si për shembull, kur burri thotë: “Unë jam garantues, nëse borxhmarrësi nuk e shlyen borxhin.”

Kjo lloj formule e kontratës nuk është e vlefshme dhe, bazuar mbi këtë rregull, fukahatë kanë arritur në një përfundim për pavlefshmërinë e garantimit të varur, sepse garantimi patjetër kërkon miratimin, por nuk mund të ketë miratim pa vendosmëri, ashtu siç nuk ka as vendosmëri me varësi.

Shpjegimet e mësipërme, në lidhje me lejimin, janë thjesht një rekomandim, pasi nuk ka asnjë tekst që të flasë për këtë çështje, prandaj është vetëm një pohim ajo që thuhet se garantimi është i vlefshëm, edhe kur miratimi është i varur. Bazuar mbi këtë pohim, ndjekësit e traditës mendojnë se kontrata e garantimit tregon miratimin për garantimin, edhe nëse garantimi jepet me varësi, prandaj kjo kontratë, jo vetëm që është e vlefshme, por është detyrim mbajtja e besës për këtë kontratë, gjithnjë bazuar mbi fjalën e Allahut të Lartësuar: “أَوْفُوا بِالْعُقُودِ” - “mbani premtimet” (Sure “El Maide”, ajeti 1), si dhe mbi fjalën e të Dërguarit më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Besimtarët janë në kushtet e tyre.”**

Ndjekësit e traditës nuk shikojnë asnjë kontradiktë mes kontratës së garantimit dhe varësisë së garantimit, madje ata e

bëjnë detyrim për cilindo garantues që i thotë borxhdhënësit: Nëse borxhmarrësi nuk të shlyen borxhin, atëherë jam unë ai që do të ta shlyej ty borxhin e tij, domethënë, unë do të mbaj besën për atë (borxhmarrësin). Në qoftë se supozohet se kjo fjalë nuk është e vlefshme si garantim, atëherë patjetër që fjala e tij për garantimin është e vlefshme nëpërmjet një rruge tjetër, qoftë edhe duke e konsideruar këtë garantim një kontratë të re prej kontratave jo nominale, për të cilat ne kemi folur në pjesën e tretë, madje kemi vërtetuar se është punuar me këto kontrata, plotësisht si me kontratat e zakonshme, sepse ato janë kontrata nominale. Përveç kësaj, kontrata e garantimit konfirmohet prej argumenteve të përgjithshme për kontratat.

Kontrata e garantimit është e detyrueshme për të dyja palët, për paraqitësin e ofertës dhe për pranuesin, madje edhe kur garantimi është bamirësi dhe kryhet pa lejen e të garantuarit prej tij. Garantuesit nuk i lejohet të thotë: “Heq dorë nga garantimi.”

Gjithashtu, nuk i lejohet as të garantuarit (borxhdhënësit) t’i thotë garantuesit, pasi më parë ka pranuar dhe ka miratuar që ai të jetë garantues: “Kam hequr dorë prej miratimit që garantimi të jetë prej teje dhe për këtë do të njoftojë të garantuarin prej tij (borxhmarrësin), përveçse kur vërtetohet se garantuesi është ngushtë nga gjendja ekonomike për të shlyer garantimin që ka marrë përsipër. Në këtë gjendje, i garantuari ka të drejtë ta prishë garantimin. Patjetër që ai ka të drejtë të rrëzojë borxhin që nga baza dhe me këtë veprim ai nuk ka më detyrim për garantimin, për shkak të heqjes së objektit të garantuar, që ishte borxhi i marrë prej tjetrit.

Garantuesi

Garantuesi duhet të plotësojë këto kushte:

1- Të ketë aftësi për veprime pasurore, prandaj nuk është e vlefshme garantimi i të çmendurit, i fëmijës, i të imponuarit dhe i të dehurit. Përsa i përket mendjelehtit, garantimi, nga ana e tij, është i lejueshëm vetëm me lejimin e kujdestarit të tij, kurse garantimi i të falimentuarit është i lejueshëm në mënyrë absolute, sepse garantimi i të falimentuarit është i vlefshëm si kreditim nga ana e tij, edhe nëse nuk ka marrë lejen e kreditorëve.

2- Kanë thënë se garantimi, në një kuptim të veçantë, është objekti i studimit në këtë kapitull. Gjithashtu, fukahatë kanë thënë se është kusht që besa e garantuesit për shlyerjen e detyrimit të marrë përsipër të mos jetë e preokupuar me një borxh në favor të të garantuarit prej tij, ndryshe angazhimi është transferim pasurie dhe jo garantim në kuptimin specifik të fjalës garantim.

3- Fukahatë më të dëgjuar kanë mbështetur mendimin se kusht për garantuesin është që ai të jetë në gjendje të mirë ekonomik, domethënë të jetë në gjendje të mbajë besën për shlyerjen e detyrimit që mori përsipër. Nëse i garantuari mëson në kohën e dhënies së garantimit se garantuesi është në vështirësi ekonomike, kjo është kusht në përmbajtjen, por jo në vlefshmërinë e kontratës së garantimit. Kur i garantuari pranon dhe më pas për atë bëhet e qartë se garantuesi është në vështirësi ekonomike, për të garantuarin vërtetohet e drejta të prishë garantimin dhe për këtë ai njofton të garantuarin prej tij, sepse kjo është përmbajtja e kontratës, pasi gjendja e vështirë ekonomike e garantuesit supozon dëmtimin e të garantuarit (borxhdhënësit).

Në këtë gjendje, dëmtimi korrigojohet me të drejtën e përzgjedhjes mes durimit ndaj garantuesit dhe mes prishjes së kontratës. Por kur i garantuari ka dijeni për vështirësinë ekonomike të garantuesit, megjithëkëtë ka dhënë miratimin në kohën e kontratës, në këtë gjendje, i garantuari s'ka të drejtë të heqë dorë nga garantimi, sepse ai ka riskuar me përzgjedhjen e tij, edhe pse ishte në dijeni për gjendjen e vështirë ekonomike të garantuesit, pra, është plotësisht si ai që ble një send me të meta, duke e ditur se sendi i blerë ka të meta, por, kur vështirësia ekonomike e garantuesit mësohet pas garantimit, atëherë s'ka përzgjedhje.

Kur borxhin e garanton më shumë se një person, nëse të gjithë ata e garantojnë borxhin me një kontratë të pavarur, është i vlefshëm garantimi i parë dhe është pa vlerë garantimi i mëvonshëm. Në qoftë se borxhin e garantojnë të gjithë me një kontratë të vetme, borxhi rrëzohet sipas numrit të garantuesve në mënyrë të barabartë.

I garantuari

Edhe për të garantuarin janë të njëjtat kushte që ishin për garantuesin, si aftësia për veprime ekonomike dhe miratimi për garantimin, sepse në këtë gjendje i garantuari është njëri prej dy kontraktuesve dhe pranimi nga ana e tij është pjesë e formulës së kontratës. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur miratojnë borxhdhënësit, shfajësohet i vdekuri për detyrimin që kishte.”

Transmetohet se kanë ardhur te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i kanë kërkuar të shkojë për të falur namazin e xhenazes së një të vdekuri. Ai i pyeti: “A ka lënë borxhe?” Ata thanë: “Po, dy dinarë.”

Ai tha: “A ka lënë ndonjë pasuri që mund t’i shlyejë këto dy dinarë?” Ata thanë: “Jo.”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk vajt. Më pas, të pranishmit i thanë: “Përse nuk vajte të falësh namazin e xhenazes së atij njeriu?”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu përgjigj: “Falja e namazit të xhenazes së tij, nga ana ime, nuk i sjell atij asnjë dobi, nëse ndonjëri prej jush nuk garanton shlyerjen e borxhit të tij.” Ndërkaq Imam Ali bin Ebu Talibi (*Paqja qoftë mbi të!*), ose sikurse thuhet, Katadeh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) garantoi të japë dy dinarët dhe i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vajt dhe fali namazin e xhenazes të së vdekurit në fjalë.

Hadithi tregon se nuk është kusht miratimi prej të garantuarit, pasi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e fali namazin e xhenazes para miratimit të borxhdhënësve.

Një grup fukahash janë shprehur se ky hadith tregon për një çështje që ka të bëjë me një ndodhi të veçantë dhe s’ka lidhje me ndodhi të tjera, prandaj fukahatë kanë thënë se përgjigjja më e saktë, në lidhje me këtë hadith, është ajo që ka dhënë autori i librit “El Xheuahir”: “Miratimi për garantimin, nga ana e Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

është më se i mjaftueshëm, pasi ai ka përparësi ndaj të gjithë besimtarëve, madje edhe më shumë se ata kanë ndaj vetes së tyre.”

Patjetër që duhet të veçojmë të garantuarin prej tij, në lidhje me atë çka është e vlefshme për qëllimin e përbashkët me atë vetë, prandaj nuk është kusht që ai të njoftohet për të vërtetën e realizimit të garantimit. Kjo çështje është e ngjashme me rastin kur ti shikon një borxhdhënës që i kërkon borxhin borxhmarrësit dhe ti i thua borxhdhënësit, pa ditur asgjë më parë për atë: “Lëre atë, unë jam garantues për borxhin e tij.”

Nuk lejohet garantimi i borxhit prej mendjelehtit pa lejen e kujdestarit të tij, kurse borxhet e të falimentuarit janë në sekuestro për llogari të borxhdhënësve dhe lejohet garantimi i borxheve të tij për borxhdhënësit dhe nuk lejohet që borxhet e të falimentuarit të garantohen për të falimentuarin.

I garantuari prej tij

Për të garantuarin prej tij nuk është kusht as mendja, as arritja e moshës, as aftësia për të dalluar e as miratimi i tij për garantimin bamirës, madje nuk është kusht as që ai të jetë gjallë. Është i vlefshëm garantimi për të çmendurin, fëmijën, mendjelehtin, të falimentuarin dhe të panjohurin, sepse garantimi është plotësisht si shlyerja e borxhit, për të cilën nuk merret parasysh miratimi i borxhmarrësit, si dhe për faktin se kontrata e garantimit realizohet me ofertën nga ana e garantuesit, kurse pranimi është nga ana e të garantuarit, kështu që garantimin e përfshijnë argumentet e mbajtjes së besës për kontratat.

Patjetër që me një mënyrë, ose me një tjetër, duhet të veçojmë të garantuarin prej tij, në lidhje me atë çka është e vlefshme për qëllimin e përbashkët me atë vetë. Në qoftë se i garantuari prej tij është i panjohur dhe nuk dihet nëse i ka borxh dy vetëve ose më shumë, në këtë gjendje, garantimi nuk lejohet, si për shembull, kur një person i ka borxh dy vetëve dhe ti thua: “Unë garantoj vetëm borxhin e njërit prej atyre të dyve.”

E drejta e garantuar

Fukahatë janë shprehur: Në të drejtën e garantuar është kusht që ajo e drejtë të jetë e vërtetuar se është në ruajtje. Garantimi nuk është i vlefshëm kur ti i thua një personi: “Jepi filanit për llogarinë time dhe unë jam garantues për atë çka ti i jep atij.” Në këtë mënyrë, nuk është vërtetuar asnjë gjë e dhënë në mirëbesim, që të ketë lidhje me garantimin, Duhet të theksojmë se kjo thënie është fjala e përbashkët e të gjithë fukahave në lidhje me këtë çështje.

Por burrat e mençur dhe ata që ndjekin traditën, një thënës të këtillë e shikojnë përgjegjës të përkushtuar në ofertën që ai bën. Atëherë, cila është rruga që bashkon mes thënies së burrave të mençur që i përmbahen vlefshmërisë së këtij obligimi dhe fjalës së përbashkët të dijetarëve të fesë që janë shprehur për prishjen e garantimit?

Përgjigje: Nuk është domosdoshmëri absolute që garantimi të mos jetë i vlefshëm. Në shembullin e mësipërm: “Jepi filanit dhe unë do të jap ty në vend të tij.”, del qartë që vlefshmëria nuk kufizohet as me garantim e as me kontratë të nominuar, pasi

ndjekësit e traditës shikojnë të rëndësishme që në obligimin të vërtetohet emri kontratë dhe obligimi i përmendur të vërtetojë emrin kontratë, ashtu siç supozohet, kështu që obligimi përfshin edhe tregtinë merr-jep. Për më tepër, kjo mënyrë obligimi, përfshihet në ajetin e Kur'anit "Ruani premtimet.", si dhe me hadithin: "Besimtarët janë në kushte e tyre."

Lejohet garantimi për atë që është vërtetuar në mirëbesim, por vetëm si lejim dhe jo si detyrim, si për shembull, dhënia e shumës së kurorës (mehr) para martesës reale, ose dhënia e çmimit për sendin e vënë në shitje gjatë kohës së përzgjedhjes, kur dihet që shuma e kurorës meritohet vetëm pas martesës reale, gjithashtu, edhe çmimi për sendin e vënë në shitje vërtetohet vetëm pasi të kalojë koha e përzgjedhjes, patjetër kur nuk kemi prishje të sendit.

Fukahatë kanë thënë se lejohet që ti të garantosh shpenzimin e kaluar të bërë për gruan dhe nuk lejohet garantimi i shpenzimit të ardhshëm, sepse ky i fundit, realisht, nuk është vërtetuar. Veç kësaj, garantimi për të ardhmen, gjithmonë është i ekspozuar të mos vërtetohet për shkak të koprracisë, divorcit, ose edhe vdekjes.

Ne mbështesim vlefshmërinë e garantimit për shpenzimin në të ardhmen, jo vetëm për faktin e ekzistencës së lidhjes ligjore, që është martesa, por edhe për faktin se në këtë obligim, në pikëpamjen e traditës, vërtetohet emri kontratë dhe, si e këtillë, përfshihet në ajetin e Kur'anit: "أَوْفُوا بِالْعُقُودِ" -"mbani premtimet" (Sure "El Maide", ajeti 1) dhe është e njëjtë me obligimin e atij që thotë: "Jepi filanit dhe unë të jap ty në vend të tij."

Kurse martesë është e ekspozuar ndaj koprracisë, divorcit dhe vdekjes së bashkëshortit, prandaj përgjigja e tij është detyrimi për mbajtjen e besës në çdo kontratë, sipas kërkesave të saj, për rrjedhojë i obliguari ka detyrim të shpenzojë për bashkëshorten e tij, derisa shkaku i shpenzimit vazhdon të jetë veprues.

Shejkh Ahmed Kàshif El Gatàë, në librin “Uesijletu Nexhàt”, në kapitullin “Garantimi”, është shprehur: “Thënia për vlefshmërinë e shpenzimit për bashkëshorten në të ardhmen nuk është larg, madje mund të ketë edhe fjalën e përbashkët të fukahave.”

Edhe Sej'jid Kàdhim El Jezdij, në librin “El Urvetul Uuthkà”, në kapitullin “Garantimi”, në “Çështja 38”, thotë: “Nuk ka pengesë për garantimin, derisa nuk është bërë detyrim pas vërtetimit të klauzolës, sepse për mosvlefshmërinë e garantimit për të ardhmen s'ka argument, nuk ka as tekst e nuk është as fjala e përbashkët e fukahave, edhe pse është shumë e përhapur në thëniet e lakuara prej njerëzve, madje për vlefshmërinë e garantimit për të ardhmen tregojnë një tërësi burimesh.

Në Çështjen 35 të kapitullit të lartpërmendur, autori i nderuar thotë: “Nuk është larg vlefshmëria e shpenzimit për të ardhmen për bashkëshorten, sepse janë të mjaftueshme ekzistenca e klauzolës detyruese, që është martesë.”

Për vlefshmërinë e garantimit nuk është kusht që garantuesi të dijë sasinë dhe llojin e borxhit. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur Muham'med bin Usàmehit po i afrohej vdekja, te ai hynë pjesëtarët e tribusë (kabile) beni Hashim. Ai u tha atyre: “Ju e dini sa i afërm jam te ju, ju dini edhe pozitën

që unë gëzoj te ju, por unë kam borxh dhe dua që ju të shlyeni këtë borxh për mua.”

Ali bin Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Gjithë borxhin tënd e marr unë përsipër.”

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) garantoj borxhet e Ibn Usamehit, pa e ditur se sa ishte sasia e lloji i atyre borxheve, natyrisht që në kuadrin e mbajtjes së besës, patjetër duhet të dihet lloji dhe sasia e borxheve, sepse tani ato janë detyrim mbi garantuesin.

Garantimi vërtetohet vetëm me mbajtjen e besës për borxhin e vërtetuar me dokument, ose të atij borxhi për të cilin mësohet me një rrugë prej rrugëve që mundësojnë njohjen me të dhe, ashtu siç kanë thënë fukahatë, me kusht që borxhi të jetë i vërtetuar në kohën e garantimit dhe jo për borxhin që mund të vërtetohet më pas.

Gjithashtu, jo edhe për atë borxh që mund të pohojë borxhmarrësi pas garantimit, sepse pohimi është argument që reduktohet vetëm në atë çka është vendosur, gjithashtu jo edhe për atë borxh që i kalohet një tjetri.

Kur garantimi është i përgjithshëm e i pakushtëzuar me njërën prej kohëve, atëherë garantimi ndjek borxhin, sepse është degë e dalë prej borxhit, për rrjedhojë shtyhet afati i mbajtjes së besës prej garantuesit, nëse borxhi i garantuar është me afat të vonuar dhe shpejtohet, nëse borxhi është me afat të shpejtuar.

Lejohet garantimi i borxhit që duhet të shlyhet, në çast me një garantim të vonuar, ashtu siç lejohet garantimi i borxhit që

duhet të shlyhet me vonesë, me një garantim të vonuar, ose me shtimin e afatit.

Thënë ndryshe: Për çdo gjë në të cilën bien dakord garantuesi dhe i garantuari dhe që ka të bëjë me vonimin e me shpejtimin e shlyerjes, kjo marrëveshje është e vlefshme dhe e lejuar, sepse afati është një e drejtë për atë që i takon, prandaj lejohet vonimi, por lejohet edhe dhënia më përpara me miratimin e palës tjetër.

Gjithashtu, lejohet edhe rrëzimi i garantimit në tërësi, por në të gjitha gjendjet për garantuesin lejohet të kërkojë prej të garantuarit prej tij vetëm në dy gjendje: E para: Të shtyjë afatin e shlyerjes së borxhit dhe jo afatin e garantimit.

E dyta: Garantuesi të shlyejë borxhin për të garantuarin prej tij dhe, kur ai nuk e shlyen, ai nuk ka të drejtë të kërkojë prej të garantuarit prej tij, madje edhe kur hyn afati i borxhit. Kur afati i shlyerjes nuk ka hyrë akoma, ai s'ka të drejtë të kërkojë prej tij, madje edhe sikur të shlyejë borxhin.

Për garantuesin e për të garantuarin lejohet që secili prej tyre të vërë kusht përzgjedhjen me një kohë të përcaktuar, bazuar mbi argumentet e përgjithshme që kushtëzojnë detyrimin për mbajtjen e besës.

Garantimi i pasurive

Nga sa u tha më sipër, u bë e qartë se garantimi i borxhit të vërtetuar në ruajtje, është i lejuar me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst (ajet Kur'ani dhe hadith), kurse garantimi i pasurive të jashtme bëhet sipas sqarimit të mëposhtëm:

1- Pasuria të jetë në dorën e një personi, i cili e garanton pronarin e saj, vetëm në rast atakimi ose abuzimi, për shembull, sendi i depozituar, sendi i lënë peng, spekulacionet pasurore, (lëvizjeve për qëllim fitimi nga njëri vend në tjetrin), si dhe kreditë që nuk janë as flori e as argjend. Të gjitha këto pasuri quhen jo të garantuara, sepse pasuria që është në dorën e tij, nuk mund të garantohet në asnjë gjendje.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për mosvlefshmërinë e garantimit të pasurive të lartpërmendura derisa ato ekzistojnë si pasuri, sepse shkak i garantimit nuk realizohet dhe në këtë gjendje garantimi i këtyre pasurive është garantim i një pasurie të pagarrantuar.

2- Pasuria të jetë në dorën e një personi që e garanton pronarin e saj në të gjitha gjendjet, abuzon ose nuk abuzon, vë ose nuk vë dorë mbi atë pasuri, si për shembull, sendi i rrëmbyer, sendi i futur në dorë me parapagim, ose me kontratë të prishur, shkëmbimi i floririt e i argjendit, të gjitha këto pasuri quhen sende të garantuara, sepse për të gjitha sendet që janë dorën e tij, ai është garantues.

Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me garantimin e këtyre pasurive. Një pjesë e fukahave janë shprehur se një të huaji i lejohet të marrë përsipër në favor të pronarit të

sendit për aq sa ai ka në dorën e tij prej asaj pasurie dhe ai merr përsipër që t'ia kthejë atij këtë send, kur sendi qëndron në gjendjen ekzistuese, ose i kthen atij zëvendësuesin, në rast të prishjes së atij sendi, sepse shkaku i garantimit është i realizuar dhe garantimi nuk është garantim për gjera që nuk janë obligim, gjithnjë sipas fjalës së të Dërguarit më të madh (*Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi atë e mbi familjen e tij!*): “Lideri është borxhli.” (me fjalën lider kuptohet garantuesi). Kjo thënie e hadithit përfshin të gjitha sendet që ai obligohet të garantojë. Kjo është e barabartë, qoftë kur sendi është borxh, ose një send prej sendeve.

Të gjitha këto çështje janë të bazuara në argumentet e përgjithshme të përmendura disa herë më sipër, si ajeti i Kur'anit: “mbani premtimet” dhe hadithi: **“Besimtarët janë në kushtet e tyre.”**

Të tjerë fukaha, ndër të cilët edhe autori i librit “El Xheuahir” dhe autori i librit “El Hadaik”, kanë thënë se nuk lejohet garantimi i këtyre pasurive, sepse kuptimi i termit garantim të fukahatë xhaferij do të thotë transferim i detyrimit për shlyerjen e detyrimit prej një personi te një person tjetër, por kjo është një gjë, kurse detyrimi për kthimin e një sendi të jashtëm është një gjë tjetër.

Me fjalë të tjera, garantimi objekt studimi në këtë kapitull, është prej çështjeve të detyrueshme të kryhen dhe nuk është prej çështjeve që kanë të bëjnë me sende të jashtme, që do të thotë se rrëmbyesi dhe ata që kanë lidhje me rrëmbyesin, ligjërisht janë të detyruar të kthejnë sendin dhe dispozitat ligjore nuk pranojnë garantimin që është në kuptimin e transferimit të sendit prej një personi te një person tjetër, por patjetër që pranohet garantimi në

kuptimin e aneksimit të një detyrimi në një detyrim tjetër për të kryer, pasi kështu mbetet detyrimi i rrëmbyesit dhe detyrimi që ai të kthejë atë çka është detyrim për atë, sepse është detyrim që nuk mund të transferohet prej tij te një person tjetër. Megjithëkëtë, fukahatë xhaferij, siç u tha edhe më sipër, nuk shprehen në lidhje me këtë çështje.

3- Shitja ndodh mes dy vetëve dhe një i tretë merr përsipër të arrijë të marrë çmimin prej shitësit në favor të blerësit, kur sendi i vënë në shitje rezulton se i takon një tjetri, ose kur bëhet e qartë prishja e shitjes për shkak të humbjes së njërit prej kushteve të shitjes, kur blerësi i ka paguar shitësit çmimin, ose kur një i tretë merr përsipër në favor të shitësit t'i paguajë blerësit, kur rezulton se çmimi i caktuar për shitjen është e drejtë e një tjetri. Ky garantim quhet paradhënie dhe garantim i arritur.

Fukahatë e kanë lejuar këtë garantim dhe kanë nxjerrë edhe argumentet për lejimin e për vlefshmërinë e tij, bazuar në rrugën që kanë ndjekur myslimanët në kohët e mëparshme dhe në kohët e mëvonshme, si dhe për domosdoshmërinë e këtij garantimi, pasi, nëse ky garantim nuk do të lejohej, njerëzit patjetër do të viheshin në vështirësi të shumta.

Garantimi i arritjes së çmimit të ndërtimit dhe i mbjelljes së tokës

Le të marrim një shembull: Një person ble prej një tjetri një tokë dhe blerësi ndërton mbi atë tokë një shtëpi, ose ai mbjell pemë në atë tokë. Më pas del në shesh se ajo tokë i takon një tjetri. Me fjalën e përbashkët të fukahave, pronari e shemb ndërtesën

dhe shpenzimi është mbi shitësin, me kushtin që blerësi nuk kishte dijeni në lidhje me të drejtën e atij tjetrit mbi atë tokë, sepse shitësi, në këtë rast, ka mashtruar blerësin, prandaj blerësi, si person i mashtruar, ka të drejtë të kërkojë prej atij që e mashtroi. Por, a lejohet që një i tretë të garantojë këtë blerës në lidhje me atë çka ndodhi mbi këtë truall, kur ai ta nxjerrë tjetrin prej të drejtës që i takon?

Fukahatë më të dëgjuar mbështesin dëshminë e autorit të librit “El Urvtul-Uuthka”, i cili flet për pavlefshmërinë e këtij garantimi, sepse blerësi s’ka asnjë të drejtë për të marrë prej shitësit para se të asgjësojë ndërtimin ose pemët e mbjella, pra, derisa garantimi të jetë i vlefshëm, i cili tani quhet garantim për diçka që e ka detyrim.

Më sipër është përmendur shumë herë se mbajtja e besës te ndjekësit e traditës është detyrim në çdo veprim për të cilin vërtetohet emri kontratë dhe se detyrimi për mbajtjen e besës, për të gjitha kontratat, vjen sipas kërkesës së kontratës. Prandaj, bazuar mbi këtë që u tha, është i vlefshëm edhe një garantim i këtillë, domethënë është detyrim mbajtja e besës për garantimin, kur të asgjësohet ndërtimi ose pemët e mbjella. Me këtë shpjegim kanë dhënë sentencë Dëshmori i parë (Shehijdul Euel), Dëshmori i Dytë (Shehijdu Thanij) dhe autori i librit “El Urveul Uuthka”.

Kurse garantimi, nga ana e shitësit për blerësin, është që ai të marrë në dorë çmimin, ose të marrë në dorë ndërtimin, ose pemët e mbjella, kurse sendi i vënë në shitje, në këtë rast toka, del nga e drejta e tjetrit. Ekzistenca e mosekzisenca e atij sendi është e barabartë, sepse ai është garantues me vetë kontratën, madje edhe

sikur të mos marrë përsipër garantimin, ai nuk del dot nga kjo përgjegjësi.

Për të garantuarin s'ka rrugë të kërkojë prej të garantuarit prej tij

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me autorin e librit “El Xheuahir”, me autorin e librit “El Hadaik” dhe me autorë të tjerë se, kur kushtet e garantimit realizohen të gjitha, pasuria transferohet prej kujdesit të të garantuarit prej tij nën kujdesin e garantuesit, prandaj i garantuari nuk ka të drejtë të kërkojë asgjë prej të garantuarit prej tij, sepse garantimi te fukahatë xhaferij është transferim i pasurisë prej një kujdestarie në një kujdestari tjetër dhe jo bashkim i një kujdestarie me një kujdestari tjetër. Në terminologjinë e përgjithshme të fukahave, ky transferim pasurie njihet me emrin kujdestari ose garantim, për faktin se në një pasuri të vetme nuk mund të ketë dy kujdestari në të njëjtën kohë, ashtu siç nuk ka kujdestari të vetme bazuar mbi transferimin e herëpashershëm dhe mbi mosaktimin.

Për këtë çështje tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur bien dakord kreditorët, i vdekuri nuk mban përgjegjësi për shlyerjen e asaj që kishte marrë në kujdestari.”

Kjo fjalë e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) flet qartë për mosmbajtjen e përgjegjësisë nga ana e të garantuarit prej tij, pasi është bërë garantimi.

Garantuesi i kërkon të garantuarit prej tij

Garantuesi i kërkon të garantuarit prej tij atë çka ai i garantoj atij, kur garantimin ai e ka bërë me lejen e të garantuarit prej tij, ndryshe garantuesi nuk ka të drejtë të kërkojë prej të garantuarit prej tij, sepse në rastin e mosmarrjes leje prej të garantuarit prej tij, garantuesi është bamirës. Autori i librit “El Xheuahir” thotë: “Për këtë dëshmon fjala e përbashkët e fukahave.”

Kur i garantuari e shkarkon garantuesin nga përgjegjësia për shlyerjen e borxhit, është i çliruar nga shlyerja e borxhit edhe i garantuari prej tij. Në këtë gjendje, garantuesi nuk ka më të drejtë të kërkojë prej të garantuarit prej tij, sepse e drejta për të kërkuar është e lidhur me kryerjen e shlyerjes së borxhit për të garantuarin prej tij me lejen e këtij të fundit, edhe nëse garantuesi ka bërë garantimin pa lejen e të garantuarit prej tij, por nëse, në mënyrë absolute, garantuesi nuk e ka shlyer borxhin, atëherë garantuesi s’ka asnjë të drejtë të kërkojë shumën prej të garantuarit prej tij.

Kur i garantuari e liron të garantuarin prej tij nga detyra e shlyerjes, përgjegjësia e garantuesit nuk mund të hiqet, sepse supozohet që i garantuari prej tij, pas garantimit, është i huaj për të garantuarin dhe shkarkimi i tij nga përgjegjësia e shlyerjes nuk ka asnjë ndikim mbi garantuesin, sepse ndryshe do të kuptohej prej tij sikur ai e dëshironte shkarkimin nga përgjegjësia për shlyerjen së borxhit. Bazuar mbi këtë klauzolë, padyshim që garantuesi lirohet nga përgjegjësia e detyrimi që mori përsipër.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se garantuesit nuk i lejohet të kërkojë prej të garantuarit për atë dhe të kërkojë prej tij

ndonjë gjë, por ai ka të drejtë të kërkojë prej tij vetëm pasi të kryejë detyrimin e të garantuarit prej tij, sepse përgjegjësia e të garantuarit prej tij nuk ka më asnjë lidhje, por ka lidhje vetëm pas shlyerjes së borxhit, me kusht që garantimi të jetë bërë me lejen e të garantuarit prej tij dhe me kusht që garantimi të mos jetë më shumë se origjina e borxhit. Kur i garantuari shkarkon garantuesin nga përgjegjësia e shlyerjes së borxhit, ky i fundit nuk mund të kërkojë asgjë prej të garantuarit prej tij, por, nëse i garantuari e shkarkon garantuesin nga një pjesë e përgjegjësisë, pasi ka marrë vetëm një pjesë të borxhit, atëherë garantuesi i kërkon të garantuarit prej tij vetëm pjesën e mbetur prej borxhit të tij.

Argumentet për këto thënie fukahatë i kanë nxjerrë prej transmetimit që tregon për një dikë që ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka garantuar një burrë tjetër deri në garantimin më të mbrapsmë dhe pastaj për këtë garantim kanë bërë pajtim mes tyre. Çfarë pjese i takon garantuesit?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Garantuesit i takon vetëm pjesa për të cilën është bërë pajtimi.”

Kur garantuesi i paguan të garantuarit eksponate të paraqitura, garantuesi ka të drejtë të kërkojë prej të garantuarit prej tij vlerën e eksponateve, qoftë kur vlera e tyre është në masën e borxhit, qoftë kur është më pak dhe, nëse borxhet janë më shumë, atëherë garantuesi kërkon të drejtën që duhet të shlyente i garantuari prej tij.

Disa garantues

Është i vlefshëm garantimi nga një person i dytë për garantuesin e parë, gjithashtu është i vlefshëm garantimi nga një person i tretë për garantuesin e dytë e kështu me radhë, sepse ky lloj garantimi është kontratë me kushte të plota, për rrjedhojë është detyrim të mbahet premtimi për plotësimin e kësaj kontrate. Bazuar mbi këtë kontratë, garantuesi i tretë ka të drejtë të kërkojë prej garantuesit të dytë, garantuesi i dytë kërkon prej garantuesit të parë dhe garantuesi i parë ka të drejtë të kërkojë origjinën e garantimit prej të garantuarit prej tij. Kushtet për të gjithë garantuesit janë të njëjta.

Çështje:

1- Për garantuesin lejohet të garantojë borxhin më pak nga sa është vetëm me miratimin e të garantuarit, prandaj garantuesi kërkon prej të garantuarit prej tij vetëm aq sa ka shlyer, patjetër ashtu siç u tha edhe më sipër, garantimi bëhet krahas lejes së këtij të fundit për garantimin.

Gjithashtu, është e vlefshme që garantuesi të garantojë borxhin edhe më shumë nga sa është, sepse supozohet që shtesa nuk rëndon si kusht në borxhin që ka marrë i garantuari prej tij, domethënë kur shtesa nuk është kamatë, sepse borxhmarrësi ka të drejtë të kthejë borxhin më shumë nga sa ka marrë si bamirësi nga ana e tij. Nga këto që thamë, arrijmë në përfundim se për garantuesin nuk lejohet të kërkojë prej të garantuarit asgjë më shumë se borxhi origjinë, madje edhe kur ka paguar për të garantuarin prej tij disa herë më shumë.

2- Kur dy vetë janë në një anije dhe njëri prej atyre të dyve ka mallra, ndërkaq tjetri i thotë atij që ka mallrat: “Flaki mallrat e tua në det, se e marr unë përsipër garantimin për ato mallra.”, a është i vlefshëm ky garantim në atë mënyrë, që kur ai të flakë mallrat në det, garantuesi të jetë i detyruar të paguajë zëvendësuesin për ato mallra?

Fukahatë kanë thënë se, kur këtë ia thotë për shkak të frikës se mund të mbytet anija, për shkak të peshës, me fjalën e përbashkët të fukahave, garantimi është i vlefshëm me argumentin e largimit të dëmit, por, nëse nuk është kjo frikë, atëherë garantimi nuk është i vlefshëm, sepse është papjekuri, madje fukahatë kanë një fjalë të përbashkët për mosvlefshmërinë e këtij lloj garantimi, edhe sikur ai t’i thotë atij: “Grise rrobën tënde, ose plagose veten dhe unë marr përsipër të garantoj.”

Me lejen e Allahut, shpjegim më i zgjeruar në lidhje me këto çështje do të jepet në kapitullin “Shuma për shlyerjen e vrasjeve” (ed’ dijat).

3- Më sipër u shpjegua se i garantuari nuk mund t’i kërkojë të garantuarit prej tij, por, nëse ky i fundit i paguan të garantuarit borxhin e marrë, atëherë nuk mbajnë më përgjegjësi për shlyerjen e borxhi as i garantuari prej tij e as garantuesi. Në lidhje me këtë çështje, autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë mvëshje e pa asnjë kundërshtim.”

4- Kur borxhi i garantuar prej garantuesit është borxh me afat kohor të caktuar dhe garantuesi vdes para se të kalojë afati, me vdekjen e tij borxhi bëhet me afat të përshpejtuar dhe merret

prej pasurisë që ai ka lënë. Këtë çështje e kemi trajtuar më sipër në kapitullin “Borxhi”.

Në këtë gjendje trashëgimtarët e garantuesit kanë të drejtë të kërkojnë prej të garantuarit prej tij vetëm pasi të kalojë afati i shlyerjes së borxhit, për faktin se ndërhyrja në pasurinë e garantuesit për shkak të vdekjes së tij, nuk kërkon ndërhyrjen në pasurinë e të garantuarit prej tij.

Gjithashtu, edhe sikur garantuesi të rrëzojë afatin dhe të shlyejë borxhin para afatit, përsëri garantuesi i kërkon të garantuarit prej tij vetëm pasi të ketë kaluar afati i borxhit.

5- Kur garantuesi garanton pa lejen e të garantuarit prej tij dhe, pasi garantimi është plotësuar, i garantuari prej tij i thotë garantuesit: “Shlyeje për mua.”, a ka të drejtë garantuesi të kërkojë shumën që pagoi për shkak të lejimit për të shlyer borxhin?

Përgjigje: Në asnjë mënyrë, sepse shkak i kerkimit është pikërisht leja për garantimin dhe jo leja për të bërë shlyerjen, sepse garantimi e transferon pasurinë që është në dorën e të siguarit prej tij në dorën e garantuesit. Bazuar mbi këtë shpjegim, i garantuari prej tij nuk mban përgjegjësi për borxhin dhe fjala e tij: “Paguaj për mua.”, është si fjala e çdo personi që s’ka përgjegjësi ndaj borxheve të njerëzve, kur ti nuk ke asnjë borxh për të shlyer.

Konflikti

1- Kur garantuesi e i garantuari kanë mosmarrëveshje në lidhje me sasisë e borxhit të garantuar, ose me sasinë që garantuesi merr përsipër të garantojë, ose kanë konflikt mes tyre në lidhje me kushtin e përshpejtimit të shlyerjes së borxhit me afat të shtyrë, për bazë merret fjala e garantuesit, sepse si origjinë është mos shtesa.

Kur ata të dy kanë mosmarrëveshje në lidhje me kryerjen e së drejtës, ose me lirimimin nga e gjithë përgjegjësia, ose nga një pjesë e saj, ose për shtyrjen e afatit, merret për bazë fjala e të garantuarit, sepse si bazë është qëndrimi i origjinës në gjendjen që ishte.

2- Kur garantuesi e i garantuari prej tij kanë mosmarrëveshje në lidhje me lejen dhe garantuesi thotë: “Ti më lejove të garantoj për ty.” dhe i garantuari prej tij thotë: “Në asnjë mënyrë, nuk të kam dhënë leje.”, në këtë rast merret për bazë fjala e të garantuarit prej tij dhe garantuesi ka detyrim të sjellë argument. Kur garantuesi thotë se i shleu borxhin të garantuarit dhe i garantuari prej tij mohon që garantuesi e ka shlyer borxhin, atëherë pyetet i garantuari. Nëse i garantuari vërteton fjalën e garantuesit, atëherë detyrimi për shlyerjen e borxhit bie mbi të garantuarin prej tij, sepse pohimi i të garantuarit vërtetohet me marrjen e të drejtës së tij dhe është argument kundër mohuesit. Por nëse i garantuari mohon që garantuesi e ka shlyer detyrimin, atëherë garantuesi ka detyrim të sjellë argument.

3- Kur garantuesi e mohon garantimin që prej bazës dhe i garantuari sjell argument për garantimin që i është dhënë atij, prej

garantuesit merret e drejta e plotë dhe garantuesi s'ka të drejtë të kërkojë asgjë prej të garantuarit prej tij, sepse vetë mohimi i tij për origjinën e garantimit, është pohim nga ana e tij, që i garantuari prej tij nuk i ka dhënë leje garantuesit për garantimin. Më sipër është shpjeguar se kur nuk ka leje, garantuesi s'ka të drejtë të kërkojë prej të garantuarit prej tij.

4- Kur ti i ke borxh një personi dhe i ke dhënë leje ndonjërit prej të njohurve të tu që ai të shlyejë borxhin tënd pa e njoftuar borxhdhënësin për garantimin dhe pas një kohe ai thotë: "Në plotësim të dëshirës tënde, unë e shleva detyrimin që ti kishe." dhe, nëse ti e mohon fjalën e tij, ke detyrim të vërtetosh se borxhi ka mbetur ashtu siç ishte, ndërsa ai ka detyrim të betohet, pasi në këtë gjendje ai është pretendues. Ndodh kështu kur borxhdhënësi nuk pohon shlyerjen e borxhit, por me pohimin e tij nuk mbetet më vend për grindje e për mosmarrëveshje.

* * *

TRANSFERIMI I PASURISË

Transferuesi, personi për ku drejtohet transferimi dhe personi mbi të cilin mbetet transferimi

Kur ti i ke borxh Zejdit një shumë, gjithashtu edhe Amri të ka borxh ty një shumë, ndërkaq ti ke lejuar që Zejdi të kërkojë borxhin prej Amrit dhe Zejdi është dakord me këtë transferim detyrimi, në këtë gjendje, ti je transferuesi, Zejdi është personi për ku drejtohet transferimi, kurse Amri është personi mbi të cilin mbetet transferimi, ndërsa paratë janë objekti i transferueshëm. Në këtë gjendje, kemi transferim të pasurisë nga një ruajtje e lidhur me detyrimin për shlyerjen e një borxhi në një ruajtje tjetër.

Këtë parashtrim e bëmë për të sqaruar shpjegimet që do të japim më poshtë.

Ligjshmëria e transferimit të pasurisë

Transferimi i pasurisë është veprim i ligjësuar me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst. Prej teksteve kemi transmetimin që tregon për përgjigjen që i ka dhënë Imam Sadiku

(*Paqja qoftë mbi të!*) një burri që i ka lejuar një burri tjetër një sasi dirhemësh. A ka të drejtë t'i kërkojë ato dirhemë prej tij? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në asnjë mënyrë nuk i kërkon atij, me përjashtim të rastit kur ai ka falimentuar para kësaj.”

Miratimi

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për transferimin e pasurisë dhe kanë thënë: “Patjetër duhet miratimi i transferuesit dhe i personit për ku drejtohet transferimi.”

Miratimi i transferuesit kërkohet për faktin se personi që ka borxh për të shlyer, mbajtja e besës nga ana e tij për shlyerjen, nuk mund të imponohet në njërin anë të pasurisë së tij dhe në anën tjetër të saj jo. Në lidhje me personin mbi të cilin mbetet transferimi, fukahatë kanë një mendim të përbashkët për marrjen në konsideratë të miratimit të tij, në rastin kur ai, në mënyrë absolute, nuk ka marrë borxh prej transferuesit, ose ka marrë borxh prej tij një lloj tjetër pasurie të ndryshme nga borxhi i parë, për shembull: I ka borxh grurë dhe ai për të shlyer detyrimin e tij në grurë, i jep para. Në këtë gjendje, marrja e të drejtës edhe pa miratim, është marrje e të drejtës, edhe pse me një lloj të ndryshëm nga lloji me të cilin kishte detyrim shlyerjen.

Fukahatë kanë kundërshtim në lidhje me miratimin e personit mbi të cilin mbetet transferimi, kur ai ka borxh për t'i shlyer transferuesit me të njëjtën pasuri që u transferua te ai.

Shumica e fukahave janë shprehur për të marrë në konsideratë fjalën e tij, sepse nuk ka argument që vërteton transferimin e pasurisë përveç miratimit nga ana e tij. Baza mbetet ashtu siç ishte: Lidhja e detyrimit të transferuesit me borxhin e personit për te i cili u drejtua transferimi dhe lidhja e detyrimit të personit mbi të cilin mbetet detyrimi me borxhin e transferuesit, edhe kur transferimi është bërë pa miratimin e tij.

Fukaha të tjerë kanë thënë se nuk merret në konsideratë miratimi i personit për te i cili bëhet transferimi, përderisa transferuesit i kërkohet e njëjta gjë që ai lejoi, sepse njerëzit janë zotërues të pasurisë së tyre në mënyrë të barabartë, qoftë kur ajo është objekt i jashtëm, qoftë kur ajo është në ruajtje me detyrim për shlyerje. Atij që ka për të marrë të drejtën e tij i lejohet t'i thotë atij që ka detyrim të shlyejë borxhin: "Jepi atij prej të drejtës që ke detyrim të shlyesh dhe bjer dakord që detyrimi që mbetet mbi, për cilido që ti dëshiron dhe me atë çka ti dëshiron, pavarësisht, nëse këtë e miraton, ose nuk e miraton personi që ka detyrim të shlyejë të drejtën që rëndon mbi atë." Gjithashtu, mbi këtë të fundit lejohet transferimi i detyrimit për shlyerjen e borxhit, pavarësisht nëse ai pranon ose kundërshton.

Bazuar mbi thënien e fukahave më të dëgjuar, në lidhje me marrjen në konsideratë, miratimin e personit mbi të cilin mbetet transferimi në përgjithësi, qoftë kur ai s'ka përgjegjësi, ose kur ka borxh për të shlyer me të njëjtën gjë që ka marrë ose me një gjë tjetër, bazuar mbi këtë, patjetër që duhet miratimi i të treve: i transferuesit, i personit për te i cili drejtohet transferimi dhe i personit mbi të cilin mbetet transferimi me të gjitha pjesët e tij, bazuar mbi rregullin e plotësimit të kontratës së transferimit vetëm me ofertën nga ana e transferuesit dhe pranimit nga ana e

personit për te i cili drejtohet transferimi. Për sa i përket miratimit nga ana e personit për te i cili mbetet transferimi, miratimi i tij është kusht për vlefshmërinë e kontratës dhe jo pjesë e kontratës. Gjithashtu, është e vlefshme që miratimi i tij të jetë paraprak ose i vonuar, si dhe i bashkëngjitur me kontratën. Për të gjitha këto thuhet se kontrata e transferimit është e përbërë prej ofertës nga ana e transferuesit dhe prej dy pranimeve: njëri pranim nga ana e personit për te i cili drejtohet transferimi dhe pranimi tjetër nga ana e personit mbi të cilin mbetet transferimi.

Sido që të jetë, poliedriku El Hil'lij në librin "El Kauaid" ka pohuar se transferimi është kontratë e ligjëruar për të bërë transferimin e pasurisë prej një ruajtjeje në një ruajtje tjetër. Gjithashtu, transferimin e kanë pohuar edhe shumë fukaha të tjerë dhe kanë thënë se transferimi, si koncept, është transferimi i pasurisë prej një ruajtjeje në një ruajtje të ngjashme që ka lidhje me shlyerjen e detyrimit. Pohimi i parë është ndërtuar mbi faktin se transferimi realizohet krahas mospërgjegjësisë për ruajtjen e detyrimit për shlyerjen nga ana e personit mbi të cilin mbetet transferimi, kurse pohimi i dytë është bazuar mbi faktin se transferimi realizohet vetëm me shqetësimin për ruajtjen e detyrimit për shlyerje nga ana e personit mbi të cilin mbetet transferimi, duke ditur se të gjithë kanë rënë dakord që marrja përsipër e shlyerjes së detyrimit prej atij që nuk ka përgjegjësi, është veprim i vlefshëm, por te mbështetësit e pohimit të parë, ai veprim quhet edhe garantim, edhe transferim, kurse te mbështetësit e pohimit të dytë ai veprim nuk quhet transferim, por quhet vetëm garantim. Siç shihet, kundërshtimi qëndron vetëm në formën e emërimit dhe jo në thelbin e çështjes.

Kjo ishte një përmbledhje e thënieve të fukahave, kurse njerëzit e zakonshëm prej kuptimit të fjalës “transmetim” kuptojnë se borxhmarrësi transferon detyrimin e tij për shlyerjen e borxhit që i detyrohet borxhdhënësit te një person tjetër dhe në asnjë rast nuk e mveshin se personi mbi të cilin bie transferimi është i kërkuar, ose nuk është i kërkuar prej transferuesit.

Kushtet

1- Të japin miratimin transferuesi, personi për te i cili drejtohet transferimi dhe personi mbi të cilin mbetet transferimi, ashtu siç u tha më sipër. Është e kuptueshme që në rast se dikush, për bamirësi, sponsorizon për të shlyer borxhin e transferuesit, nuk është kusht që të merret miratimi i tij, pavarësisht se kush është sponsorizuesi bamirës, sepse për mbajtjen e besës për shlyerjen e për garantimin e borxhit, nuk është kusht të merret miratimi i borxhmarrësit.

2- Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se transferimi patjetër duhet të jetë i ekzekutueshëm dhe i jo varur mbi ndonjë send, plotësisht siç ishte edhe për garantimin, prandaj kur personi për te i cili drejtohet transferimi i thotë transferuesit: “E pranova transferimin si detyrim mbi filanin, me kusht që në rast se ai nuk paguan, unë kam të drejtën të kërkoj prej teje.”, në këtë gjendje, kemi prishje të kushtit dhe të transferimit, për rrjedhojë çdo gjë mbetet ashtu siç ishte më parë.

Konstatohet se kjo marrëveshje mes këtyre të dyve nuk është e vlefshme si transferim, patjetër që është e vlefshme me një emër tjetër. E rëndësishme është që për këtë angazhim dhe për

ndonjë angazhim të ngjashëm, të vërtetohet emri kontratë të ndjekësit e traditës dhe, kur të vërtetohet emri kontratë, atëherë është detyrim mbajtja e besës për këtë kontratë. Shpjegime të hollësishme në lidhje me këtë çështje janë dhënë në kapitullin “Garantimi”, paragrafi “Formula”.

3- Transferuesi, personi për të i cili drejtohet transferimi dhe personi mbi të cilin mbetet transferimi, të kenë aftësi për veprime pasurore. Kuptohet që është i vlefshëm transferimi nga ana e të falimentuarit mbi një person që nuk ka përgjegjësi për borxhet e tij, sepse ai është homolog me kredituesin, prej të cilit, me fjalën e përbashkët të fukahave, transferimi është veprim i vlefshëm.

4- Pasuria e transferuar të jetë e vërtetuar që është nën ruajtjen e transferuesit në favor të personit për të i cili drejtohet transferimi. Kjo është e barabartë, qoftë kur vërtetohet se ajo është pasuri e qëndrueshme, si për shembull, kredia dhe çmimi i sendit që patjetër duhet të shitet, qoftë kur vërtetohet se pasuria nuk është e qëndrueshme, si për shembull, shuma e kurorës për gruan para martesës dhe çmimi i sendit të shitur gjatë kohës së përzgjedhjes. E rëndësishme është që pasuria e transferuar të jetë në ruajtje me njërën prej mënyrave të vërtetuara dhe, nëse ajo, në origjinë, nuk vërtetohet që është në ruajtje, atëherë ajo është marrje përsipër e detyrimit të tjetrit, që me shqiptimin e fjalës transferim, pasi në marrjen përsipër të detyrimit të tjetrit nuk është kusht të thuhet ndonjë fjalë e veçantë. Kur dikush që nuk të ka borxh asgjë, të thotë: “Unë të kam lejuar ty borxhin që kam për të marrë te filani, prandaj merre atë borxh prej tij.”, ky është prokurim i thënë me fjalën transferim pasurie dhe, kur ti e fut në

dorë atë pasuri, ajo mbetet amanet në dorën tënde për interes të pronarit të saj.

Nuk ka dallim në të drejtën e pasurisë së transferuar, nëse ajo është objekt, si para ose drithë, ose ajo është përfitim, si për shembull, burri merr taksinë për ta çuar në një vend të caktuar, ose pasuria është punë, si për shembull, burri paguan një ndërtues që ai të ndërtojë për atë një mur, pa i vënë ndërtuesit kusht që ky mur është për atë vetë. Në të gjitha këto raste transferimi është i vlefshëm.

Pyetje: Kur një njeri i thotë një tjetri: “Më kredito mua dhe kompensimin për këtë kreditim merre prej Zejdit.” dhe bashkëbiseduesi është dakord me kreditimin dhe marrjen e kompensimit prej Zejdit, gjithashtu edhe Zejdi miraton të mbajë besën për këtë shlyerje, a është i vlefshëm një veprim i tillë? Nëse është i vlefshëm, në radhë parë, duhet të dihet se prej cilës anë është, duke ditur se nuk është as garantim në kuptimin e veçantë e as transferim pasurie, sepse supozohet që detyrimi i këtij thënësi nuk ka lidhje me kredinë.

Autori i librit “El Urvrtul Uuthkà”, i është përgjigjur kësaj pyetje me këto fjalë: “Kjo është e vlefshme si transferim pasurie për shkak se emri transferim pasurie vërtetohet për këtë kreditim.”

Por përgjigje më e mirë mbetet ajo që është thënë më sipër disa herë: Nuk është prej domosdoshmërive, kur ky veprim nuk është i vlefshëm as si transferim pasurie e as si garantim në kuptimin e veçantë që të mos jetë i vlefshëm në asnjë rast, qoftë edhe me një konsideratë tjetër, domethënë, që të jetë obligim i pavarur në vetvete, si të gjitha kontratat jonominale, vlefshmëria e

të cilave vendoset me mbajtjen e besës për plotësimin e këtyre kontratave, thjesht për faktin se për ato vërtetohet emri kontratë nga këndvështrimi i ndjekësve të traditës.

Sikur personi mbi të cilin mbetet transferimi të vërë kusht shtyrjen e afatit të shlyerjes dhe për këtë shtyrje të afatit është dakord edhe personi për te i cili u drejtua transferimi, atëherë kushti është i vlefshëm, edhe nëse është borxh që duhet të shlyhet në çast. Gjithashtu, kushti është i vlefshëm, edhe kur personi për te i cili drejtohet transferimi vë kusht shlyerjen e përshpejtuar dhe për këtë është dakord personi mbi të cilin mbetet transferimi, edhe nëse borxhi është me shlyerje të vonuar, gjithnjë veprohet sipas hadihit: “Besimtarët janë në kushtet e tyre.”

5- Shumica e fukahave të dëgjuar mbështesin dëshminë e autorit të librit “El-Xhevahir” dhe të autorit të librit “Miftahul Kerameh” që janë shprehur për kushtin e pasjes dijeni prej të treve për llojin e për sasinë e pasurisë së transferuar, sepse mospasja dijeni nënkupton mashtrim dhe, kur ka mashtrim, është e pamundur të mbahet besa për shlyerjen e borxhit dhe për të marrë e për të dhënë.

6- Personi mbi të cilin mbetet transferimi në kohën që bëhet transferimi duhet të ketë fuqi që të mbajë besën për shlyerjen, ose personi për te i cili drejtohet transferimi ka dijeni për gjendjen e ngushtë të personit mbi të cilin mbetet transferimi dhe ai e miraton këtë transferim. Por nëse ai, në kohën që bëhet transferimi, s’ka dijeni për gjendjen e ngushtë të personit mbi të cilin mbetet transferimi dhe për gjendjen e tij të ngushtë ai mëson më pas, në këtë gjendje, ai ka të drejtë ta prishë kontratën e transferimit dhe të kërkojë prej transferuesit.

Kur personi mbi të cilin mbetet transferimi është në gjendje të mirë në kohën e bërjes së transferimit dhe më pas ai vjen në gjendje të ngushtë, në këtë rast, nuk ka prishje të transferimit.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që lejon një burrë të marrë prej një shkëmbyesi monedhash (kambist) dhe më pas gjendja e kambistit ndryshon. A mund të kërkojë pronari i kësaj pasuri prej atij që e lejoi dhe ai ishte dakord?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jo.”

Me fjalën “ndryshim i gjendjes së kambistit” kuptohet falimentimi i tij, pasi në kohën e transferimit ai ishte i pasur.

Nevoja e transferimit dhe mospërgjegjësia e detyrimit për shlyerje nga ana e transferuesit

Kur plotësohen kushtet, transferimi është i vlefshëm, bëhet i detyrueshëm me të drejtën e të treve. Asnjërit prej tyre nuk i lejohet të heqë dorë nga transferimi dhe i fundit shkarkohet nga përgjegjësia për të shlyer borxhin që i kishte personit për te i cili është drejtuar transferimi. Mbetet shqetësimi për detyrimin e shlyerjes prej personit mbi të cilin mbetet transferimi. Personi për te i cili drejtohet transferimi nuk ka të drejtë të kërkojë asgjë prej transferuesit, edhe në rastin kur nuk e merr të drejtën e tij prej personit mbi të cilin mbetet transferimi, sepse “transferim pasurie” do të thotë transferim i borxhit nga një përgjegjësi për shlyerje në një përgjegjësi shlyerje tjetër, ashtu siç e tregon vetë fjala “transferim pasurie”.

Sikur përgjegjësia e transferuesit të jetë e varur me borxhin, për termin “transferim pasurie” dhe për degëzimet që dalin prej këtij termi, nuk do të kishte asnjë kuptim që të tregonte transferimin.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që i lejon një burri tjetër një pasuri. A ka të drejtë të kërkojë lejuesi prej burrit të dytë?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në asnjë rast nuk kërkon prej tij, me përjashtim të rastit kur ai falimenton, domethënë falimenton para transferimit.”

Disa fukahaja, bazuar mbi një transmetim të lënë pas dore prej fukahave, kanë thënë se përgjegjësia për shlyerjen, nga ana e transferuesit, nuk mund të hiqet, derisa personi për të i cili drejtohet transferimi të prononcohet: “Unë ta heq ty përgjegjësinë për shlyerjen e borxhit.”

Kur përgjegjësia për shlyerjen e borxhit prej personit mbi të cilin mbetet transferimi është e varur për transferuesin me të njëjtën gjë me të cilën ai e ka dhënë për transferimin, atëherë bie edhe përgjegjësia e tij për shlyerjen e borxhit të tij, por, nëse përgjegjësia e shlyerjes është e varur me një send ose me një shumë jo të ngjashme, atëherë bëjnë llogari mes tyre.

Për secilin prej tre personave që përmenden për transferimin e pasurisë, lejohet të vihet kusht përzgjedhja për prishjen e transferimit, për shkak të argumenteve të përgjithshme që flasin për detyrimin e mbajtjes së besës me kushtin.

Transferim i njëpasnjëshëm

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët në lidhje me lejimin e transferimit të njëpasnjëshëm, që do të thotë bashkim mes personit për të i cili drejtohet transferimi i pasurisë, i pasurisë së transferuar dhe i disa personave mbi të cilët mbetet transferimi Shembull për këtë çështje: Ti ke borxh për të marrë prej Zejdit, Zejdi, nga ana e tij, të lejon ty të marrësh prej Amrit, më pas Amri të lejon ty të marrësh prej Halidit dhe Halidi të lejon të marrësh prej Ibrahimit. Të gjitha këto transferime janë të vlefshme, krahas kushteve që u thanë më lart.

Transferim prej blerësit dhe shitësit

Kur ti i shet Zejdit një send dhe Zejdi të lejon që çmimin ta marrësh prej një të treti dhe veprimi ka miratimin e të gjithëve, ose kur ti lejon një të tretë të marrë çmimin prej Zejdi, por më pas Zejdi të kthen sendin e shitur për një shkak të ligjësuar, në këtë rast, a është i pavlefshëm transferimi?

Përgjigjja për këtë pyetje kërkon sqarim mes faktit që kthimi është i pavlefshëm për shkak të pavlefshmërisë së shitjes që në origjinë, si për shembull, kur bëhet e qartë se objekti i shitur është vakëf, si dhe mes faktit tjetër, që kthimi për prishjen e shitjes ndodh për shkak të njërës prej përzgjedhjeve. Në qoftë se kthimi është për shkak të pavlefshmërisë së shitjes, transferimi, në mënyrë absolute, është i pavlefshëm. Kjo është e barabartë, qoftë kur blerësi lejon shitësin të marrë prej një të treti, qoftë kur shitësi lejon një të tretë të marrë prej blerësit. Për sa i përket pavlefshmërisë së transferimit, kur shitësi është transferuesi, kjo

është e qartë, sepse transferimi është i vlefshëm, kur transferuesi i ka borxh personit për të i cili drejtohet transferimi. Më sipër u shpjegua qartë se për shkak të pavlefshmërisë së shitjes, blerësit nuk mund t'i kërkohej asgjë në favor të shitësit, kurse pavlefshmëria e transferimit, kur shitësi është transferuesi dhe blerësi është personi mbi të cilin mbetet transferimi, për shkak të shqetësimit të tij për ruajtjen e detyrimit për shlyerjen e çmimit, kurse tani që u bë e qartë e kundërta, menjëherë transferimi bëhet i pavlefshëm, madje edhe nëse bazohemi mbi thënien për lejimin e transferimit si detyrim mbi një person që s'ka përgjegjësi. Me një fjalë, transferimi nuk mund të mbetet mbi blerësin, edhe sikur ai të mos mbajë përgjegjësi, por transferimi mbetet mbi lidhjen me detyrimin për kujdesin e tij për të shlyer shumën, kujdes për të cilin u bë e qartë se nuk ka të bëjë me blerësin.

Në qoftë se kthimi është për shkak të prishjes së shitjes dhe jo për shkak të pavlefshmërisë së saj, transferimi është i vlefshëm, për faktin se ka ndodhur në gjendjen kur blerësi kishte detyrimin për të shlyer çmimin, sepse prishja nuk e bën shitjen të pavlefshme në origjinën e saj, por që prej kohës së prishjes, duke supozuar se transferimi është bërë para prishjes dhe në kohën kur shitja ishte e vlefshme, atëherë transferimi është i vlefshëm plotësisht, si në rastin kur shitësi ble një rrobë me çmimin e sendit të shitur dhe pastaj blerësi e kthen sendin e blerë me përzgjedhje. Në këtë rast, nuk është e pavlefshme blerja e rrobës dhe rroba nuk është pasuri e blerësit. Në këtë gjendje, blerësi kërkon prej shitësit t'i kthejë çmimin, nëse sendi i shitur vazhdon të jetë në gjendjen që ishte, ose i kërkon zëvendësuesin, kur sendi i shitur është prishur.

Me një fjalë, transferimi nga ana e blerësit, në favor të shitësit, mbi një të tretë dhe transferimi nga ana e shitësit, në favor të një të treti mbi blerësin, është i pavlefshëm, kur shitja është e pavlefshme dhe është i vlefshëm, kur shitja është e prishur. Në gjendjen e pavlefshmërisë, çmimi mbetet pronë e blerësit dhe ai e kërkon çmimin kudo që të jetë, kurse në gjendjen e vlefshmërisë, blerësi ka të drejtën e kthimit të sendit të shitur te shitësi, edhe sikur blerësi ta ketë lejuar shitësin të marrë prej një të treti, megjithëse shitësi nuk ka marrë asgjë në dorë prej të tredit, sepse transferimi është i vlefshëm plotësisht si kërkimi për shlyerjen e borxhit.¹

Konflikti

Kur personi mbi të cilin mbetet transferimi e shlyen pasurinë e transferuar dhe pastaj kërkon prej transferuesit atë çka ai shleu për atë, por transferuesi thotë: “Ajo që ti shleve, ishte një borxh që duhet të më kthehej mua, borxh për të cilin ti kishe detyrim ta shlyeje.”, kurse personi për te i cili është drejtuar transferimi e mohon këtë dhe thotë: “Jo, ti nuk ke asgjë për të marrë prej meje.”, në këtë rast, merret në konsideratë fjala e personit mbi të cilin mbeti transferimi dhe transferuesi është i detyruar të paraqesë argumentin, sepse si orgjinë është

¹ Një grup fukahash kanë ndarë prej anëve të tjera, përveç anës që ne përmendëm dhe për këtë e kanë tjerë fjalën gjatë e gjerë. Këtë ndarje e kanë përmendur shumë prej krerëve të fukahave, sidomos ata që janë pika referuese të këtij shekulli, ndër të cilët Es’sej’jid El-Jezedij, shejhu En’nàijnij në librin “El-Urvetul-Vuthkà”, Es’sej’jid Ebul-Hasen në librin “Vesijletu-n’nexhàt”, Es’sej’jid El-Hakimj në pjesën e dytë të librit “Minhàxhu-s’sàlihijn”.

mospërgjegjësia e tij për ruajtjen e besës për shlyerjen e detyrimit, derisa të vërtetohet e kundërta.

Patjetër, kush vë kusht për vlefshmërinë e transferimit që ajo të jetë nën ruajtjen e personit të i cili mbeti transferimi të jetë e lidhur me shqetësimin në favor të transferuesit, në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e transferuesit, ku është edhe dyshimi për vlefshmërinë e transferimit, sepse origjina e vlefshmërisë është krahas transferuesit, prandaj në konsideratë merret fjala e tij dhe jo fjala e personit të i cili mbeti transferimi, i cili pretendon prishjen e transferimit. Por ti mësove se fjala më e përhapur është e kundërta e kësaj.

Pyetje: Personi të i cili mbeti transferimi pretendon se shlyerja është detyrim i transferuesit, kurse transferuesi e mohon këtë pretendim. Është e kuptueshme se origjina mbetet mosdetyrimi për shlyerjen, derisa të vërtetohet e kundërta. Bazuar mbi këtë, transferuesi, në këtë gjendje, është mohues, kurse personi të i cili mbeti transferimi është pretendues, edhe kur vlefshmëria e transferimit nuk është kushtëzuar me varësinë e përgjegjësisë për shlyerjen nga ana e personit të i cili mbeti transferimi.

Ne përgjigjemi se dyshimi në lidhje me detyrimin për shlyerjen nga ana e transferuesit është i shkaktuar dhe i lindur prej dyshimit, në shqetësimin për mbajtjen e besës për shlyerjen e detyrimit nga ana e personit mbi të cilin mbetet transferimi. Kur ne e çojmë mospërgjegjësinë e shlyerjes së detyrimit nga ana e personit mbi të cilin mbetet transferimi, bazuar mbi këtë veprim, mohohet dyshimi për mospërgjegjësinë e detyrimit për shlyerje nga ana e transferuesit. Vetëm kështu kemi dijeni të qartë për

lidhjen e detyrimit për shlyerjen, sepse, siç thuhet në bazat e fik'hut, origjina shkaktuese është autoritare mbi origjinën e shkaktuar.

2- Kur ti i ke borxh një personi dhe i thua atij: "Të kam dhënë prokurë që të marrësh prej filanit që më ka borxh mua." dhe, pasi ai e fut në dorë shumën e borxhit, të thotë ty: "Ti më lejove të marr borxhin që kishe detyrim të më shlyeje dhe me fjalën "të kam dhënë prokurë" ke pasur qëllim transferimin e detyrimit." Ti i thua atij: "Në asnjë mënyrë, me fjalën "të kam dhënë prokurë" kam pasur qëllim vetëm atë çka tregon fjala prokurë."

Në qoftë se për këtë çështje nuk ka ndonjë shembull të ngjashëm që të përcaktojë njërin prej dy kuptimeve, në konsideratë merret fjala që ti i the atij, bazuar te rregulli: "Vepruhet sipas asaj që kuptohet nga ana e jashtme e fjalës."

Kur ti i thua atij: "Të lejova.", dhe më pas pretendon se me atë fjalë ke pasur qëllim prokurimin dhe jo transferimin, puna është krejtësisht e kundërta dhe në konsideratë, për të njëjtin shkak merret fjala e tij.

Kur në mesin tuaj nuk është thënë as fjala prokurim e as fjala transferim, por është thënë një fjalë tjetër dhe më pas ka ndodhur mosmarrëveshja, nëse ishte prokurim apo transferim, në konsideratë merret fjala e atij që mohon transferimin dhe pretenduesi i kësaj fjale ka detyrim të vërtetojë pretendimin e tij dhe, ashtu siç u tha më sipër, transferim do të thotë kalimi i pasurisë prej një detyrimi për ruajtjen e saj në një detyrim tjetër për ruajtje, megjithëse bazë është mostransferimi dhe mbetja e

pasurisë në pronësi të atij që e ka atë pasuri, njëkohësisht mbi borxhmarrësin mbetet detyrimi për shlyerjen e borxhit, derisa të vërtetohet e kundërta.

* * *

GARANCIA (el kefàleh)

Ç'do të thotë garanci? (kefàleh)

Te fukahatë “garanci” do të thotë detyrim nga ana e dhënësit të garancisë për personin për të cilin jepet garancia, që të sjellë detyrimin e këtij të fundit, kur sjelljen e detyrimit e kërkon i garantuari prej garantuesit që ta ketë si dokument. Gjithashtu, dhënësi i garancisë nuk mungon të sjellë detyrimin që mori përsipër, kur i kërkohet.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Besueshmëria në burimin e garancisë qëndron në marrjen përsipër për të sjellë pikërisht detyrimin që duhet të shlyhet për shkak të një të drejte, qoftë edhe për një pretendim nga ana e kërkuesit të garancisë. Padyshim që garancia nuk është e vlefshme në dënimet fizike (el hudùd), sipas fjalës së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “S’ka garanci në ekzekutimin e dënimit ligjor.”

Siç shihet, garancia ka të bëjë me tri persona: dhënësi i garancisë, i garantuari dhe personi për të cilin jepet garancia.

Kushtet

Për garancinë janë këto kushte:

1- Kontrata e garancisë është prej elementeve të kontratës dhe jo prej kushteve të saj.¹

Kontrata e garancisë realizohet me ofertën nga ana e dhënësit të garancisë dhe me pranimin, nga ana e të garantuarit. Nisur nga ky përcaktim, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se duhet të merret në konsideratë miratimi nga ana e këtyre të dyve, por ata kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me miratimin nga ana e personit për të cilin jepet garancia. Shumica e fukahave janë shprehur për mosmarrjen në konsideratë të miratimit nga ana e këtij të fundit dhe kanë argumentuar se garantuesi është si i prokuruari dhe personi për të cilin jepet garancia është si sendi për të cilin jepet prokurimi. Ashtu siç nuk merret në konsideratë miratimi i personit për të cilin jepet prokura, po ashtu nuk merret në konsideratë miratimi i personit për të cilin jepet garancia.

Ky shpjegim ka ardhur në librat “El Xheuahir”, “El Hadaik” dhe “Miftahul Kerameh”.

¹ Dallimi mes termit “kolonë” (rukn) dhe termit “kusht” (shart) është: Kolona e sendit është brenda sendit dhe është pjesë e tij, kurse kushti është jashtë sendit. Ne i përmendëm këto dy terma në të njëjtin paragraf, sepse edhe rezultati i çdo njëres prej këtyre dy termave është i njëjtë, në atë mënyrë që prej mosekzistencës së tij, mosekzistenca bëhet e detyrueshme dhe prej ekzistencës së tij, ekzistenca nuk bëhet e detyrueshme. Për të njëjtin shkak, kështu do të veprojmë në kapitujt që kanë mbetur.

Unë nuk njoh ndonjë standard më të dobët se ky dhe do të qe më mirë të thuhej se, kush ka ndonjë detyrim për të shlyer në favor të një tjetri, është i detyruar ta kryejë këtë shlyerje dhe mban përgjegjësi për shlyerjen e atij detyrimi, e miraton ose jo dhe, kush nuk ka ndonjë detyrim ndaj ndonjërit, nuk është e vlefshme që ai të detyrohet ta shlyejë këtë detyrim, veçse me miratimin e tij. Është e kuptueshme se garantuesi nuk ka ndonjë detyrim para se ai të japë garancinë, kurse personi për të cilin jepet garancia ka përgjegjësinë e shlyerjes së detyrimit në favor të atij që ka një të drejtë për të marrë prej tij, por që të dy nuk mund të detyrohen me ndonjë gjë tjetër përveç asaj me të cilën ata angazhuan veten. Për sa i përket të garantuarit, ai ose është borxhmarrës, ose mbi atë pretendohet. Borxhmarrësi mban përgjegjësi para borxhdhënësit dhe është i detyruar të shlyejë të drejtën që i takon borxhdhënësit, kurse personi mbi të cilin pretendohet, mban përgjegjësi para pretenduesit dhe është i detyruar të paraqitet në kuvendin e gjykimit me dëshirë ose kundër dëshirës së tij, Për këtë shkak merret në konsideratë miratimi i atyre të dyve dhe jo miratimi i tij.

2- Garantuesi të jetë i mençur, në moshë madhore dhe të ketë fuqi të sjellë garancinë që ka marrë përsipër. Nuk është e vlefshme garancia e atij që s'ka fuqi, për shkak të pamundësisë së tij për të sjellë garancinë që mori përsipër. Garancia nuk i lejohet as kujdestarit të të çmendurit e as kujdestarit të fëmijës që ai të japë garanci për ndonjë person në vend të të çmendurit, ose të fëmijës (prej pasurisë së të çmendurit e prej pasurisë së fëmijës për të cilën ai është kujdestar), por këtij kujdestari i lejohet të pranojë garanci në favor të të çmendurit e në favor të fëmijës. Në qoftë se i çmenduri ose fëmija kanë ndonjë të drejtë për të marrë prej ndonjë

personi për të cilin është frikë se ai do të mungojë dhe për këtë person jep garanci një tjetër, kujdestari ka të drejtë të pranojë garancinë për personin që ai ka në kujdestari, patjetër kur plotësohen kushtet e garantuesit.

3- Personi për të cilin jepet garancia të jetë i caktuar me emër dhe nuk është e vlefshme të thuash: “Unë garantoj njërin prej këtyre të dyve, ose garantoj këtë, ose atë tjetrin.”, sepse qëllimi me garancinë është sjellja e personit për të cilin është dhënë garancia, por kjo është e pamundur, kur personi nuk njihet saktësisht se cili është.

4- Një grup fukahash kanë thënë se te garancia është kusht plotësimi i saj. Sikur garantuesi të thotë: “Unë jap garanci, që kam mundësi ta sjell, por ndodh që edhe nuk e sjell.”, kjo lloj garancie nuk është e vlefshme, sepse dituria, në dhënien e garancisë kërkon që ajo patjetër të plotësohet, por që nuk ka plotësim me ndërvarje.

Më sipër është thënë më shumë se një herë rregulli i përgjithshëm i ajetit të Kur’anit Famëllartë: “mbani premtimet”, rregull që e zhvlerëson këtë kusht, kur te ata që ndjekin traditën vërtetohet emri kontratë.

5- Personi për të cilin jepet garancia është prej atyre që ka detyrimin të shlyejë një të drejtë që njerëzit kanë për të marrë prej tij, pasuri, ose shlyerje detyrimi për faljen nga ekzekutimi i një dënimi ligjor, ose për të qenë i pranishëm në kuvendin e gjykimit për të zgjidhur armiqësinë për çdo pretendim që duhet të dëgjohet. Garancia nuk është e vlefshme për të drejtat që i takojnë Allahut të Plotpushtetshëm, sepse me kryerjen e të drejtave që i takojnë Allahut, shpresohet moslejimi i shkeljes së të drejtave të

Allahut, pasi janë shkelje që pa dyshimin më të vogël, ato mund të sprapsen plotësisht.

Autorit i librit “Miftahul Kerameh”, në vëllimin 5, në faqen 430, në botimin e parë, thotë: “Në qoftë se të drejtat e Allahut të Plotpushtetshëm janë të kategorisë dënim për prostitucion, vjedhje dhe përdorim i pijeve dehëse, te dijetarët tanë të fesë, garancia për këto fajë është e pavlefshme, sepse garancia shërben si dokument, kurse të drejtat e Allahu janë të ndërtuara që ato të mos shkelen. Kërkohet vetëm pak vendosmëri që ato ndalesa të sprapsen, domethënë të mos bëhen veprime të ndaluara me aq sa është e mundur. Mundësia gjithmonë është për të shmangur rrugën e rënies në veprime të ndaluara, ashtu siç demonstroi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur u detyrua të mos pranojë ndërhyrjen që u munduan të bëjnë te ai për të mos zbatuar ligjin e Allahut, për faljen e një personi me rëndësi, që kishte shkelur një të drejtë prej të drejtave të Allahut.”

Nuk është kusht të dihet sasia e pasurisë që kërkohet të shlyejë personi për të cilin jepet garancia, sepse garancia është e varur me sjelljen e garancisë dhe nuk është e varur me detyrimin për shlyerje nga ana e personit për të cilin jepet garancia.

Kur kushtet plotësohen, garancia bëhet e detyrueshme, prandaj dhënësit të garancisë nuk i lejohet të heqë dorë prej garancisë. Gjithashtu, personit për të cilin jepet garancia nuk i lejohet të prishë, por për të dy lejohet kompensimi e shkëmbimi, gjithashtu lejohet kushtëzimi i të drejtës për prishjen e garancisë brenda kohës së caktuar, për shkak të argumenteve të përgjithshme që e bëjnë detyrim mbajtjen e besës për kontratat.

Shpejtimi e vonimi (i shlyerjes së garancisë)

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se garancia është e vlefshme të jepet me vonesë dhe kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me dhënien e garancisë së përshpejtuar. Gjithsesi, thënia më e përhapur e tyre është për vlefshmërinë e garancisë dhe mosvënien kusht vonimin, sepse argumentet e garancisë janë të përgjithshme dhe përfshijnë të dyja format e shlyerjes, shlyerjen e shpejtuar dhe shlyerjen e vonuar, plotësisht ashtu siç e pamë edhe në lidhje me format e shlyerjes së borxhit. Është kusht miratimi nga ana e personit për të cilin jepet garancia, kur shlyerja e detyrimit është e vonuar dhe garancia jepet në çast.

Kur garancia për shlyerje nuk është e kushtëzuar me afat kohor, është garanci që shlyhet në çast, por, kur garancia është e kushtëzuar me afat kohor, është detyrim që afati të jetë i përcaktuar në atë mënyrë që nuk ndryshon, domethënë është pa shtesë e pa pakësim afati, ashtu siç është gjendja në të gjitha kushtet.

Kur garancia është me shlyerje në çast, dhënësi i garancisë ka detyrim të sjellë detyrimin, kur shlyerja i kërkohet personit për të cilin jepet garancia, por, kur garancia është me shlyerje të vonuar, i garantuari nuk ka të drejtë të kërkojë prej garantuesit pa kaluar koha e caktuar për shlyerjen e detyrimit.

Shumica e fukahave të dëgjuar janë mbështetur në dëshminë e autorit të librit “E Hadaik”, që thotë: “Kur personi që merr përsipër garancinë, sjell borxhin para afatit, personi për të cilin është dhënë garancia nuk ka detyrim që ta marrë atë në dorë prej garantuesit, sepse marrja në dorë dhe dorëzimi nuk janë të

detyrueshëm, veçanërisht kur i garantuari nuk dëshiron ta marrë në dorëzim prej tij.

Vendi i dorëzimit

Kur ne caktojmë vendin e dorëzimit, dhënësi i garancisë nuk shfajësohet, në qoftë se e dorëzon atë në ndonjë vend tjetër, për shkak se ai s'ka vepruar sipas kushteve. Në qoftë se garancia është në përgjithësi dhe ata të dy nuk kanë caktuar një vend të dhënë për dorëzimin, atëherë shikohet: Në qoftë se nuk është folur për vend të caktuar për dorëzimin e garancisë, vendi për dorëzimin e garancisë është vendi ku është lidhur kontrata, por, nëse nuk është përcaktuar vendi për dorëzimin e garancisë dhe nuk ka ndonjë shembull të ngjashëm që të tregojë përcaktimin, pra, vendi i dorëzimit mbetet jo i qartë, rregullat kërkojnë prishjen e garancisë, për shkak të mospasjes dijeni, sepse mospasja dijeni mund të jetë shkak për mashtrim.

Sjellja e personit për të cilin jepet garancia

Personi për të cilin jepet garancia ka detyrim të jetë i pranishëm në çast së bashku me dhënësin e garancisë, kur atë e kërkon i garantuari. Kjo është e barabartë, qoftë kur garancia është me lejen e personit për të cilin jepet garancia, qoftë kur garancia është dhënë pa lejen e tij. Rasti i parë është i qartë, kurse për rastin e dytë, duhet thënë se garantuesi është në pozitën e origjinalit, domethënë se ai që ka detyrim për të bërë shlyerjen, ka detyrim të

jetë i pranishëm, kur atë e kërkon ai që ka për të marrë të drejtën, edhe kur personi për të cilin nuk është, është dhënë garanci.

Dorëzimi i garancisë

Kur dhënësi i garancisë sjell detyrimin në kohën dhe në vendin e caktuar, mes tij dhe të garantuarit ka përfunduar detyrimi. Me këtë rast, dhënësi i garancisë është shkarkuar nga detyrimi i garancisë. Kjo është e barabartë, nëse këtë e pranon ose nuk e pranon i garantuari, ose nëse i garantuari e merr ose nuk e merr të drejtën e tij prej dhënësit të garancisë, sepse garancia është e varur me sjelljen e detyrimit, të cilin dhënësi i garancisë e solli dhe kështu kreu detyrimin e tij, për rrjedhojë s'ka mbetur asnjë rrugë nga e cila ai mund të atakohet.

Në qoftë se dhënësi i garancisë nuk e sjell detyrimin në kohën e në vendin e caktuar, i garantuari e çon çështjen te gjykatësi. Një grup fukahash kanë thënë se gjykatësi ka detyrë të burgosë garantuesin, derisa ai të sjellë borxhmarrësin, ose të shlyejë detyrimin për të cilin është bërë dorëzanës. Argumentin për këtë çështje fukahatë e kanë nxjerrë prej transmetimit që tregohet prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): Te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), sollën një burrë që kishte dhënë garanci për një tjetër dhe ai tha: "Burgoseni, derisa të sjellë atë që ka detyrimin."

Në të vërtetë, gjykatësi nuk ka të drejtë ta burgosë menjëherë dhënësin e garancisë, por duhet të shikojë në punën e tij, madje, para së gjithash, gjykatësi ka detyrim të vërtetojë dhe të studiojë gjendjen e tij. Nëse ai ka fuqi të sjellë personin për të cilin

ai ka dhënë garancinë dhe është në gjendje të shlyejë detyrimin që ka marrë përsipër, megjithëkëtë nga inati e për kryeneçësi nuk e sjell detyrimin, atëherë lejohet burgosja e tij, sepse garancia kërkon sjelljen e borxhmarrësit ose shlyerjen e detyrimit, kur dhënësi i garancisë ka fuqi për këtë dhe, nëse ai nuk e bën këtë, atëherë vërtetohet drejtësia e hadithit të nderuar: “Për mua është ajo që ekziston dhe dënimi i tij është hallall.”

Në qoftë se dhënësi i garancisë s’ka fuqi të sjellë borxhmarrësin, për shkak se ai ka ikur, ose nuk dihet ku gjendet, nuk i lejohet as gjykatësit e as ndonjë tjetri të kërkojë sjelljen e borxhmarrësit prej dhënësit të garancisë, sepse, në këtë rast, ai obligohet me një gjë të pamundur dhe, kur nuk shlyhet obligimi me sjelljen e tij, atëherë nuk lejohet burgosja e dhënësit të garancisë për shkak të borxhmarrësit. Kur vërtetohet se dhënësi i garancisë s’ka fuqi të sjellë borxhmarrësin, atëherë, nëse ajo çka kërkohej prej borxhmarrësit është para, ose është ndonjë send që mund të kompensohet me para, kur kjo e drejtë vërtetohet me dokument dhe dhënësi i garancisë ka fuqi të mbajë besën për shlyerjen e detyrimit, gjykatësi e urdhëron të bëjë shlyerjen e detyrimit. Nëse ai nuk e bën shlyerjen, atëherë lejohet burgosja e tij, sepse dhënësi i garancisë është dokumenti për të drejtën, është si peng, kur është e pamundur të merret e drejta prej atij që duhet të shlyejë detyrimin, atëherë kjo e drejtë, nëse është e mundur, merret prej dokumentit.

Kur dhënësi i garancisë s’ka fuqi të mbajë besën për shlyerjen e detyrimit, ose detyrimi që duhet të shlyejë borxhmarrësi është i atillë që nuk mund të kompensohet me pasuri, si për shembull pretendimi për origjinën gjenealogjike dhe për çështje të ngjashme, në mënyrë absolute, nuk lejohet burgosja

e dhënësit të garancisë, por është detyrim të tregohet durim dhe të pritët, derisa ai të jetë i fuqishëm, patjetër që dhënësi i garancisë duhet të përpiket për të sjellë borxhmarrësin. Kur borxhmarrësi nuk dihet se në cilin vend ndodhet, me fjalën e përbashkët të fukahave, dhënësi i garancisë kërkon kohë, derisa ai të shkojë të marrë përgjigje për kërkimin e tij.

Pyetje: Prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) është vërtetuar se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka burgosur dhënësin e garancisë, pa studiuar gjendjen e tij, atëherë si është burimi për këtë sqarim?

Përgjigje: Sqarimin që ne përmendën e bën të detyruar logjika dhe bazat e medh'hebit, kurse Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), padyshim që në vendimin e tij është bazuar mbi faktin se dhënësi i garancisë kishte fuqi për të sjellë borxhmarrësin, megjithëkëtë ai nuk e bën. Transmetimi dëshmon të keqen e padrejtësisë dhe detyrimin me atë që ai s'ka fuqi të mbajë.

Dhënësi i garancisë i kërkon personit që i dha garancinë

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur dhënësi i garancisë shlyen detyrimin për personin për të cilin ai jep garancinë, pa e njoftuar atë as që po jep garanci për atë e as që e shleu detyrimin e tij, nuk i kërkon asgjë atij për sa ai ka shlyer, sepse në këtë rast, ai është sponsorizues. Nëse bën shlyerjen me lejen e tij, atëherë i kërkon atij që t'i kthejë atë çka ai shleu në vend të tij, qoftë edhe kur nuk i ka marrë atij leje për garancinë.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre për rastin kur i ka dhënë leje për garancinë, por pa e shlyer detyrimin. Ka fukaha që kanë thënë se leja për garancinë është e mjaftueshme, që të lejohet kërkimi prej borxhmarrësit shuma që dhënësi i garancisë shleu në vend të tij, sepse leja për garancinë është leje edhe për shlyerjen. Të tjerë fukaha kanë thënë se nuk lejohet që garantuesi të kërkojë prej tij, sepse garancia ka lidhje me sjelljen e tij, ndërsa shlyerja ka lidhje me pasurinë, për rrjedhojë s'ka lidhje mes sjelljes së borxhmarrësit dhe mes shlyerjes së detyrimit.

Në të vërtetë, leja për garancinë s'ka efekt mbi shlyerjen, prandaj dhënësi i garancisë nuk i kërkon gjë personit për të cilin ai dha garancinë për shlyerjen që ai bëri, me përjashtim të dy rasteve: E para: Borxhmarrësi i ka dhënë leje të bëjë shlyerjen për atë. Në këtë gjendje, dhënësi i garancisë ka të drejtë të kërkojë prej tij, qoftë edhe kur nuk i ka marrë leje për dhënien e garancisë.

E dyta: Dhënësi i garancisë e ka të pamundur të sjellë personin për të cilin ai dha garancinë, ndërkaq gjykatësi vendos të burgosë dhënësin e garancisë, kur ai nuk sjell personin për të cilin ai dha garancinë dhe, për të sprapsur dëmin prej vetes, dhënësi i garancisë bën shlyerjen e detyrimit për atë. Në këtë rast, gjithashtu, ai lejohet të kërkojë prej borxhmarrësit atë çka shleu në vend të tij, edhe nëse personi për të cilin është dhënë garancia, nuk i ka dhënë leje garantuesit për dhënien e garancisë, sepse në këtë rast, ai nuk quhet sponsoizues.

Në rast se ai ka fuqi të sjellë personin për të cilin dha garancinë, megjithëkëtë nuk e sjell atë, por bën shlyerjen e detyrimit në vend të tij dhe i merr leje borxhmarrësit se po bën shlyerjen e detyrimit në vend të tij, në këtë gjendje, garantuesi nuk

i kërkon asgjë personit për të cilin ai dha garancinë, edhe kur ky i fundit e ka lejuar që të japë garancinë për të, sepse, edhe në këtë rast, garantuesi është sponsorizues

Lirimi i borxhmarrësit nga detyrimi

Borxhmarrësi është në dorën tënde dhe para se ti të marrësh prej tij të drejtën tënde, vjen një tjetër që e liron borxhmarrësin nga detyrimi, qoftë duke garantuar praninë e borxhmarrësit, qoftë duke shlyer detyrimin e tij. Edhe pse kjo çështje s'ka asgjë të përbashkët me garancinë, fukahatë e kanë përmendur në këtë kapitull për shkak se dispozita e kësaj çështjeje është e njëjtë me dispozitën e garancisë.

Argumentimin për këtë çështje fukahatë e kanë nxjerrë prej rregullit se i liruari shkakton humbjen e të drejtës, si dhe nga pyetja që i bëri një burrë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me një burrë që kishe vrarë me qëllim një burrë tjetër. Çështja u shtrua te qeveritari krahinor, i cili, nga ana e tij, e la vrasësin në dorën e të afërmeve të të vrarit që ata ta vrasin atë, ndërkaq njerëzit u ngritën dhe e shpëtuan vrasësin prej duarve të tyre. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Burgosen ata që shpëtuan vrasësin, derisa ata të sjellin vrasësin.”

Pyetësi tha: “Nëse vrasësi vdes dhe ata janë në burg?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Të gjithë ata kanë detyrim t'i paguajnë të afërmeve të të vrarit shumë e caktuar për shlyerjen e vrasjes me qëllim (dijetin).”

Garancitë e njëpasnjëshme

Lejohet garancia e njëpasnjëshme, ashtu siç ishte edhe në garantimin e në transferimin e pasurisë, sepse kriteri për vlefshmërinë e transferimit të pasurisë është vërtetimi i të drejtës që ka detyrim të shlyejë personi për të cilin jepet garancia, edhe kur kjo e drejtë është vetë garancia.

Shembull për të ilustruar këtë çështje: Një burrë jep garanci për një borxhli. Më pas dhënësin e parë të garancisë e garanton një dhënësi i dytë garancie, të dytin e garanton një i tretë e kështu me radhë. Kur i tretë sjell personin për të cilin kishte dhënë garanci i dyti, del nga përgjegjësia vetëm i tretë, kurse i dyti mbetet përgjegjës për të sjellë personin për të cilin ai ka dhënë garanci dhe, kur dhënësi i parë origjinal i garancisë e sjell garancinë te e cila është varur e drejta që ai ka te personi për të cilin u dha garancia, të gjithë kanë dalë nga përgjegjësia, sepse ata janë degë të kësaj të drejte.

Dorëzimi nga ana e njërit prej dy garantuesve

Fukahatë më të dëgjuar mbështesin dëshminë e autorit të librit “El Hadaik”, i cili është shprehur se, kur dy vetë japin garanci për një burrë dhe njëri prej dy garantuesve sjell garancinë, del nga përgjegjësia edhe garantuesi i dytë për shlyerjen, sepse qëllimi është dorëzimi i garancisë. Kur dorëzimi realizohet, madje edhe sikur vetë personi për të cilin është dhënë garancia të sjellë detyrimin, ose në vend të tij e dorëzon atë një huaj, dhënësi i garancisë del nga përgjegjësia, sepse garancia nuk është më e rëndësishme se borxhi, për të cilin borxhmarrësi mban përgjegjësi

për ruajtjen e të drejtës së borxhdhënësit, por, kur detyrimin e tij e shlyen një sponsorizues, me qëllim që borxhmarrësi t'i qëndrojë fjalës së dhënë, borxhmarrësi menjëherë del nga përgjegjësia për ruajtjen e të drejtës së borxhdhënësit.

Vdekja e garantuesit dhe e personit për të cilin jepet garancia

Fukahatë më të dëgjuar janë mbështetur në dëshminë e autorit të libri “El Xheuahir”, i cili thotë: “Kur vdes personi për të cilin është dhënë garancia, garantuesi del nga përgjegjësia e garancisë për shkak të mosekzistencës së objektit të saj.

Gjithashtu, garancia është pa vlerë, edhe kur vdes dhënësi i garancisë, për rrjedhojë trashëgimtarët e dhënësit të garancisë nuk kanë asnjë detyrim.”

Për sa i përket vdekjes së personit për të cilin jepet garancia, vdekja e tij nuk e prish garancinë, pasi detyra për shlyerjen e detyrimit kalon te trashëgimtarët e tij, të cilët kanë të drejtë të kërkojnë prej dhënësit të garancisë që ai të sjellë garancinë. Kur i garantuari e transferon të drejtën që ai ka për të marrë prej personit për të cilin është dhënë garancia te një person tjetër me anë të shitjes, të pajtimit, ose të transferimit të pasurisë, garancia prishet, sepse transferimi me trashëgimi nuk është transferim me këmbim dhe, sepse trashëgimia kërkon transferimin te trashëguesi e çdo pasurie që ishte e trashëgimlënësit, kurse këmbimi kufizohet vetëm për pasurinë për të cilën është lidhur kontrata. Mirëpo kontrata e garancisë ishte ndërmjet garantuesit dhe personit për të cilin ai dha

garancinë dhe, kur ky i fundit e transferon të drejtën e tij te një tjetër, është shuar njëra prej kolonave të kontratës, për rrjedhojë kontrata priset për shkak të mosekzistencës së objektit të vetë kontratës.

Konflikti

Kur dhënësi i garancisë dhe i garantuari e pohojnë garancinë, por më pas dhënësi i garancisë i thotë të garantuarit: “Ke nënshkruar një garanci të pavlefshme, sepse ti nuk ke asnjë të drejtë për të marrë prej personit për të cilin u dha garancia.”, ndërkaq i garantuari thotë: “Jo, ajo është e vlefshme.”, në këtë rast, merret në konsideratë fjala e tij, krahas betimit që ai bën, sepse si bazë është vlefshmëria e kontratës, derisa të vërtetohet e kundërta.

Kur i garantuari betohet për vlefshmërinë e garancisë dhe te gjykatësi vërtetohet borxhi që ai i ka dhënë personit për të cilin është dhënë garancia, këtë borxh e paguan dhënësi i garancisë, i cili nuk i kërkon personit për të cilin ai dha garancinë shumën që ai pagoi në vend të tij, sepse më parë ai kishte pohuar se ky i fundit nuk kishte asnjë detyrim.

Kur dhënësi i garancisë pohon vlefshmërinë e garancisë dhe i thotë të garantuarit se borxhmarrësi të ka paguar borxhin që kishte detyrim të shlyente, ose i thotë se unë të kam shlyer detyrimin e tij, por këtë e mohon i garantuari, në këtë rast, për bazë merret përsëri fjala e të garantuarit, sepse origjina është që borxhi mbetet ashtu siç ishte, edhe kur i garantuari betohet se borxhi as nuk është shlyer e as borxhmarrësi s’ka dalë nga përgjegjësia. Në këtë gjendje rrëzohet pretendimi i dhënësit të garancisë. Kur i garantuari kërkon që të betohet dhënësi i garancisë dhe ky i fundit betohet, në këtë rast, rrëzohet vetëm garancia, kurse e drejta mbetet ashtu siç është mes të garantuarit

dhe personit për të cilin u dha garancia, sepse njeriu nuk mund të dalë prej përgjegjësisë me betimin e një tjetri.

Sikur të vijë personi për të cilin është dhënë garancia pas përfundimit të ankimimit ndërmjet dhënësit të garancisë dhe të garantuarit dhe t'i thotë të garantuarit se unë e shleva detyrimin që kisha ndaj teje, ose i thotë se ai më nxori mua nga përgjegjësia, i garantuari ka detyrim të betohet para personit për të cilin është dhënë garancia, se ai as nuk e ka bërë shlyerjen e detyrimit e as nuk është nxjerrë nga përgjegjësia për shlyerjen e detyrimit. Në këtë gjendje, nuk mjaftohet vetëm me betimin e parë të garantuesit, sepse qëllimi me ankimin e parë ndërmjet garantuesit e të garantuarit, ishte vërtetimi i garancisë, kurse nxjerrja nga përgjegjësia dhe shlyerja e detyrimit janë përmendur si mjet për prishjen e garancisë. Mirëpo këto dy të fundit nuk janë as objekt e as qëllim i ankimimit, kurse qëllimi me ankimimin e dytë ndërmjet të garantuarit dhe personit për të cilin është dhënë garancia, ishte ose dalja nga përgjegjësia, ose shlyerja e vetë detyrimit, pavarësisht nga garancia. Me këtë shpjegim bëhet e qartë se ndërmjet dy ankimimeve s'ka asnjë lidhje.

Kur i garantuari kërkon betim prej personit për të cilin është dhënë garancia dhe ky i fundit betohet, e drejta nuk mund të kërkohej as prej të garantuarit e as prej dhënësit të garancisë, sepse garancia është degë prej vërtetimit të së drejtës që duhet të shlyejë personi për të cilin u dha garancia. Me një fjalë, rrëzimi i detyrimit prej personit për të cilin është dhënë garancia, detyrimisht kërkon edhe rrëzimin e garancisë, kurse rrëzimi i garancisë nuk kërkon rrëzimin e detyrimit për shlyerje që rëndom mbi personin për të cilin është dhënë garancia.

PAJTIMI (es sulhu)

Përkufizimi i fjalës “pajtim

Shumë fukaha e kanë përkufizuar pajtimin si kontratë ligjore, për ndalimin e armiqësisë ndërmjet dy vetëve, me miratimin prej të dyja palëve.

Prej këtij përkufizimi kuptohet se për pajtimin patjetër duhet të ketë një konflikt mes dy kontraktuesve. Gjithashtu, prej këtij përkufizimi kuptohet se pajtimi nuk është i vlefshëm kur s’ka konflikt, megjithëse fukahatë kanë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorëve të librave “El Xhevahir”, “El Hadaik” dhe “Miftahul Kerameh”, si dhe me autorë të tjerë për lejimin e pajtimit e për vlefshmërinë e tij, qoftë edhe duke u nisur nga sprapsja e një konflikti të mundshëm.

Autori i librit “El Xheuahir”, në fillim të kapitullit “Pajtimi” thotë: “Është i vlefshëm për të sprapsur një konflikt që mund të ndodhë, edhe nëse nuk ka pasur më parë. Përmendja e konfliktit të mëparshëm, në konceptin e tij, do të thotë shkujdesje e qartë.”

Për këtë na tregon ajeti 128 i sures “En Nisa”:

”وَإِنْ امْرَأَةٌ خَافَتْ مِنْ بَعْلِهَا نُشُورًا أَوْ إِعْرَاضًا فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا أَنْ يُصْلِحَا بَيْنَهُمَا صُلْحًا ۚ وَالصُّلْحُ خَيْرٌ ۚ”

“Nëse një grua ka frikë se burri mund të largohet, ose mund të ftohet prej saj, ata nuk bëjnë ndonjë mëkat, nëse bëjnë pajtim mes tyre dhe, pajtimi është veprimi më i mirë...”

Nuk është larg mendjes të thuhet se ky përkufizim është ndërtuar për shumicën e rasteve, sepse pajtimi, në shumicën e rasteve, vjen pas armiqësisë e grindjes. Shumë fukahave kanë thënë se urtësia për ligjërimin e pajtimit është pikërisht ndalimi i armiqësisë dhe ata që e kanë përkufizuar pajtimin e kanë shpikur atë pikërisht nga kjo anë. Nga rregullat e urtësisë mësojmë se nuk është detyrim që këto rregulla të jenë të adaptuara për të gjithë individët, ashtu siç qëndron çështja në lidhje me ligjërimin e kohës së pritjes për gruan (koha gjatë së cilës gruaja, para se të rimartohet, duhet të presë pas vdekjes së burrit ose pas divorcit), me qëllim që të merret vesh se ajo është apo nuk është shtatzënë. Megjithëkëtë gruaja e divorcuar dhe gruaja që i ka vdekur burri, kanë detyrim të mos kenë marrëdhënie me burrin tjetër gjatë kohës së pritjes, të saktësuar ligjërisht, derisa të merret vesh se nuk janë shtatzënë. Si kjo pikë është edhe çështja e hyrjes në Xhenet, të cilin Allahu i Plotpushtetshëm e ka krijuar për ata që kanë frikë Allahun, megjithëkëtë në Xhenet do të hyjnë edhe të tjerë përveç tyre.

Sido që të jetë, përkufizimi i fukahave për kontratën e pajtimit, për çdo kontratë pajtimi, nuk është kufi për të vërtetën e për shpjegimin e saj, por është vetëm një përshtetje, me qëllim që të dallohet një kontratë prej një tjetre me njërën mënyrë, ose me

mënyrën tjetër, ose duke sjellë shembuj prej elementeve më të qarta të kontratës, për të konstatuar sa e besueshme është ajo.

Pajtimi ka lidhje me formulimin e me dy termat, me kompensimin e propozuar për pajtimin dhe me sendin për të cilin bëhet pajtimi. Pikërisht sendi është objekti i pajtimit për të cilin ne kemi kundërshtime, ose kemi frikë se do të ndodhin kundërshtime për shkak të këtij sendi.

Ligjërimi i pajtimit

Fukahatë kanë përmendur argumente të shumta në lidhje me ligjërimin e pajtimit, ndër të cilët ajetet e Kur'anit: "وَالصُّلْحُ خَيْرٌ" - "...pajtimi është veprimi më i mirë." (sure "En Nisa", ajeti 128)

Ajeti 9 i sures "El Huxhurat":

“وَإِنْ طَائِفَتَانِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اقْتَتَلُوا فَأَصْلَحُوا بَيْنَهُمَا ۖ”^ط

“Nëse dy grupe besimtarësh luftojnë njëri-tjetrin, menjëherë t’i pajtoni ata...”

Ajeti 208 i sures "El Bekare": “أَدْخُلُوا فِي السَّلَامِ كُلَّهَا” - **“të gjithë hyni në paqe (përqafoni Islamin).”**

Ndër argumentet që flasin për paqen, kemi edhe fjalën e të Dërguarit më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Paqja është e lejuar mes myslimanëve, përveç asaj paqe që bën hallall haramin ose që bën haram hallallin.”

Prej argumenteve kemi edhe fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Paqja mes dy vetëve për mua është më e dashur se sa të jap sadaka dy dinarë.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha nëpunësit të tij të furnizimeve: “Kur shikon dy vetë që kanë konflikt mes tyre, jepe prej pasurisë sime sendin për të cilin ata kanë konflikt.”

Në të vërtetë, ligjërimi i pajtimit s’ka nevojë për argument, sepse pajtimi është prej domosdoshmërive të fesë dhe pikërisht nga domosdoshmëria është nxjerrë argumenti për ligjërimin e pajtimit dhe s’ka arsye të kërkohej argument për pajtimin, sepse, kur ka ndodhur të jetë e nevojshme që për punën e mirë e për paqen të ketë argument që të ligjërojë këto dy punë, kujt dhe ku duhet të referohemi?

Paqja qëndron në vetvete

Disa imamë të medh’hebit mendojnë se kontrata e pajtimit nuk është kontratë e veçantë, pasi, në fakt, ajo është degë e një kontrate tjetër dhe merret në konsideratë në saje të sendit për të cilin ajo është bërë. Kontrata e pajtimit është kontratë shitjeje, kur ndodh këmbimi mall me mall; është kontratë dhurimi, kur garanton pronësinë mbi send pa kompensim; është kontratë qeraje, kur bëhet për një dobi kundrejt kompensimit; është kontratë shkëmbimi, kur dobia është pa kompensim dhe është kontratë nxjerrjeje nga përgjegjësia, kur është kontratë për shlyerjen e borxhit.

Thënia më e përhapur në mesin e fukahave xhaferij tregon se pajtimi është një kontratë që qëndron me veten e saj, është e vetme në dispozitën e saj e nuk është e varur nga ndonjë kontratë tjetër, sepse baza në çdo kontratë është që kontrata të jetë e pavarur dhe të mos ndjekë një kontratë tjetër, prandaj në disa raste, kur shikohet se vjen ndonjë dobi, lidhet një kontratë tjetër. Ky takim mes kontratash nuk kërkon që kontrata e pajtimit të jetë degë e një kontrate tjetër për shkak se në njërën anë ose në anën tjetër, ajo takohet me kontratën e parë.

Pajtimi ka veçanti të shumta, të cilat takohen me njëra-tjetrën te kontratat. Të gjitha këto veçanti kanë dallim në kontrata të ndryshme, sepse kontrata e pajtimit lidhet për transferimin e sendeve e të përfitimeve, për të hequr përgjegjësinë për shlyerjen e detyrimit dhe për ndalimin e konflikteve. Kontrata e pajtimit është e lejueshme, si kur ka dijeni, si kur s'ka dijeni, si kur pohon, si kur mohon. Këto çështje, do t'i shikojmë më poshtë gjatë shpjegimit. Prej karakteristikave të kontratës së pajtimit, në legjislacionet civile, është fakti se kontratën e pajtimit nuk e përfshin prokura e përgjithshme dhe, kur një person i lëshon prokurë të përgjithshme një tjetri, të prokuruarit nuk i lejohet të bëjë pajtim në vend të prokuruesit, përveç rastit kur në prokurë është shprehur tekstualisht e drejta e të prokuruarit për të bërë pajtim.

Kushtet

Për pajtimin ka kushte:

1- Kontrata është prej elementeve të pajtimit. Ajo lidhet për harmonizimin e ofertës me pranimin dhe është e vlefshme me çdo

fjalë e veprim që tregon miratim të ndërsjellë. Në kontratën e pajtimit nuk merret në konsideratë ndonjë fjalë e veçantë.

Gjithashtu, është e vlefshme që në kontratën e pajtimit të përdoren të dyja termat e kontratës, “oferta” dhe “pranimi”. Kontrata e pajtimit është e vlefshme, nëse pretenduesi thotë: “Unë bëj pajtim me ty për pretendimin tim që kam ndaj teje për këtë shumë.”, kurse personi mbi të cilin pretendohet thotë: “Pranoj.”

Gjithashtu, kontrata e pajtimit është e vlefshme, kur personi mbi të cilin pretendohet, thotë: “Unë bëj pajtim me ty, për kaq kundrejt asaj që ti pretendon të marrësh prej meje.”, ndërkaq pretenduesi thotë: “Pranoj.”

Është më e pëlqyeshme që paraqitësi i ofertës të jetë pretenduesi dhe personi ndaj të cilit pretendohet, të jetë pranuesi.

2- Secili prej dy personave që thotë fjalët e formulës së kontratës, duhet të ketë aftësi veprimi për të drejtën që bie mbi të në kontratën e pajtimit, pra, të jetë i mençur, në moshë madhore dhe të dallojë veprimin.

3- Pajtimi të ndodhë në persona të caktuar, që do të thotë se ofruesi dhe pranuesi i pajtimit ekzistojnë. Pajtimi të jetë i ligjshëm, domethënë, pajtimi as nuk bën hallall haramin e as nuk bën haram hallallin.

Mospasja dijeni për interesat që rrjedhin prej pajtimit

Nuk është kusht të dihet lloji i sendit për të cilin ata të dy kanë konflikt, borxh në para ose send konkret, qoftë kur sendi objekt i konfliktit është i mundur të dihet, qoftë kur është i pamundur të dihet.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për dy burra të cilët kishin ushqim te njëri-tjetri, te shoku i tij, por nuk dihet sasia e ushqimit. Njëri i thotë tjetrit: “Për ty është sasia që gjendet te ti dhe për mua është sasia që gjendet te unë.”

Pyetësi i tha: A janë të drejta këto fjalë?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “S’ka problem kur të dy janë dakord dhe shpirtërisht ndihen të qetë.”

Pyetje: Mospasja dijeni, në vetvete, përmban mashtrim, mirëpo mashtrimi e prish marrëdhënien e bashkëpunimit. Bazuar mbi këtë rregull, patjetër pajtimi duhet të priset, kur nuk dihen interesat përkatëse të palëve.

Autori i librit “El Xheuahir”, kësaj pyetjeje i përgjigjet: “Argumenti për lejimin e kontratës së pajtimit, krahas mospasjes dijeni, gëzon fjalën e përbashkët të fukahave dhe fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): ‘S’ka problem për këtë, kur ata të dy janë dakord dhe shpirtërisht ndihen të qetë.’” Ky lejim përfshin gjendjen, kur nuk ka dijeni, krahas mundësisë ose pamundësisë për të pasur dijeni. Bazuar mbi këtë rregull, rezulton se argumentet për ndalimin e kontratës për shkak të mashtrimit janë të veçanta në kontratat e tjera, por jo për kontratën e pajtimit,

gjithnjë bazuar mbi supozimin për ekzistencën e këtyre argumenteve.

Kjo përgjigje është e afërt me qëllimet e ligjit të fesë, sepse pajtimi është i ndërtuar mbi lehtësimin dhe tolerancën, si dhe mbi lëshimin që bën pronari i të drejtës për të marrë një pjesë të së drejtës që i takon.

Gjithashtu, nuk është kusht që e drejta të jetë e njohur në rrëzimin e detyrimit e për daljen nga përgjegjësia për mbajtjen e besës për shlyerjen e detyrimit. Sikur pajtimi të mos lejohej, edhe krahas mospasjes dijeni për objektin mbi të cilin lind konflikti, me siguri që do të pengoheshin përfitime të shumta.

Pohimi e mohimi

Pajtimi është i vlefshëm krahas pohimit e mohimit. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Fjala e përbashkët e fukahave për këtë çështje është bazuar mbi përgjithësuesit.”, domethënë mbi argumentet e përgjithshme të pajtimit, siç janë dy ajetet e Kur’anit Famëlartë që u përmendëm më sipër: **“Pajtimi është më i miri.”**- “والصلح خير”, dhe **“...pajtimi është i lejuar.”** “الصلح جائز”, si dhe argumente të tjera veç këtyre të dy argumenteve.

Bazuar mbi këto argumente, fukahatë kanë nxjerrë akte nënligjore që kanë të bëjnë me sqarimin e rasteve të shumta të objektit të pajtimit, për shembull, kur personi mbi të cilin pretendohet shlyerja e detyrimit, i thotë pretenduesit: “Bëj pajtim me mua.”, kjo kërkesë e tij nuk është pohim nga ana e pretenduesit që ai e pranon pajtimin, sepse pajtimi është së

bashku me mohimin, kur personi mbi të cilin bëhet pretendimi e pohon të drejtën e pretenduesit. Pajtimi është i lejueshëm ose me çmimin e sendit për të cilin pretendohet, ose më pak, ose më shumë, ose për një shumë ndërmjet më pak e më shumë, përderisa miratimi i ndërsjellë është realizuar prej të dyja palëve.

Unë e kuptoj pajtimin mes dy vetëve për një send për shkak të frikës së një konflikti të mundshëm, por nuk kuptoj ndonjë formë të pajtimit, kur pohohet e drejta, sepse pohuesi me pohimin e tij merr përsipër të kryejë të plotë të drejtën që i takon pretenduesit. Për më tepër, vetë kryerja e të drejtës është mbajtje e besës për shlyerjen e detyrimit nga ana e pohuesit dhe, nëse ai jep më shumë, kjo shtesë, nga ana e tij, është dhuratë. Në rast se personi për të cilin pohohet e drejta heq dorë plotësisht nga e drejta e tij, ose ai heq dorë nga një pjesë e saj, kjo heqje dorë është dalje nga përgjegjësia për shlyerjen e detyrimit. Sido që të paraqitet çështja, puna është shumë e thjeshtë dhe rezultati është vetëm një: Të gjithë fukahatë, pa asnjë kundërshtim mes tyre, pohojnë vlefshmërinë dhe lejimin e pajtimit, me përjashtim të ndonjë veprimi të përmendur me emër në kontratë.

Kur kontrata e pajtimit nënshkruhet pas mohimit, në qoftë se pretenduesi është gënjeshtar në pretendimin e tij, për më tepër, e di se po gënjen, personi mbi të cilin ai pretendon, ose kërkon pajtim me atë gjatë konfliktit dhe shlyen pretendimin e rremë, nëse çështja qëndron kështu, pajtimi, në sipërfaqe, është i vlefshëm dhe është i rremë realisht, domethënë, me këtë pajtim, pretenduesi gënjeshtar e ka haram të marrë pasurinë ose paratë për të cilat u bë kontrata e pajtimit, sepse kjo do të thotë ngrënie padrejtësisht e pasurisë së tjetrit, duke ditur se secili prej të dy nënshkruesve është i detyruar të zbatojë kontratën e pajtimit.

Padyshim, kur pretendimi është i bazuar mbi një dyshim ose mbi një kontekst, në këtë rast, pretenduesi, nga ana e jashtme, del nga rrethi i gënjeshtërs dhe realisht kontrata e pajtimit është e vlefshme.

Për ilustrim të çështjes marrin një shembull: Një njeri shikon në një dorëshkrim të trashëguar se ai ka për të marrë pasuri prej filanit. Bazuar mbi këtë dorëshkrim, trashëguesi ngre padinë kundër atij personi. Në këtë rast, personi mbi të cilin bëhet ankimimi për këtë pretendim betohet dhe, kur ky trashëgues bën pajtim që të tërheqë ankimimin kundrejt një shume ose malli, këtë shumë ose mall ai e merr hallall, sepse personi kundër të cilit u bë ankimimi ka rrugën e betimit për të shpëtuar prej pajtimit, megjithëkëtë ai preferon pajtimin me kënaqësi e me zemërgjerësi.

Kur pretenduesi ka të drejtë në pretendimin e tij, por personi prej të cilit kërkohet e drejta e mohon të drejtën e pretenduesit, në këtë gjendje, me qëllim që pretenduesi të mbetet i kënaqur me të drejtën e tij, bën pajtim që të marrë qoftë edhe një pjesë nga e drejta që i takon të marrë. Këtë lëshim ai e bën nga frika se mos e humb të gjithë të drejtën e tij, ose e bën me qëllim që të sprapsë armiqësinë e përçarjen. Në këtë rast, pajtimi, nga ana e jashtme, është i vlefshëm, por realisht është i rremë dhe personi që duhet të shlyejë këtë të drejtë, e ka haram të hajë pjesën e të drejtës nga e cila hoqi dorë pretenduesi, sepse, edhe në këtë rast, kemi të bëjmë me ngrënie të pasurisë së tjetrit padrejtësisht.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur një burrë ka për t’i shlyer një borxh një burri tjetër, por e zgjat kohën e shlyerjes derisa vdes borxhdhënësi dhe më pas trashëgimtarët e tij bëjnë pajtim të marrin vetëm një pjesë të borxhit, pjesa që marrin

trashëgimtarët është për ata, kurse pjesa e pashlyer mbetet ta marrë i vdekuri në Botën Tjetër. Në rastin kur ai nuk ka bërë pajtim për asgjë, deri sa vdes dhe deri në këtë kohë s'ka marrë asgjë, atëherë i gjithë borxhi i takon të vdekurit për ta marrë prej borxhmarrësit në Botën Tjetër."

Është pyetur nipi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), për një burrë te cili ka depozituar një jehudi ose një kristian katër mijë dirhemë. A lejohet, që për këtë shumë, trashëgimtarët e tij të bëjnë pajtim, kur ata nuk kanë dijeni për këtë shumë? Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Nuk lejohet, derisa ai t'i njoftojë ata."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Sikur një person të rrëmbejë një send prej një tjetri dhe më pas për sendin e rrëmbyer bën pajtim me para, sendi i rrëmbyer mbetet në pronësi të pronarit dhe prej këtij sendi nuk përjashtohet as shuma që i është dhënë atij si kompensim. Kjo ndodh, se ky kompensim, në origjinë, është i prishur, me përjashtim të rastit kur pretenduesi, në brendësi të tij, e miraton dhe është i kënaqur me këtë kompensim, gjithnjë kur heqja dorë nga një pjesë e së drejtës është bërë me kënaqësi të plotë zemre."

Me fjalë më të thjeshta, pajtimi nga jashtë është i vlefshëm, pasi ndalon konfliktin. Nuk lejohet që njëra prej dy palëve në pajtim të kërkojë ndonjë gjë prej palës tjetër, megjithëse kjo nuk e ndryshon realitetin në të cilin ai gjendet. Kush ka dijeni se ka detyrim të mirëkuptohet me tjetrin, duhet të shqetësohet të bëjë pajtimin me atë, duke i paguar atij të plotë të drejtën që i takon, si për shembull, kur me pajtim merr një send, të cilin s'ka të drejtë ta marrë, atëherë ai ka detyrim që këtë send t'ia kthejë menjëherë atij

që i takon, pasi kriteri për vlefshmërinë e pajtimit, është arritja e të drejtës të ai që i takon dhe jo vetëm thjesht formula e pajtimit.

Përzgjedhja

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se kontrata e pajtimit është e detyrueshme për të dyja palët dhe asnjëra prej dy palëve s'ka të drejtë të heqë dorë prej kontratës së pajtimit pa miratimin e palës tjetër. Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se përzgjedhja në kuvend nuk vërtetohet me pajtimin, sepse hadithi: "Dy kontraktuesit kanë të drejtën e përzgjedhjes për mallin e vënë në shitje, derisa ata të dy nuk janë ndarë njëri nga tjetri.", është vetëm për shitjen, kurse, në lidhje me përzgjedhjet e tjera, fukahatë kanë kundërshtime në mesin e tyre.

Autori i librit "Miftahul Kerameh", pasi citon fjalët e fukahave, thotë: "Nëse ai e firmos pajtimin me kompensim, në atë kontratë ka hyrë përzgjedhja me kusht dhe, nëse ai e firmos kontratën, bazuar mbi rrëzimin e pretendimit, para se ai të vërtetohet, në këtë rast, nuk vërtetohet përzgjedhja me kusht, sepse pajtimi është ligjëruar për të ndaluar konfliktin.

Te pajtimi vërtetohet përzgjedhja në rastin e shikimit me sy dhe për të metën, gjithashtu vërtetohet edhe përzgjedhja e vonuar për gjërat që nuk prishen brenda ditës e që nuk sjellin dëmtrim, kurse për sende që mund të prishen, si dhe për sende me të meta, për të cilat lejohet prishja e kontratës, s'ka as përzgjedhje e as kërkohet kthimi i çmimit."

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Çdo përzgjedhje, që vërtetohet me shitjen, ajo përzgjedhje vërtetohet edhe me pajtimin, kur rregulli për këtë përzgjedhje është mohim i dëmtimit, ose edhe për raste të tjera, ku lejohet pajtimi, siç është rasti i përzgjedhjes kur ka mashtrim, ose kur përshkrimi i cilësive është i vonuar, ose kur nuk mbahet besa për shlyerjen e detyrimit me kusht, ose kur përzgjedhja është vënë si kusht, përfshirë edhe raste të tjera, që s’kanë të bëjnë me argumentin e veçantë për shitjen, si për shembull, përzgjedhja në kuvend, ose përzgjedhja për kafshën. Por kur e meta e sendit bëhet e qartë, kontrata prishet me imponim.”

Prej të dyja shprehjeve rezulton se përzgjedhja e kuvendit dhe përzgjedhja e kafshës, nuk vërtetohen me pajtimin, për shkak se argumenti për këto dy përzgjedhje është i veçantë për shitjen, por me pajtimin vërtetohet përzgjedhja e mashtrimit, vonesa e përshkrimit të cilësive, kushti, përzgjedhja e kushtëzimit të përzgjedhjes, përzgjedhja e të metës, me qëllim për të sprapsur dëmin, kur për dëmin sillen argumente që vërtetojnë dëmtimin, sepse këto argumente kanë përparësi ndaj të gjitha argumenteve, madje shtrihen deri në argumentet e pajtimit, domethënë imponim për të bërë pajtim. Por kur sendi me të meta transferohet te shitësi me anë të pajtimit, duke mos pasur dijeni për të metën që ka sendi, atëherë blerësi përzgjedh mes prishjes së kontratës së shitjes dhe mes firmosjes së saj, pa kërkuar kthimin e çmimit, sepse dëmi i shkaktuar prej të metës, hiqet vetëm me lejimin e prishjes, pa pasur nevojë për kthimin e çmimit. Për sa i përket vërtetimit të kthimit të çmimit për shitjen, ka argument të veçantë, për të cilin është folur gjatë shpjegimit të kësaj çështjeje

në pjesën e tretë të këtij libri, në kapitullin “Përzgjedhja e të metës”.

Në lidhje me këtë çështje, ne s’kemi asnjë vërejtje, sepse çështja është në përputhje me bazat dhe rregullat, me përjashtim të shprehjes që ka ardhur në librin “Miftahul Kerameh” dhe që thotë: “Pajtimi ndodh i bazuar mbi kompensimin në të cilin ka hyrë përzgjedhja e kushtit dhe, nëse pajtimi është bërë i bazuar mbi rrëzimin e pretendimit, para vërtetimit të tij, në këtë rast, përzgjedhja nuk vërtetohet.”

Aty ku s’ka dallim në përzgjedhjen e kushtit, mes ndodhjes së pajtimit, bazuar mbi kompensimin dhe mes ndodhjes së pajtimit, bazuar mbi rrëzimin e pretendimit, çfarë pengese do të kishte që atij t’i thuhej: “Unë bëj pajtim me ty për një mijë nga ato që unë pretendoj të marr prej teje, unë ato i kam trashëgimi dhe janë në mirëbesimin tënd, por me kusht që kjo shumë të mos bëhet më shumë se kaq.”

Nëse kushti nuk është vënë në këtë mënyrë dhe më pas bëhet i qartë mashtrimi me qëllim, në këtë rast, për atë vërtetohet përzgjedhja, pasi këtu ka vend për dëmtim.

Pohimi në favor të njërit prej dy ortakëve

Kur një send është në dorën e një personi dhe atë send e pretendojnë dy vetë për shkak të detyrimit të ortakërisë që është mes atyre të dyve, si për shembull, sikur ata të thonë se ky send është trashëgim prej babait tonë dhe ai që e ka në dorë sendin, pohon shumën që ai ka të drejtë të marrë, por këtë të drejtë nuk e

pohon tjetri, në këtë gjendje, sasia e pohuar është e përbashkët për të dy dhe nuk është e veçantë vetëm për pohuesin, për shkak se këtu kemi të bëjmë me bashkim të shkaku, që është ortakëria, e cila, në këtë rast, përputhet me tërësinë dhe me një pjesë të saj.

Kur pajtimi bëhet mes atij që e ka sendin në dorë dhe mes atij që e pretendon sendin për veten e tij, domethënë për gjysmën e sendit dhe mbi këtë pretendim ai ka marrë kompensimin, në qoftë se pajtimin e lejon ortaku i tij i dytë, ai është pjesëtar me atë në kompensimin dhe, nëse nuk e lejon, pajtimi është i vlefshëm vetëm në një të katërtën. Për rrjedhojë, edhe pajtimi është i prishur në një të katërtën, e cila është pjesë e ortakut, sepse pajtimi mbi pasurinë e tjetrit lejohet vetëm me lejen e tij.

Pajtimi i imponuar me forcë

Në kapitullin e pajtimit, fukahatë kanë përmendur çështje në lidhje me grumbullimin e të drejtave, për të cilat ka konflikt. Është e pamundur që ato të mblidhen të gjitha së bashku.

Gjithashtu, edhe konflikti është i pamundur të zgjidhet, nëse njëra prej dy palëve në konflikt nuk bën lëshim për të mos e marrë të plotë të drejtën që i takon, ose kur secila prej dy palëve nuk bën lëshim për një pjesë të së drejtës që kanë ndaj njëri-tjetrit. Kur të dy palët në konflikt këmbëngulin për të mos bërë asnjë lëshim, në këtë rast, gjykatësi merr në dorë procesin e pjesëtimit me imponim ndërmjet dy konfliktuesve. Ai bën pjesëtimin me drejtësi e me maturi, në atë mënyrë që të duket se vetë palët në konflikt kanë bërë pajtim për këtë pjesëtim me pëlqimin e tyre. Këtë lloj pjesëtimi fukahatë e kanë emërtuar “Pjesëtim i detyruar

me pajtim të imponuar". Në vijim do të shikojmë pjesë prej çështjeve të këtij pjesëtimi, ashtu siç është trajtuar në librat: "El Xheuahir", "El Hadaik" dhe "Miftahul Kerameh".

Çështja e dy dirhemëve

Dy vetë së bashku kanë dy dirhemë. Njëri prej tyre i thotë shokut të tij: "Të dy dirhemët më takojnë mua dhe ti s'ke asgjë në këto dy dirhemë."

Tjetri thotë: "Këto dy dirhemë ndahen mes nesh, një dirhem për ty dhe një dirhem për mua."

Pavarësisht nga fjalët e shkëmbyera, ata s'kanë arritur të gjejnë rrugën e pajtimit në këtë konflikt dhe e kanë ngritur çështjen te gjykatësi.

Në këtë gjendje, gjykatësi ka detyrim të marrë vendimin si vijon: I jep një dirhem e gjysmë atij që i pretendon dy dirhemët, kurse atij që pretendon një dirhem, i jep një gjysmë dirhemi.

Këtë ndarje gjykatësi e bën duke u bazuar te transmetimi i ardhur prej fjalëve të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*). Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me këtë çështje dhe ai është përgjigjur: "Ai që tha se dy dirhemët ndahen mes të dyve, në fakt, ka pohuar se në njërin prej dy dirhemëve ai s'ka asnjë të drejtë, domethënë që edhe ky dirhem i takon shokut të tij, prandaj dirhemi i dytë pjesëtohet mes këtyre të dyve nga një gjysmë dirhemi."

Ana e drejtësisë dhe e maturisë në këtë pjesëtim është theksuar, pasi s'ka rrugë tjetër përveç kësaj rruge. Nëse çdo njërit prej atyre të dyve ne do t'i jepnim nga një dirhem, do të vepronim sipas fjalës së atij që pretendon ndarjen në dy pjesë të barabarta, por kështu kemi neglizhuar fjalën e atij që pretendon për vete të dy dirhemët.

Gjithashtu, në qoftë se nuk do t'i jepnin asgjë atij që pretendon ndarjen në mënyrë të barabartë, do të vepronim sipas fjalës së atij që i pretendon të dy dirhemët, pa vënë në konsideratë fjalën e tjetrit. Në këtë gjendje, në të dyja rastet, kemi një anim të pamundur, për rrjedhojë, s'ka mbetur gjë tjetër veçse të caktojmë për të dy pretenduesit e këtyre dy dirhemëve nga një dirhem, për shkak se shoku i tij pohoi që tjetri s'ka asnjë të drejtë mbi këto dy dirhemë, çka do të thotë se, në të vërtetë, konflikti mes atyre të dyve është vetëm për një dirhem, të cilin secili prej atyre të dyve e pretendon për veten e vet dhe e mohon për tjetrin, prandaj ai kërkon që pjesëtimi të bëhet në mënyrë të barabartë për të dy. Në këtë gjendje, rezultati i pjesëtimit është: Pretenduesi për të dy dirhemët merr një dirhem e gjysmë dhe pretenduesi i pjesëtimit për gjysmën, merr një gjysmë dirhemi.

Meriton të theksohet se gjykatësi e bën këtë pjesëtim në mungesë të argumentit në favor të njërit prej dy konfliktuesve. Në këtë gjendje, pretenduesi i dy dirhemëve betohet se shoku i tij s'ka asnjë të drejtë mbi këto dy dirhemë, gjithashtu, betohet edhe ai që pretendon ndarjen në mënyrë të barabartë, që shoku i tij nuk ka të drejtë të plotë për të dy dirhemët. Në rastin kur ka argument në favor të njërit prej dy konfliktuesve dhe s'ka argument për tjetrin, është detyrim të veprohet sipas këtij argumenti. Në rastin kur njëri prej atyre të dyve betohet, kurse tjetri refuzon të betohet, në

këtë rast, veprohet sipas fjalës së atij që betohet. Pjesëtimi që ne përmendëm, bëhet kur secili prej atyre të dyve vjen me argument, Në pjesëtim s'ka anim në favor të njërit prej atyre të dyve, s'ka betim të përbashkët dhe s'ka refuzim betimi të përbashkët.

Ky gjykim nuk është i veçantë vetëm për pjesëtimin e dy dirhemëve, por mund të bëhet për çdo send të cilin e pretendon njëri prej dy konfliktuesve, i cili thotë se sendi në fjalë i takon vetëm atij, kurse tjetri pretendon se në sendin në fjalë ata kanë pjesë të barabartë. Këto fjalë të tyre vërtetojnë se të dy kanë pjesë në atë send.

Shembull të ngjashëm kemi edhe kur një burrë depoziton te një burrë tjetër dy dirhemë. Më pas një burrë tjetër depoziton një dirhem dhe depozituesi e vë dirhemin bashkë me dy dirhemët e parë. Por ndodh që njëri prej tri dirhemëve prishet jo për shkak të mosmirëmbajtjes, ose për shkak se depozituesi ka vënë dorë mbi to. Në këtë rast, depozituesi i jep një dirhem e gjysmë atij që depozitoi dy dirhemë dhe një gjysmë dirhemi atij që depozitoi një dirhem.

Prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka gjykuar në një çështje të ngjashme dhe atij që kishte depozituar dy dinarë i dha një dinar e gjysmë, kurse atij që kishte depozituar një dinar, i dha gjysmë dinari. Këtë çështje ne e kemi trajtuar me hollësi në librin “Ûsûlul ithbât”, kapitulli “Dituria e gjykatësit”, paragrafi “Gjykimi në kundërshtim me diturinë”.

Shembull tjetër: Një person ka një rrobë që kushton njëzet dirhemë. Një person tjetër ka një rrobë që kushton tridhjetë dirhemë. Më pas të dy rrobat ngatërrohen aq sa nuk njihen njëra

nga tjetra, veç kësaj dy pronarët e këtyre rrobave nuk kishin bërë asnjë lloj pajtimi. Në këtë gjendje, rrobat shiten të dyja dhe pronari i rrobës më të shtrenjtë merr tri të pestat, kurse pronari i rrobës tjetër, merr dy të pestat.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë, ku një burrë tjetër çon për tregti një rrobë për tridhjetë dirhemë, ndërkaq çon te ai edhe një burrë tjetër një rrobë për tregti për njëzet dirhemë. Më vonë, burri te i cili ata çuan rrobat për t'i shitur, ua ktheu të dyve, por ai nuk i dalloi dot se cila ishte rroba e njërit dhe cila ishte rroba e tjetrit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Shiten të dyja rrobat. Të parit i jep tre të pestat e çmimit dhe tjetrit i jep dy të pestat e çmimit.”

Pyetësi tha: “Pronari i rrobës për njëzet dinarë i tha pronarit të rrobës për tridhjetë dinarë: ‘Zgjidhe njëren prej dy rrobave. Merr cilën të duash.’ Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ai e ka bërë ndarjen përgjysmë.”

Ndërtimi jashtë murit

Me ndërtim jashtë murit kuptohet ndërtimi jashtë faqes së murit, domethënë një ndërtim i ngjashëm me ballkonin. Pronarit të shtëpisë i lejohej të nxjerrë ballkon jashtë murit apo diçka të ngjashme me ballkonin sipër rrugës publike dhe as komshiu e as ndonjë tjetër s’ka të drejtë ta kundërshtojë atë, me kusht kur ndërtimi i bërë sipër rrugës nuk dëmton kalimtarët ose mjetet,

sepse hapësira mbi rrugë nuk është pronë e ndonjë personi të veçantë, por të gjithë janë pronarë të barabartë në rrugë.

Komshiu s'ka të drejtë të protestojë se pronari i shtëpisë më sheh mua prej ballkonit, sepse shikimi nuk është haram, por dihet se haram është informimi me qëllim të keq, qoftë edhe nëpërmjet ballkonit. Patjetër që edhe komshiu ka të drejtë të nxjerrë në rrugë ballkon, sipër ballkonit e komshiut të tij, ose më poshtë se ballkoni i komshiut, me kusht kur ky ballkon mbi rrugë nuk errëson rrugën e nuk dëmton kalimtarët, sepse i pari s'ka të drejtë të ndalojë të dytin, për shkak se ai nuk është pronar i hapësirës mbi rrugën, por ka përparësi që ndërtoi i pari. Kur rrëzohet ballkoni, humb plotësisht edhe kjo përparësi, pra, është si përparësia në vendet publike.

Një grup fukahash kanë thënë se, kur rruga është pa krye, domethënë që kalimtarët nuk dalin prej kësaj rrugë në një rrugë tjetër, askush s'ka të drejtë të nxjerrë ballkon ose diçka tjetër mbi rrugën pa krye, pa lejen e gjithë banorëve të kësaj rruge. Nëse ata nuk e lejojnë, ose disa e lejojnë e disa të tjerë nuk e lejojnë, atij nuk i lejohej të nxjerrë asnjë lloj ndërtimi mbi këtë rrugë, sepse kjo rrugë është pronë e të gjithëve.

Degët dhe rrënjët e pemës

Një burrë mbjell një pemë në tokën e vet, por rrënjët e degët e kësaj peme shtrihen në pronën e komshiut. Në këtë gjendje, pronari i pemës ka detyrim që me çdo mënyrë të heqë pronën e tij prej pronës së tjetrit. Në qoftë se pronari i pemës nuk e bën këtë, atëherë këtë punë e bën komshiu, i cili, kur është e mundur, i

largon degët e pemës, ndryshe i pret ato. Për këtë veprim nuk kërkon leje prej gjykatësit ligjor, sepse dispozita për këtë gjykim është e njëjtë me dispozitën e kafshës që hyn në shtëpinë e tjetrit, ose e kafshës që hyn në të mbjellat e një tjetri. Në këtë rast, edhe pronari i shtëpisë, ose pronari i të mbjellave ka të drejtë të nxjerrë kafshën pa lejen e gjykatësit. Kur komshiu pret degët e pemës që kanë rënë në tokën e tij, pronari i pemës s'ka të drejtë të protestojë dhe të thotë se ky veprim është pa lejen e tij, sepse ky rregull s'ka ardhur në kapitullin e sprapsjes së padrejtësisë e të dëmtimit.

Sikur të supozohet se degët shkatërruan një send, për pronarin e tij, sendi s'ka garantim, me përjashtim të rastit, kur prej pronarit të pemës ka neglizhencë, si për shembull, kur ai pengon pronarin e tokës të marrë masa që prona e tij të mos shkatërrohet. Në dispozitën e pemës hyn edhe muri i anuar kah prona e tjetrit.

Ndërtimi i përbashkët

Një mur, një shtëpi, një burim uji dhe të ngjashme me këto, janë pronë e përbashkët e dy ose më shumë vetëve. Por ndodh që kjo pronë me ortak pëson një dëmtim, ndërkaq ortaku tjetër, ose disa prej ortakëve duan ta rindërtojnë objektin e dëmtuar, ose ta riparojnë atë, kurse një tjetër ortak nuk e ka këtë dëshirë. Në këtë gjendje, ky ndalues detyrohet apo nuk detyrohet që të lejojë rindërtimin ose riparimin?

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë shumë thënie, kurse ne mendojmë se duhet të shikohet: Në qoftë se sendi i përbashkët është i atillë që pranon pjesëtimin, ortaku ka të drejtë të kërkojë ndarjen dhe t'i japë fund ortakërisë në atë objekt me

pjesëtim. Në qoftë se objekti është i atillë që nuk pranon pjesëtim, në këtë rast, ortaku e ngre çështjen te gjykatësi, duke marrë në konsideratë personin që e ka në dorë ndalimin e rindërtimit ose të riparimit.

Në këtë rast, gjykatësi, nga ana e tij, shikon në këtë çështje: Në qoftë se ai që kërkon ndërtimin ose riparimin dëmtohet, nëse nuk e bën këtë ndërtim ose riparim të objektit me ortakëri, atëherë gjykatësi e urdhëron ortakun ndalues të lejojë tjetrin të bëjë punimet ose riparimet e duhura mbi atë objekt. Nëse përsëri ai e pengon, atëherë gjykatësi vendos sipas hadithit: “S’ka dëmtim e s’ka përgjigje të dëmtimit me dëmtim.”

Nëse nga mosndërtimi, ose nga mosriparimi nuk vjen dëmtim, ortaku që dëshiron të bëjë ndërtimin ose riparimin e objektit në fjalë, ka detyrim të bëjë durim dhe të presë, sepse kemi të bëjmë me pasuri me ortakëri, në të cilën ndalohet çdo veprim pa lejen e ortakut, ashtu siç është puna me të gjitha gjërat që janë me ortakëri, me përjashtim të rastit kur ka dëmtim, por zakonisht supozohet mosdëmtimi.

Konflikti për tavanin

Një shtëpi dykatëshe, kati përdhes i takon njërit person dhe kati i sipërm i takon një tjetri, por që të dy pretendojnë tavanin e katit përdhes, që është toka për katin e sipërm. Në këtë gjendje, cili është pretendues dhe cili është mohues?

Një grup fukahash kanë thënë se i takon katit të sipërm. Të tjerë fukaha kanë thënë se hidhet short mes atyre të dyve. Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Argumenti më i fuqishëm është se

që të dy janë ortakë. Në qoftë se njëri prej atyre të dyve ka argument dhe tjetri s'ka, atëherë i takon atij që ka argumentin, ndryshe do të betohen që të dy. Nëse ata nuk duan të betohen, atëherë bëhet pjesëtimi mes të dyve. Në qoftë se njëri betohet dhe tjetri refuzon të betohet, atëherë tavani i katit përdhes i takon atij që betohet.

Transferimi i pretendimit me pajtim

Autori i librit “Miftahul Kerameh” ka cituar prej një grupi fukahash se, kur një burrë ka pretendim ndaj një tjetri, se ka për të marrë prej tij borxhin ose ndonjë send, pretenduesi ka të drejtë të bëjë pajtim për pretendimin e tij me një person të tretë që s'ka të bëjë fare me pretendimin.

Rezultati i këtij pajtimi është se i treti me pajtimin, është në pozitën e pretenduesit dhe i thotë personit mbi të cilin pretendohet se e drejta që ti duhet të shlyesh në favor të filanit, me pajtim, është bërë e drejtë që më takon mua. Por pretenduesi, me anë të pajtimit, patjetër duhet të sjellë argumentin që vërteton të drejtën që ai fitoi në saje të pajtimit. Në qoftë se personi mbi të cilin pretendohet, e mohon se ai ka detyrim të shlyejë ndonjë të drejtë, atëherë, këtij të fundit i kërkohet të betohet. Për këtë s'ka dallim, nëse personi mbi të cilin bëhet pretendimi e pohon ose nuk e pohon këtë të drejtë para pajtimit.

Gjithashtu, s'ka dallim, nëse ky i treti që bëri pajtimin e di ose nuk e di të vërtetën e detyrimit që duhet të shlyejë personi mbi të cilin bëhet pretendimi.

* * *

ORTAKËRIA

Ç'do të thotë ortakëri?

Për fjalën “ortakëri” ka dy kuptime: gjuhësor dhe ligjor. Kuptimi gjuhësor është bashkimi i të drejtave të pronësisë mbi një send të vetëm në rrugë ortakërie. Ky shkak, për këtë ortakëri, mund të jetë i detyrueshëm, si për shembull, trashëgimia, ose përzierje e dy pasurive pa qëllim përzierje dhe pas përzierjes është e pamundur ndarja e këtyre dy pasurive.

Shkaku i ortakërisë mund të jetë edhe me pëlqim të ndërsjellë, siç ndodh kur dy vetë bëhen ortakë në blerjen e një sendi të vetëm, ose e pranojnë atë send prej një tjetri me anë të dhurimit, ose me testament, ose rasti kur të dy vetë, së bashku, kanë hedhur një rrjetë për peshkim, ose kanë ngritur bashkërisht një kurth për gjueti.

Kjo lloj ortakërie quhet ortakëri prone dhe ortakëri me ortak. Juristi i fesë (fekijh) s'ka ndonjë lidhje me ortakërinë si marrëdhënie ortakërie, por trajton çështjet juridike që lindin prej marrëdhënieve të ortakërisë, sepse, në të vërtetë, detyra e juristit të fesë është që ai të studiojë dispozitën obliguese, siç është

detyrimi për të kryer një veprim dhe ndalimi për të mos kryer një veprim tjetër.

Gjithashtu, juristi i fesë studion dispozitat konkrete të sendeve, si: vlefshmëria ligjore, ose prishja e tyre. Ortakëria, në kuptimin e pronës dhe ortakëria me pronën, nuk ka asgjë të përbashkët, as me dispozitat obliguese e as me dispozitat e gjendjes së sendeve. Nëse të drejtat bashkohen në një send, realizohet ortakëria dhe, nëse ato të drejta nuk janë në atë send, atëherë ortakëria nuk realizohet. Padyshim që detyra e juristit të fesë konsiston në faktin që ai qartëson dispozitat në lidhje me ortakërinë me pronën, siç janë: prodhimi i pasurisë me ortakëri i takon të gjithë ortakëve, njëri prej dy ortakëve nuk vepron dot mbi pronën me ortakëri, pa lejen e ortakut tjetër, ortakut ka të drejtë të kërkojë pjesëtimin e pronës në ortakëri dhe nuk e ka detyrim që të bëjë durim për pjesëtimin e pjesës së tij në ortakëri. Për sa i përket kuptimit dhe përkufizimit të pronës në ortakëri, këto çështje nuk janë prej kompetencave të juristit të fesë.

Për sa i përket kuptimit të dytë, domethënë kuptimit ligjor të ortakërisë, ky është objekt i punës së juristit të fesë, domethënë është kontrata e lidhur ndërmjet dy ose më shumë personave për të qenë në ortakëri në një pasuri të vetme, ose në disa pasuri. Në shumicën e rasteve, qëllimi me kontratën e ortakërisë është tregtia dhe pikërisht kjo ortakëri është objekti i studimit të juristit të fesë.

Llojet e ortakërisë

Ortakëria është katër llojesh

1- Ortakëri titujsh, që është ortakëri në pasuri. Në këtë ortakëri, secili prej dy ortakëve vjen me kapitalin e tij dhe e përzien atë me kapitalin e tjetrit, me qëllim që të dy së bashku të punojnë me këtë kapital dhe fitimi i realizuar, ose humbja e pësuar, të jetë në masën e kapitalit që ka sjellë secili prej ortakëve. Me fjalën e përbashkët të fukahave, kjo lloj ortakërie është e lejuar, madje thuhet se nuk lejohet ndonjë lloj tjetër ortakërie përveç kësaj.

2- Ortakëria e trupave, që do të thotë se dy vetë ose më shumë merren vesh mes tyre, që secili prej tyre të punojë me mëditje dhe fitimin e realizuar ta ndajnë në mes, sipas marrëveshjes që kanë bërë. Në këtë lloj marrëveshje nuk ka dallim, nëse puna e të gjithëve është e njëjtë, si për shembull, ortakët të gjithë janë avokatë, ose punët janë të ndryshme, si për shembull, njëri është avokat dhe tjetri është mjek.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, të bazuar mbi dëshminë e autorëve të librave “El Xhevahir”, “El Hadaik” dhe “Miftahul Kerameh”, të cilët kanë thënë se kjo lloj ortakërie është falsë, sepse, në të vërtetë, nuk është ortakëri, por është thjesht një miratim i ndërsjellë, por nuk është i mjaftueshëm për vlefshmërinë e ortakërisë, pasi s’ka tekst që të lejojë këtë lloj ortakërie.

Ne mendojmë se çdo marrëveshje mes dy vetëve ose edhe më shumë se dy, është e vlefshme. Gjithashtu, mendojmë se mbi të gjitha llojet e marrëveshjeve renditen të gjitha dispozitat e

marrëveshjes, si edhe efektet e saj, kur objekti i marrëveshjes është ligjërisht i atillë që mundëson obligimin, domethënë se marrëveshja nuk bën haram hallallin e nuk bën hallall haramin.

3- Ortakëri e negociueshme, në të cilën çdo njëri prej dy ortakëve merr detyrim ndaj tjetrit, se prodhimi që ai do të realizojë prej deleve, do të jetë në ortakëri mes atyre të dyve dhe prej kësaj ortakërie ai përjashton vetëm ushqimin e rrobat e tij, kurse detyrimet e tjera, si taksat e gjobat do të rëndojnë mbi të dy së bashku. Edhe kjo ortakëri, me fjalën e përbashkët të fukahave, është pa vlerë, sepse rregulli është: Çdo njeri, sipas punës së kryer dhe çdo person, përgjigjet për atë që ka bërë.

Pjesëtimi

Kuptimi i pjesëtimit

Pjesëtimi është veçimi i njëres pjesë prej pjesës tjetër. Pjesëtimi, si veprim, qëndron në vetvete dhe nuk është as shitje e as pajtim, sepse i mungon formula. Është detyrim që çdo pjesë të jetë në masën e pjesës tjetër, pa shtim e pa pakësim. Në disa raste, ortaku mund të imponohet të pranojë pjesëtimin, kurse në shitjen nuk kemi asgjë nga këto që u thanë.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pjesëtimi nuk është as shitje, as pajtim e as ndonjë veprim tjetër, prandaj, pa asnjë kundërshtim në mesin e fukahave, është e barabartë, nëse në pjesëtimin ka apo nuk ka kthim. Nuk ka asnjë problem për domosdoshmërinë e shtimit të ndonjë sendi mbi kuptimin e dy

pjesëve që pjesëtimi të jetë i vlefshëm. Në pjesëtim s'ka as shtim, as përzgjedhje kuvendi e as ndonjë gjë tjetër."

Pjesëtimi i imponuar dhe me konsensus

Kur njëri prej dy ortakëve kërkon pjesëtimin, kurse ortaku tjetër nuk e kërkon pjesëtimin, atëherë shikohet: Në qoftë se ai nuk e kërkon pjesëtimin për të dëmtuar ortakun që nuk e do pjesëtimin dhe s'ka as hakmarrje njëri kundër tjetrit, me fjalën e përbashkët të fukahave, ai që nuk do pjesëtimin, imponohet të pranojë pjesëtimin, por është detyrim që secili të marrë të drejtën që i takon kurdo që ta kërkojë dhe nuk lejohet që ai të privohet nga e drejta e tij. Ky quhet pjesëtim me imponim.

Kur pjesëtimi nuk është i mundur të bëhet, si për shembull, ortakëria në një diamant, ose në një pjesë të armës, ose në sende të tjera të ngjashme, në atë mënyrë që pjesëtimi sjell prishjen e sendit; ose pjesëtimi është i mundur, por ortaku nuk përfiton nga përzierja e dy pasurive, kjo ortakëri nuk është e vlefshme."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Me fjalën e përbashkët të fukahave, që të vërtetohet se ortakëria është kontratë, duhet të thuhet: "Ne u bashkuam për të ndërtuar." Me këtë shprehje realizohet ortakëria, duke bërë që secila prej dy pasurive të jetë në pronësi të përbashkët mes dy ortakëve, por ai këtë e vë kusht për vlefshmërinë e marrëveshjes dhe me këtë realizohet përzierja. Kur përzierja e dy pasurive bëhet me qëllim ndërtimin e ortakërisë pa thënë asnjë fjalë, ortakëria është realizuar dhe është dhënie e ndërsjellë. Për sa i përket përzierjes së imponuar, e zhveshur nga qëllimi për ndërtimin e ortakërisë, mbi

këtë përzierje nuk mund të renditet pasuria e secilit prej dy ortakëve me pjesën e përbashkët në të njëjtën punë, por përfitohet përngjasimi në çdo pjesë të pasurisë.”

Kuptimi që arrihet prej kësaj fjalie, do të thotë: Ortakëria ligjore për të cilën flet juristi i fesë, realizohet me përzierjen e dy pasurive, krahas qëllimit e dëshirës për ndërtimin e ortakërisë. Kjo është e barabartë, nëse thonë ose nuk thonë dy ortakët: “Ne bëme ortakëri”. Nëse dy ortakët e thonë këtë fjalë, ortakëria është me kontratë, ndryshe është ortakëri me pjesë të ndërsjella. Gjithsesi, rezultati është i njëjtë. Për sa i përket përzierjes së dy pasurive, pa qëllim ndërtimin e ortakërisë, në këtë rast, nuk ndërtohet ortakëri ligjore, për shkak se mungon qëllimi e vullneti për ndërtimin e ortakërisë, gjithashtu, nuk kemi as ortakëri në kuptimin e ortakërisë me pasuri të përbashkët, sepse çdo pjesë e pasurisë së përzier, ose i takon këtij ortakut, ose ajo i takon ortakut tjetër.

Gjithashtu, nuk është as ortakëri në kuptimin që çdo pjesë e pasurisë është e përbashkët ndërmjet dy ortakëve, sepse, në këtë gjendje, ortakëria ligjore nuk mund të ekzistojë vetëm me qëllimin. Ortakëria nuk mund të ekzistojë as vetëm me përzierjen e pasurive, pasi patjetër duhet të ekzistojnë të dyja njëherësh, domethënë, duhet të ekzistojë qëllimi dhe përzierja. Gjithashtu, edhe përzierja nuk e realizon ortakërinë, në kuptimin e pasurisë së përbashkët në të njëjtën punë e në të njëjtin realitet, pasi, në të vërtetë, kemi të bëjmë me bashkimin e dy pasurive në ortakëri ndërmjet dy pronarëve për shkak të pamundësisë për ndarjen e dy pasurive, si pasojë e përzierjes që ka ndodhur mes dy pasurive.

Kur njëri ortak shet pjesën e tij të ortakërisë me pjesën e tjetrit, ose e shet atë me një çmim dhe me atë çmim ble pjesën prej të dytit, në këtë rast, detyrimisht realizohet ortakëria në të dyja

pasuritë, edhe nëse nuk realizohet përzjerja e nuk bashkohen dy pasuritë.

Kjo ortakëri nuk është objekt i këtij studimi, sepse ajo nuk bazohet në kontratën e ortakërisë.

Dispozitat e ortakërisë

Kur ekzistojnë të gjithë faktorët që e bëjnë ortakërinë të konsiderohet e vlefshme, mbi këtë ortakëri renditen dispozitat vijuese:

1- Ortakëria është e lejueshme prej të dyja anëve dhe ortakut ka të drejtë: Të heqë dorë prej ortakërisë e të kërkojë pjesëtimin e pasurisë në ortakëri, kur të dojë, sepse njerëzit janë pronarë të pasurisë së tyre, me të gjitha llojet e pronësisë mbi pasurinë, përfshirë edhe rastin kur pasuria e tij rrjedh prej pasurisë së një tjetri. Sikur të vihet kusht vonimi dhe kufizimi i ortakërisë, deri në një kohë të përcaktuar, kjo nuk është e detyrueshme dhe ortakut ka të drejtë të heqë dorë prej saj, sepse kushti në kontratë është i lejueshëm dhe në gjykim kushti ndjek të kushtëzuarin.

2- Kur dy ortakët vënë kusht që puna t'i takojë njërit dhe jo tjetrit, ose është vënë kusht që të punojë secili prej dy ortakëve, pa i kërkuar gjë tjetrit, ky kushtëzim është i vlefshëm, por vetë kushti nuk është i detyrueshëm, për rrjedhojë lejohet heqja dorë prej tij, kur të dëshirojë ortakut.

Në qoftë se ata të dy nuk kanë vënë ndonjë kusht për këtë çështje, atëherë asnjërit prej atyre të dyve nuk i lejohet të veprojë me pasurinë në ortakëri pa lejen e ortakut tjetër, për shkak të

ndalimit kategorik për të vepruar mbi pasurinë e tjetrit, pasi vetëm ortakëria nuk tregon lejim për të vepruar me pasurinë e ortakut.

3- Kur ata të dy kanë bërë ortakëri në përgjithësi dhe nuk kanë shpjeguar sasinë e kontributeve, fitimi i realizuar pjesëtohet për pronarin e pasurive në ortakëri, në raport me pasurinë e vënë prej tyre.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që është ortak në një mall. Çfarë mund të përfitojë prej kësaj ortakërie? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse fiton, fitimi i takon atij dhe, nëse humb, humbja është për llogari të tij.”

Autori librit “El Xhevahir” ka thënë: “Për këtë çështje s’ka asnjë kundërshtim në mesin e fukahave. Kjo është e barabartë, qoftë kur dy ortakët janë, qoftë kur nuk janë të barabartë me punën e tyre. Kjo çështje ka fjalën e përbashkët të fukahave, të bazuar mbi hadithet e shumta me varg të pashkëputur përcjellësish, duke shtuar edhe kërkesën e bazave të medh’hebit dhe rregullat e tij për pasurinë në ortakëri, si dhe për faktin që kjo është edhe një kërkesë logjike.”

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me faktin kur njëri prej dy ortakëve ka vënë kusht që ai të ketë më shumë pjesë në fitim, edhe pse kapitalin e kanë të barabartë, ose ka vënë kusht që fitimi e humbja të jetë e barabartë për të dy, edhe pse ka diferencë mes dy kapitaleve të vëna prej tyre, domethënë që për vënësin e kushtit të mos ketë asnjë shtesë e asnjë dallim në shtimin e fitimit.

Një grup fukahash janë shprehur për vlefshmërinë e ortakërisë dhe të kushtit. Fukaha të tjerë kanë thënë se ortakëria dhe kushti janë fiktivë, janë pa vlerë. Një grup i tretë fukahash kanë thënë se vetëm kushti është i pavlefshëm.

Autori i librit “El Xhevahir” ka pëlqyer thënien e parë, domethënë vlefshmërinë e ortakërisë dhe të kushtit, kur kushti është me miratim të dyanshëm dhe kur kushti i vënë, nuk bën hallall haramin e nuk bën haram hallallin.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka bërë ortakëri me një burrë tjetër, në një skllave të tij dhe i ka thënë atij: “Nëse ne do të kemi fitim prej saj, ti do të kesh gjysmën e fitimit dhe, nëse do të kemi humbje, ti s’ke asnjë detyrim.” A është i drejtë ky kusht? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Me këtë kusht unë nuk shikoj ndonjë problem, kur pronari i skllaves e thotë këtë me gjithë zemër.”

Mbarimi i ortakërisë

Ka dallim mes mbarimit të ortakërisë dhe mes mbarimit të lejes për ortakun që ai të veprojë me pasurinë në ortakëri, sepse ortakëria mbaron vetëm me pjesëtimin e pasurisë, ose me prishjen e pasurisë dhe s’ka ndikim kur ortakët thonë: “Ne e përfunduam ortakërinë.”

Gjithashtu, ortakëria nuk mbaron, kur nuk ka ndodhur rrjedhje e pasurisë në ortakëri. Patjetër që me këtë mbaron ortakëria e kontratës, sepse ajo është kontratë e padrejtë, por nuk mbaron ortakëria e pasurisë dhe e pjesëve të saj. Me mbarimin e

ortakërisë mbaron edhe leja për veprim me pasurinë në ortakëri. Gjithashtu, ortakëria mbaron me çmendjen e personit të lejuar për të vepruar me pasurinë në ortakëri, ose me vdekjen e tij, ose me vënien e pasurisë së tij në sekuestro për shkak të humbjes së mendjes, ose për shkak falimentimi. Me vdekjen e ortakut, ortakëria i kalon trashëgimtarit. Gjithashtu, kur ortaku çmendet, ose humb aftësinë për të vepruar, të drejtën e ortakërisë e merr përsipër kujdestari.

Çështje

1- Një person ka në pronësi një automobil dhe bën marrëveshje me një shofer, që shoferi, me këtë automobil, të transportojë udhëtarë me pagesë. Gjithashtu, ata bien dakord që fitimin e realizuar, me mëshirën e të Plotpushtetshmit, ta ndajnë përgjysmë, ose me diferencë. Shtrohet pyetja: A është e vlefshme kjo ortakëri? Nëse kjo ortakëri është e pavlefshme, kujt i takon rezultati i saj?

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, ashtu siç ka ardhur edhe në librin “Miftahul Kerameh”, se kjo ortakëri është e pavlefshme, sepse ortakëria është e vlefshme vetëm kur bëhet ortakëri me pasurinë e të dy ortakëve dhe jo vetëm me pasurinë e njërit ortak, megjithëse në marrëveshjen mes tyre s’ka spekulim, për faktin se objekti i kësaj ortakërie janë paratë dhe jo ofertat. Kjo çështje do të sqarohet më poshtë.

Gjithashtu, marrëveshja mes atyre të dyve nuk është as qeramarrje, as mëditje e caktuar në bazë të fitimit, sepse nuk dihet se sa do të jetë pagesa e udhëtimit. Bazuar mbi këtë, nëse shoferi e

ka marrë automobilin me qera, fitimi i takon pronarit të automobilit, sepse fitimi i realizuar është prodhim i pasurisë së tij, por ky pronar ka detyrim t'i paguajë shoferit mëditjen që marrin të tjerët, për faktin se shoferi nuk mund të punojë për bamirësi.

Në të vërtetë, kjo marrëveshje është e vlefshme dhe e lejueshme, por nuk është e domosdoshme që kjo marrëveshje të përputhet me ndonjërin prej kontratave, si për shembull, me kontratën e ortakërisë, ose me kontratën e qerasë, ose me kontratën e mëditjes së caktuar, por mjafton vetëm miratimi i dyanshëm, krahas faktit që për këtë marrëveshje të dyanshme s'ka pengim, as nga ana ligjore e as nga ana logjike. Për sa i përket mëditjes së shoferit, ajo nuk është pengesë për vlefshmërinë e marrëveshjes, pasi, në fakt, mëditja e shoferit është caktuar përderisa të dy ortakët, bazuar në punën e kryer kanë dijeni për këtë mëditje si sasi e si lloj.

2- Ai që merr në pronësi një gjë ligjërisht të lejuar, si: gjah, dru, bar, ujëra, etj, me qëllim që ato të jenë për atë vetë e për ndonjë tjetër, ky tjetri a bëhet ortak në ato sende që ka në pronësi i pari?

Përgjigje: Kur i pari është person i autorizuar, ose është qeradhënës për të dytin, mes tyre realizohet ortakëria, ndryshe e gjitha është për pronarin e atij sendi dhe s'ka asgjë për atë tjetrin që ai kishte qëllim, ose që e kishte bërë nijet.

Autori i librit "El Xhevahir", në lidhje me këtë çështje, shkurtimisht është shprehur: "Shkaku për pronësinë e sendeve të lejuara në ligjin e fesë është futja në dorë, krahas qëllimit për ato sende, pavarësisht nga nijeti për t'i marrë ato në pronësi për vete

ose për një tjetër. Ai që merr në pronësi një send prej sendeve të lejuara, me qëllim që ta këtë pronë, është e barabartë, nëse qëllimin për pronësinë mbi atë send e kishte për veten e tij, ose e kishte për ndonjë tjetër, pasi kriteri për marrjen në pronësi të sendeve të lejuara në ligjin e fesë dhe specifikimi i atyre gjërave të lejuara me marrjen në pronësi për vete dhe jo për ndonjë tjetër, është vetëm që ai të ketë qëllim marrjen e atyre sendeve në pronësi dhe kaq mjafton.

3- Kur njëri prej dy ortakëve e merr të plotë të drejtën që i takon si borxh prej atij që ble pjesën e tij të pasurisë në ortakëri, blerësi është ortak në atë çka i dha ortakut, plotësisht ashtu siç qëndron puna në çdo borxh që është në ortakëri, sepse çdo pjesë e këtij borxhi është e përbashkët mes atyre të dyve. Për këtë problem ka shumë transmetime të ardhura prej Ehli Bejti (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*). Disa prej këtyre transmetimeve janë përmendur në kapitullin e borxhit.

4- Tre vetë bëjnë marrëveshje për ortakëri, për shembull, në një punishte zdrukthëtarie. Njëri prej tyre jep lokalin, i dyti veglat e mjetet e duhura dhe i treti punën. Te një grup fukahash kjo ortakëri është e pavlefshme. Në lidhje me këtë çështje është shprehur edhe autori i librit “Miftahul Kerameh”.¹

Në të vërtetë, edhe kjo ortakëri është e vlefshme dhe e lejuar, sepse bëhet me miratimin e të tre ortakëve dhe nuk ka pengim as nga ana ligjore e as nga ana logjike, ashtu siç u shpjegua edhe në çështjen e parë.

¹ Shembulli që ka përmendur autori i librit “Miftahul Kerameh” është marrëveshje mes katër vetëve: i pari jep lokalin, i dyti mullirin, i treti mushkën (për rrotullimin e gurit të mullirit) dhe i katërti punën

Konflikti

Kur pasuria në ortakëri është në dorën e njërit prej dy ortakëve dhe ai pretendon prishjen e pasurisë, merret për bazë fjala e tij, krahas betimit të tij, sepse ai është person i besueshëm dhe personi i besueshëm nuk ka detyrim tjetër përveç betimit. Në lidhje me prishjen e pasurisë, nuk ka dallim, nëse shkak është i dukshëm, si për shembull, zjarri ose mbytja, ose shkak është i padukshëm, si për shembull, vjedhja.

Kur prishja e mallit vërtetohet dhe të dy ortakët bien në marrëveshje për këtë, por pala e dytë pretendon se ai që kishte në dorë pasurinë në ortakëri, ka abuzuar, ose ka vënë dorë mbi atë pasuri, për të njëjtat shkaqe, përsëri, për bazë, merret fjala e atij që kishte pasurinë në dorë, krahas detyrimit që ai të betohet.

2- Kur njëri prej dy ortakëve ble një send dhe thotë se këtë send e bleu për vete, kurse ortaku i tij thotë se atë send e bleu për llogari të ortakërisë dhe e pretendon për vete, kur u pa se ai send jep fitim, merret për bazë fjala e blerësit, krahas betimit të tij. Sikur blerësi të thotë: "Unë e bleva atë send për llogari të ortakërisë.", kurse ortaku i tij thotë: "Jo, e beleve për veten tënde, po pretendon se e bleve për llogari të ortakërisë, vetëm kur u pa që ai send doli me humbje.", përsëri merret për bazë fjala e blerësit, sepse blerjen ai e ka realizuar me qëllimin e tij.

Autori i librit "El Xheuahir" për këtë çështje është shprehur: "Pa asnjë komplikim e pa asnjë kundërshtim."

PJESËTIMI

Kuptimi i fjalës “pjesëtim”

Pjesëtimi është veçimi i njëres pjesë prej pjesës tjetër. Si veprim, pjesëtimi qëndron në vetvete dhe nuk është as kontratë shitje e as kontratë pajtimi, sepse i mungon formula. Është detyrim që çdo pjesë të jetë në masën e pjesës tjetër, pa shtim e pa pakësim. Në disa raste, ortaku mund të imponohet të pranojë pjesëtimin, kurse për shitjen nuk kemi asgjë nga këto që u thanë. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pjesëtimi nuk është as shitje, as pajtim e as ndonjë veprim tjetër, prandaj pa asnjë kundërshtim, në mesin e fukahave, është e barabartë, nëse në pjesëtim ka apo nuk ka kthim. Nuk ka asnjë problem për domosdoshmërinë e shtimit të ndonjë sendi mbi kuptimin e dy pjesëve që pjesëtimi të jetë i vlefshëm. Në pjesëtimin s’ka as shtim, as përzgjedhje kuvendi e as ndonjë gjë tjetër.”

Pjesëtimi i imponuar dhe pjesëtimi me konsensus

Kur njëri prej dy ortakëve kërkon pjesëtimin, kurse ortaku tjetër e refuzon pjesëtimin, atëherë shikohet: në qoftë se ai nuk e kërkon pjesëtimin për të dëmtuar dhe për hakmarrje kundër ortakut, me fjalën e përbashkët të fukahave, ai që e refuzon pjesëtimin imponohet ta pranojë atë. Është detyrim që secili të marrë të drejtën që i takon kurdo që ta kërkojë dhe nuk lejohet që ai të privohet nga e drejta e tij. Ky quhet Pjesëtim me imponim.

Kur pjesëtimi nuk është i munduar të bëhet, si për shembull, ortakëria në një diamant, ose në një pjesë të armës, ose në të tjera sende të ngjashme, në atë mënyrë që pjesëtimi sjell prishjen e sendit; ose pjesëtimi është i mundur, por ortaku nuk përfiton vetëm me pjesën e tij ashtu siç përfiton kur pjesa e tij është në ortakëri, si për shembull, një dhomë e vogël, kur pjesëtohet, çdo njërit prej atyre të dyve i takon të marrë një vend të ngushtë, prej të cilit nuk mund të përfitohet sipërfaqe banimi, as për ortakun e as për ndonjë tjetër; ose pjesëtimi është i mundur dhe është mundësia që, pas pjesëtimit, të përfitohet, por nuk është i mundur barazimi i pjesëve, veçse me kthim dhe me bashkimin e mallit të tepërt me mallin e ortakërisë, si për shembull, sikur ata të dy të kishin dy dhoma, vlера e njëres dhomë është njëqind, kurse vlера e dhomës tjetër është dyqind, prandaj ortaku që merr dhomën e dytë, patjetër duhet t'i paguajë pesëdhjetë ortakut tjetër që merr dhomën e parë. Nëse çështja qëndron kështu, ortaku nuk imponohet ta pranojë pjesëtimin, gjithnjë kjo bazuar mbi rregullin: S'ka dëmtim dhe s'ka përgjigje të dëmtimit me dëmtim. Gjithashtu, ky pjesëtim bëhet duke u bazuar mbi rregullin që ndalon shpërdorimin dhe shpenzimin e tepërt, sepse bashkimi i pjesëve të pasurisë mund të realizohet vetëm me konsensus të

dyanshëm dhe për këtë shkak ky lloj pjesëtimi është quajtur Pjesëtim me konsensus.

Një grup fukahash kanë thënë se nuk lejohet pjesëtimi i mallit në ortakëri, kur dëmtohen ortakët, qoftë edhe kur vetë ortakët bien dakord për pjesëtimin, sepse, edhe në këtë rast, kemi humbje të pasurisë dhe mungesë logjike për gjykimin e punëve. Këtij grupi fukahash i është përgjigjur autori i librit “El Xheuahir” me këto fjalë: “Kjo do të thotë mohim i rregullit “njerëzit janë pronarë të pasurive të tyre”. Përveç kësaj, pronari nuk mund të ndalohet të veprojë me pasurinë e tij. Nëse kjo kërkohet, është bërë një pakësim mëkatar në pasurinë e tij, por faji ligjërisht nuk është në kundërshtim me vlefshmërinë e pjesëtimit.” Bazuar mbi sa u tha, rezulton se pjesëtimi me konsensus është i vlefshëm edhe kur dëmtohen ortakët. Sikur të supozojmë se i dëmtuar prej pjesëtimit është velëm njëri prej dy ortakëve dhe është i dëmtuari ai që ka kërkuar pjesëtimin, pranohet kërkesa e tij dhe ortaku që nuk dëmtohet, imponohet të pranojë pjesëtimin. Në qoftë se pjesëtimin e kërkon ortaku që nuk dëmtohet nga pjesëtimi, kërkesa e tij nuk merret parasysh. Pjesëtimin e imponuar e merr përsipër gjykatësi ligjor, ose zyrtari i autorizuar që kryen detyrën e gjykatësit ligjor, i cili vë në konsideratë tolerancën e të dy ortakëve dhe drejtësinë në mesin e myslimanëve, ashtu siç veprohet në të gjitha çështjet e mundshme.

Pjesëtimi i adaptuar

Dy vetë kanë të përbashkët një kopsht, ose shtëpi, ose tokë dhe janë marrë vesh mes tyre që një pjesë e objektit të përbashkët

të jetë në dorën e njërit, kurse pjesa që mbetet, të jetë në dorën e tjetrit, me kusht që çdo njëri prej këtyre të dyve shfrytëzon pjesën që ka në dorë për një kohë të caktuar, ose e shfrytëzon atë, derisa të bëhet pjesëtimi përfundimtar; ose ata të dy janë marrë vesh mes tyre që njëri të shfrytëzojë këtë pasuri të përbashkët një vit dhe vitin e ardhshëm e shfrytëzon tjetri. Në të dy rastet, kjo marrëveshje është e vlefshme dhe quhet Pjesëtim i adaptuar, domethënë pjesëtim me harmonizim. Me pjesëtimin e dobive, në përgjithësi, veprohet sipas kohës, ose sipas pjesëve të sendit të përbashkët. Këtë lloj pjesëtimi të dobive fshatarët e quajnë Pjesëtim bujqësor.

Kur pjesëtimin e kërkon njëri prej ortakëve dhe tjetri nuk e kërkon, ai që nuk e kërkon pjesëtimin, nuk imponohet, sepse pjesëtimi është në pozitën e kompensimit, në të cilin duhet të merret në konsideratë konsensusi i dyanshëm.

Domosdoshmëria e pjesëtimit

Pjesëtimi është i detyrueshëm dhe nuk lejohet heqja dorë prej tij në gjendjet e poshtëshënuara:

1- Ortakët bëjnë pjesëtimin mes tyre pa shpërndarës e pa pjesëtues dhe, kur secili prej ortakëve është i kënaqur me pjesën që ka marrë, ai është i detyruar t'i përmbahet këtij pjesëtimi. Pas miratimit për pjesëtimin e bërë, atij nuk i lejohet të heqë dorë nga pjesëtimi.¹

¹ Në librin “El Lum’atu”, në fundin e kapitullit “Gjykimi”, tekstualisht thuhet: “Kur ata të dy bien dakord që çdo njëri të marrë një pjesë të caktuar, pa bërë

2- Veçimi e pjesëtimit arrihet me marrëveshje mes të gjithëve dhe nuk konsiderohet miratim, kur miratimi ndodh pas pjesëtimit, pasi për pjesëtimin mjafton miratimi krahasues.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Është e qartë mosvënia në konsideratë e miratimit pas pjesëtimit, sepse është detyrim që miratimi të jetë para pjesëtimit. Gjithashtu, është detyrim i domosdoshëm që argumentet që tregojnë kërkesën për veçimin e përcaktimin e pjesëve të jenë të dukshme. Edhe pse ky pjesëtim arrihet të bëhet, nuk ka argument që lejon kthimin e pjesëtimit të realizuar.”

Ajo që përfitohet prej argumenteve të pjesëtimit, është mjet e rrugë për të caktuar të drejtën dhe për të dalluar një të drejtë prej të drejtave të tjera.

Kur bëhet emërtimi i të drejtës, atëherë caktohet edhe përfundimi i ortakërisë dhe përfundimi është i pakthyeshëm, përveçse me argument, megjithëse edhe për këtë s’ka argument.

3- Ortakët zgjedhin një person me përvojë në ndarjen e pjesëve. Ky person bën ndarjen e pjesëve, por duhet që pjesëtimi të ketë miratimin e ortakëve.

4- Ortakët i ngrënë çështjet te gjykatësi, i cili, nga ana e tij, emëron një ndarës dhe, pasi bëhet pjesëtimi është detyrim të

pjesëtimin, pjesëtimi bëhet i detyrueshëm për shkak të faktit se pjesëtimi është bërë me konsensus, çka e bën të detyrueshme veçimin e së drejtës. Nuk ka dallim mes pjesëtimit me kthim e mes pjesëtimeve të tjera.” Termi “Pjesëtim me kthim” do të thotë: njëri prej dy ortakëve i paguan ortakut tjetër një kompensim shtesë prej pjesës së tij, me qëllim që të realizohet barazimi.

veprohet sipas fjalës së këtij ndarësi të emëruar. Në pjesëtimin nuk është kusht miratimi i ortakëve, as para e as pas pjesëtimit. Meqenëse do të veprohet sipas ndarësit gjykatës, fjala e tij është e detyrueshme për të gjithë, duan apo nuk duan ata. Është detyrim që ndarësi të jetë njeri me përvojë dhe i njohur për drejtësi, ashtu siç duhet të jenë të gjithë personat, bindja ndaj të cilëve është detyrim. Për ndarësin që zgjedhin vetë ortakët nuk vihet kusht drejtësia, madje nuk është kusht as që ai të jetë mysliman.

Me fjalë të tjera, pjesëtimi bëhet i detyrueshëm në rastet vijuese: kur secili mbetet i kënaqur me pjesën e tij, kur pjesëtimi realisht nuk bëhet, pas pjesëtimit të sendit për të cilin ata kanë rënë në marrëveshje, ose kur pas pjesëtimit që bën ndarësi i emëruar prej gjykatësit, ortakët nuk janë të kënaqur me ndarjen e tij.

Gabimi

Kur gabimi të pjesëtimi bëhet i qartë, pjesëtimi është pa vlerë. Kur gabimin e pretendon njëri prej dy ortakëve dhe tjetri e mohon gabimin, mohuesi ka detyrim të betohet që ai s'ka dijeni për gabimin, pra, ai betohet, nëse ortaku i tij pretendon se ai ka dijeni për gabimin, ndryshe fjala e tij nuk merret parasysh, veçse kur ai sjell argument. Nëse ai betohet, pjesëtimi është plotësuar, por, nëse ai refuzon të betohet, bazuar mbi lejimin e gjykimin, thjesht për shkak të refuzimit për betim, pjesëtimi është i pavlefshëm,

Kur pas pjesëtimin për ata të dy del sheshit se ata kanë edhe një ortak të tretë në rrugë pronësie, të cilin të dy nuk e kishin

llogaritur, pjesëtimi i bërë nuk është i vlefshëm, për shkak se ai pjesëtim nuk është bërë me miratimin e të gjithë ortakëve. Kur pjesëtohen dy parcela dhe çdo njëri prej atyre të dyve ka marrë një parcelë, por më pas bëhet e qartë se njëra prej këtyre dy parcelave, ose një pjesë e asaj i takon një personi tjetër, pjesëtimi është i prishur. Gjithashtu, pjesëtimi është i prishur edhe kur në parcelën objekt pjesëtimi del në shesh një e metë, me përjashtim të rastit kur të dy ortakët bëjnë marrëveshje që pjesëtimi të realizohet kundrejt kompensimit. Kur ortaku në pjesën e vet ka ndërtuar një shtëpi, ose ka mbjellë pemë dhe më pas bëhet e qartë se kjo parcelë i takon një tjetri, pronari ka të drejtë ta shembë shtëpinë dhe të shkulë pemët. Në këtë gjendje, i treti nuk i kërkon gjë ortakut, sepse pjesëtimi nuk është shitje dhe ortaku nuk e ka mashtruar atë që mund të thuhet se i mashtruari i kërkon atij që e mashtroi.

Paralajmërim

Janë edhe disa çështje që fukahatë i kanë përmendur në kapitullin e pjesëtimit dhe ato janë: në sendin e pjesëtuar ndodh që pjesët e tij herë janë të barabarta dhe herë janë të ndryshme. Shembull: Le të marrim pjesëtimin e një shtëpie dy ose më shumë kate. Pjesëtimin e banjës dhe të tjera mjedise që janë specialitet i inxhinierëve dhe jo i blerësve. Detyra e juristit të fesë qëndron në faktin se ai shpjegon qartë rastin, kur njëri ortak kërkon pjesëtimin. A është detyrim apo jo për ortakun tjetër t'i përgjigjet kërkesës së ortakut që kërkon pjesëtimin? Në qoftë se ai nuk i përgjigjet kërkesës së ortakut tij, a ka detyrim gjykatësi të imponojë refuzuesin që të pranojë pjesëtimin? Pjesëtimi është i

detyrueshëm apo është i lejueshëm? Gjithashtu, juristi i fesë bën shpjegimin e dispozitave obliguese dhe jo obliguese. Për sa i përket trajtimit të subjekteve të dispozitave, gjykatësi i fesë i referon ato te specialistët dhe te ata që kanë përvojë. E gjitha kjo për shkak të frikës se mos humb ndonjë gjë tepër e rëndësishme që nuk është ekspozuar.

Kushdo që ka interes, për më shumë informacion rreth kësaj teme, le të lexojë vëllimin e gjashtë të librit “El Xheuahir” dhe vëllimin e dhjetë të librit “Miftahul Kerameh”, kapitullin “Gjykimi”.

* * *

E DREJTA PËR TË BLERË I PARI

(esh shuf'atu)

Kuptimi i konceptit “e drejta për të blerë i pari”

Në terminologjinë e ligjit të fesë, e drejta për të blerë i pari pjesën e ortakut, do të thotë: Njëri prej dy ortakëve merr pjesën e ortakut të vet për shkak të transferimit të asaj pjese me anë të shitjes, me kusht që atë pjesë e merr në pronësi prej blerësit, është apo jo i kënaqur blerësi. Le ta ilustrojmë këtë çështje me një shembull: Dy vetë janë ortakë në një truall dhe njëri prej atyre të dyve e ble pjesën e tjetrit prej një të treti që ka pjesë në këtë truall. Në këtë gjendje, ortakë i dytë ka të drejtë të marrë në pronësi pjesën e shitur me imponim prej blerësit, kundrejt detyrimit për të paguar çmimin që ai ka dhënë.

Prej fjalës sonë “njëri prej dy ortakëve” kuptohet kur njëri prej dy ortakëve e ka shitur pjesën e tij, pasi është arritur pjesëtimi dhe, pasi çdo ortak ka marrë pjesën e vet, në atë mënyrë që në kohën e shitjes s’ka më ortakëri. Gjithashtu, kuptohet sikur ortakëria është mes më shumë se dy vetëve.

Me fjalën tonë “transferimit të saj me anë të shitjes”, mund të kuptohet edhe pasuria e transferuar me dhurim, me shumën e kurorës, ose me pajtim, për të cilat shpjegimi do të vijë më poshtë.

Ortaku që kërkon bashkimin e pjesës së tij me pjesën e ortakut, quhet bashkuesi. Blerësi që e bleu prej ortakut tjetër, quhet bashkues prej tij dhe trualli objekt shitje quhet bashkues me të.

Ligjshmëria e bashkimit të pjesëve

Bashkimi i pjesëve në ortakëri me anë të shitjes është i ligjësuar me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst. Prej teksteve kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), që tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka gjykuar për bashkimin e pjesëve në ortakëri me të drejtën e blerjes mes ortakëve për shtëpitë e për banesat.

Objekti

Objekti i bashkimit të pjesëve në ortakëri është trualli, domethënë sendi për të cilin vërtetohet se është me pjesë në ortakëri. Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se bashkimi i pjesëve në ortakëri me anë të blerjes vërtetohet për trojet që pranojnë pjesëtimin, si: tokat, shtëpitë dhe kopshtet, kurse për objekte të tjera, fukahatë kanë kundërshtime mes tyre.

Një grup fukahash mbështesin mendimin për vërtetimin e bashkimit të pjesëve në ortakëri të çdo pasurie të vënë në shitje, të

luajtshme ose të paluajtshme, e pranon ose jo bashkimin e pjesëve të saj. Për këtë pohim ata janë mbështetur në transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*). Këto transmetime i kanë neglizhuar e i kanë anashkaluar disa fukahë të dëgjuar, të cilët janë shprehur se bashkimi i pjesëve, me anë të blerjes së pjesëve të ortakëve, vërtetohet vetëm në ato objekte që pranojnë pjesëtimin dhe e mohojnë bashkimin e pjesëve me anë të shitjes për pasuritë e luajtshme, si dhe për ato pasuri të paluajtshme që nuk e pranojnë pjesëtimin. Gjithashtu, ata e mohojnë bashkimin e pjesëve në ortakëri me anë të blerjes, edhe në ato pasuri prej cilave pas pjesëtimit nuk arrihet përfitim.

Në lidhje me këtë çështje, ky grup fukahash e ka nxjerrë këtë përfundim prej dy argumenteve.

Argumenti i parë: Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) i cili tregon: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “S’ka bashkim të pjesëve për anijen, lumin, rrugën, mullirin e blojës (gurët e mullirit) dhe për hamamin.”

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: “S’ka bashkim të pjesëve në ortakëri për kafshën.”

Në një transmetim të tretë ka thënë: “Bashkimi i pjesëve të ortakëve bëhet vetëm për tokat e për shtëpitë.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në mesin e fukahave të mëvonshëm është mjaft e përhapur thënia për të vepruar sipas këtyre transmetimeve, madje ata veprojnë në përputhje me këto transmetime.”

Argumenti i dytë: Bashkimi i pjesëve në ortakëri është e kundërta e origjinës, sepse, kur merr në pronësi një send me anë të shitjes, ai send nuk mund të merret prej tij pa miratimin e pronarit dhe rregulli, në lidhje me këtë çështje, është si vijon: Detyrimi për të kufizuar në objektin konkret në ato gjëra që janë në kundërshtim me origjinën, kur objekti konkret në bashkimin e pjesëve në ortakëri është objekt i palëvizshëm dhe i atillë që nuk pranon pjesëtim.

Autori i librit “Miftahul Kerameh” ka thënë: “Mbi këtë rregull janë bazuar njerëzit në marrëdhëniet e tyre në fushat e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe janë po njerëzit ata që nuk e pranojnë bashkimin e pjesëve për rrobën, për enën, për ibrikun, për kalin, për devenë, për grurin, për elbin, për hurmën, për kripën dhe për rrushin e thatë (stafidhe). Sikur dikush në ditët e sotme të pretendojë bashkim të pjesëve në ortakëri me pjesën e tij në objekte e materiale të tilla, të tjerët menjëherë do të kundërshtojnë, por do t’i shkëmbejnë këto sende dorë për dorë. Ka rezultuar se kjo është rruga më e drejtë e një praktike të vazhdueshme.”

Për sa i përket pemëve e ndërtesave që shiten së bashku me tokën, me fjalën e përbashkët të fukahave, për këto objekte vërtetohet bashkimi i pjesëve në ortakëri me anë të shitjes. Nëse ato shiten si elemente më vete, pa tokën, atëherë për këto nuk vërtetohet bashkimi i pjesëve në ortakëri, me përjashtim të rasteve kur është saktësuar bashkimi i pjesëve të elementeve të lartpërmendura për të gjitha objektet.

Partneriteti për sendet e përbashkëta

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se komshiu jo ortak s'ka të drejtë të bashkojë pjesën e ortakut me pjesën e tij, sepse teksti si ortak ka veçuar vetëm komshiun, përjashtoi rastet kur ai është ortak në sende të përbashkëta, si rrugë e burim uji të pijshëm, që do të thotë se dy trojet fqinje kanë një udhë kalimi të përbashkët, ose ndërmjet dy trojeve ka një burim uji të përbashkët, në këtë rast secili prej dy pronarëve të trojeve, për tjetrin quhet ortak. Kur njëri prej dy pronarëve e shet truallin e tij së bashku me rrugën ose burimin e ujit, në këtë rast, komshiu i tij ka, i pari, të drejtën e blerjes, për të bërë bashkimin e pjesës së ortakut me pjesën e tij, me kusht që bashkuesi është vetëm një person dhe s'ka dallim nëse rruga ose burimi i ujit është i mundur ose nuk është e mundur të pjesëtohet. Nëse ai ka qëllim ta shesë vetëm rrugën ose vetëm burimin e ujit, atëherë merret në konsideratë mundësia ose pamundësia e pjesëtimit. Në këtë rast, bashkuesi s'ka të drejtë të përzgjedhë rrugën ose burimin e ujit e as truallin, por ai ose i merr të gjitha, ose i le të gjitha.

Vlen të theksohet se teksti i transmetuar prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), në të vërtetë, ka ardhur vetëm për rrugën, por fukahatë, duke u bazuar në dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe të autorit të librit "Miftahul Kerameh", e kanë shtrirë të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri edhe në burimet e përbashkëta të ujit të pijshëm.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një shteg në të cilin ka disa banesa në një oborr të përbashkët dhe dikush ka blerë banesën e njërit prej pronarëve të këtyre banesave. Shtrohet

pyetja: A kanë të drejtë ortakët e tij në rrugën që ta marrin atë me të drejtën e bashkimit?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse blerësi i banesës e hap portën e kësaj banese në një rrugë tjetër, të tjerët nuk e kanë të drejtën për bashkimin e pjesës së këtij pronari, edhe nëse ai e ka blerë banesën së bashku me rrugën. Në këtë rast, pronarët e tjerë të shtëpive kanë të drejtën e bashkimit të kësaj pjese me anë të blerjes.”

Siç shihet, ky transmetim vërteton të drejtën e ortakëve për bashkimin e pjesës së ortakut që shet pjesën e tij me pjesët e tyre, edhe nëse janë më shumë se dy ortakë, por fukahatë, në përgjithësi, e kanë adaptuar këtë rregull vetëm për dy ortakë, duke e atashuar thënien e tyre në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ka bashkim të pjesëve, përveçse kur janë dy ortakë, përderisa ata të dy nuk janë ndarë. Nëse bëhen tre ortakë, s’ka më bashkim të pjesës në ortakëri për asnjërin prej këtyre tre ortakëve.”

Kur pusi i përbashkët është në një tokë të përbashkët dhe është i atillë që nuk mund të pjesëtohet mes dy pronarëve të pusit, por është e mundur të arrihet një lloj barazimi mes truallit e pusit, duke ia dorëzuar vetëm njërit prej atyre të dyve, edhe nëse ai nuk përfiton me këtë dorëzim, ashtu siç kishte përfituar më parë, por prej saj ai ka një përfitim tjetër, për ortakun vërtetohet e drejta e bashkimit të pjesës së tij me pjesën e ortakut tjetër.

Në këtë mënyrë gjykohet për të gjitha gjërat që nuk është e mundur të pjesëtohen si gjë më vete, por ai send pjesëtohet vetëm kur është së bashku me një send tjetër, si dhe kur është mundësia

që të dy sendet të barazohen, krahas mundësisë së përfitimit prej secilit nga dy këto sende me një mënyrë ose me një mënyrë tjetër, siç mund të jetë një dhomë e vogël së bashku me kopshtin, ose banjën, ose një dyqan i vogël së bashku me sheshin para dyqanit, ose të tjera gjëra të kësaj natyre.

Ortakëria në vakëf

Kur një pjesë trualli, ose një copë toke është vakëf dhe pjesa tjetër është pronë e një personi, ndërkaq pronari e shet pjesën e tij, në këtë rast a vërtetohet e drejta e bashkimit të pjesëve për kujdestarin e vakëfit e për familjen e tij?

Një grup fukahash, ndër të cilët edhe autori i librave “Esh Sheràiu” dhe “El Xheuahir”, janë shprehur për mosvërtetimin e të drejtës për bashkimin e pjesëve, as atëherë kur vakëfi përdoret vetëm prej një personi, sepse vakëfi s’ka pronar, por prej vakëfit mund të përfitohet vetëm dobia që vjen prej tij, prandaj administruesit e vakëfit janë, si qeramarrësi që s’ka të drejtë të bashkojë pjesët e pronës në ortakëri.

Te fukahatë më të dëgjuar, e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri me anë të blerjes vërtetohet për shtëpinë, kopshtin, tokën, truallin e në prona të tjera të paluajtshme që pranojnë pjesëtimin, me kusht që pjesa të mos jetë vakëf, kurse për pasuritë e luajtshme, në mënyrë absolute, nuk vërtetohet bashkimi i pjesëve në ortakëri me anë të blerjes. Gjithashtu, kjo e drejtë nuk vërtetohet as për pasuritë e paluajtshme që nuk pranojnë pjesëtimin, rrugë ose burim uji, pasi këto dy fundit mund të shiten vetëm së bashku me pronën.

Bashkuesi

Më sipër u tha se bashkuesi është ortakut që merr në pronësi prej blerësit me anë të blerjes me të drejtën e bashkimit të pjesës së tij me pjesën e ortakut. Bashkuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1- Të jetë ortak në objektin në kohën e shitjes, pasi qeramarrësi s'ka të drejtën e bashkimit të pjesës së ortakut tjetër me anë të blerjes, ashtu siç nuk e ka këtë të drejtë as ortakut pas pjesëtimit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “E drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri me anë të blerjes, është vetëm për ortakun që ka bërë pjesëtimin e pronës në ortakëri.”

Në një transmetim tjetër, ai ka thënë: “Të drejtën për bashkimin e pjesëve të pronës në ortakëri e kanë vetëm dy ortakët që s'kanë bërë pjesëtimin dhe, kur caktohen kufijtë, s'ka më të drejtë për bashkimin e pjesës me anë të blerjes.”

Në hadithin sherif thuhet qartë: “I Dërguari Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka gjykuar me të drejtën e bashkimit të pjesëve, derisa nuk janë caktuar kufijtë.”, domethënë derisa toka ose trualli nuk është pjesëtuar dhe derisa nuk janë vënë kufijtë.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për të drejtën e bashkimit të pjesëve me anë të blerjes për banesat dhe pyetjes, se si duhet të jetë bashkuesi, ai iu përgjigj: “Të drejtën e bashkimit të pjesëve me anë të shitjes, ai e ka vetëm nëse është ortak.”

2- Të ketë fuqi të paguajë çmimin, të jetë besnik dhe të mos e vonojë pagesën më shumë se tri ditë, me përjashtim të rastit kur pretendon se pasurinë e tij e ka në një vend tjetër, atëherë do të vonojë pagesën vetëm aq kohë sa duhet që pasuria të arrijë te ai, duke shtuar edhe tri ditët, me kusht që blerësi nuk dëmtohet për shkak të vonimit.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Për këtë çështje, në mesin e fukahave, nuk gjej asnjë kundërshtim.” Argumentin për këtë thënie ai e gjen në një transmetim që ka ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka kërkuar bashkimin e pjesës së ortakut me pjesën e tij, në një tokë dhe ka shkuar që të sjellë shumën, por nuk është kthyer. Si duhet të veprojë pronari i tokës, nëse ai ka qëllim ta shesë tokën e tij? A duhet ta shesë atë tokën apo duhet të presë që të kthehet ortakut i tij, pasi vetëm ai gëzon i pari të drejtën e bashkimit të pjesës në ortakëri me anë të blerjes?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse është në të njëjtin qytet me të, le të presë tri ditë dhe, nëse ai nuk sjell çmimin brenda këtij afati, atëherë le ta shesë tokën dhe e drejta që kishte ortakut për bashkimin e pjesës së tij të tokës me pjesën e ortakut tjetër është pa vlerë. Por nëse ai kërkon afat që të sjellë paratë prej një vendi tjetër, atëherë le të presë aq sa duhet që ai të udhëtojë prej vendit të tij në vendin tjetër. Kur ai të kthehet, duhet të presë edhe tri ditë të tjera. Nëse ai i qëndron fjalës brenda këtij afati, bëhet bashkimi i pjesëve, ndryshe ai e humb të drejtën për të bërë bashkimin e pjesës së tij me pjesën e ortakut me anë të blerjes.”

3- Bashkuesi të jetë mysliman, kur edhe blerësi është mysliman, kurse për jomyslimanin, e drejta e bashkimit të pjesës në ortakëri me anë të blerjes vërtetohet për një të ngjashëm me të, edhe nëse shitësi është mysliman.

Kjo nuk vërtetohet për myslimanin, kur shitësi nuk është mysliman. E drejta e bashkimit të pjesës së ortakut me pjesën e tij me anë të shitjes, vërtetohet, në mënyrë absolute, për myslimanin me myslimanin dhe me jo myslimanin. Argumentin për këtë rregull fukahatë e kanë nxjerrë prej fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili tregon se gjyshi i tij, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çifuti e kristiani s’ka të drejtë të bashkojë pjesën e tij me pjesën e ortakut mysliman.”

4- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir”, që thotë se e drejta e bashkimit të pjesës me pjesën e ortakut me anë të blerjes nuk vërtetohet, nëse janë disa ortakë, qoftë edhe nëse shtohet vetëm një ortak.

Për këtë rregull, ata e kanë nxjerrë argumentin prej argumenteve të mësipërme dhe prej fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse janë më shumë se dy ortakë, asnjëri prej tyre s’ka të drejtën e bashkimit të pjesës së tij me pjesën e ortakut me anë të blerjes.”

5- Bashkuesi nuk i jep leje ortakut të tij të shesë pjesën e vet, ose bashkuesi refuzon blerjen, kur atij i ofrohet, megjithëse ai ka fuqi ta blejë këtë pjesë. Ky rregull nuk ka të bëjë me rrëzimin e asaj që nuk është detyrim, por është një kërkesë se një veprim, në përputhje me fjalën e autorit të librit “El Xhevahir” dhe është i ngjashëm me lejimin e trashëgimtarit për testamentin që i ka lënë

trashëgimlënësi para vdekjes së tij, kur bëhet fjalë për më shumë se një të tretën.

Për këtë çështje flet hadidhi sherifi: “Nuk lejohet që ai ta shesë, derisa ta lejojë ortakut i tij. Nëse ai e shet pa lejen e ortakut, ky fundit ka më shumë të drejtë mbi atë pjesë.”

Kjo do të thotë: Nëse ortakut e lejon, atëherë ai s’ka më të drejtë për pjesën në fjalë. Shpjegimi më i hollësishëm për këtë çështje do të jepet ne vijim.

6- Një grup fukahash kanë thënë se është kusht që bashkuesi të ketë dijeni për çmimin dhe për pjesën që do të vlerësohet me çmim në kohën e marrjes së pjesës me atë të bashkimit me blerje. Sikur ai të thotë: “Unë e mora këtë pjesë me të drejtën për bashkimin e pjesëve në ortakëri, me anë të blerjes aq sa të jetë çmimi.”, kjo blerje është e pavlefshme, sepse e drejta e bashkimit të pjesës me anë të blerjes, është në kuptimin e kompensimit të ndërsjellë, kurse mospasja dijeni për çmimin nënkupton mashtrim, por mashtrimi është prishës edhe për këtë shitje, plotësisht ashtu siç ishte blerja me çmim të panjohur.

Autori i librit “El Xheuahir” dhe shumë prej fukahave të mëdhenj janë shprehur se nuk ka as argument logjik e as tekst që e bën të detyrueshëm pasjen dijeni për çmimin në kohën e bashkimit të pjesës me pjesën e ortakut me anë të blerjes, por mjafton që për këtë të mësohet me rrugë dokumentimi, ose me rrugë të tjera në kohën e pagesës, sepse mashtrimi, në të vërtetë, prish vetëm shitjen, ashtu siç mësojmë prej hadithit: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka ndaluar shitjen me mashtrim dhe bashkimi i pjesës së ortakut pa e

ditur çmimin, për analogji është veprim pa vlerë.”, që do të thotë se, kur është e pamundur të mësohet çmimi në kohën marrjes e të pagesës, domethënë kur nuk është e mundur që çmimi të mësohet në asnjë gjendje, atëherë është pa vlerë marrja e pjesës së ortakut me anë të bashkimit me blerje, për shkak të pamundësisë për ta dhënë atë pjesë në dorëzim.

Një shembull të ngjashëm sjell autori i librit “Esh Sheràiu” dhe autori i librit “El Xheuàhir”: Sikur blerësi të thotë: “E harrova sa ishte çmimi.” Këtë fjalë e vërteton edhe bashkuesi.”

Personi që nuk është i pranishëm, i çmenduri, fëmija dhe mendjelehti

Mendja, mosha madhore dhe aftësia për të dalluar punët nuk janë prej kushteve të bashkuesit, sepse e drejta e bashkimit të pjesës së ortakut më anë të blerjes është një e drejtë e ndërtuar mbi pronën, sepse për pasjen e një prone në pronësi nuk është kusht as mendja, as mosha madhore e as aftësia për të dalluar punët, sepse për të çendurin, për fëmijën e për mendjelehtin, është kujdestari i punëve të këtyre ai që merr për ata me anë të bashkimit të pjesës në ortakëri me blerje, me kusht që marrja të mos jetë e prishur, ndryshe kjo marrje është e pavlefshme.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë problem, sepse qëllimi është veprimi i tij në mënyrë ligjore dhe, nëse ai merr me shitje të prishur, është garantues për çmimin që pagoi dhe pjesa e marrë me anë të bashkimit me blerje mbetet në pronësi të blerësit.”

Kur kujdestari i personave të paaftë për të vepruar nuk e merr pjesën që duhet të marrë për llogari të tyre, megjithëse i ka mundësitë për ta marrë atë pjesë, e drejta e bashkimit të pjesës në ortakëri me anë të blerjes mbetet e qëndrueshme, derisa fëmija të arrijë moshën madhore, derisa i çmenduri të ndërgjegjësohet dhe derisa mendjeshkurtri të dallojë punët, edhe sikur nga shitja e tokës apo e truallit të kenë kaluar shumë vjet:

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa këtë çështje ,s’ka asnjë problem e asnjë kundërshtim, madje këtë çështje nuk e mohon vonimi, sepse vonimi ishte për shkak të një pengese dhe, që në rastin konkret, ishte mungesa e mendjes dhe mosha e vogël. Për sa i përket shkujdesjes së kujdestarit, me tekst e me sentencën (fetvanë) e juristëve të ligjit të fesë, e drejta e vërtetuar e të çmendurit dhe e fëmijës, nuk rrëzohet për shkak të shkujdesjes së kujdestarit, prandaj, kur rikthehet aftësia për të vepruar, plotësimi i kësaj të drejte është marrja në dorë dhe jo origjina e të drejtës, madje edhe kur kujdestari kërkon falje, falja e tij nuk merret në konsideratë, krahas detyrimit prishës, madje edhe sikur kërkuesi i faljes të jetë babai ose gjyshi nga ana e babait.

Në lidhje me dëmtimin e blerësit për shkak të zgjatjes së pritjes, pritja nuk e rrëzon të drejtën për shkak të neglizhuesit, kur vetë blerësi është shkak për futjen dhe dëmtimin mbi vetveten, sepse ai rriskoi të blinte, edhe pse kishte dijeni për ekzistencën e bashkuesit të pjesës së tij me pjesën e ortakut. Prandaj mendohet se është më i fuqishëm rregulli për lejimin e caktimit të kujdestarit që ai të marrë, edhe nëse më parë ka hequr dorë, ose ka kërkuar falje dhe, e gjitha kjo për shkak të pavlefshmërisë së veprimit të tij e të faljes që ai kërkoi. Prandaj mbi këto dy faktorë nuk renditen efektet.”

Për sa i përket bashkuesit, nëse ai ka dijeni për shitjen dhe hesht për kërkesën, por vonon e nuk paraqitet, nuk lëshon as prokurë për marrjen, e drejta e tij për bashkimin e pjesës së tij me pjesën e ortakut rrëzohet, sepse kjo e drejtë vërtetohet në çast, ashtu siç do të trajtohet më poshtë rasti kur ai nuk ka dijeni për shitjen, ose ka dijeni dhe nuk e bën kërkesën për shkak të një pengese ligjore. Gjithashtu, kur ai ka dijeni që ka të drejtë të marrë me anë të bashkimit të pjesëve në ortakëri, kjo e drejtë e tij mbetet e pacenuar, edhe nëse koha zgjatet.

Për këtë çështje tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kujdestari i jetimit është në pozitën e babait të tij. Ai merr me bashkim pjesën në ortakëri për llogari të fëmijës, kur ai ka dëshirë për këtë bashkim të pjesëve në ortakëri.”

Gjithashtu, e drejta e bashkimit të pjesëve mbetet edhe për personin që nuk është i pranishëm.

Bashkimi i pjesëve me blerje, me përzgjedhje

Kur ai ble me përzgjedhje, prej njërit prej dy ortakëve, a vërtetohet e drejta e bashkimit të pjesëve për ortakun e dytë gjatë kohës së përzgjedhjes, apo ai pret, derisa të përfundojë koha e përzgjedhjes, që blerja të bëhet e detyrueshme. Përgjigjja për këtë pyetje kërkon sqarimet vijuese:

1- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, me dëshminë e autorit të librit “El Mesalik” dhe “El Hadaik” se, kur përzgjedhja është për blerësin dhe jo për shitësin, e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri vërtetohet edhe për ortakun me të njëjtën

kontratë. Gjithashtu, vërtetimi i të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri nuk pezullohet për shkak të kalimit të kohës së përzgjedhjes, sepse sendi objekt shitje me bërjen e kontratës ka dalë nga pronësia e shitësit dhe ka hyrë në pronësi të blerësit, edhe sikur prona të jetë duke shkuar drejt asgjësimit. Kur bashkuesi i paguan çmimin blerësit dhe merr prej tij sendin objekt shitje, e drejta e përzgjedhjes për blerësin rrëzohet, sepse qëllimi me përzgjedhjen e tij qëndron në prishjen e kontratës dhe në kthimin e çmimit, mirëpo ai e ka marrë çmimin prej bashkuesit, prandaj s'ka më vend të flitet për prishje, madje në mënyrë absolute nuk mund të flitet për prishje të shitjes.

2- Fukahatë kanë kundërshtim mes tyre, kur e drejta e përzgjedhjes është vetëm për shitësin, ose këtë të drejtë e ka shitësi dhe blerësi. Në grup fukahash janë shprehur për mosvërtetimin e të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri, sepse objekti i vënë në shitje, sipas pretendimit të tyre, nuk del prej pronësisë së shitësit.

Fukaha të tjerë, ndër të cilët edhe autorët e librave “Esh Sherai’u” dhe “El Hadàik”, kanë thënë se e drejta e bashkimit të pjesës në ortakëri, me anë të blerjes, mbetet e pandryshueshme, edhe krahas përzgjedhjes, sepse kërkesa për bashkimin e pjesëve në ortakëri ekziston dhe konsiston në faktin se argumentet që vërtetojnë bashkimin e pjesëve në ortakëri, me anë të shitjes, përfshijnë të gjitha llojet e shitjeve, qoftë edhe shitjen me përzgjedhje, sepse vetë përzgjedhja nuk shërben si argument që ndalon pronësinë për blerësin, pasi, në të vërtetë, e bën atë pronë të lëkundur, domethënë pronë që shkon drejt asgjësimit, në një kohë që objekti i bashkimit të pjesëve në ortakëri, me anë të

shitjes, është pikërisht pronësia që ai ka, pavarësisht prej detyrimit ose mosdetyrimit.

3- Kur njëri prej dy ortakëve i shet pjesën e tij, për shembull Zejdit dhe pastaj ortaku tjetër, që ka të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, ia shet pjesën e tij Amrit, para se ta marrë atë pjesë me anë të bashkimit, me anë të blerjes, e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri i kalon Zejdit dhe ai bëhet bashkues (shefij'ë), pasi më parë ishte bashkues prej tij (meshfuan minhu). Nëse ai dëshiron, e merr pjesën prej Amrit me të drejtën që ai ka për bashkimin e pjesëve në ortakëri, sepse tani Amri është ortaku i tij i vërtetë, kurse ortaku që i shiti Amrit pjesën e tij, s'ka të drejtë të kundërshtojë Zejdin në asgjë, sepse, pas shitjes, tanimë ai është bërë person i huaj, ose, thënë ndryshe, vetëm bashkuesi është personi për të cilin vërtetohet emri ortak në kohën e marrjes me anë të bashkimit të pjesëve në ortakëri, me anë të blerjes. Kjo është e barabartë, qoftë kur ky emërtim vërtetohet para arritjes së shitjes, qoftë kur ai vërtetohet pas arritjes së shitjes.

Bashkuesi merr në pronësi, vetëm pasi paguan çmimin

Blerësi e merr në pronësi sendin prej shitësit, sapo të plotësohet shitja pa ndalim, sapo paguan çmimin, kurse bashkuesi gëzon të drejtën e marrjes në pronësi, prandaj vetëm pas blerjes së kontratës dhe vetëm pasi paguan çmimin, ai bëhet pronar mbi pjesën e bashkuar. Në lidhje me këtë çështje fukahatë janë shprehur: "Bashkuesi, në fillim, është i detyruar të paguajë çmimin, apo është detyrim shkëmbimi objekt në shitje-çmim me një pagesë të vetme mes shitësit e blerësit."

Autori i librit “El Xheuahir” dhe fukaha të tjerë janë zgjatur shumë në vërtetimin dhe në trajtimin e hollësive, kurse ne e kemi parë këtë problem si çështje sigurimi, i cili, nëse ekziston, atëherë vazhdohet i bazuar mbi sigurinë, ndryshe çmimi lihet te gjykatësi, ose lihet te një njeri besnik për të cilin shitësi e blerësi bien dakord.

Bashkuesi s’ka të drejtë të marrë një pjesë të sendit objekt shitje, por, ose e merr të gjithë sendin ose e le të gjithë. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Nuk është larg që bashkimi i pjesëve në ortakëri të jetë nga lloji i të drejtës për ekzekutimin e dënimit fizik që nuk pranon pjesëtim. Prandaj edhe nëse ortaku mund të miratojë që ai të marrë vetëm një pjesë të sendit objekt shitje, kjo shitje është e pavlefshme.”

Me këtë fjalë ai ka qëllim të thotë: Sikur bashkuesi dhe ortaku të bien dakord të pjesëtojnë sendin objekt shitje, me fjalën e përbashkët të fukahave, kjo është e pavlefshme dhe shitja është e prishur.

Unë nuk shikoj ndonjë shkak për prishjen e shitjes, pasi parimi i miratimit të ndërsjellë vendos mbi të gjitha gjërat, me përjashtim të rastit kur ky miratim i dyanshëm bën hallall haramin, ose bën haram hallallin. Kur ortaku është i kënaqur që çmimi të paguhet me vonesë, shitja është e vlefshme. Gjithashtu, shitja është e vlefshme, kur ai është i kënaqur që të ndajë pjesën me bashkuesin, pasi qëllimi kryesor mbetet sprapsja e dëmtimit të blerësit, sepse dihet që me miratimin e dyanshëm hiqet mundësia e dëmtimit, madje ndodh që interesi i blerësit mund të përputhet me pjesëtimin e sendit në disa pjesë.

Çmimi material dhe çmimi objekt

Çmimi mbi të cilin lidhet kontrata mes dy ortakëve, herë mund të jetë materiale, si për shembull: para, grurë, oriz etj, herë tjetër çmimi mund të jetë objekt, si: kafshë e shtëpi. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët dhe kanë thënë se, kur çmimi është në materiale, për ortakun vërtetohet e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri dhe ai merr në pronësi atë pjesë me çmimin real me të cilën është bërë kontrata e shitjes mes shitësit e blerësit. Kjo është e barabartë, qoftë kur çmimi është çmimi i tregut, qoftë kur është më pak, qoftë kur është më shumë, sepse bashkuesi e merr në pronësi sendin objekt shitje prej blerësit me të njëjtat sende që ai e ka marrë më parë atë prej shitësit, prandaj s'ka efekt në shtesën, e cila formalisht i bashkëngjitet çmimit real.

Të gjitha këto masa janë vënë, me qëllim që të pengojë bashkuesin për të marrë pjesën në ortakëri në saje të së drejtës për të qenë i pari në këtë bashkim pjesësh në ortakëri dhe për të mënjeluar dëmtimin e bashkuesit, por bashkuesi ka detyrim të vërtetojë formën e të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri, prandaj, kur blerësi e mohon këtë të drejtë, është i detyruar vetëm të betohet, duke vepruar sipas anës sipërfaqësore të çështjes, derisa të vërtetohet e kundërta. Kur shitësi e ul çmimin, pas bërjes së kontratës, bashkuesi nuk përfiton prej kësaj ulje çmimi, në rastin kur ulja e çmimit është dhuratë nga ana e shitësit për blerësin. Në këtë gjendje, blerësi përfiton dhe patjetër që i rrëzohet prej shumës totale të çmimit, në rastin kur çmimi është kthim çmimi e kompensim për shkak të të metave të vërejtura në sendin objekt shitje, sepse çmimi i vërtetë është ai që mbetet pas lidhjes së kontratës.

Kur blerësi e shton çmimin pas bërjes së kontratës, shtesa nuk është e detyrueshme dhe blerësi s'ka të drejtë ta kërkojë këtë shtesë prej bashkuesit, sepse shtesa s'ka asgjë të përbashkët me çmimin e pjesës, me përjashtim të rastit kur bëhet e qartë se shitësi ka probleme me shëndetin mendor, ose ka dashur të bëhet kthimi i sendit objekt shitje dhe me këtë shtesë ai ka dashur të kënaqë blerësin, në atë mënyrë që shtesa të ishte pjesë e çmimit.

Çështja qëndron kështu, kur çmimi është në materiale. Kur çmimi është në objekte, fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, kundërshtime që reduktohen në dy thënie. Thënia e parë: Bashkimi i pjesëve në ortakëri rrëzohet që në themel. Mbështetësit e kësaj thënieje e kanë nxjerrë argumentin duke u bazuar mbi një transmetim, prej të cilit, sipas dëshmisë së autorit të librit "Mifahul Kerameh", janë larguar shumica e fukahave.

Thënia e dytë: Bashkimi i pjesëve në ortakëri vërtetohet, edhe sikur çmimi të jetë në objekte dhe është plotësisht sikur ky çmim të ishte në materiale. Kjo thënie gëzon fjalën e shumicës së fukahave, të cilët mbështesin dëshminë e autorëve të librave "Miftahul Kerameh", "El Mesalik" dhe "Err Rrijad". Në lidhje me këtë thënie, fukahatë kanë arritur në një përfundim se vlera është në vend të kompensimit dhe, duke u bazuar në argumentet e përgjithshme që flasin për bashkimin e pjesëve në ortakëri, ata mbështesin në mënyrë të barabartë, si rastin kur çmimi është në materiale, ashtu edhe rastin kur çmimi është në objekte.

Veç kësaj, vlera merret në konsideratë në kohën e bërjes së kontratës, pasi caktimi i vlerës, pas bërjes së kontratës, s'ka asnjë efekt as shtesa e çmimit e as pakësimi i çmimit. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është ajo që njihet në mesin e fukahave."

Favorizimi me çmimin

Më sipër u tha se bashkuesi merr në pronësi kundrejt çmimit me të cilin është lidhur kontrata. Për ilustrim le të shikojmë supozimin e shtjelluar në librin “El Xheuahir”, madje ky supozim patjetër duhet të ekspozohet, për shkak të hollësive dhe dobive shkencore që ai përmban.

Këtë supozim po e shtjellojmë: Sikur njëri prej dy ortakëve i shet pjesën e tij (aksionin e tij) një personi të afërm me të ose një personi të largët dhe e shet me çmim më pak se çmimi i pjesëve të ngjashme, me qëllim favorizimi e përfitimi për veten e tij, si për shembull, sikur çmimi i pjesës (aksionit) të jetë dyqind dhe ai e shet për njëqind, shtrohet pyetja: A merr bashkuesi pjesën në ortakëri me çmimin nominal, apo e merr atë pjesë me vlerën e saj reale? Përgjigjja për këtë pyetje kërkon sqarimet si më poshtë:

1- Ai shet, kur gëzon shëndet, ose kur është i sëmurë nga një sëmundje e pashërueshme, duke u bazuar mbi rregullin se realizimet e të sëmurit dalin prej një të tretës dhe jo prej origjinës, sepse shitja është prej realizimeve dhe jo prej testamenteve, por realizimet, në dispozitën e tyre, kanë bazë ligjore më të shëndoshë, ashtu siç do të trajtohet me ndihmën e Allahut në vendin përkatës. Kur çështja qëndron kështu siç u shtrua, bashkuesi e merr prej blerësit të plotë pjesën objekt shitje me çmimin që është ndërtuar kontrata, sepse argumenti që flet për bashkimin e pjesëve në ortakëri thotë: Bashkuesi merr me çmimin që përfshin këtë burim dhe nuk bën ndarje, nëse çmimi është i barabartë me vlerën, ose është më pak, ose është më shumë. Autori i librit “El Xheuahir”, në lidhje me këtë çështje, ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë komplikim.”

2- Ai shet, kur është sëmure nga një sëmundje vdekjeprurëse, krahas faktit se një e treta nuk ka vend për favorizim. Kjo është sikur shitësi ka në pronësi vetëm pjesën (aksionin) e tij, të cilin ai e shiti, në një kohë që as trashëgimtarët nuk e kanë pjesëtuar këtë shitje. Nëse çështja qëndron kështu siç u shtrua, një e treta e sendit objekt shitje i takon blerësit, si favorizim për blerësin nga ana e shitësit dhe është sikur shitësi e ka lënë një të tretën me testament për blerësin. Gjithashtu, ai merr edhe gjysmën kundrejt çmimit që në rastin e përmendur është njëqind, sepse kemi supozuar se ai e bleu për njëqind atë që kishte vlerë dyqind. Duke u bazuar mbi këtë fakt, blerësi merr në pronësi gjysmën dhe një të tretën, përfundimisht për trashëgimtarët nga sendi objekt shitje mbetet një e gjashta së bashku me njëqind dirhemët ose dinarët me të cilët është lidhur kontrata e shitjes.

Më sipër u tha që bashkuesi merr atë çka kishte në pronësi blerësi dhe, bazuar mbi këtë rregull, ai për zgjedh mes heqjes dorë nga bashkimi i pjesës në ortakëri dhe mes marrjes së pesë të gjashtave të sendit objekt i shitjes me çmimin e plotë që është bërë kontrata e shitjes, e cila, në rastin e lartpërmendur, ishte njëqind. Me këtë përshkrim gjen shpjegim edhe fraza e përmendur në librin "El Hadaik: "Sikur të supozohet që vlera e pjesës (aksionit) është dyqind dhe ai e favorizon dhe e shet atë pjesë për njëqind, në një kohë kur ai s'ka pjesë tjetër përveç saj, kjo shitje është e vlefshme në pesë të gjashtat e pjesës, që i bie të jetë gjysma dhe një e treta e saj. Gjithashtu, shitja është e pavlefshme në një të gjashtën, kur nuk paguhet çmimi. Në këtë rast, bashkuesi, nëse dëshiron, merr pesë të gjashtat me të gjithë çmimin."

Shpenzime të tjera

Në librat “Esh Sheràiu”, “El Xheuahir’”, “El Mesalik” dhe në librat e tjerë kryesorë të fik’hut thuhet se bashkuesi nuk përballon asgjë më shumë se çmimi që blerësi i ka paguar shitësit, prandaj paga e afishuesit (tellallit), kujdestarit dhe shpenzime të tjera të kësaj kategorie, të gjitha këto, janë detyrim i blerësit dhe jo i bashkuesit. Asnjë fukaha nuk ka përmendur diçka që është në kundërshtim me këtë thënie, sepse as hadithet e as transmetimet nuk bëjnë fjalë, as nga afër e as nga larg, për shpenzime të tjera përveç çmimit, sepse edhe rregullat e bashkimit të pjesëve në ortakëri, me anë të blerjes, bëjnë detyrim vetëm çmimin dhe jo shpenzime të tjera.

Konstatim: Nëse shpenzimet e tjera nuk janë prej rregullave të bashkimit të pjesëve në ortakëri me anë të shitjes, patjetër që ato janë prej rregullave të drejtësisë, të cilat nuk lejojnë që dikush të përfitojë padrejtësisht në kurriz të tjetrit. Bazuar mbi këto rregulla, bashkuesi është i detyruar të përballojë shpenzimet e nevojshme, me qëllim që të plotësohet shitja.

Vonimi i çmimit

Kur në tekstin e kontratës është shkruar vonimi i çmimit, ose është shkruar që çmimi të paguhet me këste, në këtë rast, bashkuesi përfiton, sepse bashkuesi merr në pronësi ato që kishte në pronësi blerësi, por bashkuesi ka detyrim të gjejë garantues, kur garantuesin e kërkon blerësi. Kjo bëhet me qëllim që blerësi të mos jetë i detyruar të mbajë edhe vështirësitë e bashkuesit.

Kur bashkuesi e merr në pronësi pjesën në ortakëri me çmim të vonuar dhe blerësi vdes para se të vijë afati i pagesës, shitësi ka të drejtë t'i kërkojë trashëgimtarëve të blerësit, sepse i vdekuri, me vdekjen e tij, i ka shlyer borxhet e tij të vonuara, ashtu siç u shpjegua në kapitullin "Borxhet". Gjithashtu, edhe trashëgimtarët e blerësit s'kanë të drejtë të kërkojnë prej bashkuesit para afatit të saktësuar në kontratë.

Në rastin kur vdes bashkuesi, para ardhjes së afatit të pagimit, blerësi ka të drejtë të kërkojë prej trashëgimtarëve të bashkuesit të pjesëve në ortakëri. As shitësi s'ka të drejtë të kërkojë prej trashëgimtarëve të bashkuesit pa ardhur afati për pagesën.

Menjëherë

Fukahatë më të dëgjuar anojnë kah dëshmia e autorëve të librave "El Hadaik" dhe "Miftahul Kerameh", që thonë se e drejta për të bashkuar pjesët në ortakëri, me anë të blerjes, vërtetohet menjëherë dhe jo me vonesë. Kur bashkuesi mëson për shitjen dhe nuk shpejton të kërkojë të drejtën e tij për të marrë me anë të bashkimit të pjesëve në ortakëri, pa pasur ndonjë pengesë, e drejta e tij për të bashkuar pjesët në ortakëri humbet, sepse vonimi është dëmtim për blerësin dhe bashkimi i pjesëve në ortakëri, me anë të blerjes, është e kundërta e origjinës. Atëherë çështja reduktohet duke u bazuar në kohën e marrjes dijeni, që do të thotë se kërkesa për bashkimin e pjesëve në ortakëri bëhet sapo të mësohet për shitjen, edhe nëse bashkuesi nuk ka dijeni për çmimin.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka kërkuar bashkimin e pjesës në ortakëri dhe pastaj është larguar. Si duhet të veprohet?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Pritet tri ditë.”

Në qoftë se e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri, me anë të blerjes, është saktësuar, bazuar mbi pagesën e vonuar, patjetër që kjo e drejtë do të vazhdojë edhe pas tri ditëve.

* * *

VEPRIMET E BLERËSIT

Më sipër u shpjegua se blerësi e merr në pronësi sendin objekt shitje me kontratë. Gjithashtu, u shpjegua se bashkuesi e merr në pronësi këtë pronë objekt shitje me të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri. Fakti i marrjes në pronësi të sendit objekt shitje nga ana e blerësit, tregon se blerësi ka të drejtë të veprojë mbi këtë pronë si të dëshirojë, por këtë pronë në ortakëri objekt shitje ka të drejtë ta marrë në pronësi edhe bashkuesi, me të drejtën që ai gëzon për të bashkuar pjesët në ortakëri. Prandaj në këtë gjendje, e drejta e blerësit bëhet pa vlerë. Duhet të theksohet se në këtë dyzim të të drejtave s'ka asnjë kontradiktë, pasi që të dyja të drejtat janë të ngjashme me të drejtën e dy borxhdhënësve mbi trashëgiminë që ka lënë i vdekuri borxhmarrës, si dhe me të drejtën e trashëgimtarëve të këtij të vdekuri për të marrë në pronësi trashëgiminë e lënë prej të vdekurit. Trashëgimtarët e të vdekurit kanë të drejtë të veprojnë mbi pasurinë që trashëguan, por, në të njëjtën kohë, dy borxhdhënësit kanë të drejtë të bëjnë pa vlerë veprimet e trashëgimtarëve mbi trashëgiminë e fituar, derisa trashëgimtarët nuk i kanë shlyer atyre borxhet e të vdekurit. E njëjtë më këtë çështje është edhe dhurata, pasi dhuruesi ka të drejtë të kthejë nga dhënia e dhuratës, por ama edhe personi të

cilit i është bërë dhurata, ka të drejtë të veprojë mbi këtë dhuratë, deri në kohën para se dhuruesi të kthejë mendimin për dhuratën e bërë.

Fukahatë kanë përmendur disa shembuj, kur bashkuesi prish veprimet e blerësit të pjesës në ortakëri. Gjithashtu, kanë vënë dispozitën në lidhje me gjendjet që mund të ndodhin në sendin objekt shitje, kur ai send është në dorën e blerësit, si për shembull, sendi shkatërrohet, shtohet, ose pakësohet.

Në vijim do të shtjellojmë në mënyrë të përmbledhur disa nga këta shembuj.

Kompensimi e shkëmbimi ndërmjet shitësit e blerësit

Shitësi e blerësi bëjnë shkëmbim e kompensim të ndërsjellë, kur të dy bien dakord që t'i kthejnë sendin objekt shitje pronarit të atij sendi, para se atë ta marrë bashkuesi me të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri. Në këtë rast, kompensimi e shkëmbimi është i vlefshëm, sepse e drejta e bashkuesit ka përparësi ndaj të drejtës së blerësit, për faktin se bashkimi i pjesëve në ortakëri arrihet me kontratë, kurse shkëmbimi e kompensimi është në gradë më të ulët. Me fjalë të tjera, e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri ka përparësi ndaj kompensimit e shkëmbimit. Kur del në shesh një mangësi, ose pakësim në sendin objekt shitje, pas kthimit të këtij sendi te shitësi, garantimi për këtë send është detyrim mbi blerësin, sepse blerësi është përgjegjës për atë çka ndodhi në sendin objekt shitje para shkëmbimit ose kompensimit, prandaj përgjegjësia vijon edhe pas kompensimit ose shkëmbimit.

Kjo është fjala e fukahave, të cilët nuk kanë cituar ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë çështje. Në të vërtetë, që në fillim nuk ka bashkim të pjesëve në ortakëri krahas shkëmbimit e kompensimit, sepse argumentet që flasin për bashkimin e pjesëve në ortakëri, flasin qartë në lidhje me marrjen në pronësi të sendit objekt shitje prej blerësit dhe nuk tregojnë asgjë në lidhje me gjendjen e kompensimit e të shkëmbimit, madje subjekti i bashkimit të pjesëve në ortakëri, në rastin e shkëmbimit e të kompensimit, është ortaku i ri, pavarësisht se supozohet mosekzistenca e këtij të fundit, sepse, në këtë gjendje, nuk ekziston bashkimi i pjesëve në ortakëri, për shkak të mosekzistencës të së drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri.

Veprimi i blerësit me shitje, me lënie vakëf, me dhurim

Kur blerësi ble pjesën prej ortakut, bashkuesi ka të drejtë ta prishë këtë shitje dhe përzgjedh ndërmjet marrjes së asaj pjese prej blerësit të parë, ose prej blerësit të dytë, sepse e drejta e bashkuesit të pjesëve në ortakëri është e saktësuar, megjithatë ajo është e shumëllojshme, sipas llojeve të shumta të shitjes.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Këtë unë e gjej pa kundërshtim në ndonjë send.” Kur bashkuesi e merr pjesën në ortakëri prej blerësit të parë, i paguan këtij të fundit çmimin me të cilën është bërë kontrata dhe prish shitjen e dytë. Nëse bashkuesi e merr pjesën prej blerësit të dytë, i paguan këtij çmimin me të cilin ai e ka blerë, sado që të jetë.

Kur janë disa kontrata njëra pas tjetrës, pra, janë më shumë se dy kontrata, me cilën kontratë do të veprojë bashkuesi, me të

parën që ishte e vlefshme, apo me atë që ishte pas kontratës së parë dhe që ishte e prishur? Vlefshmëria e kontratës së parë vjen prej miratimit me kontratë të vonuar, e cila, siç është shpjeguar më sipër, detyrimisht kërkon miratimin me dëshirë, kurse pavlefshmëria e kontratës me pagesë të vonuar, është e prishur për faktin se kontrata para kësaj është asgjësuar me prishje, për rrjedhojë, bëhet pa vlerë kontrata me pagesë të vonuar, për shkak se është degë e dalë prej kontratës së parë.

Kur dy pronarë trojesh kanë pjesë në një pronë të përbashkët shoqëruese të trojeve të tyre, si për shembull, rrugë ose burim uji, ose pus, ndërkohë njëri prej këtyre dy pronarëve e shet truallin e tij dhe blerësi ndërton mbi këtë truall një xhami, me pas atë truall e merr bashkuesi prej blerësit, në këtë gjendje, lënia e këtij trualli vakëf është pa vlerë, madje bashkuesi ka të drejtë ta shembë edhe xhaminë.

Në këtë rregull hyn edhe rasti kur një truall është pronë e përbashkët e dy vetëve, ndërkaq njëri prej dy ortakëve e shet pjesën e tij pa e vënë në dijeni ortakun e tij për emrin e blerësit, për më tepër, ky blerës i thotë bashkuesit: “Pjesën unë e mora dhuratë prej ortakut tënd.”. Blerësi i kërkon atij të bëjë pjesëtimin. Pas pjesëtimit, blerësi ndërtoi xhaminë në pjesën e tij.

Në të vërtetë, bashkuesi, të gjitha këto i mësoi më vonë. Në këtë gjendje, bashkuesi ka të drejtë të marrë prej blerësit pjesën objekt shitje dhe ta shembë xhaminë.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Këtë çështje e gjej pa asnjë kundërshtim mes nesh, domethënë mes fukahave të medh’hebit, e gjej edhe pa asnjë kompleksitet, për shkak të

përparësisë që ka bashkuesi në të drejtën e tij për të bashkuar pjesët në ortakëri.

Në librin “E Mebsût” mësohet se, me fjalën e përbashkët të juristëve të fesë, bashkuesi ka të drejtë ta shembë xhaminë, nëse blerësi e ka ndërtuar atë mbi atë truall.”

Kur blerësi e dhuron truallin objekt shitje, përsëri bashkuesi ka të drejtë ta marrë këtë pjesë dhe, kur ai e merr pjesën në fjalë, dhurimi i saj bëhet i pavlefshëm. Gjithashtu, bashkuesi e merr pjesën objekt shitje kudo që ai e gjen atë, duke i paguar çmimin blerësit dhurues dhe jo personit që i është dhuruar ajo pjesë, sepse, në këtë gjendje, është detyrim prishja e dhurimit, si dhe kthimi i kësaj pjese në gjendjen që ishte para dhurimit.

Pakësimi i sendit objekt shitje në dorën e blerësit

Kur sendi objekt shitje pëson një shembje, ose i ndodh ndonjë mangësi, duke qenë në dorën e blerësit, gjykimi për këtë çështje, te shumica e fukahave, është si vijon:

1- Sendi objekt shitje asgjësohet për shkak të ndonjë faktori atmosferik, aq sa prej tij nuk mbetet asnjë shenjë, në këtë gjendje, e drejta e bashkimit të pjesëve është e pavlefshme, për faktin se nuk ekziston më objekti i bashkimit.

2- Sendi objekt shitje pakësohet pa vullnetin e blerësit e pa veprimin e tij, ose edhe pa punën e ndonjë të huaji që s’ka të bëjë me këtë objekt, për shembull, shembet një pjesë e shtëpisë, ose e gjithë shtëpia, por mbetet trualli, në këtë gjendje, gjykimi është: Bashkuesi përzgjedh mes marrjes së pjesës me çmimin e plotë, ose

heq dorë nga e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri. Kjo është e barabartë, nëse pakësimi ka ndodhur para ose pas kërkesës për bashkimin e pjesëve në ortakëri. Në këtë gjendje supozohet që blerësi nuk kryen asnjë punë që do të bënte detyrim garantimin.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka blerë prej një burri tjetër një shtëpi me ortak dhe shtëpia akoma nuk është pjesëtuar. Përveç kësaj, ortaku tjetër nuk është i pranishëm. Ndodh që pasi blerësi e merr në pronësi këtë shtëpi, një rrymë uji e fuqishme e shemb shtëpinë, ndërkaq vjen edhe ortaku që mungonte dhe kërkon bashkimin e pjesëve në ortakëri. Shitësi ia jep atij pjesën e kërkuar, me kusht që ai t'i japë atij të plotë çmimin me të cilin e ka blerë, ndërkaq ortaku i thotë bashkuesit: "Hiqe prej çmimit vlerën e shtëpisë."

Në këtë gjendje, si qëndron detyrimi për këtë çështje? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Në këtë çështje, s'ka asgjë tjetër përveç blerjes e shitjes, domethënë që blerësi merr çmimin me të cilin është bërë kontrata."

3- Pakësimi ka ndodhur për shkak të punës së blerësit, por ka ndodhur para se bashkuesi të kërkojë bashkimin e pjesëve në ortakëri. Gjykimi për këtë çështje është ashtu siç ishte edhe në rastin e parë, domethënë, kur bashkuesi ka të drejtë të përzgjedhë ndërmjet marrjes së sendit objekt shitje me të gjithë çmimin, ose heq dorë nga e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri, për shkak se blerësi ka vepruar në pronën e vet dhe nuk ka bërë atakim prone, për rrjedhojë nuk ka ndonjë veprim që e bën obligim garantimin.

4- Pakësimi ka ardhur për shkak të blerësit, por ka ndodhur pas kërkesës së bashkuesit për të bashkuar pjesët në ortakëri. Në këtë gjendje, gjykimi është: Blerësi garanton pakësimin, domethënë zbritet prej çmimit vlera e pakësimit që shkaktoi blerësi, sepse bashkuesi ka të drejtë ta marrë pjesën objekt shitje të plotë me kërkesën e tij. Por, nëse veprimi i blerësit ka ndodhur pas kërkesës për bashkimin e pjesëve në ortakëri, në këtë gjendje, veprimi i tij konsiderohet atakim prone nga ana e blerësit, prandaj atakuesi ka detyrim garantimin.

Shtimi i sendit objekt shitje

Dy pronarë trojesh janë ortakë në objekte shoqëruese të trojeve të tyre, si rrugë, ose ujë dhe njëri prej dy ortakëve e shet pjesën e tij, ndërkaq blerësi mbi atë pjesë ndërton, ose mbjell pemë. Nëse këtë pjesë e merr bashkuesi, me të drejtën e tij për bashkimin e pjesëve në ortakëri, a ka detyrim bashkuesi ta kompensojë blerësin për ndërtimin, ose për pemët e mbjella, apo i lejohet atij që ta shembë ndërtimin dhe të shkulë pemët e mbjella dhe këto ia hedh të gjitha blerësit?

S'ka dyshim që bashkuesi dhe blerësi duhet të merren vesh mes tyre që bashkuesi të marrë në pronësi ndërtimin dhe pemët e mbjella, kundrejt kompensimit që i paguan blerësit, ose ndërtimi e pemët do të mbeten në pronësi të blerësit kundrejt kompensimit që blerësi i paguan bashkuesit të pjesëve në ortakëri, por edhe ortaku ka të drejtë të shkulë pemët e mbjella e të shembë ndërtimin dhe t'i asgjësojë ato prej tokës së bashkuesit, pa i marrë atij leje, sepse ai është pronari i ndërtimit e i pemëve të mbjella,

për faktin se pronari ka të drejtë të veprojë me pronën e tij si të dëshirojë, prandaj bashkuesi s'ka të drejtë të kundërshtojë ortakun në asgjë për këtë veprim.

Gjithashtu, bashkuesi nuk e ndalon ortakun të hyjë e të kalojë në tokën e tij për të shkukur pemët e për të shembur ndërtimin. Gjithashtu, nuk e ndalon atë as që të transportojë mbeturinat e shembjes e të shkuljes, sepse ky është veprim i domosdoshëm që ai bën në pronën e tij. Edhe blerësi s'ka të drejtë të kërkojë ndonjë gjë prej bashkuesit, për shkak të dëmtimit që ai pësoi prej shembjes e prej shkuljes së pemëve, sepse ishte vetë blerësi që këmbënguli të bëhej ndërtimi e të mbilleshin pemët.

Në lidhje me këtë çështje, nuk ka asnjë dyshim e kundërshtim, por dyshimi e kundërshtimi qëndron në faktin kur bashkuesi i pjesëve në ortakëri këmbëngul për shembjen e ndërtimit e për shkuljen e pemëve dhe asgjësimin e tyre prej tokës së tij, ndërkohë blerësi, nga ana e tij, këmbëngul që bashkuesi të mos e shembë ndërtimin e të mos i shkulë pemët. Në këtë gjendje, nuk është i mundur kompromisi mes bashkuesit e blerësit.

Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El Xheuahir" ka cituar fjalët e fukahave, të cilat flasin se bashkuesi për zgjedh mes dy punëve: ose të rrëzojë të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, ose të marrë ndërtimin dhe pemët me vlerën që ka ndërtesa e shembur dhe pemët e shkultura, sepse edhe blerësi i ka në pronësi që të dy elementet e asgjësuar.¹

¹ Në tekst, shprehja e autorit të librit "El-Xhevahir" është dhënë në tërësi, por tekstualisht fjala e tij është: "Ai jep vlerën e asaj që ka marrë prej blerësit.". Këtë ne e kemi shpjeguar si vijon: Bashkuesi merr pemët e mbjella dhe ndërtimin që

Thënie të tjera të fukahave flasin se bashkuesi për zgjedh mes tri veprimeve: ose të heqë dorë nga e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri, ose të marrë ndërtimin dhe pemët me vlerën që ato kanë, ose të imponojë (ligjërisht) blerësin që të shembë ndërtimin e të shkullë pemët pa pagesë e pa kompensim. Nëse blerësi kundërshton, atëherë bashkuesi bën vetë shembjen e ndërtimit dhe shkulljen e pemëve.

Thënie të tjera të fukahave, të cituara në librin e lartpërmendur, flasin për për zgjedhjen që bën bashkuesi mes tri veprimeve të lartpërmendura, duke përballuar vetë dëmin që i shkaktohet blerësit për shkak të shembjes e të shkulljes së pemëve. Përballimi bëhet kur bashkuesi i paguan blerësit diferencën mes vlerës së pemëve të mbjella e pemëve të shkullura, si dhe diferencën mes ndërtesës ekzistuese dhe vlerës së materialeve të kësaj ndërtese pas shembjes.

Shehu Et'tusij, i njohur me epitelin Shehu i grupit dhe shumë fukaha të mëdhenj, janë shprehur se thënia e fundit është thënia që peshon më shumë, sepse ajo merr në konsideratë të dyja të drejtat.

Rritja e sendit objekt shitje

Rritja është dy llojesh: rritje e bashkëngjitur, si rritja e pemës dhe shtimi i degëve të saj, si dhe rritja e ndarë, siç është rritja e njëres pemë më shumë se pema tjetër, ose shtimi i

meritojnë të shembet e të shkullen, sepse ky koncept mund të vihet në rrugë të drejtë vetëm me këtë shpjegim.

dhomave të shtëpisë. Nëse shtimi ka ndodhur pas shitjes, shtesa i takon bashkuesit.

Në lidhje me çështjen e rritjes së pemëve, autori i librit “El-Xhevahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë komplikim, shtesa detyrimisht ndjek origjinën e saj, me të cilën lidhet e drejta e bashkuesit, kurse në rastin e dhomës së shtuar pas shitjes dhe para marrjes së saj me të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, kjo shtesë i takon blerësit.”

Edhe në lidhje me këtë çështje, autori i librit “El-Xhevahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë komplikim, patjetër që kjo është një rritje që ka ndodhur në pronën e blerësit, e cila, nga ana e pronësisë, ishte në gjendje të paqëndrueshme. Gjithashtu, duhet të shtohet se rritja që ndodhi, nuk ka lidhje me shitjen në të cilën vërtetohet e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri.”

* * *

RRËZUESIT E BASHKIMIT TË PJESËVE NË ORTAKËRI, SHPËRNDARJA E BASHKIMIT TË PJESËVE NË ORTAKËRI DHE KONFLIKTI

Rrëzuesit

E drejta për të bashkuar pjesët në ortakëri rrëzohet me njërin prej shkaqeve vijuese:

1- Pjesa e vënë në shitje është asgjësuar plotësisht, para se ajo të merret në dorë, me anë të së drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri, që do të thotë se ajo nuk ekziston më si objekt, por, kur prishet vetëm njëra pjesë e saj për shkak të ndonjë sëmundjeje (faktori) atmosferike, bashkuesi përzgjedh, ose heq dorë nga e drejta e bashkimit të pjesës në ortakëri, ose e merr të gjithën të plotë me çmimin që është lidhur kontrata. Kjo çështje është trajtuar më sipër në kapitullin e mëparshëm, në paragrafin “Pakësimi i objektit të vënë në shitje në dorën e blerësit.”

2- Bashkuesi i pjesëve në ortakëri heq dorë prej të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri para shitjes. Gjithashtu, është

thënë edhe se nuk ka ndonjë efekt prej kësaj dorëheqjeje, sepse ajo është një e drejtë që i takon vetëm atij dhe kushdo që ka një të drejtë për të marrë, ka të drejtë të edhe të heqë dorë prej asaj të drejte.

3- Bashkuesi heq dorë nga e drejta për të bashkuar pjesën në ortakëri para shitjes, por është thënë se kjo dorëheqje s'ka efekt, sepse ky është rrëzim i të drejtës para se ajo të vërtetohet.

Ne i përmbahemi fjalës së autorit të librit “El Xheuahir”, i cili e ka rrëzuar të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri me këtë dorëheqje. Në një hadith të nderuar, i Dërguarit më i madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Shitja nuk është hallall (e lejuar) pa i marrë leje ortakut të tij. Nëse ai e shet dhe nuk i merr leje ortakut, atëherë ortaku ka më të drejtë në pjesën e shitur.”

Kjo do të thotë se, kur ortaku lejon shitjen, ai nuk e gëzon më të drejtën për bashkimin e pjesëve në ortakëri, sepse leja për shitje do të thotë heqje dorë prej të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri.

I Dërguari më i madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i dha të drejtë ortakut dhe e lejoi atë të shesë pjesën e tij, njëkohësisht e ndaloi që ai ta shesë pjesën e tij para dhënies së lejes prej ortakut. Në qoftë se ai e ka këtë të drejtë para shitjes, vetëkuptohet që ka të drejtë të rrëzojë këtë të drejtë para shitjes.

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Nuk duhet të vështirësohet çështja e mosbashkimit të pjesëve në ortakëri krahas

kryerjes së shitjes, bazuar mbi mendimin se ortaku s'ka të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri me lejen e tij."

Më pas tha: "Është e mjaftueshme për vlefshmërinë e të drejtës varësia e të drejtës sipas asaj që unë kam dëgjuar prej tekstit."

Me fjalën "tekst" ai ka qëllim hadithin e lartpërmendur të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Veç kësaj, e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri, në të vërtetë, është ligjëruar me qëllim trajtimin e ortakut me mëshirë dhe për të sprapsur dëmet që mund të parashikohen se mund të vijnë prej ortakut të ri që u fut në pjesën në ortakëri, por, s'ka dëmtim, edhe kur shitja është bërë me miratimin me heqjen dorë prej të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri, pavarësisht se miratimi është dhënë para ose pas shitjes.

4- Në librin "Miftahul-Kerameh", cituar prej librave "El Mukan'neah", "En Nihàjeh", "El Uesijleh" dhe "Xhamiu Sheràii", thuhet: "Kur shitësi i propozon shitjen bashkuesit të pjesëve në ortakëri me një çmim të caktuar dhe ai e refuzon blerjen, ndërkaq shitësi e shet pjesën e tij me këtë çmim, ose edhe më shumë, bashkuesi i pjesëve në ortakëri, nuk e ka më të drejtën të kërkojë prej tij, por, nëse ai e shet me çmim më të ulët se çmimi që ai i ofroi bashkuesit të pjesëve në ortakëri, atëherë ky i fundit ka të drejtë të kërkojë prej tij bashkimin e pjesës në ortakëri."

5- Kur ai e di se ka të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, megjithëkëtë nuk e bën këtë bashkim, pa pasur ndonjë justifikim, është detyrë të pritët, derisa ai të konsiderohet se ka

arritur limitin e neglizhencës dhe vetëm atëherë atij i hiqet e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri.

6- Kur shitja nënshkruhet për një çmim të caktuar dhe më pas bëhet e qartë se pjesa e shitur i takon një tjetri, e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri bëhet pa vlerë për shkak të pavlefshmërisë së kontratës së shitjes, pasi objekti i shitjes me këtë kontratë ishte pikërisht pjesa në ortakëri. E njëjta dispozitë është edhe kur pjesa në ortakëri prishet e asgjësohet para se ajo të merret në dorë.

7- Kur bashkuesi nxjerr prej pasurisë së tij pjesën e vet me anë të shitjes, ose me anë të dhurimit, ose me rrugë të tjera, pasi ortaku e ka shitur, rrëzohet e drejta e tij për bashkimin e pjesëve në ortakëri. Kjo është e barabartë, nëse ai ka ose nuk ka dijeni për shitjen, sepse klauzola e marrjes me anë të së drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri, kërkon që marrësi të jetë ortak në kohën e marrjes së asaj pjese dhe jo para marrjes së saj. Siç u shpjegua edhe më sipër, ky është edhe shkakun që e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri nuk vërtetohet pas pjesëtimit.

9- Një grup fukahash kanë thënë se e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri rrëzohet kur gjenden shembuj që tregojnë miratimin për shitjen e pjesës në ortakëri nga ana e bashkuesit, si për shembull, ai është i pranishëm në shitjen, ose hesht për shitjen, ose i uron mbarësi shitësit e blerësit, ose është garantues për të parin në shitjen, ose për të dytin në blerjen pjesës në ortakëri objekt i shitjes, ose garanton blerësin për pjesën objekt shitje, kur bëhet e qartë se ajo është një e drejtë që i takon një tjetri, ose garanton shitësin për çështjen e çmimit.

Shihet qartë se miratimi për shitjen është një gjë dhe miratimi për lënien e të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri dhe heqja dorë prej kësaj të drejte është një gjë tjetër, por ajo që e rrëzon të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, është një miratim i dytë, përveç miratimit të parë dhe është prej veprimeve të lejuara, kur qëllimi i bashkuesit të pjesëve në ortakëri është krijimi i një shkakut që bën të meritohet e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri. Në lidhje me këtë çështje, autori i librit “El-Xhevahir”, ka thënë: “Patjetër, kur shembujt tregojnë se ai, me miratimin e tij, ka pasur qëllim shitjen. Ky miratim, nga ana e tij, tregon se ai heq dorë prej të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri dhe kjo e drejtë është rrëzuar, ndryshe miratimi s’ka asnjë efekt në shitjen sido që ajo të jetë bërë.

9- Kur blerësi e bashkuesi bëjnë pajtim që ai të lërë të drejtën e bashkuesit të pjesës në ortakëri kundrejt një kompensimi që i paguan blerësi bashkuesit, ky pajtim është i vlefshëm dhe e drejta e bashkimit të pjesës në ortakëri rrëzohet, për shkak se edhe kjo e drejtë është një e drejtë pasurore, si përzgjedhja, për rrjedhojë, edhe mbi të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri pajtimi është i zbatueshëm. Argumenti për vlefshmërinë e këtij pajtimi është fjala e të Dërguarit më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Pajtimi është i lejuar”

Duhet të theksohet se ky hadith është përgjithësues, pasi, përveç bashkimit të pjesëve në ortakëri, përfshin edhe punë të tjera, patjetër kur pajtimi nuk bën hallall haramin e nuk bën haram hallallin. Gjithashtu, pajtimi është i vlefshëm kundrejt kompensimit për heqjen dorë prej të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri dhe pajtimi është pjesë e objektit të shitjes, sepse ky pajtim është pajtim i lejuar.

Trashëgimia i të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri

Kur e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri rrëzohet prej ndonjërit prej shkaqeve që e bëjnë të detyrueshëm rrëzimin e kësaj të drejte, ndërkaq bashkuesi vdes, trashëgimtarët e të vdekurit nuk mund të kërkojnë të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, sepse rrëzuesi nuk kthehet, por, kur bashkuesi vdes gjatë kohës, kur ai e gëzonte të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, shumica e fukahave mbështesin dëshminë e autorit të librit “El Hadaik” dhe të autorëve të tjerë, të cilët kanë thënë se e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri transferohet te trashëgimtarët e tij, plotësisht siç transferohen te ata pasuritë e tjera të të vdekurit.

Argumentet për këtë pohim fukahatë i kanë nxjerrë prej ajeteve të Kur’an Kerimit dhe prej haditheve profetike, që tregojnë se trashëguesi gëzon të drejtën e trashëgimlënësit. Ndër këto argumente përmendim hadithin e nderuar profetik: “Të drejtat që ka lënë i vdekuri, i kalojnë trashëgimtarit të tij.”

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se e drejta e përzgjedhjes dhe e drejta për të kërkuar zbatimin e ndëshkimit fizik për shkak të atakimit të gruas në nder, si dhe e drejta për të kërkuar zbatimin e ekzekutimit kapital për vrasjen, transferohet te trashëguesi. Është e padiskutueshme, që e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri është në kuptimin e përzgjedhjes, prandaj dispozita, në lidhje me të drejtën për bashkimin e pjesës në ortakëri, është mosrrëzimi i kësaj të drejte.

Fukaha të tjerë kanë thënë se e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri bëhet pa vlerë me vdekjen e atij që e ka të drejtën për bashkimin e pjesëve në ortakëri. Për këtë thënie ata janë mbështetur në një transmetim të gradës “I dobët”, që do të thotë se vargu i përcjellësve të këtij transmetimi ka shkëputje, ose midis përcjellësve ka edhe persona që nuk gëzojnë të gjitha cilësitë e përcjellësit të hadithit, si për shembull, dihet se njëri prej përcjellësve njihet se harron ose shton fjalë nga vetja.

Bazuar mbi këtë hadith, fukahatë kanë thënë se e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri ka lidhje fizike e jofizike me shitjen, kurse pronësia e trashëgimtarëve është e ardhur pas shitjes.

Në realitet, kjo shprehje e tyre është një shembull tipik prej thënieve të gabuara, sepse edhe trashëgimtarët gëzojnë të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, sepse këtë të drejtë e ka pasur trashëgimlënësi i tyre në kohën e shitjes, prandaj edhe pse pronësia e trashëgimtarëve është e ardhur, nuk është pengesë që edhe trashëguesit të gëzojnë të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, pasi kjo e drejtë ekzistonte edhe më parë.

Gjithashtu, nuk është pengesë që trashëgimtarët të gëzojnë të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, kur janë shumë trashëgimtarë, kur origjina e parë prej të cilit ata trashëguan këtë të drejtë, është një person i vetëm.

Mënyra e pjesëtimit të së drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri

Trashëgimtarët mund të jenë shumë dhe pjesët e tyre mund të jenë të diferencuara, si për shembull, trashëgimlënësi ka lënë një vajzë e një djalë, por dihet se dispozita e Librit të Fuqiplotit cakton qartë një të tretën për vajzën dhe dy të tretat për djalin. Kjo është dispozita për pasuritë, por a pjesëtohet me të njëjtën mënyrë edhe e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri? A bëhet kjo mënyrë pjesëtimi sipas detyrimit të ardhur në librin e Allahut, që edhe e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri të jetë një e treta për vajzën dhe pjesa tjetër të jetë për djalin, apo pjesëtimi do të bëhet sipas kokëve dhe jo sipas pjesëve, domethënë që vajza dhe djali trashëgojnë në mënyrë të barabartë, domethënë secili trashëgon gjysmën e të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri?

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El-Xhevahir”, i cili është shprehur se çdo trashëgimtar gëzon të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri sipas pjesës që ai trashëgon prej asaj që ka lënë trashëgimlënësi dhe jo si person, për faktin se të gjithë trashëgimtarët e kanë atë pasuri prej trashëgimlënësit dhe jo prej blerësit, për rrjedhojë, s’ka asnjë dallim mes të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri dhe mes pasurive të tjera që ka lënë i vdekuri.

Meqenëse e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri është një tërësi që nuk ndahet, përsëri kjo e drejtë, kur transferohet te trashëgimtarët, përsëri është një dhe e pandashme. Bazuar mbi këtë rregull, trashëgimtarët, ose e marrin të gjithë pjesën objekt shitje, ose heqin dorë prej saj si tërësi. Kur njëri prej trashëgimtarëve heq dorë prej pjesës së tij, pra, nuk kërkon pjesën

e vet në të drejtën për bashkimin e pjesëve në ortakëri, kjo lënie e kësaj të drejte prej njërit trashëgimtar, bëhet pengesë që të mos e gëzojë të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri as trashëgimtari që nuk ka hequr dorë prej kësaj të drejte të trashëguar, pra, ata ose e marrin të gjithë, ose e lënë këtë drejtë të gjithë. Për rrjedhojë, asnjëri prej trashëgimtarëve s'ka të drejtë të marrë prej saj pjesën që i takon si trashëgimtar. Patjetër që ky rregull është vënë për të ruajtur prej copëtimit të drejtën për bashkimin e pjesëve në ortakëri.

Me një fjalë, e drejta për të bashkuar pjesën në ortakëri, në asnjë gjendje, nuk mund të ndahet në pjesë. Kjo është e barabartë, qoftë kur ai që e gëzon këtë të drejtë është vetëm një person, qoftë kur janë disa trashëgimtarë. Në qoftë se ata janë më shumë se një person, asnjëri prej tyre si individ s'ka të drejtë të gëzojë të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, pa miratimin e trashëgimtarëve të tjerë. Nëse njëri prej trashëgimtarëve në këtë të drejtë heq dorë prej pjesës së tij, ai konsiderohet sikur të mos ishte, për rrjedhojë, e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri i mbetet trashëgimtarëve që nuk kanë hequr dorë prej saj. E gjitha kjo bëhet për të shmangur pjesëtimin dhe copëtimin e të drejtës së trashëguar për bashkimin e pjesëve në ortakëri.

Konflikti

1- Kur ka mosmarrëveshje mes blerësit e bashkuesit të pjesëve në ortakëri, në lidhje më shumë me blerjes dhe i pari, blerësi, thotë: "Unë e bleva atë për dy mijë.", ndërsa i dyti,

bashkuesi, thotë: “Jo, e bleve për një mijë,” në këtë rast, cili është pretenduesi dhe cili është mohuesi?

Në radhë të parë, duhet të tërheqim vëmendjen se në këtë rast dëshmia e shitësit s’ka asnjë efekt, prandaj dëshmia e tij, në mënyrë absolute, nuk pranohet. Kjo është e barabartë, qoftë kur ai e ka bërë dëshminë së bashku me blerësin, qoftë kur ai e ka bërë dëshminë së bashku me bashkuesin, sepse kriteri për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit është që sendi për të cilin bëhet dëshmia të mos jetë vepër e dëshmitarit. Pa dyshim që çmimi objekt konflikti ka ndodhur mes shitësit e blerësit, prandaj, në lidhje me këtë konflikt, nuk mund të pranohet dëshmia.

Në qoftë se gjendet argument ligjor që vërteton fjalën e blerësit, ose të bashkuesit, është detyrim të veprohet sipas këtij argumenti. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë më të dëgjuar janë shprehur në favor të dëshmisë së autorit të libri “El-Xhevahir”, i cili thotë: “Në këtë rast veprohet sipas fjalës së blerësit, krahas betimit që ai bën në lidhje me pohimin e tij, sepse blerësi nuk ka ndonjë pretendim ndaj bashkuesit, pasi e gjithë dëshira e tij është që ai të lihet në punën e vet.”

Nga ky shpjegim del qartë se për blerësin përputhet përkufizimi në lidhje me mohuesin, që do të thotë se ai heq dorë prej asaj që nuk mund të hiqet dorë. Veç kësaj, blerësi është pronari i pjesës objekt shitje dhe ajo pjesë tanimë është në dorën e tij, ndërsa bashkuesi ka qëllim që t’ia marrë atë pjesë blerësit. Të gjithë fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët e janë në pajtim të plotë me mendimin bazë që pasuria nuk mund t’i merret atij që e ka atë në dorën e tij, veçse me argument.

Pyetje: Prej bazave të objektit për të cilin është bërë pajtim është edhe rasti kur ndodh grindje së paku mes dy vetëve, ose edhe më shumë, merret në konsideratë fjala e atij që pretendon më pak, sepse baza është që të mos jetë më shumë.

Përgjigje: Kjo bazë është e vërtetë në rastin kur njëri prej dy personave në konflikt pretendon se ai ka të njëjtën në mirëbesim një shumë, për shembull, dhjetë, ndërsa pretenduesi thotë: “Jo, unë kam marrë në mirëbesim vetëm pesë dhe jo dhjetë.” Në këtë rast merret për bazë fjala që tregon më pak, sepse, siç u tha, baza është që pretendimi të mos ketë më shumë.

Kjo çështje, në fakt s’ka të bëjë me çështjen që ne po trajtojmë, sepse, në rastin tonë të konfliktit, blerësi nuk ka asnjë pretendim ndaj bashkuesit, por është pikërisht bashkuesi ai që pretendon se ka të drejta për të marrë prej blerësit.

Autori i librit “El-Xhevahir” thotë: “Merret për bazë fjala e blerësit së bashku me betimin e tij, sepse ai është personi të cilit synohet t’i hiqet pasuria që ai ka në dorë. Gjithashtu, blerësi është personi që njeh më mirë kontratën, është personi që paguan dhe është ai që ka pjesën e blerë në pronësi të tij, për rrjedhojë është personi që heq dorë prej pjesës së blerë, nëse mund të hiqet dorë prej saj, si dhe për faktin se blerësi s’ka asnjë pretendim ndaj bashkuesit. Veç kësaj, blerësi nuk pretendon se ka diçka në mirëbesim për të marrë prej bashkuesit, as nuk pretendon se ndonjë gjë e tij është në dorën e personit të mësipërm. Në të kundërt, është bashkuesi ai që mohon, prandaj fjala e tij “Që e kam blerë me më shumë.”, nuk e bën detyrim që bashkuesi të jetë pretendues, edhe nëse është në kundërshtim me origjinën, sepse

blerësi nuk pretendon asgjë ndaj bashkuesit dhe as nuk kërkon që ai t'i paguajë atij."

E gjitha kjo është e vërtetë dhe e drejtë. Megjithëkëtë është detyrim të mos merret në konsideratë fjala e blerësit, kur gjenden shembuj që tregojnë për akuza kundër tij, si për shembull, ai ka përmendur një shumë tepër të madhe, madje shumë herë më të madhe se çmimi i zakonshëm i blerjes.

2- Kur blerësi i thotë bashkuesit: "Pasi unë e bleva, në atë pjesë unë kam mbjellë pemë e kam bërë ndërtim.", ndërkaq bashkuesi i thotë: "Në asnjë mënyrë, pemët dhe ndërtimi kanë qenë aty para blerjes.", në këtë rast merret në konsideratë fjala e blerësit së bashku me betimin e tij, sepse ndërtimi e pemët e mbjella janë pronë e tij, kurse bashkuesi pretendon pronësinë mbi to, prandaj ai duhet të vërtetojë pretendimin e tij.

3- Kur njëri prej dy ortakëve pohon se i ka shitur pjesën e tij një të huaji, por ky i huaj e mohon fjalën e tij dhe betohet, në këtë rast, rrëzohet pretendimi i ortakut. Por, a ka të drejtë ortaku i dytë të kërkojë të drejtën për bashkimin e pjesëve në ortakëri prej ortakut që pretendoi se ai e ka shitur pjesën e tij, thjesht për shkak se ai ka pohuar shitjen?

Një grup fukahash kanë thënë se në këtë rast gjykohet sipas hadithit: Pohimi i të mençurve kundër vetes, është i lejuar."

Fukaha të tjerë, ndër të cilët edhe autori i librit "El Xheuahir" janë shprehur se në një gjendje të tillë nuk duhet të vërtetohet e drejta e ortakut të dytë për bashkimin e pjesëve në ortakëri, sepse vërtetimi i kësaj të drejte, në këtë gjendje, është degë prej vërtetimit të shitjes, prandaj është e detyrueshme

mosvërtetimi i kësaj të drejte. Fjala e përbashkët e dijetarëve të fesë dhe teksti flasin qartë: Bashkuesi merr prej blerësit dhe jo prej shitësit. Për sa i përket pohimit të shitësit se ai i ka shitur pjesën e tij një të huaji, në mënyrë absolute, kjo fjalë e tij s'ka asnjë efekt në raport me bashkuesin, në mënyrë të veçantë, pasi është rrëzuar pretendimi i tij.

4- Kur bashkuesi pretendon të drejtën për bashkimin e pjesës në ortakëri objekt shitje dhe blerësi i thotë bashkuesit: "Ti je i huaj dhe nuk je ortak, prandaj ti nuk e ke të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri.", në këtë rast, blerësi ka detyrë të vërtetojë fjalën e tij, kurse bashkuesi e vërteton të drejtën e pretenduar me argumente.

5- Më sipër u shpjegua se e drejta për bashkimin e pjesëve në ortakëri vërtetohet për atë që ishte ortak në kohën e shitjes dhe pjesa e tij nxirret prej pasurisë së tij para marrjes me anë të së drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri, por ai që dëshiron të marrë me anë të kësaj të drejte, ka detyrë të vërtetojë se ai ishte pronar në kohën e shitjes. Bazuar mbi këtë rregull, del nënregulli: Kur njëri prej dy ortakëve i shet pjesën e tij, për shembull Zejdit, kurse ortaku tjetër i shet pjesën e vet Amrit dhe shitja është bërë prej të dyve me një pagesë të vetme, në këtë gjendje, asnjëri prej dy ortakëve nuk mund të kërkojë prej tjetrit të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri. Edhe për atë që është në mënyrë të barabartë në shitjen e pjesës, nuk ka të drejtë të jetë i pari. Por kur blerja e njërit është para tjetrit dhe tjetri është më i vonuar në blerjen e tij, në këtë rast, e drejta e bashkimit të pjesëve në ortakëri i takon atij që ka blerë para tjetrit. Kur secili prej atyre të dyve pretendon se ai ka blerë i pari, por s'ka asnjë argument që të caktojë datën e shitjes për të dy, ose edhe datën e shitjes së njërit

prej atyre të dyve, në këtë rast, secili prej tyre është edhe pretendues edhe mohues në të njëjtën kohë, domethënë secili prej atyre të dyve pretendon të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri për veten e tij dhe ia mohon këtë të drejtë të tjerëve. Në këtë rast, në gjykim kërkohet betim prej të dy pretenduesve dhe, kur betohet secili prej dy blerësve, prona që ai ka blerë mbetet në pronësi të tij dhe rezultati është: Rrëzimi i të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri për secilin prej atyre të dyve.

Kur njëri prej atyre të dyve kërkon të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri dhe tjetri nuk e kërkon këtë të drejtë, ai që pretendon të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri ka detyrim të argumentojë, ashtu siç u theksua më sipër, kurse tjetri është i detyruar të betohet, sepse kushti për vërtetimin e të drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri, gëzon përparësi që ajo pjesë të jetë në pronësi të bashkuesit, pasi është e padiskutueshme që thjesht vetëm dyshimi për ekzistencën e kushtit të jetë i mjaftueshëm për mohimin e të kushtëzuarit. Është e mjaftueshme që mohuesi të betohet për të mohuar të drejtën e bashkimit të pjesëve në ortakëri, prandaj me betimin për mohimin e të drejtës realizohet qëllimi i kërkuar. Kështu qëndron çështja në të gjitha pretendimet, domethënë, prej betuesit kërkohet vetëm që ai të mohojë objektin e pretendimit që duhet të vërtetohet.

* * *

SPEKULIMI

Ç'do të thotë spekulim?

Dy vetë bëjnë marrëveshje që kapitali është i njërit dhe tjetri do të tregtojë me këtë kapital, me kusht që fitimi i realizuar të ndahet mes tyre. Kjo lloj marrëveshje është quajtur spekulim dhe në gjuhën arabe thirret me termat , مضاربة, قراض, و مقارضة (Mudàrebeh), (Kiràd) dhe (Mukàredah).

Burimi nga është nxjerrë termi “mudàrebeh”-“spekulim” është fjala e Allahut të Lartësuar:

“وَأَخْرَجُوا يَصْرُفُونَ فِي الْأَرْضِ يَبْتَغُونَ مِنْ فَضْلِ اللَّهِ”

“...dhe të tjerë lëvizin nëpër tokë në kërkim të mirësive të Allahut...” (Sure “El muzem’mil”, ajeti 20)

Kuptimi i fjalës “kiràd” është nxjerrë prej falës “kard” që do të thotë “pres”, për shembull, në gjuhën arabe thuhet: “karadtu-sh’shej’e”, që do të thotë: “unë e preva sendin, pra, e shkëputa prej diçkaje”.

Në këtë kuptim zotëruesi i kapitalit ose i mallit (në vijim do ta quajmë pronari), shkëput një pjesë prej pasurisë së tij dhe këtë pjesë të shkëputur ia dorëzon personit që do të punojë me këtë kapital në tregti (në vijim do ta quajmë punëtori); kurse fjala *“mukàredah”* do të thotë *“barazim”*.

Lejohet që pronari dhe punëtori të jenë më shumë se një person, për shembull, burri i jep prej pasurisë së tij dy vetëve sipas përsëkrimit që u dha për spekulimin, ose dy burra i japin prej pasurisë së tyre vetëm një njeriu dhe kështu me radhë.

Në librat e fik’hut, në kapitullin *“Spekulimi”* është përsëritur shpesh shprehja: Kur dy vetë bien në marrëveshje që malli, ose kapitali të jetë prej njërit dhe punën ta bëjë tjetri, në këtë gjendje, fitimi që do të marrin këta të dy është spekulim.

Në qoftë se ata të dy kanë rënë dakord që fitimin e merr punëtori, por ai përballon edhe humbjen, ndërsa edhe për pronarin s’ka gjë tjetër përveç kapitalit të tij, kjo mënyrë dhënie kapitali është kredia e njohur në kapitullin e borxhit. Në qoftë se ata të dy kanë rënë dakord që fitimi dhe humbja të jetë për pronarin, kurse për punëtorin s’ka asgjë përveç mëditjes.

Në librin *“El Xheuahir”* thuhet: *“Spekulimit i atashohen disa dispozita të garantimit, lënies në ruajtje, ortakërisë, si dhe dispozita të tjera që janë të kategorisë së rrëmbimit, si dhe mëditja, ose pagesa për punën e kryer.”*

Ligjshmëria e spekulimit

Spekulimi është i ligjëruar me fjalën e përbashkët të juristëve të fesë (fukahave) dhe me tekst. Prej teksteve përmendim fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për rastin, kur një burrë i thotë tjetrit: “Të jap kapital për tregti dhe fitimi të jetë mes nesh.” A është e drejtë fjala e këtij burrit? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “S’ka problem.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Fukakatë më të dëgjuar, madje të gjithë fukahatë, janë shprehur për ligjshmërinë e spekulimit. Këtë ligjshmëri ata e kanë nxjerrë prej fjalës së Allahut të Lartësuar:

“إِلَّا أَنْ تَكُونَ بَحَارَةً عَنْ تَرَاضٍ”

“...përveçse kur është tregti për të cilën keni rënë dakord mes jush...” (Sure “En Nisa”, ajri 29)

Hadithe profetike të gradës “sahijh” – “Plotësisht të vërtetuara” gjenden te librat e hadithit të Ehli Sunetit dhe te librat e haditheve të shi’ave. Pavarësisht kësaj, disa fukaha janë shprehur për mosligjëshmërinë e spekulimit, sepse spekulimi, sipas mendimit të këtij grupi fukahash, ka elemente të pavlefshme dhe elemente të qarta korrupsioni.

Spekulimi është i lejuar dhe jo i detyruar

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët që kontrata e spekulimit është e lejuar për atë që ka kapitalin dhe për atë që do të punojë me këtë kapital. Gjithashtu, për të dy lejohet ta prishin

këtë kontratë ose të heqin dorë prej saj, para fillimit të punës, ose edhe pas fillimit të punës, pavarësisht nëse është realizuar apo nuk është realizuar fitimi, pavarësisht nëse kapitali është shndërruar në mallra apo nuk është shndërruar dhe pavarësisht, nëse në kontratë është vënë kusht një kohë e caktuar, ose kontrata është pa asnjë kusht kohor.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave dhe fjala e tyre është argument për nxjerrjen e kontratës së spekulimit jashtë rregullit të kontratave të detyrueshme.”

Kushtet

Kontrata e spekulimit patjetër duhet të plotësojë kushtet vijuese:

1- Oferta nga ana e pronarit dhe pranimi nga ana e punëtorit. Oferta dhe pranimi realizohet me çdo fjalë e veprim që tregon ofertën dhe pranimin.

2- Pronari dhe punëtori janë të mençur, kanë moshë madhore dhe dinë të përzgjedhin, sipas të gjitha rregullave të vendosura për kushtet që duhet të plotësojnë dy kontraktuesit. Këtë çështje e kemi shpjeguar në pjesën e tretë. Gjithashtu, për të dy kontraktuesit merret në konsideratë gjendja e tyre mendore, sepse shitja e të çmendurit nuk është e lejuar, ashtu siç nuk është e lejuar as blerja që ai bën e as marrëveshja që ai lidh vetë për të punuar me mëditje. Për sa i përket ngurtësimit në raste falimentimi, është e qartë se ngurtësimi i heq të falimentuarit të

drejtën për të vepruar me pasurinë e tij, por nuk e nxjerr atë jashtë aftësisë që ai të zëvendësojë dikë tjetër, ose të veprojë me pasurinë e tjetrit, sidomos kur ky veprim i sjell përfitim, edhe nëse ajo që ripërtërihet, është kapital dhe si kapital ai sjell përftimin për të kredituarin e për kredituesin.

3- Kapitali i spekulimit të mos jetë borxh. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon përgjigjen që ka dhënë Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë që ka për të marrë borxhin prej një burri tjetër dhe ia kërkon borxhin, por borxhmarrësi s'ka para që t'ia kthejë borxhin, ndërkaj borxhdhënësi i thotë borxhmarrësit: "Borxhi le të jetë te ti për spekulim."

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Jo, nuk është e vlefshme, derisa ai t'i shlyejë atij borxhin."

4- Kapitali i dhënë për spekulim (sipas kushteve që u thanë në përkufizimin e spekulimit) të jetë në monedha argjendi ose floriri, si për shembull, dirhemë ose dinarë. Kjo është fjala e fukahave. Megjithëkëtë fukahatë kanë pohuar se, në të vërtetë, s'ka tekst që e redukton llojin e kapitalit vetëm në dy llojet e monedhave (argjendi ose floriri).

Fjala e përbashkët që kanë përmendur fukahatë, në lidhje me këtë çështje, përmbledhet në faktin që spekulimi është e kundërta e origjinës, pasi origjina, në fushën e fitimit, është që fitimi ndjek kapitalin, prandaj çdo gjë që bie në kundërshtim me origjinën, detyrimisht duhet të jetë diçka konkrete, prandaj kapitali reduktohet te floriri e te argjendi. Në pjesën e shtatë të librit "Miftahul Kerameh", kapitulli "Kreditimi", në faqen 439,

thuhet: “Pa dyshim që kontradikta e spekulimit me origjinën është në disa drejtime dhe për këtë shkak reduktohet në faktin që spekulimi është në kontradiktë me objektet konkrete, për të cilat dijetarët e fesë ndajnë një fjalë të përbashkët.

Në vijim, autori i librit në fjalë, thotë: “Si do të mendoje ti në lidhje me përputhjen e thënieve të fukahave, të fukahave shi’a dhe të shumicës së fukahave të Ehli Sunetit në lidhje me kushtin që kapitali i spekulimit të jetë prej dy monedhave (argjendi e floriri)?”

Kësaj pyetjeje ne i përgjigjemi:

E para: Spekulumi bëhet në përputhje me rregullin për të cilin tregon fjala e Allahut të Lartësuar:

”إِلَّا أَنْ تَكُونَ بِجَارَةٍ عَنْ تَرَاضٍ”

“...përveç kur është tregti për të cilën keni rënë dakord mes jush...”

Bazuar mbi këtë rregull, është i vlefshëm çdo spekulim i bazuar në monedhën që është në qarkullim, pavarësisht nga lloji i monedhës.

E dyta: Ne nuk e marrim në konsideratë fjalën e përbashkët që dimë, por vetëm e kemi atë parasysh, madje ne marrin në konsideratë mundësinë që bazë për fjalën e përbashkët të fukahave është pikërisht kjo origjinë, ose është ky ajet i Kur’anit, apo ky transmetim.

Përveç kësaj, ne e konsiderojmë anësore mbështetjen në fjalën e përbashkët të fukahave dhe vështrojmë te vetë

mbështetësi, pasi këtë fjalë, mbi të cilën ne bazohemi, e kemi të qartë se ajo ka ardhur prej mendimit të të ruajturit prej gabimeve (imamit). S'ka dyshim që s'ka asgjë të përbashkët me diturinë e mirëfilltë.

Fjala e përbashkët e fukahave nxjerr në dritë ekzistencën e një argumenti të marrë në konsideratë prej atyre që hulumtojnë fjalën e tyre, të cilët pohojnë përputhjen e fjalës së përbashkët të fukahave me origjinën, por për ne mbetet e njohur, prandaj te ne ajo është fjalë që s'ka burim, ndryshe ajo mbetet vetëm fjalë pa adresë e atij që e ka thënë.

Sikur kjo të ishte e vërtetë, me siguri do të ishte e vërtetë edhe thënia: Sentenca (fetvaja) e sahabiut (ata që kanë ndenjur me Profetin (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)) është argument, sepse ai ka dëgjuar hadithin prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por për ne ajo fjalë është e panjohur.

E treta: Transmetimi i ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se spekulimi nuk është i kushtëzuar me dy llojet e monedhave (argjendi e floriri), ashtu siç kanë pohuar fukahatë, të cilët e kanë reduktuar spekulimin vetëm me këto dy monedha.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Ai që punon në fushën e tregtisë me spekulim, ka pjesë në fitim dhe s'ka asnjë detyrim që të shlyejë kapitalin për tregtinë që bën, përveçse kur ai kundërshton urdhrin e pronarit." Ky transmetim përfshin të gjitha llojet e parave me të cilat bëhet tregti. Kjo është e barabartë, qoftë kur kapitali është në dy monedha, qoftë kur kapitali është në monedha të tjera.

Në lidhje me këtë çështje, shembujt janë të shumtë. Bazuar mbi këtë fakt, autori i librit “El Hadàik” ka thënë: “Ai që nuk shikon në një pretendim të tillë, si këto fjalë të përbashkëta të fukahave, sepse është vërtetuar që ato fjalë, në ligjin e fesë, nuk janë argumente, pasi në dispozitën e ligjit të fesë ai lejohet të veprojë edhe me monedha të tjera përveç dy llojeve të monedhave të përmendura, duke pasur parasysh se argumentet tregojnë lejimin e spekulimit, mendon gabim. Përveç kësaj, reduktimi i vlefshmërisë së spekulimit vetëm me dy llojet e monedhave, ka nevojë për një argument ligjor, por një argument ligjor i tillë nuk ekziston.”

E katërta: Sikur të supozohet se tregtia që bëhet me monedha të tjera dhe jo me dy llojet e monedhave të njohura, nuk emërtohet, ose nuk është e vlefshme të emërtohet spekulim (mudàrebeh), atëherë ajo është e vlefshme si mëditje, pasi rezultati është i njëjtë.

Autori i librit “El Urveul Vuthkà” tekstualisht ka thënë: “Lejohet që spekulimi të ndodhë edhe në adresë të mëditjes me kusht, si për shembull, pronari thotë: “Kur të tregtosh me këtë kapital dhe realizon fitim, gjysma e fitimit të takon ty.” Në këtë rast kemi të bëjmë me mëditje të kushtëzuar, por që sjell të njëjtin përftim si edhe spekulimi, pasi mëditja e kushtëzuar është e përfshirë tërësisht në kushtet e spekulimit, për rrjedhojë lejohet që kapitali të jetë edhe në monedha të tjera përveç dy llojeve të monedhave, ashtu siç lejohet që kapitali për spekulim të jetë borxh, ose pa adresë, me kusht që nuk përbën mashtrim.”

E pesta: Floriri dhe argjendi janë përmendur, ngaqë ishin monedhat qarkulluese të asaj kohe. Po sjellim fjalën e Imam

Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Toka nuk jepet me qera me grurë, as me elb e as me hurma, por vetëm me flori e argjend.”

Megjithëkëtë ne nuk dimë asnjë jurist të fesë (fakijh) që të thotë se nuk është e vlefshme dhënia e tokës me qera në monedha të tjera përveç monedhave prej floriri e argjendi. Krahës këtij pohimi, ne themi: Dihet se flori e argjendi, në mënyrë absolute, nuk janë përmendur në transmetimet që flasin në lidhje me spekulimin.

5- Kapitali të jetë i njohur, domethënë të dihet si shumë, sepse mosnjohja e tij sjell që të mos dihet as fitimi, për rrjedhojë bëhet i pamundur veçimi i fitimit prej kapitalit dhe kështu ndodh konflikti. Gjithashtu, dihet se është detyrim të qëndrohet sa më larg rrugëve që çojnë në konflikt.

6- Fitimi të jetë ndërmjet pronarit dhe punëtorit që punoi me këtë kapital në tregti. Nuk është i vlefshëm caktimi i një shume fitimi të cilësuar për asnjërin prej atyre të dyve, si për shembull, njëzet dirhemë dhe ajo që mbetet i takon tjetrit, sepse një veprim i tillë çon në ndërprerjen e ortakërisë dhe sjell mosekzistencën e marrëveshjes së spekulimit (mudàrebeh) nga kreu deri në fund. Ky fakt tregon se fitimi patjetër duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë mes atyre të dyve, kurse humbjen e përballon kapitali.

Nuk është prej domosdoshmërive që pjesa e fitimit për njërin të jetë e barabartë me pjesën e tjetrit, por lejohet diferenca, si për shembull, një e katërta, ose një e pesta, ose në masa të tjera, sipas kushteve me të cilat është bërë marrëveshja dhe ashtu siç është e njohur në marrëdhëniet e këtij lloji mes njerëzve.

7- A është detyrim që kapitali të jetë në dorën e punëtorit në atë mënyrë që nuk është i vlefshëm kushti që punëtori të bëjë pazar, të shesë e të blejë për llogari të spekulimit, duke mënjanuar pronarin, plotësisht ashtu siç vepron arkëtari?

Një grup fukahash kanë thënë se është e detyrueshme që kapitali të jetë në dorën e punëtorit, me qëllim që ai të ketë mundësi të punojë. Të tjerë fukaha kanë thënë se nuk është e detyrueshme, sepse puna është e mundshme dhe e lehtë. Shumica e fukahave nuk janë shprehur as negativisht e as pozitivisht për kushtin.

Autori i librit “Miftahul Kerameh” ka thënë: “Ajo që bie në sy te shumica e fukahave, është fakti se ata e marrin në konsideratë këtë kusht, kur përmendin të gjitha kushtet dhe heqin dorë prej tij.” Ja kjo është e vërteta.

Ç’kushte vënë pronari dhe punëtori?

Kushtet që ne përmendën në paragrafin e mësipërm janë kushte ligjore, të marra në konsideratë prej vetë ligjvënësit, në atë mënyrë që spekulimi nuk realizohet pa ekzistencën e plotë të tyre dhe as nuk mund të ekzistojë, kur nuk ekziston njëri prej atyre të dyve. Prandaj si pronari, ashtu edhe punëtori kanë të drejtë të shtojnë kushte të tjera rreth të cilave ata të dy bien dakord, me kusht që kushtet e vëna prej tyre nuk bien në kundërshtim me kërkesat e me natyrën e kontratës. Gjithashtu, kushtet e vëna prej tyre as nuk bëjnë hallall haramin e as nuk bëjnë haram hallallin, domethënë që rregulli për kontratën e spekulimit është si për të gjitha kontratat e tjera.

Nisur nga ky përshkrim, le të supozojmë se pronari i vë kusht punëtorit që ai të mos udhëtoje me kapitalin me vete, ose të udhëtojë me kapitalin në një drejtim të caktuar dhe jo në drejtime të tjera, ose që punëtori të tregtojë vetëm një lloj malli të përcaktuar; ose pronari i vë punëtorit edhe kushte të tjera të kësaj kategorie. Në këtë gjendje, kushti i vënë është i vlefshëm dhe mbajtja e besës për kushtin e vënë është detyrim.

Kur punëtori e kundërshton kushtin e vënë dhe kapitali pëson ndonjë gjë, në këtë rast, garantimi është detyrim mbi punëtorin, sepse ai është i prokuruari, ose është në pozitën e të prokuruarit për këtë kapital, por i prokuruari ka detyrim të zbatojë urdhrat e prokuruesit.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që punon me kapital në fushën e spekulimit. Çfarë i takon atij? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Atij i takon fitimi dhe ai s’ka asnjë detyrim për humbjen, përveçse kur kundërshton urdhrat që ka marrë prej pronarit.”

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që e jep kapitalin e tij për spekulim, por e ndalon punëtorin ta marrë me vete kapitalin. Si duhet të veprohet në këtë gjendje?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Punëtori garanton kapitalin, ose mallin, kurse fitimi pjesëtohet mes atyre të dyve.”

Pyetje: Garantimi për rastin e shkeljes së lejes së pronarit, është në përputhje me rregullin, kurse ortakëria e këtij shkelësi me pronarin në fitim, nuk ka asnjë rrugë ligjore që të tregojë për këtë

çështje, prandaj shtrohet pyetja: A meriton punëtori ndonjë gjë për punën e kryer, për të cilën nuk kishte leje të kryente?

Përgjigje: Mosmeritimi, krahas moszbatimit të urdhrit, është prej kërkesave të origjinës dhe të hulumtimit. Por, vetëkuptohet që s'ka as origjinë e as hulumtim, kur ekziston teksti. Kur bëhet e qartë që punëtori e bën shkëljen, pas arritjes së fitimit dhe ai di mirë se, kur pronari bëri marrëveshje me atë që ai të tregtojë me kapitalin e tij, punëtori është bërë ortak me pronarin në bazë të interesit dhe është sikur pronari i ka thënë atij: "Bëj gjithçka që është në interes të spekulimit, madje edhe sikur unë të ndaloj ty nga ato punë."

Kushti i përfitimit më shumë se pjesa

Autori i librit "El Urvetul Vuthkà" ka thënë: "Kur njëri prej atyre të dyve i vë kusht tjetrit brenda kuadrit të kontratës së spekulimit kapital ose punë, si për shembull, pronari i vë kusht punëtorit të qepë për atë një rrobë, ose t'i japë atij një dirhem, ose diçka të këtillë, ose punëtori i vë kusht pronarit, bëhet e qartë vlefshmëria e kushtit të vënë. Gjithashtu, kushti është i vlefshëm edhe në rastin kur njëri prej atyre të dyve i vë kusht tjetrit shitje, ose kredi, ose shkëputje e një pjese të mallit, ose të ndonjë asortimenti, ose të tjera veprime të kësaj kategorie. Pretendimi për një shumë të vërtetuar, kur ajo shumë nuk është prej pronarit, për pronarin s'ka asgjë tjetër përveç kapitalit, gjithashtu edhe për punëtorin s'ka asgjë përveç tregtisë së paguar.

Ky rregull ka të bëjë me kontratën, e cila nuk e bën këtë veprim të detyrueshëm, kur kontrata është pa kusht, por, kur

kontrata është me kusht, atëherë zbatimi i kushtit është kërkesë e kontratës, e cila nuk e mohon kushtin dhe për këtë janë të mjaftueshme argumentet e përgjigje të kushtit.

Kohëzgjatja e spekulimit

Kur marrëveshja e spekulimit është e kufizuar në kohë të caktuar, si për shembull, pronari thotë: “Këtë kapital ta lë për spekulim për një vit dhe punëtori pranon, a është e vlefshme kjo kontratë dhe a është i vlefshëm ky kusht, apo që të dy, si kontrata ashtu edhe kushti janë pa vlerë, apo kontrata është e vlefshme dhe kushti nuk është i vlefshëm?

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë tri thënie, ndërsa ne mbështetemi në opinionin e autorit të librit “El Xheuahir”, i cili ka thënë: “Me kushtin e afatit, unë kam qëllim që spekulimi të jetë i detyrueshëm para përfundimit të afatit, në atë mënyrë që nuk i lejohet as pronarit e as punëtorit të kthejnë fjalën e të prishin kontratën para mbarimit të afatit kohor, sepse kontrata dhe kushti prishen vetëm pas përfundimit të afatit. Edhe lejimi për më pas, është në kundërshtim me kërkesat e me natyrën e këtij kushti. Me këtë dua të them se çdo veprim që del prej punëtorit pas përfundimit të afatit, nuk është veprim i lejueshëm, pasi në këtë gjendje ky veprim i punëtorit nuk është prej spekulimit për të cilin ata kanë rënë në marrëveshje që të jetë e vlefshme kontrata dhe kushti, sepse veprimi, pas përfundimit të afatit, nuk nënkupton asnjë ndalim.

Kur kontrata është e pakushtëzuar, është kontratë në përgjithësi dhe punëtorit nuk i është vënë kusht ndonjë punë e

veçantë, ose që punëtori të punojë për një kohë të caktuar në një vend të veçantë, punëtori vepron sipas kërkesave të interesit të ortakërisë.

Kushti, kur garantimi dhe humbja janë mbi punëtorin

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se, kur kapitali pëson humbje, ose një pjesë e tij prishet në dorën e punëtorit, jo për shkak se ai ka vënë dorë, ose ka neglizhuar, kjo humbje mbulohet prej fitimit, kur kapitali ka rezultuar me fitim. Por kur kapitali, në të vërtetë, nuk ka rezultuar me fitim, ose fitimi i realizuar nuk e mbulon humbjen, në këtë rast, humbja llogaritet prej kapitalit dhe këtë humbje e përballon vetëm pronari.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në të vërtetë, fitimi është ruajtje për kapitalin ligjërisht dhe me traditë.”

Ky rregull qëndron vetëm kur kontrata e spekulimit është e pakushtëzuar dhe në të nuk është përmendur as që punëtori përballon ndonjë send prej humbjes e as që punëtori është garantues për mallin e prishur, edhe nëse punëtori abuzon. Nëse pronari ka vënë kusht që punëtori të përballojë pjesë prej humbjes, ose që punëtori të garantojë mallin në të gjitha gjendjet dhe punëtori e ka miratuar këtë kusht, a është i vlefshëm kushti, apo kushti ka ndodhur si fjalë pa vlerë?

Është thënë: Kushti dhe kontrata janë të prishura njëherësh, por është thënë edhe se prishet kushti, por jo kontrata. Autori i librit “El Xheuahir” dhe autori i librit “El Urvetul Vuthkà” kanë thënë: “Është e vlefshme edhe kontrata, sepse spekulimi prej kësaj

kontrate është i pakushtëzuar, domethënë se kontrata nuk është kushtëzuar me asnjë kusht. Prej dispozitave të këtij spekulimi është që humbja e të gjitha llojeve përballohet vetëm prej pronarit, ndërsa punëtori nuk ka detyrim të përballojë asgjë, me përjashtim të rastit kur ai abuzon ose vë dorë mbi kapitalin. Ka edhe spekulim me kushte, domethënë se bëhet fjalë për spekulim të kushtëzuar me kushte, ndër të cilat është kushti i garantimit e i kontributit nga ana e punëtorit, në rast humbje, edhe nëse punëtori nuk abuzon. Ky kusht është në kontradiktë me spekulimin e pakushtëzuar, ose kushti nuk është në kontradiktë as me natyrën e spekulimit, domethënë me pjesëtimin e përbashkët të fitimit, nuk është në kontradiktë as me vlerësimin përgjithësues mes spekulimit të pakushtëzuar dhe spekulimit të kushtëzuar. Sipas thënies së fukahave, ky kusht është në kontradiktë me kontratën pa kushte, por jo me kontratën në përgjithësi, domethënë me kontratën e pakushtëzuar. Bazuar mbi këtë shpjegim, s'ka ndonjë ndalim që të përmbahemi në vlefshmërinë e kushtit, sepse dhe për këtë ne bazohemi në hadithin: "Besimtarët janë në kushtet e tyre." dhe në ajetin kur'anor: "...ose tregti për të cilën keni rënë dakord mes jush..."

Veprimet e punëtorit

Fukahatë kanë thënë se, kur kontrata e spekulimit është e pakufizuar me kushte, për punëtorin nuk lejohet që ai të udhëtojë me kapitalin, ose që ai të marrë një tjetër në punët e spekulimit kundrejt pagesës.

Gjithashtu, për punëtorin nuk lejohet që ai të shesë ose të blejë me pagesë të vonuar, as të shesë me çmim më të ulët se çmimi i zakonshëm, as të blejë me çmim më të lartë se çmimi i zakonshëm, përveçse me lejen e pronarit. Kur punëtori bën ndonjë veprim nga veprimet e lartpërmendura, pa lejen e pronarit, veprimi i tij nuk është i vlefshëm, përveçse kur e lejon pronari.

Në të vërtetë, pronari, kur e kushtëzon veprimin me ndonjë kusht specifik, është detyrim për punëtorin që ai të përmbahet në këtë kusht.

Gjithashtu, punëtori s'ka të drejtë të bëjë ndërrim, ose të heqë dorë, përveçse kur vetë pronari kërkon kthimin e parave, sepse kapitali është pronë e tij dhe njerëzit veprojnë me pasuritë e veta sipas asaj që ata duan. Në qoftë se punëtori kundërshton, ai bëhet garantues. Kur pronari nuk ka vënë kushte dhe nuk e ka kushtëzuar punëtorin me ndonjë veprim të caktuar, në këtë gjendje, punëtori ka të drejtë të veprojë mbi bazën e interesit, ashtu siç e mendojnë interesin njerëzit e mençur, të cilët, me veprimet e tyre, synojnë realizimin e këtij interesi. Gjithashtu, punëtori është i detyruar të mos ndërmarrë asnjë veprim që ai e mendon të dëmshëm për ortakërinë.

Shpenzimi

Të gjitha shpenzimet që bën punëtori për vajtje-ardhjet e tij, apo për lëvizje të tjera që ai bën për të harmonizuar qëllimet e ortakërisë, të gjitha këto shpenzime përballohen prej pasurisë së ortakërisë, me kusht që shpenzimi të jetë për të mirë, kurse lëvizjet

e tjera të punëtorit, jashtë qëllimeve të ortakërisë e jashtë interesave të saj, i përballon punëtori prej pasurisë së tij.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Shpenzimet që bën punëtori që punon me spekulim në udhëtimet e tij, përballohen prej gjithë kapitalit. Nëse punëtori udhëton për të ardhur në vendin e vet, këto shpenzime përballohen prej pjesës së tij të fitimit.”

Specifikimi i burimit të transmetimit me udhëtimin nuk i bën shpenzimet që të kenë lidhje vetëm me udhëtimin, pasi udhëtimi, në këtë transmetim, është përmendur thjesht si shembull, pasi transmetimi përfshin të gjitha llojet e shpenzimeve.

Prishja e spekulimit

Kur spekulimi priset për një shkak prej shkaqeve, fitimi i takon pronarit, sipas klauzolës: “Fitimi ndjek kapitalin.”, por pronari ka detyrim t’i paguajë punëtorit një mëditje të ngjashme. Kjo është e barabartë, qoftë kur punëtori ka dijeni për marrëdhënien e spekulimit, qoftë kur ai s’ka dijeni për këtë prishje të marrëdhënies, prandaj është detyrim që punëtori të paguhet për faktin se ai ka punuar me lejen e pronarit. Këtu nuk mund të bëhet fjalë për bamirësi. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se prishja e kontratës së lejuar është si prokurimi, shitja me humbje dhe kreditimi, por spekulimi nuk kërkon prishjen e lejes, prandaj

fukahatë janë shprehur për qëndrimin e lejes, edhe pas prishjes së kontratës së lejuar me lejë të nënkuptueshme.¹

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se çdo punë që nuk bëhet falas, ose nuk bëhet për bamirësi, është detyrë që ajo punë të paguhet me një pagesë të njohur, sipas rregullit: “Respekt për pasurinë dhe për punën e njeriut.”

Garantimi i punëtorit

Punëtori nuk garanton asgjë për atë çka mund të pësojë kapitali, me përjashtim të rastit kur ai vë dorë mbi kapitalin, ose për shkak shkujdesje nga ana e punëtorit. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush tregon me një kapital dhe ka vënë kusht gjysmën e fitimit, ai s’ka detyrim të garantojë.”

Në lidhje me këtë çështje, s’ka dallim nëse kontrata e spekulimit është e vlefshme apo ajo është e prishur, sepse rregulli thotë: “Ajo që ai garanton me kontratën e vlefshme, e garanton edhe me kontratën e prishur.”

Këtë çështje e kemi trajtuar me hollësi në pjesën e tretë.

¹ Prej dallimeve mes kontratave të detyrueshme dhe kontratave të lejuara është edhe fakti se kontrata e detyrueshme, si shitja, kur kjo kontratë prishet, nuk mund të flitet më për lejim, sepse lejimi ka të bëjë me sigurimin e kompensimit dhe me vlefshmërinë e shkëmbimit. Kur kompensimi nuk është i sigurt dhe shkëmbimi nuk është i vlefshëm, atëherë detyrimisht mungon edhe lejimi. Për sa i përket kontratës së lejuar, si shkëmbimi, lejimi në këtë kontratë nuk ka të bëjë me kompensimin e me shkëmbimin, pasi, kur kjo lloj kontrate prishet, lejimi mbetet. Për këtë arsye fukahatë i kanë emërtuar këto lloj kontratash: Kontrata të lejuara, ose Kontrata me lejim.

Kur pronari pretendon se punëtori ka vënë dorë ose ka neglizhuar, pronari ka detyrim të sjellë argument për pretendimin e tij, kurse punëtori, në këtë rast, nuk ka asnjë detyrim përveç betimit, sepse ai është person besnik.

Çështje

1- Kur pronari është sëmure nga sëmundje e pashërueshme, nga e cila do të vdesë dhe në këtë gjendje ai i jep kapital një tjetri, që ky i fundit të tregtojë me këtë kapital sipas rregullit të spekulimit, por i ka vënë kusht punëtorit që pjesa e fitimit për pronarin të jetë më shumë se sa praktikohet zakonisht, si për shembull, tre të katërtat, ose katër të pestat, atëherë ky kusht është i pavlefshëm dhe trashëgimtarët nuk kanë të drejtë të kundërshtojnë, pavarësisht që ne kemi thënë se dhuratat e të sëmurit dalin jashtë origjinës, ose prej një të tretës, sepse trashëgimtarët nuk humbin asgjë, ngaqë fitimi që realizon punëtori nuk është pasuri e të sëmurit, por është pasuri që erdhi prej punës së punëtorit. Veç kësaj, arritja e këtij fitimi nuk është mbështetur drejtpërdrejt në kapitalin e të sëmurit, si për shembull, frytet në pemë e të tjera të ngjashme.

2- Kur mes dy vetëve lidhet një kontratë e detyrueshme, si për shembull, kontratë shitje dhe njëri prej kontraktuesve i vë tjetrit kusht që t'i japë atij kapital, me të cilin ai të tregtojë sipas rregullit të spekulimit, kushti është i detyrueshëm dhe është prej kapitullit të "Detyrimi brenda detyrimit". Sipas këtij detyrimi, ai që pranon kushtin, ka detyrim të mbajë besën për zbatimin e kushtit të vënë. Nëse e kundërshton kushtin, në analogji me

kontratën e detyrueshme, për tjetrin lind e drejta e përzgjedhjes. Por kur ai i paguan atij shumën e marrë, përsëri kontrata e spekulimit nuk bëhet e detyrueshme, prandaj për secilin prej atyre të dyve lejohet që të heqin dorë prej spekulimit. Kur për spekulimin është vënë kush një kohë e caktuar, në këtë rast, nuk lejohet prishja e kontratës së spekulimit para përfundimit të këtij afati kohor, pasi mbajtja e besës për kushtin e vënë është detyrim, prandaj edhe kjo kontratë spekulimi bëhet kontratë e detyrueshme brenda një kontrate të detyrueshme.

3- Kur punëtori është i shkujdesur, ose është përtac, aq sa humbin shumë raste pune, megjithëkëtë ai nuk shqetësohet që atij vetë dhe pronarit i del nga dora një fitim i mirë, në këtë gjendje, pronari s'ka të drejtë të kërkojë prej tij asnjë send përveç kapitalit, edhe pse ai është i detyruar.

Në të vërtetë, ky punëtor është mëkatar ndaj pasurisë së tjetrit. Sekreti qëndron në faktin se punëtori s'ka vepruar me kapitalin e pronarit në atë mënyrë që me veprimin e tij ka dashur dëmtimin, pasi në të vërtetë punëtori e ka ngurtësuar kapitalin dhe ka mbajtur qëndrime negative ndaj këtij kapitali të marrë në mirëbesim, për rrjedhojë, ka lejuar që të mos ketë përftim as për veten e tij. Duhet të theksohet se mospasja përfitim është një gjë dhe futja e dëmit me dashje është gjë tjetër, sepse futja e dëmit me dashje e ngarkon kredimarrësin me detyrim. Nëse për ty gjendja paraqitet e komplikuar, atëherë krahaso mes atij që prish e shkatërron pasurinë e tjetrit dhe mes atij që ndalon tjetrin të blejë një mall që atij i sjell fitim. Në këtë krahasim vëmë re se i pari është mëkatar dhe garantues, kurse i dyti nuk është garantues. Nga ky shpjegim del qartë se çështja jonë është prej çështjeve të llojit të dytë.

4- Kur punëtori ble mall me borxh, në të vërtetë, bën një veprim të lejuar, por më pas kapitali i spekulimit prishet, megjithëkëtë prej tij ka mbetur vetëm aq sa mjafton për shlyerjen e borxhit, a mund të kërkojë borxhdhënësi kthimin e borxhit prej punëtorit ose prej pronarit?

Përgjigje: Borxhëdhënësi, që në këtë rast është pronari i mallit të blerë borxh, përzgjedh mes kërkimit të borxhit prej punëtorit, për faktin se punëtori është ai që hyri në marrëdhënie të ndërsjellë me borxhëdhënësin dhe kërkoi borxh prej tij, si dhe mes kërkimit të borxhit prej pronarit, sepse vërtetohet që borxhi është në ruajtje te ai, atëherë rezulton që humbja do të përballohet vetëm prej pronarit. Nëse borxhëdhënësi e kërkon shlyerjen e borxhit prej punëtorit, ky i fundit, nga ana e tij, e kërkon atë prej pronarit.

5- Shumica e fukahave më në zë miratojnë thënien e autorit të librit “El Mesalik”, i cili është shprehur se punëtori ka si pasuri pjesën e tij të fitimit, sapo të realizohet fitimi dhe pronësia e tij mbi këtë fitim nuk qëndron as në pjesëtimin dhe as në shndërrimin e mallit në para, sepse shkak i pasurisë së tij prej fitimit, është i njëjti kusht konkret i përfshirë në kontratë. Sipas detyrimit të kushtit, ai e merr në pronësinë e tij kudo e gjen atë. Mbi fitimin si pronë e punëtorit, renditen të gjitha efektet që rrjedhin, ngaqë punëtori është ortak me pronarin, për rrjedhojë punëtori lejohet ta shesë pjesën e tij të fitimit, ta transferojë atë pjesë te trashëgimtarët, përfshirë edhe detyrimin e një të pestës, zekatin, të drejtën e kreditorëve dhe të tjera detyrime të kësaj kategorie.

Bazuar mbi sa u tha, kur të dyja palët bien në marrëveshje për pjesëtimin e fitimit, krahas mbetjes në fuqi të marrëveshjes së

spekulimit të bazuar mbi kapitalin, që të dy e gëzojnë këtë të drejtë. Kur vetëm njëri prej atyre të dyve kërkon pjesëtimin e fitimit, kurse tjetri nuk pranon pjesëtimin e fitimit, në lidhje me këtë çështje poliedriku El Hil'lij, në librin e tij "Bazat" ka thënë: "Ai që nuk pranon, nuk mund të detyrohet të bëjë pjesëtimin."

Ne mendojmë se është detyrë t'i referohemi dispozitave të vendosura në kapitullin "Ortakëria" në lidhje me refuzimin e pjesëtimin të fitimit nga ana e njërit ortak, kur pjesëtimin e kërkon ortaku tjetër.

Përfundimi i spekulimit

Spekulimi merr fund me njërin prej shkaqeve vijuese:

1- Pronari ose punëtori prish kontratën, pasi kontrata e spekulimit është kontratë e lejuar për të dyja palët.

2- Kapitali i spekulimit asgjësohet para se punëtori të fillojë punën dhe të blejë ndonjë send për llogari të spekulimit. Në këtë rast, spekulimi përfundon për shkak të mosekzistencës së objektit.

Kur punëtori, me urdhër të veçantë, ose me urdhër të përgjithshëm të pronarit, ble një mall para se të marrë shumën në dorë, kapitali i spekulimit prishet dhe pronari ka detyrim të paguajë çmimin e këtij malli, ndërsa marrëveshja e spekulimit mbetet ashtu siç ishte më parë.

Në paragrafin e mësipërm me nr. 4 e kemi trajtuar këtë çështje. Gjithashtu, marrëveshja e spekulimit mbetet edhe kur

kapitalin e spekulimit e prish një i huaj, në këtë rast, humbja shndërrohet në kompensim, të cilin e mbulon prishësi i mallit.

3- Punëtori ose pronari vdes. Në këtë rast, punëtori është në pozitën e agentit tregtar të lejuar dhe, kur vdes punëtori, s'ka më vlerë as lejimi e as pozita e tij si agent tregtar. Në qoftë se vdes i dyti, domethënë pronari, kapitali i kalon trashëgimtarëve të tij, prandaj veprimi me këtë kapital të trashëguar ka nevojë për lejen e trashëgimtarëve.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Prishe marrëveshja e spekulimit me vdekjen e secilit prej atyre të dyve, sepse ajo është marrëveshje në kuptimin e prokurimit, e cila është si të gjitha kontratat e lejuara, si për shembull, kontrata e kreditimit dhe kontrata e depozitimit. Marrëveshja e spekulimit priset edhe në rast vdekje, çmendje, humbje të ndërgjegjes e të tjera gjendje të ngjashme, për shkak të të cilave lejimi, nga ana e pronarit, bëhet pa vlerë, sepse për kontratën e spekulimit e për kontrata të ngjashme me të, pronari është në pozitën e shpirtit.

Fukakatë më të dëgjuar, në lidhje me këtë çështje, janë shprehur për mospasjen efekt të lejimit nga ana e trashëgimtarit, ose të kujdestarit të pronarit në rastet kur pronari çmendet ose humb vetëdijen, për shkak se ata deklarojnë prishjen e mallrave nga efekti i ekspozimit të mallrave ndaj elementeve prishëse."

Kur ndër mallrat e spekulimit është një send të cilin e ka shitur punëtori pas vdekjes së pronarit dhe e ka shndërruar atë send në para, domethënë që fitimi është bërë fakt, me këto para nuk lejohet të blihet një mall tjetër, sepse, në këtë gjendje, është e detyrueshme përfundimi i marrëveshjes së spekulimit dhe me

prishjen e marrëveshjes, punëtori merr pjesën e tij të fitimit, kurse pjesën e mbetur ia jep trashëgimtarëve të pronarit

4- Njëri prej atyre të dyve çmendet, mirëpo çmendja i heq njeriut aftësinë për të vepruar me pasurinë e tij dhe me pasurinë e të tjerëve. E ngjashme me rastin e çmendjes është edhe rasti kur pronari ose punëtori pëson tronditje nga e cila nuk është në gjendje të kontrollojë veprimet e tij. Edhe në këtë gjendje, marrëveshja e spekulimit prishet për të njëjtin shkak. Për sa i përket ngurtësimit që i bëhet kapitalit të pronarit në rast falimentimi, pronari nuk lejohet të jetë pronar i kapitalit, domethënë, nuk i lejohet të bëjë marrëveshje spekulimi me kapitalin e tij, por ky pronar lejohet të jetë punëtor, sepse ngurtësimi i kapitalit të tij ka të bëjë me falimentimin dhe është falimentimi ai që e nxjerr atë jashtë aftësisë për të vepruar në pasuritë e tij, por nuk e nxjerr atë jashtë aftësisë për të vepruar si përfaqësues me pasurinë e tjetrit.

Pjesëtimi pas përfundimit të spekulimit

Kur njëri prej shkaqeve sjell përfundimin e marrëveshjes së spekulimit, puna vazhdon sipas sqarimit vijues:

1- Marrëveshja e spekulimit përfundon para se punëtori të fillojë punën ose përgatitjet për punën. Në këtë rast, gjykimi është: Kapitali i kthehet pronarit, kurse punëtori s'ka asnjë detyrim. Gjithashtu, edhe pronari s'ka asnjë detyrim dhe gjendja është sikur të mos ketë ndodhur asgjë.

2- Marrëveshja e spekulimit përfundon gjatë punës, por përfundimi ndodh para se të arrihet fitimi. Edhe në këtë rast, gjykimi është i njëjtë me rastin e parë, domethënë: Kapitali i kthehet pronarit dhe as punëtori e as pronari s'kanë asnjë detyrim.

Autori i libri "Esh Sheràiu" ka thënë: "Në një gjendje si kjo që u shtrua, pronari ka detyrim t'i paguajë punëtorit një mëditje të praktikueshme."

Autori i librit "El Xheuahir" e ka kundërshtuar, duke thënë: "Kjo mohon atë çka është e njohur për ligjërimin e marrëveshjes së spekulimit të ndërtuar mbi faktin që punëtori ka të drejtën të marrë pjesën e tij të fitimit, nëse është realizuar fitim, ndryshe s'ka asgjë."

3- Marrëveshja e spekulimit përfundon pas punës dhe pas shndërrimit të gjithë mallit të spekulimit në para, aq sa prej mallit nuk ka mbetur asgjë. Në qoftë se shitja e mallit ka rezultuar me fitim, punëtori merr pjesën e tij prej fitimit të realizuar sipas kushteve me të cilat është bërë marrëveshja, kurse ajo që mbetet nga fitimi, i takon pronarit. Në qoftë se nuk është realizuar fitim, pronari merr të gjithë mallin, kurse punëtori nuk do të marrë asgjë dhe nuk ka asnjë detyrim.

4- Kur marrëveshja e spekulimit përfundon dhe te kapitali ka një mall, në këtë rast shikohet: Nëse në atë mall ka fitim, punëtorit nuk i lejohej të veprojë me këtë mall pa lejen e pronarit. Gjithashtu, as pronari s'ka të drejtë të detyrojë punëtorin që ta shesë këtë mall.

Në qoftë se në këtë mall të mbetur ka fitim, pronari dhe punëtori janë ortakë në këtë send dhe, bazuar mbi këtë të drejtë,

ata të dy bëjnë kompromis ta pjesëtojnë ose ta shesin, ose të presin një kohë të përshtatshme për shitjen e këtij malli. Nëse njëri prej atyre të dyve kërkon shitjen e këtij malli, kurse tjetri e kundërshton shitjen, në këtë gjendje, a detyrohet apo jo refuzuesi i shitjes?

Për këtë çështje fukahatë kanë tri fjalë: e para: imponohet, e dyta: nuk imponohet dhe e treta: imponohet punëtori dhe nuk imponohet pronari. Në të vërtetë, ne zbatojmë dispozitën e vendosur në kapitullin “Ortakëria” për të ndalur ortakun të mos pranojë pjesëtimin, kur pjesëtimin e kërkon ortakun i tij.

Konflikti

1- Kur pronari i thotë punëtorit: “Të dhashë kapitalin tim për spekulim.”, por punëtori e mohon dhe thotë: “Në asnjë mënyrë, unë s’kam marrë asgjë prej teje.”, por pasi pronari e vërteton pretendimin e tij me argument, punëtori pohon dhe thotë: “Natyrisht unë e mora kapitalin që të punoj me spekulim, por kapitali u asgjësua.” Në këtë gjendje, fjala e punëtorit nuk dëgjohet, madje kjo fjalë e punëtorit hidhet poshtë pa argument e pa kërkuar prej tij të betohet. Gjykimi është që punëtori ngarkohet të paguajë shumë, sepse mohimi i tij herën e parë vërtetoi se ai është gënjeshtar në pretendimin e asgjësimit të kapitalit. Në qoftë se punëtori nuk e mohon marrjen e kapitalit, madje pohon hapur që e ka marrë kapitalin, por pretendon asgjësimin e kapitalit jo për shkak se ai ka vënë dorë mbi kapitalin, ose ka neglizhuar, në këtë rast, merret për bazë fjala e tij, por ai ka detyrim të betohet.

Po kështu gjykohet edhe kur punëtori pretendon humbjen, ose thotë që nuk është realizuar fitim. Fjala e tij përsëri merret në konsideratë, sepse ai është besnik dhe besniku s'ka detyrim tjetër përveç betimit.

Kur punëtori thotë se ai i ka kthyer kapitalin pronarit dhe ia ka dhënë atij në dorë, kjo fjalë e tij pranohet vetëm me argument, ndryshe nuk pranohet.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Veprohet sipas kuptimit të përgjithshëm të hadithit: “Argumenti është detyrim për pretenduesin.””. Pranimi i fjalës së punëtorit për asgjësimin, nuk nënkupton se duhet të pranohet edhe fjala e tij që ai e ka kthyer kapitalin. Ndër argumentet s'ka ndonjë klauzolë që të kërkojë pranimin e fjalës së besnikut për gjithçka që ai pretendon, përfshirë edhe çështjen që jemi duke trajtuar, sepse analogjia te ne (te fukahatë e shi'ave), për sendin e lënë në mirëbesim, nuk pranohet, sidomos, pasi ata të dy janë ndarë nga njëri-tjetri, sepse marrja në dorë, në rastin e depozitimit, është vetëm për interes të pronarit, kurse marrja në dorë, në rastin e spekulimit, është për interes të pronarit dhe të punëtorit.

2- Kur ata të dy (pronari e punëtori) kanë mosmarrëveshje në lidhje me sasinë e kapitalit dhe pronari i thotë punëtorit: “Kapitali është dy mijë.”, kurse punëtori thotë: “Jo, kapitali është një mijë.”, në këtë rast, kur nuk ka as argument, merret në konsideratë fjala e punëtorit, krahas betimit që ai bën, sepse baza është që të mos ketë shtesë.

Kur ata të dy kanë mosmarrëveshje në lidhje me një kusht të shtuar mbi kontratën e pakushtëzuar, si për shembull, kur

pronari i thotë punëtorit: “Të kam vënë kusht të mos blesh pambuk.”, mirëpo punëtori e mohon, sipas hadithit, pretenduesi për kushtin ka detyrim të sjellë argument, kurse mohuesi ka detyrim të betohet, mirëpo baza është mosvënia e kushteve, derisa të vërtetohet e kundërta.

Kur ata të dy kanë mosmarrëveshje në lidhje me sasinë e pjesës së fitimit që i takon punëtorit dhe pronari thotë: “Pjesa e tij është një e katërta.”, kurse punëtori thotë: “Jo, është gjysma.”, në këtë rast, kur pronari nuk ka argument, merret në konsideratë fjala e pronarit krahas betimit të tij, sepse baza është që fitimi ndjek kapitalin, ndërsa punëtori do të ketë vetëm pjesën që pohon për atë pronari, ose atë pjesë që vërtetohet me dokument.

3- Pasi fitimi është bërë i qartë, punëtori i thotë pronarit: “Unë e mora kapitalin prej teje si borxh dhe jo bazuar mbi garantimin, prandaj ty nuk të takon asgjë prej fitimit.”, kurse pronari thotë: “Jo, unë të dhashë kapitalin në bazë të marrëveshjes së spekulimit, prandaj mua më takon gjysma e fitimit.” Nëse çështja qëndron kështu siç u shtrua, secili prej atyre të dyve është pretendues dhe mohues në të njëjtën kohë, sepse pronari pretendon se kapitali është dhënë në bazë të marrëveshjes së spekulimit dhe mohon se është dhënë borxh, gjithashtu edhe punëtori pretendon se kapitali është borxh dhe mohon që është dhënë sipas marrëveshjes për spekulim.

Nëse ka dokument, veprohet në bazë të dokumentit, ndryshe secili prej atyre të dyve do të betohet për të hedhur poshtë pretendimin e tjetrit. Në qoftë se betohet vetëm njëri prej atyre të dyve dhe tjetri refuzon të betohet, atëherë merret në konsideratë fjala e betuesit. Në qoftë se ata betohen të dy, ose të dy refuzojnë të betohen, rrëzohet fjala e të dyve dhe çdo gjë

kthehet në origjinën e vet, domethënë çdo gjë kthehet ashtu siç ishte dhe çështja trajtohet sikur nuk kemi të bëjmë as me borxh e as me dhënie kapitali me marrëveshje për spekulim. Në këtë gjendje, kapitali dhe fitimi i takojnë pronarit, por pronari ka detyrim t'i paguajë punëtorit një shpërblim të ngjashëm për punën e bërë, me përjashtim të rastit kur shpërblimi i ngjashëm është më shumë se i gjithë fitimi. Në këtë gjendje punëtori merr vetëm fitimin, sepse pretendoi që ai ka të drejtë të marrë më shumë, por në fakt po merr më pak. Në qoftë se shpërblimi i ngjashëm është më pak se gjysma e fitimit, në këtë gjendje, pronari ka detyrim t'i paguajë punëtorit vetëm gjysmën e fitimit dhe jo shpërblimin e ngjashëm, sepse pronari pretendon që ka të drejtë të marrë vetëm gjysmën, edhe sepse fitimi është realizuar mbi bazën e marrëveshjes për spekulim. Ky është edhe kuptimi i fjalës së fukahave: "Punëtori merr më të shumtën e dy punëve: merr shpërblim të ngjashëm, ose merr vetëm gjysmën e fitimit, kur shpërblimi i ngjashëm është më shumë se gjysma e fitimi."

4- Kur punëtori ble një mall dhe pretendon se e ka blerë për veten e tij, kurse pronari i thotë atij: "Jo, ti e bleve atë mall për spekulimin dhe tani pretendon se e ke blerë për veten tënde, vetëm pasi u pa që ai mall ka fitim.", merret në konsideratë fjala e punëtorit, sepse ai, me njetin e tij, ishte më parashikues dhe këtë parashikim askush nuk e ka ditur para tij.

E njëjta gjë është kur punëtori thotë: "E bleva për spekulim.", kurse pronari i thotë: "Jo e bleve për veten tënde dhe tani pretendon se e ke blerë për spekulimin, vetëm pasi u bë e qartë se ai mall është me humbje."

Kujdes, argumenti dhe vetëm argumenti.

* * *

MARRËVESHJA PËR SHRYTËZIMIN

E TOKËS (el muzàreah)

Kuptimi i konceptit “marrëveshje për shfrytëzimin e tokës”

Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës është një lloj ortakërie bujqësore që lidhet mes pronarit të tokës dhe punëtorit. I pari, pronari vë në këtë ortakëri tokën, kurse i dyti, punëtori, vë punën. Prodhimi ndahet mes tyre, sipas marrëveshjes së arritur. Bazuar mbi këtë përkufizim, është referuar edhe përkufizimi i kësaj fjale prej fukahave, të cilët janë shprehur: Ajo është një marrëdhënie e ndërsjellë, bazuar mbi tokën kundrejt një sasi të caktuar prej prodhimit të marrë, prej saj.

Prej termit “muzàreah”-“marrëveshje për shfrytëzimin e tokës” ka dalë edhe termi “musàkàt” që është marrëdhënie e ndërsjellë mes dy vetëve për pemët. Është nxjerrë edhe termi “his’satun”-“pjesa e caktuar”, që do të thotë “dhënia e tokës me qera për bujqësi”. Të gjitha këto terma, në lidhje me shfrytëzimin e

tokës, janë të vlefshme vetëm kundrejt një sasive të përcaktuar prej prodhimit të tokës.

Punëtori që punon tokën, quhet fermer, bujk, kurse ai që ka tokën quhet pronari i tokës.

Ligjshmëria e marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës

Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës është e ligjësuar me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst. Ndër tekstet kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “S’ka problem që marrëveshja për shfrytëzimin e tokës të jetë me një të tretën, me një të katërtën, ose me një të pestën e prodhimit.”

Gjithashtu, prej teksteve kemi veprimin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kur ai çliroi Hajberin, e la tokën në dorën e banorëve të këtij vendi kundrejt gjysmës së prodhimit. Ka edhe shumë transmetime të tjera. Po përmendim fjalën e autorit të librit “El Xheuahir”: “Dijetarët islamë s’kanë asnjë dyshim për ligjshmërinë e marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës, pasi tekstet, në lidhje me këtë marrëveshje dhe për marrëveshjen në lidhje me pemët, janë të shumta dhe me varg përcjellësish të pashkëputur.”

Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës është e detyrueshme

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, kontrata për shfrytëzimin e tokës është kontratë e detyrueshme, bazuar në rregullin që urdhëron

ajeti i nderuar i Kur'anit: "respektoni kontratat", që do të thotë, mbani besën për zbatimin e kontratave. Kontrata për shfrytëzimin e tokës prishet vetëm me marrëveshje të dyanshme, ose me kushtin e përzgjedhjes, ose, kur nga toka nuk mund të përfitohet. Kontrata për shfrytëzimin e tokës nuk prishet për shkak të vdekjes së njërit prej dy kontraktuesve, ashtu siç është rregulli për të gjitha kontratat e detyrueshme dhe, kur vdes pronari i tokës ose fermeri, trashëgimtari zë vendin e tij.

Kushtet

Në marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës kërkohen kushtet vijuese:

1- Oferta prej pronarit të tokës dhe pranimi i kësaj oferte prej fermerit. Oferta dhe pranimi realizohen me çdo fjalë ose veprim që tregon ofertën dhe pranimin.

2- Aftësia e dy kontraktuesve për zbatimin e kontratave të kompensueshme.

3- Pjesa që merr secili kontraktues prej prodhimit duhet të jetë e përcaktuar dhe e njohur për të dy, si për shembull, në mënyrë të barabartë, ose pjesët kanë diferencë, gjithnjë sipas marrëveshjes mes atyre të dyve.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Toka nuk merret për shfrytëzim me numër të caktuar, si për shembull, njëzet ose tridhjetë, por ajo merret për shfrytëzim vetëm me gjysmën e prodhimit, ose një të tretën, ose një të katërtën, ose një të pestën."

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës s’ka problem që ajo të lidhet me një të tretën, ose me një të katërtën, ose një të pestën e prodhimit.”

Prej këtij transmetimi rezulton: Sikur i gjithë prodhimi të jetë vetëm për njërin, ose për atë do të jetë vetëm një pjesë e përcaktuar prej prodhimit, si për shembull, një kuintal dhe pjesa tjetër i takon kontraktuesit të dytë, ose pjesa e tij do të jetë prej prodhimit të parë të tokës, ose pjesa e tij do të jetë prej prodhimit të një ane të kësaj toke, ose kur marrëveshja është bërë për më shumë se një parcelë, pjesa e tij do të jetë vetëm prodhimi i njëres parcelë.

Të gjitha këto kushte e prishin marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës dhe kontrata del jashtë rregullit, për shkak të kontradiktës që ka në këtë kusht, në lidhje me pjesën e prodhimit që praktikohet zakonisht për secilën prej atyre të dyve, sepse përcaktimi i pjesës së prodhimit që do të marrë secili prej atyre të dyve, është kusht për vlefshmërinë e marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre për dy çështje që kanë lidhje me këtë kusht: e para, kur ata të dy kanë vënë kusht që prej prodhimit të heqin një sasi të caktuar, për shembull, farën, ose taksën e pushtetit (taksën e tokës), ose shpenzimet për përmirësimin e tokës, ose për qëllime të tjera, që kanë të bëjnë me tokën, kurse pjesa tjetër e prodhimit do të ndahet mes atyre të dyve.

Shumica e fukahave shkojnë pas dëshmisë së autorit të librit “El Mesalik”, i cili është shprehur për mosvlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje, pasi ka mundësi që toka të mos japë prodhim më shumë nga sa është përjashtuar dhe kështu tjetri mbetet pa gjë. Kjo është në kundërshtim me atë çka është vërtetuar në lidhje me marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës, e cila kushtëzon që dy kontraktuesit në marrëveshje të jenë ortakë në prodhim dhe ndarja e pjesëve për secilin të bëhet sipas praktikës së zakonshme.

Një grup fukahash, ndër fukahatë e mëparshëm edhe shehu Et Tusij, kurse ndër fukahatë e mëvonshëm, edhe autori i librit “El Xheuahir”, janë shprehur për vlefshmërinë.

Sej’jid El Asfehànij në librin “Uesijletu Nexhàt” dhe sej’jid El Hakijm në librin “Minhàxhu Sàlihijn” kanë thënë: “Ky kusht lejohet, kur dihet ose ata janë të sigurt se do të mbetet diçka pas ndarjes së kësaj sasive prodhimi, ndryshe kushti është krejtësisht i pavlefshëm.”, domethënë që lejimi i kushtit dhe vlefshmëria e tij janë të varura me sasinë e prodhimit që mbetet, pas heqjes së pjesës që ata të dy ranë dakord të heqin prej totalit të prodhimit.

Fjala e dy sej’jidëve, në të vërtetë, i referohet thënies së fukahave më të dëgjuar për të ndaluar vënien e një kushti të tillë, nga frika se mund të mos mbetet gjë për tjetrin, por të dy, sej’jidët, e kanë lejuar kushtin, duke marrë parasysh se do të mbetet diçka nga prodhimi, pas heqjes së pjesës së lartpërmendur.

Çështja e dytë: Kur ata të dy bien në marrëveshje që njëri t’i japë tjetrit para, ose të bëjë për atë një punë, përveç pjesës së tij prej prodhimit.

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur për vlefshmërinë e kushtit të lartpërmendur, pra, janë shprehur edhe për detyrimin për mbajtjen e besës për zbatimin e këtij kushti.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kështu janë shprehur fukahatë më të dëgjuar, madje edhe të gjithë fukahatë e mëvonshëm. Ka të ngjarë që thënësi nuk ka pasur dijeni për moslejimin, por ata janë bazuar në hadithin: “Besimtarët janë në kushtet e tyre.”, si dhe në fjalën e Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ti s’ke të drejtë të marrësh asgjë prej atyre të dyve, derisa ata të vënë kusht për njëri-tjetrin.”

4- Caktimi i parcelës me emër, pasi marrëveshja për shfrytëzimin e tokës për njërën mbi dy parcelat nuk është e vlefshme, por padyshim që ajo marrëveshje është e vlefshme, kur përmenden disa dynymë të përcaktuar me numër të një parcele të caktuar, për shembull, kur pronari i tokës i thotë bujkut: “Të jap për bujqësi dhjetë dynymë prej kësaj parcele.” Pra, parcelën ku gjenden këto dhjetë dynymë e cakton vetë pronari i tokës.

5- Toka është e mirë dhe e përshtatshme për mbjelljen e bimëve bujqësore, edhe sikur të kërkojë punë e trajtim.

Ky kusht është i natyrshëm dhe s’ka nevojë për argument, pasi me fjalën e përbashkët të fukahave, pikërisht mbjellja e bimëve bujqësore ishte objekti i qëllimit në këtë marrëveshje për shfrytëzimin e tokës dhe ky kusht duhet të mbahet parasysht jo vetëm në fillim të kontratës, por edhe në vazhdim të saj. Nëse ndodh diçka që ndalon përfitimin prej mbjelljes së tokës, kjo zbulon edhe pavlefshmërinë e marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës, që në themel, për shkak të humbjes së kushtit brenda kohës

së mbetur. Në këtë gjendje s'ka asnjë detyrim as mbi pronarin e tokës e as mbi fermerin, sepse pjesa që ata do të merrnin, patjetër duhet të ishte prej prodhimit, por tani kjo gjë u bë e pamundur.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Nëse ti e merr mbjelljen e bimëve burim dhe kusht për kontratën e shfrytëzimit të tokës, por më pas del qartë se ajo tokë nuk është e përshtatshme për bujqësi, marrëveshja për shfrytëzimin e kësaj toke prishet, pavarësisht se toka është objekti dhe burimi i kontratës, sepse bujqësia është motiv dhe jo kusht për vlefshmërinë e kontratës, prandaj bujku ka të drejtën e përzgjedhjes, kur nga toka s'mund të përfitohet me ndonjë mënyrë tjetër."

Vërtetohet:

E para: Mbjellja e tokës është objekti i marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës dhe, kur prej mbjelljes së bimëve nuk mund të përfitohet, përfundon edhe kontrata.

E dyta: Meqenëse bujqësia është motiv dhe jo kusht, kontrata duhet të jetë e detyrueshme dhe nuk ka më vend të flitet për përzgjedhje.

E treta: Dallimi ndërmjet kushtit dhe motivit, edhe pse është i vlefshëm nga ana teorike dhe e hollësive logjike, është shumë larg që atë ta kuptojë masa e njerëzve, prandaj këtë dallim e bëjnë vetëm njerëz të veçantë.

Është e qartë që dispozitat ligjore janë vënë duke u bazuar mbi kuptimin që ato kanë në këndvështrimin e traditës dhe të hollësive logjike.

6- Caktimi i kohës bëhet me ditë, ose me muaj, ose me vite dhe është detyrë që koha të jetë e mjaftueshme, derisa të mbjellat të piquen.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Toka pranohet me afat kohor të përcaktuar, deri në vite.”

Kur koha nuk është përcaktuar, atëherë për bimën e mbjellë merret në konsideratë koha e zakonshme, sipas traditës dhe, nëse për atë mbjellje s’ka traditë, atëherë marrëveshja për shfrytëzimin e tokës është pa vlerë.

Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës lejohet edhe për më shumë se një vit, kur kushti është saktësuar. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk ka problem, kur njerëzit e një vendi detyrohen me tokën për dhjetë vjet, ose për më pak, ose për më shumë vite se kaq.”

Fermeri kundërvajtës

Kur pronari i tokës nuk përcakton llojin e të mbjellave, nëse fara është e fermerit, ai e zgjedh vetë cilën lloj bime të mbjellë. Kështu janë shprehur shumica e fukahave, por patjetër duhet të përmbahemi në kushtet e të mbjellave, për të cilat nuk ka të ngjashme, por nëse ka shembuj për të mbjellat që kultivohen në atë vend, është detyrim të veprohet sipas atyre shembujve, pasi pjesa më e madhe e parcelave nuk janë të përshtatshme për mbjelljen e të gjitha llojeve e kultivarëve.

Kur pronari i tokës përcakton një lloj të veçantë të mbjellash, për shembull, ai përcakton që fermeri të mbjellë grurë,

nuk lejohet të kundërshtohet pronari i tokës. Nëse fermeri e kundërshton dhe në vend të grurit ai mbjell elb ose mel (në arabisht ades), në këtë rast, pronari i tokës ka të drejtën e përzgjedhjes ndërmjet prishjes ose firmosjes së marrëveshjes, për shkak të mos mbajtjes së besës për zbatimin e kushtit. Në qoftë se pronari i tokës e firmos marrëveshjen, merr pjesën e tij të prodhimit dhe, nëse ai e prish marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës, prodhimi është për fermerin, i cili, në këtë rast, ka detyrim t'i paguajë pronarit të tokës qeranë e tokës, sepse fermeri, në këtë rast, përfitoi me pronën e tjetrit pa e marrë as me qera e as pronari nuk ia la fermerit për bamirësi, prandaj fermeri ka detyrim të kompensojë pronarin e tokës. Kështu ka dhënë fetva (ka gjykuar) Muhak'kiku i Dytë (thani) në librin "Xhàmiul Mekàsidi", Dëshmori i Dytë (Shehijdu Thanij) në librin "Sherhul lum'ah", sej'jid Ebul Hasani në librin "Uesijletu Nexhàt" dhe dijetarë të tjerë.

Kur marrëveshja për shfrytëzimin e tokës priset, prodhimi i takon atij që ka dhënë farën, sipas rregullit: Në çështjet e pronësisë prodhimi ndjek origjinën. Nëse fara është e fermerit, atëherë i gjithë prodhimi i takon fermerit. Në këtë rast, fermeri ka detyrim t'i paguajë pronarit të tokës qeranë për tokën. Gjithashtu, prodhimi i takon pronarit të tokës, kur fara është prej tij. Në këtë rast, pronari i tokës ka detyrim t'i paguajë fermerit mëditjen për punën e bërë. Në rastin kur fara është prej të dyve, prodhimi i takon të dyve në proporcion me sasinë e farës që ka vënë secili prej atyre të dyve. Nëse prodhimi është më i madh, pronari i tokës ka detyrim t'i paguajë fermerit për këtë sasi më tepër se sa ai merr nga prodhimi. Gjithashtu, edhe fermeri ka detyrim të paguajë qeranë e tokës për prodhimin shtesë që mori.

Kur fermeri është i shkujdesur në punimin e tokës dhe një pjesë të parcelës e lë pa mbjellë, derisa kalon koha për mbjellje, megjithëse pronari i tokës i ka vënë atij tokën në dispozicion dhe ai e ka marrë në dorëzim atë parcelë toke për mbjellje në kohën e duhur, për më tepër, nuk ka pasur as faktorë atmosferikë që pengojnë mbjelljen e tokës, si për shembull, dëborë, ose faktorë të tjerë pengues, në këtë gjendje, a e garanton fermeri pronarin e tokës për tokën e pa mbjellë duke i paguar atij qeranë për pjesën e tokës të lënë pa mbjellë, apo ai s'ka asnjë detyrim?

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë dy thënie:

Thënia e parë: Ai ka detyrim edhe më shumë, prandaj detyrohet t'i paguajë pronarit të tokës qeranë e zakonshme për pjesën e lënë pa mbjellë, sepse ai u bë shkak që pronarit të tokës t'i dalë nga dora përfitimi, që ishte një e drejtë e tij, si dhe për faktin se fermeri e punon tokën e tjetrit brenda kohës së përcaktuar në marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës. Nga ky këndvështrim, fermeri është si një person që merr me qera diçka për ta përdorur dhe për të cilën ka detyrim të paguajë qeranë, madje fermeri paguan qeranë e tokës, edhe kur nuk e ka shfrytëzuar fare pjesën e lënë pa punuar. Gjithashtu, fermeri paguan, edhe nëse toka nuk jep prodhim për shkak të shkujdesjes së tij.

Thënia e dytë: Mbi fermerin nuk rëndon asnjë detyrim përveç mëkatit, sepse në atë parcelë ai nuk ka prishur ndonjë send që ekzistonte konkretisht, prandaj mbi këtë fermer nuk mund të zbatohet sentenca: "Kush prish pasurinë e tjetrit, ai është garantues për atë që prishi."

Gjithashtu, nuk kemi të bëjmë me faktin që ai ka vënë dorë mbi ndonjë send dhe për rrjedhojë të gjykojmë punën e tij sipas hadihit: “Dora ka detyrim për atë çka ka marrë, derisa ta shlyejë atë.”

Në këtë gjendje, s’ka gjë tjetër përveç kontratës për shfrytëzimin e tokës, kërkesat e së cilës janë që pronari i tokës të marrë pjesën e tij prej prodhimit të realizuar, pasi ajo që duhet të ishte nuk ekziston. Atëherë, në mënyrë absolute, s’ka asnjë detyrim as mbi pronarin e tokës e as mbi fermerin.

Vërtetohet se elementet që e bëjnë detyrim garantimin, nuk kufizohen vetëm me prishjen e me vënien dorë, pasi, në të vërtetë, edhe veprimi i papërgjegjshëm i shkaktarit e bën të detyruar garantimin.

Gjithashtu, është e padiskutueshme që edhe tradita vërteton detyrimin mbi fermerin neglizhues.

Të gjitha këto janë më se të mjaftueshme që për këtë fermer neglizhues të gjykohet se ai ka detyrim të bëjë garantimin.

Fermeri ka të drejtë të bëjë ortak një tjetër dhe ta lërë atë të shfrytëzojë tokën

Ai që merr një tokë me qera, në bazë të marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës, ka të drejtë që atë tokë t’ia japë një tjetri, pasi kriteri për vlefshmërinë e marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës është: Përfitimi prej tokës është pronë e atij që e punon tokën, kurse pronësia mbi tokën nuk është kusht.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “S’ka problem që toka të merret me qera me dirhemë dhe njerëzit të punojnë atë për një të tretën, ose për një të katërtën, ose për më pak, ose për më shumë, kur ti nuk merr prej burrit më shumë nga sa prodhon toka jote.”

Gjithashtu, për fermerin lejohet që ai të pranojë tokën prej pronarit të saj dhe këtë tokë ta punojë një tjetër, domethënë, fermeri e transferon të drejtën e tij për shfrytëzimin e tokës sipas marrëveshjes përkatëse për shfrytëzimin e saj te cili person që ai dëshiron, por me kusht që të ruhet e drejta e pronarit të tokës.

Gjithashtu, për fermerin lejohet të bëjë ortak në punën e tokës cilin të dëshirojë me pjesën e tij të prodhimit. Le ta ilustrojmë këtë rast me një shembull: Fermeri merr në pronësi pjesën e tij të prodhimit me një kontratë të detyrueshme. Gjithashtu, dihet që njerëzit pronën e vet e kanë nën pushtetin e tyre, për rrjedhojë, fermeri ka të drejtë që pjesën e prodhimit të tokës, i takon atij, si një e drejtë që i takon vetëm atij. Këtë të drejtë ai e transferon të plotë te një tjetër, ose transferon vetëm një pjesë të saj dhe askush nuk ka të drejtë të kundërshtojë veprimin e tij, sepse ky veprim i tij, është i ngjashëm me shitjen nga ana e tij e pjesës së prodhimit që i takon, domethënë, shet prej pasurisë së tij. Në këtë pjesë kanë të drejtat e tyre borxhdhënësit, prej saj nxirret një e pesta, zekati dhe të tjera efekte të pronësisë.

Fukahatë, në librat e tyre, kanë përmendur kundërshtime në lidhje me këtë transferim të drejtë. Një grup fukahash kanë thënë se kjo i lejohet fermerit, kur pronari i tokës nuk i ka vënë atij kusht që tokën duhet ta punojë ai vetë, prandaj, kur është ky kusht, fermerit nuk i lejohet t’i japë tokën një tjetri me kontratë për

shfrytëzimin e saj, ose të bëjë ortak ndonjë tjetër në këtë tokë të marrë prej pronarit të tokës.

Por për autorin e librit “El Xheuahir” sentenca “Pasurinë njerëzit e kanë nën pushtetin e vet.”, lejon që fermeri të ketë të drejtë të bëjë marrëveshje për shfrytëzimin e tokës e të bëjë ortakëri me cilin të dëshirojë. Gjithashtu, disa fukahave kanë cituar fjalën e përbashkët të fukahave, kur shitësi i vë kusht blerësit që ai të mos e shesë sendin e blerë prej tij, nuk është detyrim të mbahet besa për këtë kusht. Bazuar mbi këtë që u tha, kur pronari i tokës i vë kusht fermerit që ai ta punojë vetë tokën, nuk është detyrim të mbahet besa për këtë kusht.

Në librin “El Xheuahir”, tekstualisht thuhet: “Në lidhje me vlefshmërinë e këtij kushti, ka qëllim kushtin e pronarit të tokës që fermeri ta punojë vetë tokën, kemi të bëjmë me një studim të përgjithshëm të rregullit: Njerëzit kanë pushtet mbi pasuritë e veta. Gjithashtu, ajo që rezulton prej fjalës së përbashkët të fukahave, në kapitullin “Shitblerja”, flet qartë për pavlefshmërinë e një kushti të këtillë.”

Sido që të jetë, në lidhje me këto imtësi, nuk ka ardhur asnjë lloj teksti, por ato janë nxjerrë prej rregullave të përgjithshme. Gjithashtu, nuk ka ardhur tekst i veçantë as në lidhje me ortakërinë e fermerit me një tjetër, pasi vetë fermeri e ka marrë tokën me marrëveshje për shfrytëzimin e saj.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që hedh njëqind, ose më pak ose më shumë “xherijb” (masë matëse prej lëkure) farë të lashtash ose farë bimësh të tjera, ndërkaq vjen dikush dhe i thotë: “Të marrësh prej meje gjysmën e

çmimit të kësaj fare dhe gjysmën e shpenzimit që ke bërë, me kusht që të më bësh ortak në prodhimi. A duhet të veprojë fermeri sipas kësaj fjale? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “S’ka problem.”

Duhet të theksohet se specifikimi i këtij transmetimi për ortakërinë pas kryerjes së punës, nuk e bën atë të veçantë, sepse kriteri për lejimin e ortakërisë në punimin e tokës së marrë me marrëveshje për shfrytëzimin e saj, kërkon që përfitimi të jetë pronë e fermerit dhe s’ka dyshim që fermeri e mori në pronësi përfitimin në sajë të kontratës dhe jo në sajë të punës, ose ngaqë mbijnë të mbjellat. Bazuar mbi këto që u shpjeguan, për fermerin lejohet që ai t’i transferojë të drejtat e tij te një tjetër, sapo të lidhet kontrata.

Taksa e tokës

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët me autorin e librit “El Hadaik” dhe me autorin e librit “Miftahul Kerameh”, që taksa e tokës, domethënë taksa e pushtetit mbi tokën, në të vërtetë, është detyrim ta paguajë pronari i tokës dhe jo fermeri që punon në atë tokë.

Gjithashtu, taksa e tokës nuk paguhet as prej prodhimit total që do të ndahet mes pronarit të tokës dhe fermerit, sepse kjo taksë i vihet pikërisht tokës dhe toka është pronë e pronarit të saj. Është e natyrshme që pronari i tokës të vërë kusht për fermerin që taksën e tokës duhet ta paguajë vetëm ai, ose që kjo taksë të paguhet prej prodhimit total. Nëse kjo vihet kusht, mospasja dijeni për shumën e taksës së tokës nuk përbën dëmtim, sepse

mospasja dijeni për rrezikun në veprime të ngjashme, është e falur me traditë dhe ligjërisht.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka një copë tokë dhe ai e di shumën e taksës që duhet të paguajë për atë tokë, mbase kjo shumë që ai duhet të paguajë mund të jetë më shumë ose më pak. Ky burrë ia jep këtë tokë një tjetri, me kusht që ai të paguajë taksën e tokës, ndërsa ai që e merr token do t'i japë burrit të parë për shembull 200 dirhemë. A është i drejtë ky veprim? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "S'ka problem."

Përsëri është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka një tokë, për të cilën paguhet taksa e tokës dhe ai ia jep këtë tokë një burri tjetër, me kusht që ai të banojë në atë tokë, ta mirëmbajë atë dhe të paguajë edhe taksën për këtë tokë, kurse prodhimi që do të teprojë ta ndajnë mes tyre. A është e drejtë kjo marrëveshje? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "S'ka problem."

Në librat e hadithit dhe të fik'hut gjenden transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), që përshkruajnë dhunën dhe padrejtësinë e qeveritarëve mbi fshatarët e qytetarët. Transmetimet tregojnë se kjo dhunë e kjo padrejtësi kishte arritur deri në atë cak, sa njerëzit i linin pronat e tyre një tjetri, që të mos kishin të bënë me taksat e rënda. Prej këtyre transmetimeve kemi edhe rastin kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë, i cili ka ardhur në një fshat mbi banorët e të cilit pushteti po ushtronte aq dhunë, sa ata nuk kishin mundësi të paguanin taksën e tokës dhe, pavarësisht që fshati ishte në dorën e tyre, në të vërtetë, nuk dihej që kjo tokë

ishte toka e tyre, apo ishte tokë e të tjerëve. Prandaj banorët e atij fshati i dhanë tokën e tyre burrit të ardhur në fshatin e tyre, me kusht që ai të paguante taksën e tokës.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “S’ka problem.”

Transmetimet e kësaj kategorie janë të shumta dhe një pjesë prej këtyre transmetimeve i ka përmendur autori i librit “El Hadaik” në vëllimin e pestë, në faqen 368.

Duhet të theksojmë se punët që kërkohen për mbarësinë e të mbjellave e për vijimësinë e prodhimit, duke filluar që nga punimi i tokës, vaditja, sistemimi i tokës, pastrimi i tokës prej barërave të këqija dëmtuese, etj, të gjitha këto punë janë detyrim për fermerin, kurse për punët e tjera që kërkon toka, si për shembull, çarja e kanalit deri te lumi, hapja e pusit, përgatitja e mjeteve të vaditjes e të tjera punë si këto, patjetër që duhet të specifikohen se cili prej tyre i ka detyrim këto punë. Nëse në atë vend ka një zakon që tregon se kush i ka detyrim këto punë, nuk është e nevojshme që ato punë të përcaktohen në marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës.”¹

Fara

Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës, sipas përkufizimit, do të thotë që toka është e njërit prej atyre të dyve që bëjnë këtë marrëveshje, ndërsa punën e bën tjetri. Gjithashtu, edhe kontrata

¹ “Uesijletu Nexhàt”, e autorit Ebul Hasan El Asfehànij.

për shfrytëzimin e tokës përbëhet prej ofertës nga ana e pronarit të tokës dhe prej pranimit nga ana e fermerit.

Për sa i përket farës, lejohet që ajo të jetë vetëm prej pronarit të tokës, ose vetëm prej fermerit, ose prej të dyve në mënyrë të barabartë, ose me diferencë dhe është e barabartë, nëse kanë rënë dakord apo kanë kundërshtime për pjesën e prodhimit që do të marrin. Fara të jetë prej njërit prej tyre, ose që ajo të jetë prej të dyve, përcaktohet vetëm me tekst, mbi të cilin është bazuar edhe marrëveshja mes atyre të dyve, ose në atë vend, për punën e farës, ekziston zakoni i përhershëm që zbatohet në mënyrë absolute.

Kur ata të dy nuk e kanë sqaruar se prej kujt duhet të jetë fara, për më tepër, nuk ekziston as zakoni që mund të shpjegojë punën e farës, në këtë gjendje, ne mendojmë se marrëveshja për shfrytëzimin e tokës duhet të shpallet e pavlefshme, sepse ata të dy nuk e dinë se prej cilit duhet të jetë fara.

Thuhet: Në këtë gjendje, fara është prej fermerit, sepse, kur është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës, ka thënë: “Shpenzimi është nga ana jote, kurse toka është pronë e pronarit të saj.”, duke vënë në konsideratë që shpenzimi përfshin edhe farën.

Mirëpo kjo konsideratë hidhet poshtë, pasi marrëveshja për shfrytëzimin e tokës është e vlefshme, edhe kur fara është prej pronarit të tokës. Gjithashtu, marrëveshja është plotësisht e vlefshme, edhe kur është prej fermerit. Vetëkuptohet që rregulli i përgjithshëm nuk tregon të veçantën, përveçse me anë të shembullit krahasues dhe aty ku nuk ka shembull krahasues, si

për shembull, për ofertën, marrëveshja për shfrytëzimin e tokës prishet për shkak të mospasjes dijeni. Me fjalën “shpenzime” nënkuptohet punimi i tokës, korrja e të mbjellave dhe punë të tjera të bujqësisë. Veç kësaj, është pyetur dhe ka thënë: “Toka është për pronarin e saj.” dhe nuk ka thënë “prej pronarit të saj”.

Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës mes më shumë se dy vetëve

A është e vlefshme që kontrata për shfrytëzimin e tokës të jetë mes më shumë se dy vetëve, për shembull, toka është e njërit, fara prej një të dyti, puna prej një të treti dhe lopët prej një të katërti?

Shumë fukaha kanë thënë se marrëveshja për shfrytëzimin e tokës me më shumë se dy vetë nuk është e vlefshme, sepse kontrata për shfrytëzimin e tokës plotësohet me propozuesin e ofertës, që është pronari i tokës dhe me pranuesin, që është fermeri dhe, hyrja e më shumë vetëve e nxjerr kontratën prej vendit të saj, ose ajo ka nevojë të vërtetohet me argument.

Vërteohet se, kur kontrata për shfrytëzimin e tokës plotësohet mes dy vetëve, nuk është prej domosdoshmërive që ajo të mos plotësohet mes më shumë se dy vetëve, ndryshe çështja do të komplikohet te kompanitë, ku bashkohen dhjetëra firma. Për sa i përket nevojës për të vërtetuar me argument marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës me më shumë se dy vetë, pa dyshim që kjo marrëveshje është e vlefshme, megjithëse nuk është e domosdoshme që argumenti të jetë tekst i veçantë për

bashkëpunimin në fjalë, ndryshe çështja do të vështirësohej në pjesën më të madhe të bashkëpunimeve të ndërsjella.

Prandaj, për vlefshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë, është e mjaftueshme të mbështetemi në ajetet e Kur'anit: "...veç në qoftë tregti mes jush me mirëkuptim...", "respektoni kontratat..."

Duhet të theksohet se argumentet që flasin në lidhje me marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës, janë përgjithësuese, qoftë kur kjo marrëveshje ndodh mes dy vetëve, qoftë kur ajo ndodh mes më shumë se dy vetëve.

Çështje

1- Kur marrëveshja për shfrytëzimin e tokës është e përcaktuar me afat kohor dhe afati mbaron pa u pjekur të mbjellat, si është gjykimi në këtë rast?

Një grup fukahash kanë thënë se pronari i tokës ka të drejtë të asgjësojë të mbjellat prej tokës së tij. Kjo është e barabartë, qoftë kur vonesa ka ardhur prej mangësive të fermerit, qoftë kur vonesa ka ardhur për shkak të ndonjë faktori atmosferik, si për shembull, vonesa e ujitjes, ose ndryshimi i motit, sepse e drejta e fermerit ka përfunduar me përfundimin e afatit.

Autori i librit "Miftahul Kerameh" ka thënë: "Muhak'kiku i Dytë, në librin "Xhamiul Mekasid", ka thënë: "Në qoftë se vonesa ka ardhur për shkak të mangësive të fermerit, pronari i tokës ka të drejtë të asgjësojë të mbjellat, sepse fermeri, me përfundimin e afatit, është si grabitësi. Por nëse vonesa nuk ka ardhur për shkak

të mangësive të fermerit, atëherë është detyrim që të mbjellat të mos preken, derisa të piquen.””

Më pas, autori i librit “Mifahul Kerameh”, tha: “Me këtë ka dhënë fetva (ka gjykuar) shehu Et Tùsij në librin “El Mabsut” dhe kjo është e vërteta.”

Ne mendojmë se pronari i tokës, në mënyrë kategorike, nuk ka të drejtë të asgjësojë të mbjellat, edhe kur vonesa ka ardhur prej mangësive të fermerit, sepse fermeri, në radhë të parë, ka vepruar me të drejtë dhe për një shkak ligjor, natyrisht që ai ka detyrim të paguajë qeranë e tokës për kohën që duhet deri në pjekjen e të mbjellave, pas përfundimit të afatit. Për sa i përket krahasimit të fermerit me rrëmbyesin, ne themi se në këtë krahasim duhet të bëhet dallim, sepse rrëmbyesi, që në fillim i kishte vënë vetes qëllim që të përvetësonte të drejtën e tjetrit dhe të mos e respektonte pasurinë e tjetrit, prandaj, me fjalën e përbashkët të fukahave, shembet shtëpia e ndërtuar në tokën e tjetrit (e ndërtuar pa lejen e pronarit të tokës), kurse fermeri nuk ka bërë asgjë nga veprimet që bën rrëmbyesi.

Me një fjalë, për rrëmbyesin vërtetohet plotësisht fjala e hadithit: “S’ka të drejtë për djersën që derdh dhunuesi.”, prandaj sentenca e këtij hadithi nuk mund të përfshijë edhe fermerin e lartpërmendur.

2- Kur toka është e degraduar, lejohet që këtë tokë t’ia japësh një tjetri, me kusht që ai ta përmirësojë dhe për punën e tij të marrë gjithë prodhimin e saj për një vit ose për më shumë vite, pastaj prodhimi do të jetë për ju të dy, secili me një pjesë të përcaktuar.

3- Kur të mbjellat rriten, ose kur frutat dalin mbi pemë, lejohet që të mbjellat ose frutat t'i pranojë një burrë tjetër kundrejt një sasive të caktuar nga prodhimi i të mbjellave e i frutave. Në qoftë se formula e kontratës përkatëse është thënë mes pronarit të tokës dhe pranuesit, domethënë garantuesit, sipas shprehjes së traditës, bashkëpunimi i ndërsjellë është bërë i detyrueshëm dhe nuk lejohet që prej këtij bashkëpunimi të hiqet dorë, përveçse me marrëveshje të të dyja palëve, ndryshe dispozita ligjore, në këtë gjendje, është si dispozita e praktikës marrje-dhënie, ose do të veprohet ashtu siç u shpjegua në pjesën e tretë. Kur bëhet e qartë shtesa e prodhimit, ajo i takon pranuesit. Gjithashtu, edhe kur bëhet e qartë se prodhimi do të jetë më pak, edhe pakësimi do të jetë për pranuesin, me kusht, kur të mbjellat ose frutat nuk janë prekur nga ndonjë sëmundje që i prish të mbjellat para korrjes dhe frutat para vjeljes, ndryshe dispozita në këtë gjendje është si dispozita e prishjes së sendit objekt shitje para marrjes së tij në dorë.

Pra, ai prodhim mbetet pasuri e pronarit të tokës. Nëse prishja dhe shkatërrimi ndodh pas korrjes e pas vjeljes, ato janë prej pasurisë së pranuesit, sepse në këtë rast pranuesi përfshihet në dispozitën e blerësit.

4- Në qoftë se pas përfundimit të periudhës së të mbjellave dalin filiza prej rrënjëve të të mbjellave, nëse fara ishte prej pronarit të tokës, këto mbirje e dalje të reja i takojnë pronarit të tokës. Nëse fara ishte prej fermerit, atëherë mbirjet e dyta i takojnë fermerit, sipas rregullit: Prodhimi ndjek farën.

Në këtë rast, fermeri ka detyrim të paguajë qeranë e tokës, përveçse kur pronari ka hequr dorë prej prodhimeve të dyta, ashtu siç veprohet në shumicën e rasteve.

Konflikti

1- Kur ata të dy kanë mosmarrëveshje në lidhje me afatin e marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës dhe njëri thotë: "Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës ishte për një vit.", kurse tjetri thotë: "Jo, ajo ishte për dy vjet.", merret në konsideratë fjala e mohuesit, i cili ka detyrim të betohet, pavarësisht nëse ai është pronari i tokës ose fermeri, sepse rregulli bazë është: "Pretenduesi s'ka të drejtë të marrë shtesën."

Kur ata të dy kanë mosmarrëveshje në lidhje me sasinë e pjesës nga prodhimi, në këtë rast, merret në konsideratë fjala e atij që ka dhënë farën, por ai duhet të betohet, madje edhe sikur të pretendojë shtesën për veten e tij, sepse rregulli është: "Në fushën e pronësisë fara ndjek prodhimin dhe baza është qëndrimi i saj në pronësi të tij, derisa të vërtetohet transferimi me pohim ose me argument."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim, unë e gjej atë një send prej dy gjykimeve."

2- Kur fermeri i thotë pronarit të tokës, pasi e ka mbjellë tokën e tij: "Ti ma dhe tokën me kredi, prandaj s'ke të drejtë të marrësh asgjë prej meje.", kurse pronari i tokës thotë: "Jo, tokën ta kam dhënë me qera."; ose pronari i tokës i thotë fermerit: "Bujqësia jote është me një pjesë prodhimi të përcaktuar.", pasi në

këtë gjendje s'ka argument që të tregojë asnjërën prej dy pretendimeve, atëherë si do të jetë gjykimi?

Fukahatë më të dëgjuar kanë thënë se pronari i tokës betohet se nuk është me kreditim. Në këtë rast, ai është mohues i kreditimit, por pretendimi që toka është dhënë me qera ose me marrëveshje për shfrytëzimin e saj, vërtetohet vetëm me argument.

Gjithashtu, edhe fermeri betohet për shkak se mohon marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës dhe marrjen e saj me qera, prandaj edhe fermeri, në këtë rast, është mohues, sepse mohon marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës dhe marrjen e saj me qera, njëkohësisht edhe pretendimi i fermerit se e ka marrë me kredi, nuk mund të vërtetohet pa argument.

Kur ata të dy kanë kontradiktë, bien poshtë të dy pretendimet dhe është sikur këto dy pretendime të mos ishin fare. Në një gjendje të tillë, është detyrim që fermeri të marrë të gjithë prodhimin, pasi fara ishte nga ana e tij, por fermeri ka detyrim t'i paguajë pronarit të tokës qeranë e zakonshme të tokës, sepse leja që fermeri të punonte tokën, nuk ishte për bamirësi. Padyshim, kur qeraja e zakonshme për tokën është më shumë se pjesa ose qeraja që pretendon pronari i tokës, në këtë rast, ai ka të drejtë të marrë sasinë e pretenduar, për shkak se ai vetë pohoi që nuk ka të drejtë të marrë më shumë.

Autori i librit "Mifahul-Kerameh" ka thënë: "Jo. Në të gjitha gjendjet, pronari i tokës merr qeranë e zakonshme, pavarësisht se është më shumë ose më pak nga sa ai pretendon,

sepse betimi i dyanshëm e ka rrëzuar efektin e pretendimit të pronarit të tokës.

3- Kur fermeri thotë: “Ti ma dhe tokën me kredi.”, kurse pronari i tokës thotë: “Jo, ti ma rrëmbeve mua tokën.”, në këtë rast, betohet vetëm pronari i tokës për kreditimin, sepse baza është qëndrimi i përfitimeve prej tokës në pronësi të tij dhe mosdalja e këtyre përfitimeve prej dorës së tij më anë të kreditimit ose me rrugë të tjera, kurse pretenduesi i kreditimit duhet të sjellë argument, sepse, në këtë gjendje, ai është pretendues dhe pretenduesit nuk i pranohet betimi. Kur betohet pronari i tokës, fermerit i kërkohet qeraja e zakonshme për tokën përgjatë gjithë kohës që toka ishte në dorën e tij. Gjithashtu, fermeri ka detyrim të asgjësojë të mbjellat. Nëse fermeri nuk i asgjëson ato, atëherë pronari i tokës ka të drejtë t’i asgjësojë ato me imponim, duke i ngarkuar fermerit shpenzimet dhe kompensimin për dëmin e shkaktuar.

Ndryshimi mes këtyre dy çështjeve dhe çështjes përpara kësaj, qëndron në faktin se fermeri, në çështjen e mësipërme, ishte i lejuar të vepronte me miratim të dyanshëm, prandaj mbi atë nuk mund të renditen dispozitat që flasin për rrëmbyesin, kurse në çështjen që kemi në trajtim, fermeri nuk ishte i lejuar, prandaj ai dënohet sipas dispozitave të rrëmbyesit, për shkak të mosvërtetimit të lejes për veprim.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Këtu fermeri është si rrëmbyesi, mbi të cilin renditen dispozitat e rrëmbyesit dhe nuk është vetëm pohimi i pronarit të tokës ai që e bën të detyrueshëm gjykimin e fermerit si rrëmbyes.

Gjithsesi, për renditjen e dispozitave të rrëmbyesit është e mjaftueshme mosvërtetimi i lejes prej pronarit të tokës, vërtetim të cilin ai e arriti me betimin e tij për të mohuar kreditimin që pretendoi fermeri, ashtu siç u bë e qartë.”

* * *

MARRËVESHJA PËR DRUFRUTORËT

(el musàkàt)

Kuptimi i konceptit “marrëveshje për drufrutorët”

Marrëveshja për drufrutorët është një lloj ortakërie për prodhimin e drufrutorëve, për të cilin lidhin kontratë pronari dhe punëtori me pjesë në prodhim, sipas sasisë së njohur që praktikohet në atë vend. Me këtë shpjegim gjejmë edhe komentin e fjalës së fukahave për përkufizimin e kësaj marrëveshjeje, pasi kjo marrëveshje lidhet mbi baza të qëndrueshme, që janë pemët dhe një pjesë e prodhimit të pemëve.

Në të vërtetë, nga termi “bazat” ka dalë “marrëveshja për shfrytëzimin e tokës”, domethënë marrëdhënia që mundëson mbirjen dhe rritjen e të mbjellave. Gjithashtu, ka dalë edhe termi “të qëndrueshme” për zarzavatet, të cilat në fakt, i aneksohen të mbjellave të tokës.

Ka dalë edhe termi “me pjesë që praktikohen prej rritjes së bazës”, domethënë qerasë, sepse kjo marrëveshje është me pagesë të përcaktuar.

Gjithashtu, ka dalë edhe marrëveshja për drurët që nuk kanë prodhim, si për shembull, plepat, por që edhe këto hyjnë në grupin e marrëveshjes për drufrutorët, ashtu siç hyjnë në grupin e marrëveshjes për drufrutorët edhe ato lloj drurësh që përfitohet prej gjetheve të tyre, siç janë për shembull, druri i manit dhe druri i kënasë. Prandaj kriteri që e bën të vlefshme marrëveshjen për drufrutorët, është përfitimi prej frytit ose prej gjethes së pemës, krahas qëndrimit të vetë pemës si origjinë e prodhimeve që sjellin përfitimin.

Ligjshmëria e marrëveshjes për drufrutorët

Me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe të autorëve të tjerë, togfjalëshi “marrëveshje për drufrutorët” (*el musàkàt*) nuk është përmendur as në Librin e Allahut e as në hadithet profetike, por fukuhatë i kanë nxjerrë dispozitat për këtë marrëveshje prej librave të ligjit të fesë dhe sipas praktikës së përdorimit, e kanë emërtuar “marrëveshja për drufrutorët”, sepse pema e shton nevojën e saj për vaditje.

Veç kësaj, duhet të dihet se bashkëpunimi i ndërsjellë për drufrutorët është i vlefshëm edhe për pemët që janë nëpër kodra, të cilat i vadit vetëm shiu, plotësisht siç është i vlefshëm bashkëpunimi i ndërsjellë, kur ato janë në toka që vaditen, për faktin se kriteri për vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje është puna që kërkon pema që ajo të lidhë e të pjekë fruta, pasi pema ka nevojë për krasitje, spërkatje, punimin e tokës nën pemët, pastrimin e tokës nga barërat e këqija e të tjera punë të pemëtarisë.

Marrëveshja për drufrutorët është ligjëruar me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst. Prej teksteve është edhe fjala që tha Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), kur u pyet për një burrë që jep tokën e tij, ku ka shëgë, ose hurma, ose drufrutorë të tjerë. Burri thotë: *“Vadite këtë tokë, ose shërbeji pemëve dhe do të kesh gjysmën e frutave të saj.”* A është e drejtë kjo marrëveshje? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“S’ka problem.”*

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Marrëveshja për drufrutorët është e lejuar, me fjalën e përbashkët të dijetarëve tanë dhe tekst. Për këtë marrëveshje, transmetimet janë me varg përcjellësish të pashkëputur, ose ato janë taksative në përmbajtjen e tyre.

Kushtet

Në marrëveshjen për drufrutorët merren në konsideratë:

1- Oferta prej pronarit dhe pranimi prej punëtorit, me çdo fjalë ose veprim që tregon ofertën e pranimin. Më sipër është shpjeguar që oferta dhe pranimi janë prej kushteve për vlefshmërinë e marrëveshjes.

2- Aftësia e dy kontraktuesve për të hyrë në marrëdhënie pasurore.

3- Origjina e marrëveshjes, domethënë pemët, të cilat duhen të dihen sa janë për të dyja palët. Gjithashtu, është detyrim që në kontratën përkatëse të përmenden e të përcaktohen punët që ka detyrim të bëjë punëtori. Në qoftë se punët e kërkuara nuk janë përmendur të specifikuar, atëherë marrëdhënia e ndërsjellë

zgjidhet sipas traditës. Nëse nuk ka traditë, puna e kërkuar caktohet prej vetë punëtorit, por kështu prishet bashkëpunimi, për shkak të mospasjes dijeni për kushtet.

4- Të përfitohet prej frutave që japin pemët, krahas qëndrimit të bazës, domethënë qëndrimit të pemës, si për shembull, druri i hurmës, drufrutorët e tjerë dhe vreshta e hardhitë e rrushit, ose kur përfitimi janë gjethet e pemës, si për shembull, pema e manit dhe pema e kënasë. Për sa i përket prodhimeve të tokës, si shalqiri, kastraveci, patëllxhani, pambuku e kallami i sheqerit, të gjitha këto nuk hyjnë në marrëveshjen për drufrutorët, megjithëkëtë lejohet që pronari dhe punëtori të bien në marrëveshje për vaditjen e për shërbimet e tjera që kërkojnë këto bimë kundrejt një pjese të caktuar të prodhimit që ato japin, pasi edhe në këtë marrëveshje vepron rregulli: “Tregti me mirëkuptim”.

Autori i librit “El Urvetul Vuthkà” ka thënë: “Nuk përjashtohet lejimi për të njohurat, domethënë për shembull, tregtinë me mirëkuptim të dyanshëm, megjithëse kjo marrëdhënie nuk është marrëveshje që përdoret si term për drufrutorët, madje nuk përjashtohet lejimi në të gjitha llojet e të mbjellave. Gjithsesi, kërkesa përgjithësuese, edhe në këtë marrëdhënie, është vlefshmëria e saj, si për të gjitha bashkëpunimet racionale, domethënë se ky bashkëpunim i ndërsjellë nuk përmban mashtrim.”

Kur themi “te ata”, kemi parasysh traditën, e cila toleron mashtrimin e lindur për shkak të mospasjes dijeni të përpiktë për pagën e punëtorit. Gjithsesi, qëllimi kryesor i punës është që kjo

marrëdhënie nuk është prej terminologjisë që përdoret në marrëveshjen për drufrutorët.

5- Përcaktimi i kohës: Nuk ka kufi për kohën më të gjatë, por lejohet që të jetë për disa vjet, kurse përcaktimi i kohës më të shkurtër vlerësohet që ajo të zgjasë aq kohë sa të piquen frutat.

Gjithsesi kjo kohë ndryshon sipas llojit të pemëve.

Kur koha e përcaktuar nuk është e mjaftueshme deri në pjekjen e frutave, marrëveshja për drufrutorët prishet dhe punëtori ka të drejtë të marrë një page të ngjashme, kur ai ka punuar te pemët.

Kur punëtori bën atë çka kërkohet prej tij dhe pema nuk jep fruta për shkak të ndonjë sëmundje atmosferike, ai nuk merr asgjë, sepse, në këtë rast, ai është si ai që punon me marrëveshje për shfrytëzimin e tokës dhe pëson humbje. Kur frutat dalin brenda periudhës së zakonshme për llojin e pemës, por afati i marrëveshjes përfundon para se të piquen frutat, në këtë rast, punëtori është ortak në prodhimin e frutave, sepse shkak i ortakërisë është ekzistenca e frutave dhe jo pjekja e tyre.

6- Marrëveshja për drufrutorët të bëhet para pjekjes së frutave. Kjo është e barabartë, qoftë kur frutat nuk kanë dalë akoma, ose kanë dalë, por nuk janë pjekur, sepse pas pjekjes së frutave nuk mbetet më objekt për marrëveshjen për drufrutorët.

Marrëveshja për drufrutorët është e detyrueshme

Kontrata për drufrutorët është e detyrueshme, prandaj nuk i lejohet asnjërit prej tyre ta prishë këtë kontratë pa miratimin e tjetrit. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim, unë e gjej këtë edhe te ne, ngaqë origjina e kësaj kontrate bazohet në ajetin e Kur’anit: **“respektoni kontratat”**.”

Kur vdes njëri prej dy kontraktuesve, trashëgimtari i të vdekurit zë vendin e kontraktuesit, patjetër kur pronari i ka vënë kusht punëtorit që ai të punojë vetë. Kur punëtori vdes para përfundimit të punës, pronari përzgjedh mes prishjes së kontratës dhe mes miratimit që trashëgimtari i punëtorit të zëvendësojë punëtorin.

Shkujdesja e punëtorit

Punëtori ka detyrim të kryejë të gjitha punët që duhet të bëjë. Nëse punëtori nuk i bën ato punë për shkak të ndonjë penguesi, ose edhe kur nuk ka pengues, në këtë gjendje, pronari përzgjedh mes prishjes së kontratës për shkak të mosplotësimit të kushtit dhe mes marrjes së një mëditësi, që të punojë në vend të punëtorit, por paga e punëtorit të dytë do të jetë prej pjesës së prodhimit që do të marrë punëtori kontraktues. Në këtë gjendje, pronari ka detyrim t’i paguajë punëtorit kontraktues mëditjen e zakonshme për sasinë e punës që ai ka bërë, nëse me të vërtetë ka punuar. Ky rregull është kur prishja e kontratës bëhet para daljes së frutave, ndërsa kur ajo priset pas daljes së frutave, në këtë gjendje, punëtori ka të drejtë të marrë pjesën e tij prej prodhimit të frutave, por punëtori është i detyruar t’i paguajë pronarit qeranë e

tokës për kohën që frutat qëndrojnë mbi pemë deri në kohën e pjekjes.

Kur pemët kanë nevojë për vaditje dhe në këtë kohë Allahu dërgon shiun, çka e bën vaditjen të panevojshme, detyra e vaditjes që kishe punëtori rrëzohet, megjithëkëtë marrëveshja për drufrutorët vazhdon të mbetet jo vetëm e vlefshme, por edhe e detyrueshme.

Ti mund të thuash: Marrëveshja për drufrutorët është si marrëveshja e qeramarrjes, e cila detyrimisht priset kur nuk ekziston më objekti i saj, si për shembull, dikujt i kërkohet të heqë një dhëmballë kundrejt pagesës, por dhëmballa bie vetë, kështu duhet të priset edhe marrëveshja për drufrutorët, kur pemët nuk kanë më nevojë më vaditje, për shkak të shiut. Veç kësaj dihet që uji i shiut është i mjaftueshëm për pemët.

Në përgjigjen tonë ne themi: Ka dallim mes qeramarrjes dhe marrëveshjes për drufrutorët, sepse qëllimi me qeramarrjen është pagesa kundjet punës dhe, kur nuk ka më punë, nuk mbetet më vend të flitet për pagesë kundrejt punës. Kurse në marrëveshjen për drufrutorët dhe në marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës, në të dyja këto marrëveshje, qëllimi është arritja e prodhimit në saje të punës që bën punëtori. Kur puna e punëtorit nuk është e nevojshme për shkak të veprimit nga ana e Allahut të Lartësuar, ose për shkak të punës së ndonjë personi tjetër, detyrimi për punën në fjalë nuk mbetet më detyrim për punëtorin, megjithëkëtë punëtori, edhe në këtë gjendje, ka të drejtë të marrë pjesën e tij prej prodhimit. Në këtë linjë mendimi është edhe autori i librit “E Xheuahir”.

Prishja e marrëveshjes për drufrutorët

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Çdo situatë në të cilën prishet marrëveshja për drufrutorët, punëtorit i takon paga e zakonshme, në respekt të punës që kryen myslimani me lejen e atij që ka pasur nevojë për punën e tij, kurse frutat i takojnë pronarit të origjinës, domethënë pronarit të pemëve, sepse prodhimi ndjek origjinën. Nuk ka asnjë dallim, nëse punëtori ka ose jo dijeni për prishjen e bashkëpunimit në kohën kur ndodhi prishja, qoftë edhe kur prishja e bashkëpunimit ka ardhur prej kushtit që i gjithë prodhimi të ishte për pronarin.”

Bazuar mbi sa thotë autori i librit “El Xheuahir” se, kur punëtori riskon të punojë me kusht që ai të mos ketë asgjë prej prodhimit dhe në këtë pikëpamje ai është bamirës dhe si i tillë nuk ka të drejtë të marrë asnjë send, atëherë, prej kësaj gjendje duhet të veçohet rregulli: “Çdo situatë në të cilën prishet marrëveshja për drufrutorët, punëtorit i takon paga e zakonshme.”.

Në qoftë se bëhet e qartë që pemët i takojnë një tjetri, nëse ky tjetri e lejon bashkëpunimin që ka bërë rrëmbyesi me punëtorin, marrëveshja për drufrutorët është e vlefshme dhe punohet në bazë të kësaj marrëveshjeje, por, nëse ai nuk e lejon, atëherë marrëveshja prishet dhe i gjithë prodhimi i takon pronarit, sipas rregullit: “Prodhimi ndjek bazën”, kurse rrëmbyesi që bëri marrëveshjen e bashkëpunimit me punëtorin ka detyrim t’i paguajë punëtorit pagën për punën e tij, nëse punëtori me të vërtetë nuk kishte dijeni për rrëmbimin, sepse punëtori është thirrur të punojë. Prandaj, në këtë gjendje, ai është i mashtruar dhe si i tillë, s’ka asnjë rrugë të kërkojë prej pronarit, sepse në këtë

rast, pronari as nuk e ka urdhëruar punëtorin dhe as nuk e ka lejuar të punojë në pronën e tij.

Çështje

1- Punëtori nuk paguan asgjë prej taksës që vë pushteti për pemët, përveçse kur kjo është prej kushteve të marrëveshjes.

2- Kur kushtet plotësohen dhe janë të mjaftueshme, lejohet që në marrëveshjen për drufrutorët të jetë një pronar dhe disa punëtorë. Gjithashtu, lejohet të jenë disa pronarë me një punëtor, për shembull, kopshti është pronë e dy ose më shumë vetëve dhe punëtori që do të merret me pemët, është vetëm një person.

3- Për punëtorin lejohet që, kundrejt pagesës, të marrë të tjerë për kryerjen e punës së kërkuar, nëse pronari nuk i ka vënë atij kusht që ai duhet ta bëjë vetë punën. Shtrohet pyetja: A i lejohet punëtorit të marrë persona të tjerë për të kryer punën, kur kushti nuk është i drejtpërdrejtë që ai duhet ta bëjë vetë punën me pemët dhe kur nuk e ka të ndaluar prej pronarit që të marrë të tjerë për të kryer punët që ai ka marrë përsipër të kryejë sipas marrëveshjes?

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë disa thënie, kurse ne jemi bazuar në mendimin e autorit të librit “El Xheuahir”, i cili ka thënë: “Kjo nuk i lejohet punëtorit, sepse prej kushteve të marrëveshjes për drufrutorët është që bashkëpunimi i ndërsjellë mes punëtorit e mes pronarit të pemëve, ose mes të autorizuarit prej pronarit e mes punëtorit, ose mes kujdestarit të pronarit e punëtorit, askush s’ka të drejtë të kërkojë argumente që lejojnë

vlefshmërinë e marrëveshjes që krahas punëtorit të punojë në pemëtari edhe një person i dytë me kontratë, ose të punojë bazuar në rregullin “Tregti me mirëkuptim të ndërsjellë.”, ose sipas rregullit “Besimtarët janë në kushtet e tyre.”, sepse këto argumente, si dhe argumente të tjera janë specifike për origjinën, e cila, në rastin në fjalë, është ose vetë pronari, ose personi i autorizuar prej pronarit, ose kujdestari i pronarit.

Siç shihet, në këtë argument nuk përfshihet i huaji, domethënë ai që s’ka të bëjë me marrëveshjen.

Konflikti

1- Kur ata të dy kanë konflikt për vlefshmërinë e kontratës dhe prishjen e saj, ai që pretendon prishjen e kontratës, ka detyrim të sjellë argument, sepse origjina është vlefshmëria e kontratës, derisa të vërtetohet e kundërta.

2- Kur ata të dy kanë konflikt në lidhje me sasinë e pjesës që do të marrë punëtori prej prodhimit, e cila në rastin tonë është gjysma e prodhimit dhe pronari thotë: “Jo, pjesa jote është një e treta.”, në këtë rast, merret në konsideratë fjala e pronarit, sepse rregulli është: “Baza ndjek prodhimin, por prodhimi i takon pronarit”.

3- Kur ata të dy kanë konflikt për kohën kur është bërë marrëveshja për drufrutorët, për një vit ose për më shumë, në këtë rast, merret në konsideratë fjala e atij që mohon shtesën, sepse origjina e marrëveshjes është që të mos ketë shtesë.

4- Kur pronari pretendon se punëtori ka abuzuar me punën, ose ka vënë dorë mbi prodhimin dhe punëtori e mohon, merret në konsideratë fjala e punëtorit, por ai ka detyrim të betohet, sepse, në këtë gjendje, ai është mohues. Kjo është e barabartë, qoftë kur punëtori është besnik, qoftë kur ai nuk është besnik. Në këtë linjë mendimi është edhe autori i librit “El Xheuahir”.

Kur pronari pretendon tradhti ose rrëmbim nga ana e punëtorit, a dëgjohet pretendimi i tij në mënyrë parësore, madje edhe kur pronari nuk është në gjendje të përcaktojë sasinë e rrëmbyer prej punëtorit, apo ky pretendim i pronarit dëgjohet vetëm nëse ai përcakton sasinë e rrëmbyer, sepse pretendimi për diçka të panjohur është i refuzuar dhe nuk lejohet që një pretendim i tillë të dëgjohet.

Autori i librit “El Urvetul Vuthkà” dhe autori i librit “El Xheuahir” kanë thënë: “Pretendimi i pronarit dëgjohet, edhe kur nuk është i përcaktuar, pasi hadithi është përgjithësues: “Pretenduesi ka detyrim të sjellë argumentin dhe mohuesi ka detyrim të betohet.”.

Marrëveshja për mbjelljen e pemëve

Marrëveshja për mbjelljen e pemëve realizohet kur dy vetë bien dakord që toka ku do të mbillen pemët, është e njërit prej atyre të dyve, i cili ia jep këtë tokë tjetrit që ai të mbjellë në atë tokë një lloj të caktuar pemësh, me kusht që pemët të jenë të të dyve. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe me autorin e librit “El Hadaik”,

që kjo marrëveshje është pavlefshme dhe është e barabartë, qoftë kur marrëveshja është bërë që mbjellësi të ketë një pjesë prej asaj toke, qoftë kur është bërë që për mbjellësin të mos ketë asgjë prej saj.

Autori i librit “El Xheuahir” nuk ka përmendur ndonjë fakt për mosvlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje, përveç origjinës së prishjes. Tekstualisht ai thotë: “Marrëveshja për mbjelljen e pemëve te ne është e pavlefshme, sepse baza është prishja.”

Autori i librit “El Urvetul Vuthkà” ka thënë: “Tregohet prej shejkh Erdebijlit dhe prej autorit të librit “El Kifàjeh” që në këtë bazë ka komplikim dhe s’ka vend që të mësohet vlefshmëria prej argumenteve përgjithësuese, prandaj kjo marrëveshje është në vendin e vet, pavarësisht që nuk ka fjalën e përbashkët të fukahave.”

Argumente përgjithësuese që e bëjnë të detyrueshme vlefshmërinë janë dy rregullat e lartpërmendura: “Tregti me mirëkuptim të ndërsjellë.” dhe “Besimtarët janë në kushtet e tyre.”.

Ne jemi bazuar mbi mendimin që flet për lejimin dhe për vlefshmërinë, derisa mirëkuptimi është realizuar prej të dyja palëve, kushtet janë pranuar dhe dihen si janë, prandaj fjala e përbashkët e fukahave, për këtë rast, nuk ka asnjë vlerë, pasi ne u njohëm me argumentin që mbështet këtë mendim dhe argumenti si bazë ka prishjen e marrëveshjes, sepse kjo bazë është gjykuar me argumentet përgjithësuese, ashtu siç ka thënë vërtetuesi i gradës së saktësisë së haditheve Erdebelij’ji.

Bazuar mbi mosvlefshmërinë e këtij bashkëpunimi për mbjelljen e pemëve, përsëri ajo është e vlefshme me kontratë pajtimi, ose me një kontratë tjetër, nëse nuk është prej kontratave specifike, domethënë që lejohet të bësh gjysmën e pemëve të mbjella, për vaditjen e për shërbimet që ato kërkojnë për një kohë të përcaktuar, kundrejt një pjese të tokës, ose kundrejt përfitimit prej saj për një kohë të përcaktuar.

Sej'jid Ebul Hasan El Asfehànij, në librin "Uesijletu Nexhàt", në fundin e kapitullit "Marrëdhënia për drufrutorët", thotë: "Pas pavlefshmërisë së marrëdhënies për mbjelljen e pemëve, mund të arrihet në rezultatin e marrëveshjes nëpërmjet rrugëve të futjes së saj nën një emër tjetër ligjor, si për shembull, ata të dy të jenë ortakë në bazat, pastaj mbjellësi paguan vetveten, duke mbjellë pjesën e pronarit të tokës dhe duke e vaditur atë e duke kryer shërbimet që ajo kërkon për një kohë të caktuar, kundrejt gjysmës së përfitimit që jep toka gjatë kësaj kohe, ose me gjysmën e vetë tokës, ose me rrugë të tjera ligjërisht të pranueshme.

* * *

DEPOZITIMI (vënia në ruajtje)

Kuptimi i fjalës “depozitim”

Fjala depozitim është marrë prej foljes “depozitoi sendin”, kur sendi është vënë që të mos lëvizet. Kjo fjalë thuhet për sendin e depozituar, për shkak të depozitimit dhe mospasjes përfitim me atë send, kurse ligjvënësit, domethënë fukahatë, me fjalën “depozitim” kanë qëllim: Dikush ka marrë në dorë një send prej pasurisë së depozituesit për ta ruajtur atë për depozituesin, prandaj ky send quhet “send në ruajtje”, kurse kontrata quhet “kontratë ruajtje”. Siç u tha, pronari i atij sendi quhet “depozitues”, kurse personi që merr sendin për ruajtje, quhet “ruajtësi”.

Ligjshmëria e depozitimit

Depozitimi është ligjëruar me fjalën e përbashkët të fukahave, të bazuar në Librin e Allahut dhe në hadithin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Allahu i Lartësuar, në Librin e Tij të nderuar, thotë:

“ فَإِنْ أَمِنَ بَعْضُكُم بَعْضًا فَلْيُؤَدِّ الَّذِي أُؤْتِنَ أَمَانَتَهُ ”

“... nëse i lini në besim njëri-tjetrit, atij që i është lënë në besim, le të dorëzojë amanetin te lënësi...” (Sure “El Bekare”, ajeti 283)

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Mos shikoni që ata falin shumë namaz e agjërojnë shumë, ose që kanë bërë disa herë Haxh, ose që ata urdhërojnë të mirën, apo zhurmën e tabureve të tyre natën, por shikoni vërtetësinë e fjalës së tyre dhe si e sa e kryejnë ata amanetin...”

Transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), që trajtojnë këtë çështje, janë të shumta dhe të përcjella me rrugë e mënyra të shumta.

Kushtet

1- Oferta prej depozituesit dhe pranimi prej ruajtësit.

Oferta dhe pranimi mund të jenë fjalë ose veprime që tregojnë pikërisht ofertën dhe pranimin. Kemi theksuar shumë herë se oferta dhe pranimi janë kolona të kontratës (pa të cilat ajo nuk është e vlefshme), por nuk mjafton vetëm lejimi i pronarit për ruajtjen e pasurisë së tij, pasi për ruajtjen e sendit në fjalë, duhet përputhja e vullnetit të depozituesit me vullnetin e ruajtësit, ndryshe kontrata e ruajtjes nuk mund të realizohet.

Autori i librit “El-Xhevahir” ka thënë: “Nuk ka problem për marrjen në konsideratë të kuptimit të kontratës së ruajtjes, qoftë kur ajo bëhet me fjalë, qoftë kur ajo bëhet me ndonjë veprim, ashtu siç veprohet për shitjen, pajtimin, qeranë dhe për kontrata të tjera, jo ngaqë ajo është prej kontratave të lejuara, apo thjesht që është e lejuar, por ngaqë te ajo nuk konstatohet as lidhja mes dy qëllimeve dhe as miratimi prej të dyja palëve. Sikur pronari i sendit të lërë sendin e vet te një person me qëllim ruajtje te ai, ky person nuk është i detyruar ta ruajë atë send, nëse nuk e pranon as me fjalë e as me ndonjë veprim që tregon se ai pranon ta marrë atë send në ruajtje.

Pra, ai nuk është i detyruar ta ruajë atë send, sepse, në këtë formë, nuk kemi të bëjmë me depozitim ligjor.

Gjithashtu, nëse pronari i sendit e lë sendin te një person, i cili nuk pranon ta marrë atë send në ruajtje, ndërkaq sendi prishet, personi që nuk e pranoi, s’ka asnjë detyrim të garantojë prishjen e sendit, sepse baza është mosgarantimi.”

2- Të dyja palët në marrëveshje kanë aftësi për kontraktime pasurore. Sikur burri i mençur dhe në moshë madhore, domethënë burri ka arritur moshën në të cilën obligohet me detyrimet e fesë, pranon ta marrë sendin për ruajtje prej një fëmije, ose prej një të çmenduri, është i detyruar të garantojë çdo pasuri që merr në dorë prej fëmijës e prej të çmendurit, madje edhe kur ai nuk abuzon me atë pasuri dhe ka kujdesin më të madh për ruajtjen e saj, sepse vetëm fakti që ai e merr në dorë atë pasuri për ruajtje, bën që çdo humbje e çdo pakësim në këtë pasuri të konsiderohet vënie dorë mbi pasurinë nga ana e ruajtësit, sepse fëmija dhe i çmenduri nuk kanë aftësi as të lejojnë e as të lidhin

kontratë, me përjashtim të rastit kur fëmija është në gjendje mendore të bëjë dallimin, për rrjedhojë është i lejuar të veprojë me pasurinë e tij, me kusht kur vlefshmëria e lejimit dhe e veprimit të këtij fëmije është e bazuar.

Kjo çështje është trajtuar në pjesën e tretë, kapitulli “Mosha e arritur”, paragrafi “Kontrata e fëmijës”. Në qoftë se i mençuri në moshë madhore ka frikë që sendi në dorën e fëmijës, ose në dorën e të çendurit do të prishet, nisur nga qëllimi që të fitojë shpërblim (te Allahu) për punën e mirë, lejohet ta marrë atë send në ruajtje prej atyre të dyve, me qëllim ruajtjen e sendit dhe ai send do të jetë në dorën e tij në ruajtje ligjore, me kusht që sendin ia kthen kujdestarit të fëmijës, ose kujdestarit të të çmendurit, por jo fëmijës e të çmendurit. Kur një person lë në ruajtje një send në dorën e një fëmije, ose në dorën e një të çmenduri dhe sendi prishet, ose zhduket, që të dy nuk garantojnë as prishjen e sendit e as zhdukjen e tij, sepse, në të vërtetë, vetë depozituesi është ai që asgjësoi pasurinë e tij dhe është plotësisht sikur ai ta flakë atë send në det.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Nuk është e vlefshme që fëmija e i çmenduri të marrin ndonjë send në ruajtje, sepse në kontratë vihet në konsideratë që të dyja palët duhet të jenë të plotësuar, por edhe kontrata e ruajtjes, pa asnjë kundërshtim, është si të gjitha kontratat e tjera, madje ky rregull gëzon fjalën e përbashkët të fukahave. Nuk lejohet që mbi sendin e lënë në ruajtje të vihet dorë dhe ai që vë dorë mbi atë send, ka detyrim të garantojë për pasurinë e fëmijës e për pasurinë e të çmendurit që ai kishte në ruajtje dhe nuk mund të shfajësohet vetëm duke i kthyer atyre pasurinë e vet, sepse s’ka vend të flitet që pasuria të jetë në dorën e fëmijës dhe të të çmendurit. Pasuria

do të lihej në ruajtjen e atyre të dyve, të fëmijës e të çmendurit, kjo kontratë ruajtje, me fjalën e përbashkët të fukahave më të dëgjuar, është e pavlefshme, sepse fëmija e i çmenduri nuk garantojnë, sepse janë të shkujdesur.

Përveç kësaj, depozituesi që e vë pasurinë në ruajtje te një fëmijë, ose te një i çmendur, e di mirë që as fëmija e as i çmenduri nuk mund të detyrohen as për ruajtjen e pasurisë e as të kryejnë amanetin e lënë te ata. Përveç kësaj, shkak i asgjësimit të pasurisë së lënë nën ruajtjen e secilit prej atyre të dyve, është më i fuqishëm se shkujdesja që ata kanë ndaj asaj pasurie.”

Me fjalë të tjera, kur fëmija dhe i çmenduri fillojnë të asgjësojnë pasurinë e lënë në ruajtje te ata të dy, ata s’kanë asnjë detyrim të garantojnë pasurinë e prishur, sepse vetë pronari i asaj pasurie u dha atyre të dyve pushtet mbi pasurinë e tij, prandaj vetë depozituesi është shkak për asgjësimin, pasi rregulli flet qartë: Shkak është më i fuqishëm se sa vepruesi i drejtpërdrejtë, prandaj edhe asgjësimi i adresohet depozituesit dhe jo atyre të dyve.

3- Marrja në dorë, sepse marrëveshja e ruajtjes se sendit të depozituar plotësohet vetëm me marrjen në dorë të asaj pasurie.

4 - Pranuesi ka fuqi ta ruajë sendin e depozituar.

5- Ruajtësi e ruan sendin e depozituar te ai pa pagesë, ndryshe dispozita për sendin e vënë në ruajtje është si dispozita e qerasë.

Kontrata e ruajtjes së pasurisë së depozituar është e lejueshme

Kontrata e ruajtjes së pasurisë së depozituar, është kontratë e lejueshme për të dyja palët, domethënë për depozituesin dhe për ruajtësin, prandaj lejohet që secili prej tyre ta prishë këtë kontratë, kur të dëshirojë. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, domethënë se është argumenti që tregon specifikimin e rregullit të bazuar në ajetin e Kur’anit: **“mbani besën në kontratat...”** Gjithashtu, fjala e përbashkët e fukahave, është bazuar edhe në argumente të tjera që flasin për ato kontrata, zbatimi i të cilave është detyrim.”

Bazuar mbi sa u tha më sipër, kontrata e ruajtjes për sendin e vënë në ruajtje, prishet me njëren prej katër veprimeve vijuese:

1- Njëri prej atyre të dyve (depozituesi e ruajtësi) e prish kontratën.

2- Vdekja e njërit prej tyre. Kontrata është realizuar pikërisht mes atyre të dyve, për rrjedhojë, nuk mund të ketë vijim të kontratës as me trashëgimtarin e depozituesit e as me trashëgimtarin e ruajtësit.

3- Depozituesi çmendet. Kjo gjendje e transferon administrimin e veprimit te një i tretë dhe jo te personi që ka bërë kontratën.

4- Depozituesi humb vetëdijen. Edhe kjo gjendje hyn në dispozitën e çmendjes.

Kur kontrata e ruajtjes së sendit të depozituar prishet për shkak se depozituesi vdes, ose çmendet, ose humb vetëdijen,

sendi i lënë në ruajtje, që është amanet pasuror i lënë në mirëbesim, kthehet në amanet ligjor. Dallimi mes këtyre dy amaneteve qëndron në faktin se lënia në mirëbesim është me miratimin e pronarit të sendit, kurse lënia ligjore është pa lejen e pa miratimin e tij, madje mund të jetë edhe pa dijeninë e tij, si për shembull, rrobën e merr era dhe e çon në shtëpinë e fqinjit, atëherë kjo rrobë në dorën e fqinjit është amanet ligjor, në të cilën nuk mund të zbatohet asnjëra prej dispozitave për sendin e lënë në ruajtje, prandaj kushdo që ka në dorë një send të tillë, ai e ka detyrim t’ia kthejë atë personit që i takon, ose ai njofton menjëherë pronarin e sendit dhe nuk lejohet që njoftimi të vonohet, me përjashtim të gjendjeve kur ka ndonjë pengesë ligjore. Në rast se vonohet kthimi i atij sendi, ose vonohet njoftimi kur s’ka ndonjë pengesë, personi që ka në dorë atë send, është garantues dhe numërohet si ruajtësi që vë dorë mbi sendin e lënë te ai në ruajtje, ose si ruajtësi që neglizhon me atë send që ka nën ruajtjen e tij, sepse thjesht kthimi i atij sendi me vonesë, ose vonesa për njoftimin e pronarit të atij sendi, kur s’ka asnjë pengesë, konsiderohet abuzim e shkuajdesje.

Ruajtja e sendit të depozituar

Ligjvënësi e ka bërë obligim ruajtjen e sendit të depozituar, njëkohësisht mënyrën e ruajtjes e ka lënë sipas zakonit dhe traditës që ndjekin njerëzit në raste të këtilla. Është e qartë se çdo send ruhet sipas llojit të sendit të depozituar, për shembull, paratë ruhen në një arkë të kyçur, rrobat në dollapin e rrobave, kafsha mbahet në stallë, delja në kullotë, etj. Kriteri për ruajtjen e sendit të depozituar është: “Ruajtësi e ruan sendin e depozituar ashtu siç

ruan pasurinë e vet.”, domethënë që në pikëpamjen e traditës të mos numërohet as person që vë dorë mbi pasurinë e tjetrit e as person që nuk kujdeset për sendin e lënë në dorën e tij për ruajtje.

Fukahatë kanë thënë se, kur depozituesi i vë kusht ruajtësit që sendin e lënë te ai për ruajtje ta vendosë në një vend të veçantë, është detyrim që kushti i vënë të zbatohet, për shkak të ndalimit kategorik për të vepruar me pasurinë e tjetrit pa lejen e tij. Por pa diskutim, që lejohet transferimi i sendit të lënë për ruajtje, kur këtë transferim e kërkon interesi i ruajtjes së sendit të depozituar, si për shembull, kur vendi i përcaktuar shembet, ose në atë vend bie zjarr, ose raste të tjera në të cilat transferimi i atij sendi bëhet i detyrueshëm.

Faktori që bën detyrim garantimin

Ruajtësi garanton vetëm kur neglizhon, ose kur vë dorë mbi sendin e lënë te ai për ruajtje, sepse neglizhimi është veprim negativ, është heqje dorë nga detyrimi për ruajtjen, kurse vënia dorë, është veprim faktik, është veprim i bërë mbi sendin e lënë për ruajtje për interesat vetjake të ruajtësit, si për shembull, ruajtësi vesh rrobën e lënë te ai për ruajtje, ose e jep atë me qera, ose përdor kafshën për ngarkesë e për hipje, përdor paratë ose i jep ato me kredi, ose udhëton duke i marrë ato para me vete, pa qenë e domosdoshme që ata të merren me vete, ose ruajtësi bën veprime të tjera të ngjashme që vënë në rrezik sendin e lënë te ai për ruajtje.

Kur një mizor ka qëllim të rrëmbejë sendin e lënë në ruajtje dhe ruajtësi ka mundësi ta largojë atë send pa pësuar sendi ndonjë

dëmtim, ruajtësi e ka detyrim ta bëjë këtë veprim, si veprim paraprak për ruajtjen e amanetit që ai ka detyrim të ruajë, sepse veprimi paraprak për plotësimin e një detyrimi, është detyrim. Nëse ai nuk vepron, për pasojë mizori e merr atë pasuri. Në këtë gjendje, ruajtësi garanton depozituesin për shkak shkujdesje e moskokëçarje nga ana e tij.

Kur është e mundur që mizori të kënaqet me një pjesë të sendit të lënë për ruajtje, si për shembull, me gjysmën, ruajtësi e ka detyrim t'ia japë atë pjesë mizorit, me qëllim që të ruajë pjesën tjetër. Nëse ruajtësi nuk i jep mizorit gjysmën që u tha, në këtë gjendje, ruajtësi garanton vetëm gjysmën dhe jo të gjithë depozitimin, sepse shkujdesja, në këtë gjendje, ka ndodhur vetëm mbi gjysmën në raport me gjysmën tjetër.

Në qoftë se mizori bindet që ruajtësi të betohet se filani nuk la lënë te ai asgjë për ruajtje, në këtë gjendje, ruajtësi e ka detyrim të betohet se depozituesi nuk ka lënë gjë te ai natën, kur në të vërtetë sendin e ka depozituar ditën, ose që ai s'ka lënë gjë te ai ditën, kur në të vërtetë e ka depozituar natën. Por nëse ruajtësi nuk betohet, ruajtësi është garantues, sepse, në këtë gjendje, gënjeshtër është e lejuar dhe nuk është veprim i ndaluar. Lejimi i rrenës në këtë gjendje është për të ruajtur sendin e lënë amanet dhe për të sprapsur padrejtësinë që kërkon të bëjë mizori. Është e kuptueshme që detyrimi rrëzohet kur është fjala për të mënjeluar një veprim haram.

Me fjalë të përgjithshme, ky është gjykimi i fukahave në lidhje me këtë çështje, ashtu siç ka ardhur në librin “El Xhevahir”, në librin “Miftahul Kerameh” e në libra të tjerë të fik’hut, në të cilat shpjegohet që lejimi për të gënjer duhet të kushtëzohet, kur

ruajtësi ka dijeni për lejimin e gënjeshtres në gjendje të këtilla, megjithëkëtë ruajtësi nuk betohet, por, duke mos u betuar, ai konsiderohet neglizhues. Nëse ai nuk betohet për gënjeshtren, ngaqë nuk e di që rrena është e lejueshme, në raste të tilla, për shkak se është i vendosur në besimin e vet që gënjeshtra është haram, për rrjedhojë mizori e merr pasurinë e lënë te ai. Në këtë gjendje ruajtësi nuk ka detyrim të garantojë asnjë send, sepse ai nuk kishte dijeni në lidhje me lejimin e gënjeshtres në këtë gjendje, prandaj ai nuk mund të konsiderohet neglizhues ndaj pasurisë së lënë te ai për ruajtje.

Shpenzimi për sendin e depozituar

Në rastet kur sendi i depozituar ka nevojë për shpenzime, ruajtësi e ka detyrim që për sendin e depozituar te ai të shpenzojë me rrugë të njohura, si masë paraprake për ruajtjen e atij sendi. Këto shpenzime i përballon pronari dhe, nëse ruajtësi lë mangët ndonjë gjë në këtë drejtim, ai është i detyruar të bëjë garantimin, për shkak të abuzimit me detyrimin.

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Fukahatë janë shprehur që ruajtësi duhet ta plotësojë këtë shpenzim, por është detyrim që shpenzimi që ai bën duhet të jetë me lejen e pronarit të sendit, ose të kujdestarit të tij dhe, nëse marrja e lejes prej pronarit është e pamundur, çështja i referohet gjykatësit dhe leja merret prej tij, por edhe nëse kjo është e pamundur, atëherë vetë ruajtësi shpenzon në prani të dëshmitarëve. Nëse është e pamundur të gjenden dëshmitarë, atëherë ruajtësi mjaftohet të shpenzojë, duke

pasur parasysh që shpenzimin e bërë e përballon pronari i sendit të lënë në ruajtje.

Nëse sendi i lënë në ruajtje është kafshë dhe pronari i saj i thotë ruajtësit: “Mos bëj asnjë shpenzim për kafshën.”, a është detyrim për ruajtësin të veprojë sipas fjalës së pronarit të kafshës? Nëse ruajtësi e shkel kushtin e vënë prej pronarit dhe shpenzon për kafshën që ka marrë në ruajtje, ky shpenzim, a do të përballohet prej pronarit të kafshës?

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në këtë rast, fjala e pronarit nuk dëgjohet, sepse kafsha, si gjallesë, kërkon ushqim dhe respektohet shpirti i saj, prandaj është detyrim që ajo të ruhet në të drejtën e Allahut që ajo ka për të jetuar, madje kjo e drejtë e kafshës nuk mund të hiqet për shkak se atë e heq njeriu, prandaj ruajtësi, në këtë gjendje, ka detyrim të shpenzojë për kafshën dhe shpenzimin e bërë ka të drejtë ta kërkojë prej pronarit të kafshës. Nëse ruajtësi nuk shpenzon për kafshën dhe për pasojë kafsha ngordh, ruajtësi është mëkatar, por nuk garanton asnjë send për humbjen e kafshës, sepse është vetë pronari ai që e rrëzoi garantimin, që kur e ndaloi ruajtësin të shpenzojë. Për rrjedhojë, pronari, në këtë gjendje, është si ai që e flak pasurinë e tij në det.”

Kthimi i sendit të marrë në ruajtje

Ruajtësi ka detyrim t’i kthejë pronarit sendin e lënë te ai në ruajtje, kur ai e kërkon. Allahu i Lartësuar, në Librin e Tij të nderuar, thotë:

“إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا”

“Allahu ju urdhëron t’i ktheni sendin e lënë amanet (në ruajtje në mirëbesim) atyre që u takon...” (Sure “En Nisa”, ajeti 58)

Në qoftë se ruajtësi e shtyn kthimin pa ndonjë pengim, ai numërohet rrëmbyes, sepse vënia dorë nga ana e ruajtësit mbi sendin e lënë në ruajtje te ai, është sulm mbi pasurinë e tjetrit dhe kërkon garantimin, pasi kontrata është prishur për shkak se s’ka leje dhe ruajtësi është i pakënaqur prej kërkesës së pronarit.

Le të supozojmë se depozituesi nuk është mysliman, për më tepër, nuk është shtetas i shtetit islam, pra, është prej atyre që lejojnë vënien dorë mbi pasurinë e tjetrit, përsëri sendi që ai ka lënë në ruajtje është detyrim t’i kthehet atij dhe në asnjë gjendje nuk lejohet që ai të tradhtohet, sepse dispozita për sendin e lënë amanet është e njëjta dispozitë si për të gjitha pasuritë e lejuara. Në lidhje me këtë çështje ka shumë transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahu qoftë mbi ta!*), ndër të cilat fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Në tri gjëra s’ka justifikim për asnjë njeri: kthimin e amanetit punëmirrit e mëkatarit; mbajtja e besës për të mirin e për mëkatarin dhe mirësjellja ndaj prindërve, të mirë apo mëkatarë qofshin ata.”

Ndër transmetimet kemi edhe rastin kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që e konsideron hallall vënien dorë mbi pasurinë e fisit emevi (benij umej’jeh), ashtu siç konsideron hallall edhe gjakun e tyre, por disa prej pjesëtarëve të këtij fisi kanë lënë sende në ruajtje të ai. A është hallall që ai të hajë sendet që ata kanë lënë në ruajtje te ai?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ktheni pasuritë e lëna për ruajtje te ju atyre që ua kanë lënë, edhe sikur ata të jenë adhures të zjarrit (mexhûs).”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse ai që më godet me shpatë, kur unë jam duke luftuar me atë, ka lënë një amanet te unë, ose më këshillon, ose kërkon këshillë prej meje, unë do ta pranoja këtë prej atij dhe do të kryeja amanetin e tij.”

Gjyshi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Ali bin Husejn Zejnul Abidijni (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Keni detyrim të dorëzoni amanetin. Beto hem për Atë që e dërgoi Muhamedin profet, sikur vrasësi i babait tim, Hysenit, të më linte amanet shpatën me të cilën ai vrau babain tim, patjetër që unë do t’ia ktheja atë.”

Këto janë dispozita ligjore dhe jo norma morale, janë veprime të detyrueshme të zbatohen dhe nuk janë prej veprimeve të lejuara, sepse në lidhje me amanetin, lënien në ruajtje në mirëbesim të një sendi, ka një dispozitë të veçantë.

Autori i librit “El Xhevahir”, në kapitullin “Sendi i lënë në ruajtje”, ka thënë: “Kthimi i sendit të lënë në ruajtje është detyrim, edhe sikur depozituesi të jetë mohues. Tekstet e ardhura sipas rregullit të përcjelljes së transmetimeve urdhërojnë kthimin e sendit të lënë në ruajtje te ai që e ka lënë, madje edhe sikur ai të jetë vrasësi i Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ose vrasësi i Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ose vrasës i fëmijëve të profetëve, ose ai është zjarradhurues, ose prej havarixhëve, të cilët i luftoi Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) për devijim që u munduan të fusin në punët e fesë. Fukahatë kanë punuar me këto tekste.”

Autori i librit “Miftahul Kerameh” ka thënë: “Kjo është fjala më e përhapur në mesin e fukahave dhe argument për këtë janë tekstet dhe sentencat (fetratë) përgjithësuese.

Çështje

1- Kur vjedhësi depoziton te një person sendin e vjedhur, ruajtësit nuk i lejohet t'ia kthejë atë vjedhësit, natyrisht kur është i siguruar se nuk dëmtohet, sepse sendi i vjedhur në dorën e ruajtësit është amanet ligjor. Në qoftë se ruajtësi e njëh pronarin e sendit të vjedhur që ra në dorën e tij, pa humbur kohë ia kthen atë pronarit, ose e njofton pronarin që ai send gjendet në dorën e tij. Në qoftë se ruajtësi nuk e njëh pronarin e sendit që i la vjedhësi për ruajtje, pret një vit dhe, nëse gjatë kësaj kohe nuk e gjen pronarin, atëherë sendin e lënë te ai në ruajtje e jep sadaka për pronarin e atij sendi, ose atë send e shet dhe shumën e realizuar e jep sadaka për pronarin e sendit. Në qoftë se pronari shfaqet pas dhënies sadaka të atij sendi, në këtë gjendje, pronari përzgjedh: ose miraton sadakanë e dhënë, ose kërkon kompensim prej sadakadhënësit. Në rast se ai kërkon kompensim, ruajtësi ka detyrim të kompensojë këtë pronar, por shpërblimi i sadakasë tani mbetet te ruajtësi.

2- Kur te ruajtësi fillojnë të shfaqen shenjat e vdekjes, është detyrim që ai t'i kthejë pronarit ose kujdestarit sendin e lënë te ai për ruajtje. Në rast pamundësie për t'ia kthyer pronarit ose kujdestarit, ia dorëzon atë send gjykatësit ligjor. Nëse edhe kjo e fundit është e pamundur, atëherë ai lë porosi për atë send në prani të dëshmitarëve.

3- Sej'jid Ebul Hasan El Asfehànij, në librin "El Uesijleh" thotë: "Sikur ruajtësi të ketë qëllim të veprojë me sendin e lënë te ai për ruajtje, por nuk vepron me atë send, në këtë rast, ai nuk garanton asnjë send, pavarësisht nga qëllimi që kishte. Por nëse ai ka qëllim rrëmbimin e atij sendi, me synim që ta marrë atë nën

zotërimin e vet dhe të mposhtë pronarin e atij sendi, në këtë gjendje, ai është si të gjithë rrëmbyesit, prandaj ai garanton sendin e lënë te ai për ruajtje dhe dora e tij u bë dorë agresore, pasi ishte dorë sigurie, madje edhe nëse ai heq dorë prej qëllimit, garantimi mbetet detyrim për atë.”

Në paragrafin e mësipërm, *së pari*, konstatohet dallimi mes qëllimit për të vepruar me pasurinë e tjetrit pa lejen e tij dhe mes qëllimit për ta rrëmbyer atë pasuri, por të dy qëllimet janë veprim kategorikisht i ndaluar (haram).

Së dyti, thjesht qëllimi për të vepruar, në pikëpamjen e traditës, nuk është as shkak për garantim e as nuk numërohet vënie dorë mbi pasurinë e lënë për ruajtje. Por shtrohet pyetja: Thjesht dyshimi për qëllimin e rrëmbimit, a e bën detyrim garantimin, apo dyshimi nuk është i mjaftueshëm për mohimin e qëllimit, ndërsa baza është mosekzistenca e atij qëllimi?

4- Kur ruajtësi vepron me sendin e lënë te ai për ruajtje në atë mënyrë që ai send nuk pëson asnjë ndryshim dhe pastaj atë send ai e kthen aty ku ishte dhe vazhdon ta ruajë, si për shembull, ai e vesh për pak kohë një rrobë të lënë te ai në ruajtje pa lejen e depozituesit, ose lexon disa faqe të një libri pa lejen e pronarit të librit, në këtë gjendje, ai del nga dispozita e ruajtësit dhe hyn në dispozitën e rrëmbyesit, përveçse kur ka njoftuar depozituesin dhe ai e ka miratuar veprimin e tij, madje ka ripërtërirë besueshmërinë për të lënë sendin të ai. Kriteri i shndërrimit të dorës nga dorë ruajtëse në dorë sulmuese, është kur veprohet konkretisht mbi sendin e lënë në ruajtje pa lejen e pronarit të sendit jo për interesat e atij sendi, kurse thjesht qëllimi, pa kryer asnjë veprim mbi atë send, nuk është asgjë.

Konflikti

Kur pronari i thotë ruajtësit: “Lashë te ti për ruajtje kaq.”, kurse ruajtësi e mohon duke i thënë: “Nuk ke lënë te unë asgjë për ruajtje.”, në këtë gjendje, pretenduesi ka detyrim të sjellë argument, kurse mohuesi betohet.

2- Kur ruajtësi e pohon se ka marrë sendin në ruajtje, por pretendon prishjen e sendit, shumica e fukahave më të dëgjuar mbështesin dëshminë e autorit të librit “El Xhevahir” dhe të autorit të librit “El Hadaik”, që thonë: “Merret në konsideratë fjala e ruajtësit, qoftë kur për prishjen pretendon një shkak të dukshëm, si për shembull, sendi u dogj nga zjarri, ose u përmyt nga ujërat, pasi për këto lloj shkaqesh është e mundur të sillët argument, qoftë kur ai pretendon ndonjë shkak të fshehtë, si për shembull, vjedhjen.”

Në nxjerrjen e këtyre dispozitave, fukahatë janë mbështetur në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ke të drejtë të akuzosh personin që i ke besuar, por mos i beso tradhtarit, të cilin e ke provuar.”

Si dhe në fjalën tjetër të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ty nuk të tradhton njeriu besnik, por ti i besove tradhtarit.”, domethënë, se nuk ke të drejtë të konsiderosh tradhtar atë që më parë e konsiderove njeri të besueshëm dhe, nëse ti e konsideron atë tradhtar, përgjegjësia bie vetëm mbi ty që i besove një tradhtari dhe e zgjodhe atë për të lënë pasurinë tënde në ruajtje të tij.

Shtrohet pyetja: A pranohet pa betim fjala e ruajtësit për prishjen e mallit, apo ai patjetër duhet të betohet?

Autori i libri “El Xhevahir” ka thënë: “Argumenti më i fuqishëm është që fjala e tij duhet të merret në konsideratë krahas betimit, ashtu siç thuhet në hadithin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Unë gjykoj mes jush me argumente dhe me betim.”

Sikur të merrej në konsideratë fjala e ruajtësit pa betimin, atëherë do të duhej që edhe gjykimi të bëhej pa argument e pa betim, por kjo mohon përmbajtjen e hadithit profetik.

Kur pronari e vërteton fjalën e ruajtësit për prishjen e sendit të lënë në ruajtje, por pretendon që ruajtësi ka vënë dorë mbi atë send, ose ka neglizhuar ruajtjen, në këtë gjendje, pronari ka detyrim të sjellë argument, kurse ruajtësi ka detyrim të betohet, sepse ai është besniku dhe besniku s’ka detyrim tjetër përveç betimit.

3- Fukahatë më të dëgjuar mbështesin dëshminë e autori të librit “El Xheuahir” dhe të librit “El Hadaik”, për rastin kur ruajtësi i thotë depozituesit: “Unë të kam kthyer sendin që më le për ruajtje.”, merret në konsideratë fjala e ruajtësit, krahas betimit të tij, sepse ai është personi të cilit iu besua ruajtja e sendit. Kur vdes depozituesi dhe trashëgimtari kërkon sendin e lënë në ruajtje, por ruajtësi i thotë atij: “Unë e kam kthyer sendin që kërkon.”, në këtë gjendje, nuk dëgjohet fjala e ruajtësit, përveçse kur ai sjell argument, sepse trashëgimtari nuk është personi që i ka besuar atij, prandaj nuk ka detyrim të vërtetojë fjalën e ruajtësit.

Në qoftë se ruajtësi, në marrëdhënien e tij me trashëgimtarin, nuk është besnik, origjina e gjykimit është moskthimi dhe gjykimi është i formës së prerë dhe asgjë nuk e

kundërshton, pasi gjykimi është në përputhje me fjalën e trashëgimtarit.

4- Kur ruajtësi e mohon që në fillim dhe thotë se ai nuk ka marrë ndonjë send në ruajtje, por, pasi depozituesi e vërteton me dokument që ka lënë pasuri te ai në ruajtje, domethënë, kur ruajtësi detyrohet të pranojë nga dokumenti që ai ka marrë prej depozituesit pasuri për ruajtje, në këtë gjendje, nuk pranohet prej ruajtësit as dokumenti që ai mund të sjellë e as betimi i tij, sepse mohimi i tij i parë, për mosmarrjen e sendit në ruajtje, është pohim që vërteton se ruajtësi ka vënë dorë mbi sendin e lënë te ai për ruajtje.

Gjithashtu, vërteton edhe tradhtinë e tij. Me këtë shpjegim gjejmë komentin e fjalës së autorit të librit “El Xheuahir”, i cili ka thënë: “Me mohimin e tij është arritur shkak i efektit të detyrimit të tij për garantimin, prandaj fjala e tij nuk dëgjohet, sepse vetë mohimi i tij është si pohim për garantimin që ai duhet të bëjë.”

5- Kur ruajtësi e pohon mallin, por pretendon se ai mall nuk është lënë te ai për ruajtje, ndërkah malli prishet, megjithëse ruajtësi as nuk ka vënë dorë mbi atë pasuri e as nuk ka qenë i shkujdesur, megjithëkëtë pronari i asaj pasurie thotë: “Jo, ti e more prej meje atë mall si kredi dhe jo për ta ruajtur, prandaj ti ke detyrim të mbash besën, edhe sikur malli të jetë prishur jo për shkak të vënies dorë mbi atë mall, e as për shkak se ti nuk je interesuar.”, në këtë gjendje, prej cilit kërkohet dokumenti?

Shumica e fukahave mbështesin dëshminë e autorit të librit “El Hadaik”, i cili thotë: “Merret në konsideratë fjala e pronarit,

krahas betimit të tij, kurse pretenduesi i sendit të lënë në ruajtje, sjell dokumentin.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për rastin kur një burrë i thotë një tjetri: “Ti ke detyrim të më kthesh një mijë dirhemë.”, kurse ai i thotë: “Jo, ajo shumë është lënë te unë për ruajtje.” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në këtë gjendje merret në konsideratë fjala e pronarit të mallit, krahas betimit që ai bën.”

Është pyetur nipi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), për një burrë i cili ka depozituar te një burrë tjetër një mijë dirhemë, por kjo shumë humbi, kurse burri tjetër, domethënë ruajtësi thotë: “Ajo shumë ishte te unë për ruajtje.”, kurse pronari i shumës thotë: “Jo, në të vërtetë, ajo shumë ishte te ti si kredi.” Kujt i takon malli? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Malli detyrimisht i takon pronarit, përveçse kur ruajtësi sjell dokument që ajo shumë ishte te ai në ruajtje.”

* * *

PARATHËNIE 7

KREDIA DHE BORXHI.....	5
Ndryshimi mes kredisë dhe borxhit.....	5
Borxhi është i urryer.....	6
Nijeti i shlyerjes.....	7
Shpërblimi për borxhdhënësin.....	8
Shkrimi i borxhit.....	8
Kontrata.....	9
Shpejtimi i shlyerjes së borxhit duke hequr një pjesë të tij.....	14
Kushtet.....	16
Kushti i përfitimit.....	16
Zgjatja e kohës, krahas fuqisë për shlyerjen.....	17
Forma e mbajtjes së besës.....	18
Nxitiimi në shlyerjen e borxhit.....	19
Mbajtja e besës për një pjesë të borxhit.....	19
Mbajtja e besës për shlyerjen e borxhit me shumë (dijeti) e marrë për vrasjen.....	20
Shlyerja e borxhit prej Shtëpisë së pasurisë.....	21
Të veçuarat për shlyerjen e borxhit.....	22
Borxhdhënësi nuk dihet ku është.....	23
Pjesëtimi i borxhit.....	25
Heqja e parasë nga qarkullimi.....	26
Vdekja nuk e prish afatin.....	26
Shlyerja e borxhit me këste (et tenxhijm).....	27
Kalimi i kohës	28
Shkëputja e borxhit (el mekàsah).....	29
PENGLËNIA.....	32

Ç' do të thotë penglënie?.....	32
Lejimi i penglënies.....	32
Kontrata.....	33
Marrja në dorë	34
Penglënia është absolute, e pakushtëzuar.....	37
Penglënia e kushtëzuar, pa afat kohor.....	38
Sendi i lënë peng.....	39
E drejta.....	41
Shtimi i borxhit.....	43
Sendi i lënë peng prishet shpejt.....	43
Kushtet për penglënësin dhe për pengpranuesin.....	44
Veprimi i penglënësit dhe i pengpranuesit.....	45
Pengpranuesi ka përparësi ndaj të gjithë borxhdhënësve.....	45
Prishja e sendit të lënë peng.....	46
Dobitë e dala prej sendit të lënë peng.....	48
Pamundësia e mbajtjes së besës, pa sendin e lënë peng.....	49
Shlyerja e një pjese të borxhit.....	52
Shpenzimi për sendin e lënë peng.....	53
Konflikti.....	55
GARANTIMI.....	60
Garantimi, transferimi i pasurisë dhe marrja përsipër e detyrimit të tjetrit.....	60
Ligjshmëria e garantimit.....	61
Garantimi e marrja përsipër e detyrimit të tjetrit, janë veprime të urryera.....	62
Kontrata.....	63
Garantuesi.....	66
I garantuari.....	67
I garantuari prej tij.....	69
E drejta e garantuar.....	70

Garantimi i pasurive	75
Garantimi i arritjes së çmimit të ndërtimit dhe i mbjelljes së tokës.....	77
Për të garantuarin s'ka rrugë të kërkojë prej të garantuarit prej tij.....	79
Garantuesi i kërkon të garantuarit prej tij.....	80
Disa garantues.....	82
Çështje.....	82
Konflikti.....	85
TRANSFERIMI I PASURISË.....	87
Transferuesi, personi për ku drejtohet transferimi.....	87
dhe personi mbi të cilin mbetet transferimi	87
Ligjshmëria e transferimit të pasurisë.....	87
Miratimi.....	88
Kushtet.....	91
Nevoja e transferimit dhe mospërgjegjësia e detyrimit për shlyerje nga ana e transferuesit.....	95
Transferim i njëpasnjëshëm.....	97
Transferim prej blerësit dhe shitësit.....	97
Konflikti.....	99
GARANCIA (el kefàleh).....	103
Ç'do të thotë garanci (kefàleh)?.....	103
Kushtet.....	104
Shpejtimi e vonimi (i shlyerjes së garancisë).....	108
Vendi i dorëzimit.....	109
Sjellja e personit për të cilin jepet garancia.....	109
Dorëzimi i garancisë.....	110
Dhënësi i garancisë i kërkon personit për të cilin ai dha garancinë.....	112
Lirimi i borxhmarrësit nga detyrimi.....	114

Garancitë e njëpasnjëshme.....	115
Dorëzimi nga ana e njërit prej dy garantuesve.....	115
Vdekja e garantuesit dhe e personit për të cilin jepet garancia....	116
Konflikti	117
PAJTIMI (es sulhu).....	119
Përkufizimi i fjalës “pajtim”	119
Ligjërimi i pajtimit.....	121
Paqja qëndron në vetvete.....	122
Kushtet.....	123
Mospasja dijeni për interesat që rrjedhin prej pajtimit.....	125
Pohimi e mohimi.....	126
Përzgjedhja.....	130
Pohimi në favor të njërit prej dy ortakëve.....	132
Pajtimi i imponuar me forcë.....	133
Çështja e dy dirhemëve	134
Ndërtimi jashtë murit.....	137
Degët dhe rrënjët e pemës.....	138
Ndërtimi i përbashkët.....	139
Konflikti për tavanin.....	140
Transferimi i pretendimit me pajtim.....	141
ORTAKËRIA.....	142
Ç’do të thotë ortakëri?.....	142
Llojet e ortakërisë.....	144
Pjesëtimi.....	145
Pjesëtimi i imponuar dhe me konsensus.....	146
Dispozitat e ortakërisë.....	148
Mbarimi i ortakërisë	150
Çështje.....	151
Konflikti.....	154
PJESËTIMI.....	155

Kuptimi i fjalës “pjesëtim”	155
Pjesëtimi i imponuar dhe pjesëtimi me konsensus.....	156
Pjesëtimi i adaptueshëm.....	157
Domosdoshmëria e pjesëtimit.....	158
Gabimi.....	160
Paralajmërim.....	161
E DREJTA PËR TË BLERË I PARI (esh shuf’atu).....	163
Kuptimi i konceptit “e drejta për të blerë i pari”	163
Ligjshmëria e bashkimit të pjesëve.....	164
Objekti	164
Partneriteti në sendet e përbashkëta.....	167
Ortakëria në vakëf.....	169
Bashkuesi.....	170
Personi që nuk është i pranishëm, i çmenduri, fëmija dhe mendjelehti:.....	174
Bashkimi i pjesëve me blerje, me përzgjedhje.....	176
Bashkuesi merr në pronësi, vetëm pasi paguan çmimin.....	178
Çmimi material dhe çmimi objekt.....	180
Favorizimi me çmimin.....	182
Shpenzime të tjera.....	184
Vonimi i çmimit.....	184
Menjëherë.....	185
VEPRIMET E BLERËSIT.....	187
Kompensimi e shkëmbimi ndërmjet shitësit e blerësit	188
Veprimi i blerësit me shitje, me lënie vakëf, me dhurim.....	189
Pakësimi i sendit objekt shitje në dorën e blerësit.....	191
Shtimi i sendit objekt shitje.....	193
Rritja e sendit objekt shitje.....	195

RRËZUESIT E BASHKIMIT TË PJESËVE NË ORTAKËRI, SHPËRNDARJA E BASHKIMIT TË PJESËVE NË ORTAKËRI DHE KONFLIKTI.....	197
Rrëzuesit.....	197
Trashëgimia e së drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri.....	202
Mënyra e pjesëtimit të së drejtës për bashkimin e pjesëve në ortakëri.....	204
Konflikti.....	205
SPEKULIMI.....	211
Ç'do të thotë spekulim?.....	211
Ligjshmëria e spekulimit.....	213
Spekulimi është i lejuar dhe jo i detyruar.....	213
Kushtet.....	214
Ç'kushte vënë pronari dhe puntori?.....	220
Kushti i përfitimit më shumë se pjesa.....	222
Kohëzgjatja e spekulimit.....	223
Kushti kur garantimi dhe humbja janë mbi punëtorin.....	224
Veprimet e punëtorit.....	225
Shpenzimi.....	226
Prishja e spekulimit.....	227
Garantimi i punëtorit.....	228
Çështje.....	229
Përfundimi i spekulimit.....	233
Pjesëtimi pas përfundimit të spekulimit.....	234
Konflikti.....	236
MARRËVESHJA PËR SHRYTËZIMIN E TOKËS (el muzàreah).....	240
Kuptimi i konceptit “marrëveshje për shfrytëzimin e tokës”	240
Ligjshmëria e marrëveshjes për shfrytëzimin e tokës.....	241
Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës është e detyrueshme.....	241
Kushtet.....	242

Fermeri kundërvajtës.....	247
Fermeri ka të drejtë të bëjë ortak një tjetër dhe të lërë atë të shfrytëzojë tokën.....	250
Taksa e tokës.....	253
Fara.....	255
Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës mes më shumë se dy vetëve.....	257
Çështje.....	258
Konflikti.....	260
MARRËVESHJA PËR DRUFRUTORËT (el musàkàt).....	264
Kuptimi i fjalës “marrëveshje për drufrutorët”	264
Ligjshmëria e marrëveshjes për drufrutorët.....	265
Kushtet.....	266
Marrëveshja për drufrutorët është e detyrueshme.....	269
Shkujdesja e punëtorit.....	269
Prishja e marrëveshjes për drufrutorët.....	271
Çështje.....	272
Konflikti.....	273
Marrëveshja për mbjelljen e pemëve.....	274
DEPOZITIMI (vënia në ruajtje)	277
Kuptimi i fjalës “depozitim”	277
Ligjshmëria e depozitimit.....	277
Kushtet.....	278
Kontrata e ruajtjes së pasurisë së depozituar është e lejueshme.....	282
Ruajtja e sendit të depozituar	283
Faktori që bën detyrim garantimin.....	284
Shpezimi për sendin e depozituar.....	286
Kthimi i sendit të marrë në ruajtje.....	287
Çështje.....	290
Konflikti.....	292

فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام

المؤلف: محمد جواد مغنية

الجزء السابع

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2018

اسم الكتاب: فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام - الجزء السابع

المؤلف: محمد جواد مغنية

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفی

المشرف العام: شيخ وُلُنْتُ مَرِيَا

التصحيح اللغوي: يريدا كولا

الاخراج و الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية "النسيم"

المطبعة: انتشارات "ليلو"

تيرانا: 2018